

HYRJE NË KRIMINALISTIKË



Dr.Goce Xhukleski Dr.Muhamet Racaj

Shkup 2012

Dr.Goce Xhukleski

Dr.Muhamet Racaj

Hyrje në kriminalistikë

Shkup, 2012

Ky botim „HYRJE NË KRIMINALISTIKË„është e recenzuar dhe e miratuar më vendimin nr.17-3748/3 më datën 28.12.2011 nga Këshilli arsimor-shkencor të Fakultetit për detektiv dhe siguri pranë Univerzitetit FON në Shkup, si libër mësimore për lëndën Hyrje në kriminalistikë,për mësim në gjuhën shqipe i cili është i përfaqësuar në programet mësimore ne Fakultein për detektiv dhe siguri.

DEKANI
Prof.D-r Aleksandar Donqev

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.Nuk lejohet ribotimi në asnjë lloj forme qoftë elektronike,mekanike apo në cilën do mënyrë tjetër,të njohur apo të panjohur duke përfshirë edhe fotokopjimin dhe xhirimin ose ndonjë lloj doponimi informativ apo sistem arkivi pa leje me shkrim nga autorët.

Recensentë:

Prof.Dr Aleksandar Donçev

Prof.Dr.Vladimir Pivovarov

Doc.Dr.Bashkim Selmani

Lektor:

Liri Lena

Ballina dhe editimi grafik:

Taulant Racaj(student ne Shkencat kompjuterike)

Shtypi:

Solaris print,Shkup

PËRMBAJTJA

Parathënie.....	10
KREU I	14
KUPTIMI I PËRGJITHËSHËM MBI KRIMINALISTIKËN	14
1. NOCIONI I KRIMINALISTIKËS	15
2. LËNDA DHE DETYRAT E KRIMINALISTIKËS	20
3. METODAT E KRIMINALISTIKËS.....	22
4. RELACIONET E KRIMINALISTIKËS ME SHKENCAT TJERA....	27
4.1. Kriminalistika në suaza të sistemit të shkencave penale.....	27
4.2. Relacioni i kriminalistikës me shkencat (jo penale) të tjera.....	33
5. ZHVILLIMI SHKENCOR I KRIMINALISTIKËS	35
5.1. Zhvillimi i kriminalistikës në Republikën e Maqedonisë	41
<i>Pyetje për studentët:</i>	43
KREU II.....	44
PARIMET THEMELORE TË KRIMINALISTIKËS	44
1. VËREJTJE HYRËSE.....	45
1.1. Parimi i ligjshmërisë.....	46
1.2. Parimi i së vërtetës	47
1.3. Parimi i kritikës dhe vetëkritikës.....	48
1.4. Parimi i shpejtësisë dhe i befasisë	52
1.5. Parimi i objektivitetit.....	55
1.6. Parimi i planifikimit metodik	56
1.7. Parimi i tentimit dhe parimi themelor	58
1.8. Parimi i lirisë teknike-taktike dhe parimi i proporcionalitetit	59
1.9. Parimi i udhëheqjes unike dhe i zbatimit të veprimtarisë kriminalistike	62
1.10. Parimi ekonomik në procedurë.....	63

Hyrje në kriminalistikë

1.11.	Parimi i ruajtjes së sekretit zyrtar	64
1.12.	Parimi i humanitetit	65
1.13.	Parimi i qasjes aktive kriminalistike dhe i zhvillimit konsekuent të parandalimit kriminalistik	67
1.14.	Parimi i bashkëpunimit ndërkombëtar policor	69
1.14.1.	<i>Interpoli</i>	70
1.14.2.	<i>Evropoli</i>	80
1.14.3.	<i>Format e bashkëpunimit regional kriminalistik</i>	82
1.14.4.	<i>Organizatat e specializuara ndërkombëtare</i>	83
1.14.5.	<i>Bashkëpunimi bilateral policor</i>	83
	<i>Pyetje për studentët gjatë provimit:</i>	86
	KREU III.....	87
	VEPRIMTARIA KRIMINALISTIKE-OPERATIVE	87
1.	LLOJET E HETIMEVE KRIMINALISTIKE.....	88
1.1.	Metoda dhe mjete të kontrollit kriminalistik.....	91
1.2.	Planet e kontrollit kriminalistik.....	91
1.3.	Mangësitë më të shpeshta në organizimin e kontrollit kriminalistik 93	
2.	PËRPUNIMI KRIMINALISTIK.....	95
2.1.	Organizimi dhe planifikimi i përpunimit kriminalistik	96
3.	VALORIZIMI DHE ANALIZA E HETIMIT KRIMINALISTIK.....	99
4.	ZHVILLIMI I HETIMEVE TË PËRBASHKËTA KRIMINALISTIKE 100	
4.1.	Hetimet të përbashkëta kriminalistike ndërsektorale	100
4.2	Hetimet të përbashkëta kriminalistike ndërkombëtare	102
5.	BASHKËPUNIMI SI METODË OPERUESE NË PUNËN POLICORE 104	
5.1.	Informatori	104
5.2.	Bashkëpunëtori	106
5.3.	Përkufizimi dhe karakteristikat e raportit të bashkëpunimit	108
6.	LIDHJA OPERATIVE	109
6.1.	Dallimet ndërmjet lidhjes operative dhe bashkëpunëtorit.....	110

7. RRJETI I BASHKËPUNËTORËVE	111
8. EVIDENCA E PËRPUNIMIT OPERATIV DHE E RRJETIT TË BASHKËPUNËTORËVE	116
8.1. Evidenca e përpunimit operativ.....	117
8.2. Evidenca e rrjetit të bashkëpunëtorëve.....	117
9. VËZHGUESIT E FSHEHTË POLICOR DHE OPERATORËT E FSHEHTË	118
Pyetje për studentët:	122
KREU IV	123
MËNYRAT E KUPTIMIT (NJOFTIMIT) TË PËRGATITJES OSE EGZISTIMIT TË VEPRAVE PENALE	123
1. SHËNIME TË PËRGJITHSHME	124
2. VEPRIMTARIA KRIMINALISTIKE-INFORMATIVE.....	126
3. FLETPARAQITJE E PJESËTARIT TË STRUKTURAVE TË SIGURISË.....	127
4. FLETPARAQITJA E INSPEKSIOENEVE, E SHËRBIMEVE TË REVIZORIT DHE TË SUBJEKTEVE EKONOMIKE	128
5. FLETPARAQITJE TË TË DËMTUARIT OSE E DËSHMITARËVE TJERË.....	132
6. DENONCIME ANONIME DHE ME PSEUDONIM	134
7. THASHETHEMET (BISEDA PUBLIKE).....	136
8. VETËPARAQITJA (DORËZIMI) E KRYERËSIT TË VEPRËS PENALE	137
9. MEDIUMET SI MËNYRË PËR TË KUPTUAR PËR VEPRËN PENALE	140
10. KURTHET KRIMINALISTIKE SI MJET PËR ZBULIMIN E VEPRËS PENALE DHE TË KRYERËSIT	142
11. “AKTI I FRESKËT”	144
Pyetje për studentët:	146
KREU V	147
PLANIFIKIMI I VEPRIMTARIVE KRIMINALISTIKE	147
1. NOCIONI, PARIMET DHE QËLLIMET E PLANIFIKIMIT	148

2. ANALIZA E GJENDJES FAKTIKE DHE PYETJET E ARTA KRIMINALISTIKE	150
2.1. Pyetjet e arta të kriminalistikës	150
3. PËRMBAJTJA E PLANIFIKIMIT	161
3.1. Definicioni i nocionit version.....	161
3.2. Nocioni i versionit kriminalistik	162
3.3. Verifikimi i versioneve kriminalistike	164
3.4. Klasifikimi i versioneve kriminalistike	166
4. MUNDËSITË E REJA TË RRRITJES SË CILËSISË SË PLANIFIKIMIT TË PROCEDURËS PARAHETIMORE DHE PENALE.	168
4.1. PROFILIMI I PERSONALITETIT TË KRYERËSIT TË VEPRËS PENALE	169
4.1.1. Nocioni i profilizimit	169
4.1.2. Analiza e gjendjes faktike dhe procedura e profilimit	173
4.1.3. Llojet themelore të profilimit.....	179
4.1.4. Zbatimi i profilizimit.....	184
4.1.5.Përkrahja kompjuterike e profilizimit: sistemi viklas	186
4.1.6.Profilizimi gjeografik.....	188
4.1.5. Profilizimi gjeografik me zbatimin e sistemit informativ gjeografik	195
4.2. MENDIME KRIMINALISTIKE	198
4.3. ZBATIMI I PARASHIKIMIT GJATË VEPRIMIT SISTEMATIK DHE TË PLANIFIKUAR TË POLICISË	201
5. PARASHIKIMI I KRIMINALITETIT	205
<i>Pyetje për studentët:</i>	208
KREU VI	210
INDICJET DHE METODAT INDIKATIVE GJATË ZBULIMIT DHE ARGUMENTIMIT TE KRIMIT	210
1. NOCIONI, BURIMET DHE LLOJET E INDICJEVE	211
2. METODAT E TË DËSHMUARIT TË TËRTHORTË	225
2.1. Metodatat e eliminimit gjatë zbulimit të akteve penale të veçanta .	226

2.2. Metoda e shfrytëzimit të kryerësve të regjistruar të akteve penale sipas mënyrës së kryerjes – MOS	228
2.3. Metoda e përpilimit të listës të indicjeve për shumë vepra penale dhe për shumë persona.....	231
2.4. Metoda e vërtetimit të neto-vlerës.....	233
3. MËSIMI KRIMINALISTIK MBI TË DHËNA	237
2.2. Zhvillimi, nocioni dhe llojet e informacionit krimnalistik.....	237
3.2. Faktet (të dhënat) dhe vërtetimi i tyre	240
3.3. Ndarja e fakteve të rëndësishme për kriminalistikën	242
Pyetje për studentët:	244
KREU VII	246
RROLI I RI I POLICISË NË BASHKËSINË LOKALE	246
1. SHËNIME TË PËRGJITHSHME	247
2. PERSONELI	252
3. SHOQËRIA	253
4. MENAXHIMI DHE STRUKTURA E FORCAVE POLICORE	255
5. STËRVITJET	256
6. POLICIA NË BASHKËSIONË LOKALE, SI FORMË E RE E DEMOKRATIZIMIT TË FUNKSIONIT TË POLICISË	258
Pyetje për studentët:	264
Literatura.....	265

Parathënie

Punimi “*Hyrje në kriminalistikë*” i profesorëve dr. Goce Xhukleski dhe dr. Muhamet Racaj e kuptoi, nga njëra anë, si një vepër të vlefshme në lëmin e kriminalistikës, ndërsa nga ana tjetër, si shprehje e guximit të autorëve që kanë vendosur të hulumtojnë dhe të formësojnë një vepër të një fushe jashtëzakonisht të ndërlikuar shkencore.

Në fakultetin për detektiv dhe sigurisë në Shkup Kriminalistika, sipas vëllimit të përmbajtjeve të planeve dhe programeve mësimore dhe të zhvillimit të disiplinave mësimore, ka statusin e një nga shkencat themelore nëpërmjet së cilës *profilizohen kuadro* të cilët arsimohen për zgjidhjen e dukurive të ndërlikuara kriminalistike në baza shkencore, ndërsa nëpërmjet saj, inspektorët e ardhshëm fitojnë *profesionin e kriminalistit*.

Në Republikën e Maqedonisë, në punën praktike profesionale të shërbimeve të sigurimit, kriminalistika ka një traditë të gjatë. Që pas Luftës së dytë botërore pothuajse në të gjitha format e arsimit nëpërmjet të cilave janë shkolluar kuadrot policore, kriminalistika studiohej, më së tepërmi nëpërmjet analizës së zhvillimeve kriminalistike të veprave penale të bëra në hapësirën maqedonase. Kriminalistika ishte parashikuar në të gjitha planet dhe programet mësimore si lëndë themelore, nëpërmjet së cilës ndërtohej struktura e inspektorëve. Mile Kovaçeski, jurist i diplomuar, tërë jetën e vet punuese e ka kaluar duke ligjëruar kriminalistikë në seminare, kurse për policë, për komandantë, për inspektorë dhe më vonë në Shkollën e mesme të punëve të brendshme. Kriminalistikë ka ligjëruar edhe juristi i diplomuar Radivoje Jovanoski.

Në vitin 1957, në Ministrinë e punëve të brendshme u punësuan rreth 40 veta me arsim të mesëm nga të gjitha drejtimet

(gjimnazi, normalja, shkolla ekonomike e të tjera). Me ta gjithashtu u organizua një kurs tremujor për inspektorë.

Deri në formimin e Shkollës së mesme të punëve të brendshme në vitin 1971/72, tanimë në Ministrinë e punëve të brendshme (MPB) ishte formuar *Muzeu kriminalistik* të cilën e drejtonte Vlastimir Maxharoski, një entuziast i njohur dhe ihtar i ruajtjes së gjurmëve të rasteve me karakteristike kriminogjene (provat e akteve, për kryerësit dhe për mënyrat e zbardhjes së tyre). U pasuruan me pajisje bashkëkohore dhe me teknikë por edhe u standardizua Sektori i teknikës kriminalistike. Në periudhën prej vitit 1967 deri në vitin 1970 ky sektor në RSFJ të atëhershme u afirmua si njëri nga më të mirët në lëmin e teknikës kriminalistike. Në vitin 1977 u formua Fakulteti i sigorisë, Anton Rop, ndërsa në Fakultetin e mjekësisë u standardizua dhe u zhvillua Instituti i mjekësisë gjyqësore, i cili pati një rrol të madh në zgjidhjen e delikteve të gjakut.

Me formimin e Qendrës për arsimim të kuadrove të sigorisë dhe të vetëmbrojtjes shoqërore në vitin 1977, në kuadër të të cilit organizoheshin të gjitha nivelet e arsimit (arsimim permanent për kuadrot ekzistuese të punëve të brendshme, Shkolla e mesme katërvjeçare policore dhe Fakulteti i sigorisë), kriminalistika u standardizua së pari si lëndë mësimore, ndërsa pastaj edhe si disiplinë shkencore.

Me formimin e studimeve posdiplomike për kriminalistikë kjo disiplinë shkencore u ngrit si shkencë me vete, kështu që u mundësua që të dalin një numër i madh magjistrash dhe doktorësh të shkencave në lëmin e kriminalistikës. Ata merrnin pjesë edhe në zhvillimin e mësimin në kriminalistikë në arsimin superior.

Deri tani janë botuar një numër i madh i punimeve shkencore profesionale, monografi dhe tekste shkollore nga lëmi i kriminalistikës.

Mund të themi lirisht se kriminalistika gradualisht po standardizohet si teori dhe si praktikë që ndihmon në përmirësimin e kushteve për luftë kundër kriminalitetit në hapësirën maqedonase, e cila ka tipare specifike të cilat determinohen nga kushtet e veçanta të jetës. Karakteristikat specifike të veçanta për sqarimin, hetimin, zbulimin, dokumentimin dhe dënimin në hapësirën maqedonase u verifikuan dhe u afirmuan nëpërmjet shkencës së kriminalistikës dhe nëpërmjet praktikës së drejtpërdrejtë.

Punimi i dr. Muhamet Racajt dhe dr. Goce Xhukleskit *Hyrje në kriminalistikë* paraqet një kontribut të çmuar në kultivimin e mendimit kriminalistik në Maqedoni. Ai në radhë të parë u dedikohet studentëve të Fakultetit të sigurisë, por do t'u shërbejë edhe praktikantëve të cilët punojnë drejtpërdrejtë në organet e sigurisë.

Autorët gjatë përpunimit të punës i kanë shfrytëzuar njohuritë e deritashme në lëmin e kriminalistikës në Maqedoni, duke shfrytëzuar edhe burime të huaja me çka punimi merr tipare të universalizmit dhe aktualitetit në suaza më të gjera.

Karakteristikë tjetër pozitive e punimit është se autorët me sukses kanë përfshirë elemente të përvojës personale . Ky punim, parë nga aspekti i zhvillimit të kriminalistikës në Maqedoni, paraqet një kontribut edhe për kultivimin e vazhdimësisë së mendimit teorik të këtij lëmi, ndërsa ky do të shërbejë edhe në praktikë për pengim të suksesshëm të kriminalitetit në baza shkencore.

Unë shpresoj dhe pres që në Fakultetin e sigurisë në Shkup të formohet një bërthamë kadrovike cilësore profesorësh, hulumtuesish, asistentësh, të cilët do të paraqesin ekipin themelor dhe më të rëndësishëm shkencor profesional në lëmin e kriminalistikës, jo vetëm në Maqedoni por edhe më gjerë.

Sipas konceptit për profilizimin e kuadrit të cilët janë arsimuar dhe edukuar Fakulteti i sigurisë në Shkup shkon drejt rrugës që shpie drejt standardizimit të plotë evropian, që do t'i siguronte funksionim si institucion bashkëkohor edukativ dhe hulumtues. Ajo, kërkon krijimtari e cila do të shkonte në linjë të përpjetme.

Prof.dr. Jordan Spaseski

KREU I

KUPTIMI I PËRGJITHËSHËM MBI KRIMINALISTIKËN

1. NOCIONI I KRIMINALISTIKËS

Kriminalistika te ne, rëndom kuptohet si shkencë e cila i studion, i hulumton dhe i përmirëson metodat, mjetet shkencore të mbështetura në përvojat praktike, të cilat janë më të përshtatshme për të zbuluar dhe për të zbardhur veprat penale, të gjejë dhe të nxjerrë para sanksioneve penale kryerësin e tyre, të sigurohen dhe të fiksohen të gjitha provat për të përcaktuar të vërtetën objektive si dhe të pengohet kryerja e veprave penale të ardhshme të planifikuara dhe të paplanifikuara. Me fjalë të tjera kjo është shkenca mbi teknikën, taktikën dhe metodikën rreth masave hulumtuese gjyqësore e të tjera, si dhe për pengimin e kriminalitetit.¹

Kriminalistika studion veprimtarinë e përgjithshme represive dhe preventive, e cila ka për qëllim mënjanimin e kriminalitetit.

Kriminalistika preventive ka karakter të pavarur dhe ndihmës. Ajo i përsos metodat dhe mjetet ekzistuese dhe hulumton të reja për preventivën kriminalistike. Për shembull, format më të rëndësishme të falsifikimit të parave dhe të dokumenteve, llojet e kurtheve² etj. Ka karakter ndihmës, nëse politikës kriminale dhe sociale i vë në dukje potencialet e masave të profilizuara.

¹ Shih, V. Vodineliq: Kriminalistika, të gjitha botimet. Këtë përkufizim kriminalistët e ish shtetit jugosllav e kishin përkrahur në tërësi. Shih edhe tek B. Simonoviq, Kriminalistika, Kragujevac, 2004,3

² Kurthi paraqet masën e fshehtë operative taktike, që përbëhet nga mashtrimi i kryerësit i cili përpiqet të bëjë vepra penale në të njëjtën mënyrë, me qëllim që kryerësi i këtyre të kapet në flagrancë ose menjëherë pas kryerjes së veprës penale.

Gjithashtu, një varg i tërësishëm i plotë i masave operative-taktike dhe të veprimeve hetimore kanë karakter represiv-preventiv (pritat, racionet, patrullimet, arrestimet etj).

Kriminalistika represive më ngushtë është e lidhur me shkencën e procedurës penale. Ajo i studion veprimet e të gjithë pjesëmarrësve në procedurën penale dhe në të gjitha fazat e saj. Është e domosdoshme që kriminalistika të përdoret në mënyrë permanente dhe të gjerë edhe në procesin kryesor, dhe jo vetëm në atë para hetuese (parapenale) dhe në hetim.

Këshilli gjyqësor gjatë mbarështimit dhe vlerësimit të provave duhet të shqyrtojë metodat dhe mjetet, të cilat i ka përdorur prokurori publik gjatë mbledhjes së tyre dhe gjatë formësimit të tyre, të përcaktojë anën e vlefshmërisë së tyre për argumentimin e fakteve kontestuese.

Verifikimi i rezultateve të hetimit është kryer në mënyrë profesionale vetëm nëse më këtë rast janë përdorur metoda dhe mjete adekuate kriminalistike. Gjithashtu, këshilli gjyqësor e përdor taktikën gjyqësore, e planifikon shqyrtimin kryesor, rregullisht operon me versionet, i dëgjon dëshmitarët, ekspertët, e pyet të akuzuarin, bënë njohjen dhe ballafaqimin, e bënë kontrollin provave reale etj. Avokati mbrojtës dhe prokurori publik, duke mbështetur secili versionin e vet të tentimeve për vlerësim, zbatojnë njohuritë, të dhënat, mjetet dhe metodat kriminalistike. Njohja dhe zbatimi i kriminalistikës në seancën gjyqësore kryesore japin mundësinë reale për përcaktimin e së vërtetës.

Teknika kriminalistike i studion, i zhvillon dhe nga shkencat teknike dhe natyrore i merr mjetet më të përshtatshme të cilat shërbejnë për të gjetur, siguruar, fiksuar dhe hetuar gjurmët e veprave kriminale (për shembull: mikroskopët, teknikat e fotografive etj.); për të formuar një bazë të informatave

kriminalistike (për aktorët e veprave kriminalistike, për mjetet e kryerjes së aktit), si dhe për pengimin e ekzekutimit dhe të parandalimit të veprave penale (sistemet e alarmit, kamerat për video mbikëqyrje e të tjera). Me metodat, në drejtim të gjetjes, fokusimit dhe hetimit të gjurmëve materiale të veprave penale, merret traseologjia kriminalistike. Traseologjia kriminalistike parqet disiplinën kriminalistike e cila fut në përdorim të arriturat teknike në lëmin e procedurës para hetuese dhe penale dhe paraqet një ndërlidhje ndërmjet teknologjive bashkëkohore dhe qasjes kriminalistike ndaj gjurmëve.

Teknika kriminalistike me format e paraqitjes së veprave penale, me motivet, qëllimet (teknika dhe taktika kriminale, delikumente); me njohuritë profesionale, aftësitë, zakonet, mënyrën e jetesës dhe psikologjinë e aktorëve të veprave penale (fenomenologjia kriminalistike); i përsos të gjitha ato metoda, të cilat shërbejnë për të zbuluar dhe për të zbardhur veprat penale të kryera dhe për të parandaluar të ardhshmet, të cilat nuk janë të natyrës teknike dh në mënyrë organike i lidhë mënyrat teknike dhe taktike të punës.

Metodika kriminalistike është disiplinë e kriminalistikës. Gjersa taktika kriminalistike i studion dhe i përpunon rregullat themelore dhe metodat punuese tipike për zbulimin, hulumtimin dhe për zbardhjen e të gjitha llojeve të veprave penale (domethënë metodat e përgjithshme dhe të përbashkëta), metodika kriminalistike i hulumton dhe i studion veçoritë (specifikat). Pra atë që është e rëndësishme për zbulimin, hulumtimin dhe zbardhjen e një lloji të caktuar të veprës penale. Taktika kriminalistike e studion parimet themelore për të bërë evidencimin, ndërsa metodika kriminalistike merret me sendet e evidencuara dhe me zbatimin e mjeteve dhe aparaturës teknike te llojet e veçanta të veprave penale. Për shembull, specifikat dhe

rregullat gjatë bërjes së evidencimit të deliktet penale, të deliktet e trafikut të komunikacionit³, të krimi ekologjik⁴ etj.

Ose, për shembull, taktika kriminalistike i studion rekomandimet e përgjithshme të cilat kanë të bëjnë me marrjen në pyetje të aktorit të dyshuar, ndërsa metodika kriminalistike i studion specifikat gjatë zhvillimit të dëgjimit të aktorit të dyshuar tek veprat penale të veçanta.

Në teorinë dhe praktikën e huaja tani më janë paraqitur tendenca të reja për nocionin e kriminalistikës ku futet edhe pjesa e katërt, që përfshinë strategjinë kriminalistike.⁵ Autori i këtij dorëshkrimi tërësisht i përkrah këto tendenca bashkëkohore. Aq më tepër kur koncepti klasik i kriminalistikës, i cili mbështetet në taktikën, teknikën dhe metodikën kriminalistike është orientuar rreth veprës penale individuale (tanimë një herë të kryer) dhe hulumton si fenomen të izoluar (metoda të sigurimit të gjurmëve, organizime të ndjekjeve të kryerësit, vënia në proces kriminalistik të tij etj.), por nuk i studion metodat kriminalistike për t'iu kundërvënë kriminalitetit si dukuri, në tërësi. Kriminaliteti gjithnjë në rritje kërkon një qasje krejtësisht tjetër kriminalistike.⁶ Në fakt, nga kriminalistika pritet që jo vetëm të përsosë metodat për zbulimin e veprave penale të veçanta tani më të kryera, por të mënjanojë kriminalitetin si dukuri. Veprimtaria kriminalistike, që paraqitet si reaksion i veprës penale të kryer, paraqet konceptin reaktiv për t'iu kundërvënë kriminalitetit, mbështetet në

³ Shih për më tepër tek B. Murgoski, *Policia dhe siguria në trafik*, disertacioni doktorati, Fakulteti I sigurisë, 2003.

⁴ Shih për më tepër tek M. Malish- Sazdovska, *Policia kriminalistike dhe krimi ekologjik*, Shkup, 2005 – faqe 87-90.

⁵ Shih më tepër tek Rblokov/Golovin: *Sistema kriminalistiki, nastupil li ev krznie?*

⁶ Për fenomenin e krimit të organizuar shih më shumë në librin me titull *Krimi I organizuar*, Shkup, 2005 nga autori V. Kambovski; në librin të titulluar “Kriminaliteti I organizuar transnacional”, Beograd, 2003 nga autori M. Boshković si dhe në librin e titulluar “Makedonia- simbol i sigurisë dhe i paqes në Ballkan”, të autorit J. Spaseski, Shkup, 2005.

aktivitetin pas deliktit, dhe në këtë mënyrë është i vonuar dhe ka orientim represiv. Koncepti klasik i reagimit klasik kriminalistik nuk mundi ta bëjë operative idenë për nevojën e zhvillimit të preventivës kriminalistike. Dobësitë e përmendura janë evidente gatë viteve të tetëdhjeta dhe nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, si dhe paaftësia për të gjetur përgjigje efektive rreth rritjes së krimit të organizuar dhe të terrorizmit ndërkombëtar. Nga ana tjetër, zhvillimi i teknologjisë kompjuteristike, mundësia për të krijuar baza të mëdha të të dhënave etj., kanë ndihmuar që të krijohen ide për strategjinë kriminalistike, përkatësisht policore, në radhë të parë, në: SHBA, Kanada, Gjermani, Britani të Madhe.

2. LËNDA DHE DETYRAT E KRIMINALISTIKËS

Objekti i kriminalistikës. Që në fillim të këtij kreu, duhet thënë se të gjitha shkencat penale i lidh i njëjti objekt i përgjithshëm i hulumtimit shkencor, dhe ky është *kriminaliteti*. Ky objekt i hulumtimit shkencor i vë ato në të njëjtin grup, përkatësisht në familjen e shkencave kriminalistike. Çdo shkencë penale përpiket, në kuadër të objektit të saj të përgjithshëm të hulumtimit (kriminaliteti), të përcaktojë ligje objektive dhe ligjshmëri të cilët e përbëjnë objektin e interesimit të tyre.

Kështu, kriminalistika i hulumton ligjshmëritë e rëndësishme për zbulimin dhe dëshmimin e veprave penale dhe të kryerësve të tyre, si dhe parandalimin, duke zbatuar metodat kriminalistike.

Nëse e marrim parasysh atë që u tha më lartë, atëherë objekti i kriminalistikës do të përfshinte këto elemente:

- T'i zbulojë, hulumtojë, studiojë dhe t'i shpjegojë ligjshmëritë gjatë paraqitjes, grumbullimit (fiksimit) hetimit dhe shfrytëzimit të informacioneve operative dhe argumentuese të përfshira në manifestime të ndryshme kriminalistike që çojnë në dyshime se ekziston vepër penale.
- Të studiojë, të analizojë dhe të konstatojë praktikën delikuede (taktikën dhe teknikën e kryerjes dhe të fshehjes së veprës penale), me qëllim të ballafaqimit me ligjshmëritë të përgjithshme ose tipike (metodika kriminalistike);
- Të studiojë praktikën operative, hetimore dhe gjyqësore. Kriminalistika nuk e hulumton anën juridike (procesin) të praktikës, sepse kjo hynë në lëndën e së drejtës penale të

procesit. Ajo e studion përmbajtjen, anën e njohur të praktikës së tillë: dhe

- Të studiojë masat taktike kriminalistike-strategjike, parandaluese dhe mjetet teknike në praktikë (sistemet e alarmit, kurthet kimike etj).

Në lëndën e kriminalistikës bie edhe përcaktimi i ligjshmërive- lidhjet reciproke dhe veprimet e ndërsjella të objekteve materiale, si dhe veprimi fizik i njerëzve.

Detyrat e kriminalistikës. Për të njohur natyrën dhe esencën e kriminalistikës domosdo është e nevojshme të përcaktohen edhe detyrat e saj. Kriminalistika është e lidhur ngushtë me praktikën dhe i shërben asaj. Ajo ka për detyrë t'i përsosë metodat ekzistuese dhe të gjejë metoda të reja dhe mjete teknike me qëllim që ato të zbatohen në praktikë gjatë procedurës para hetimore dhe penale. Gjithashtu ajo e studion praktikën që të vë në dukje vështirësitë dhe mangësitë e saj me të cilat ballafaqohet dhe të gjejë zgjidhje për mënjanimin e tyre. Ndërmjet shkencës së kriminalistikës dhe zbatimit të saj në praktikë duhet të ekzistojë një varshmëri e ndërsjellë shumë e ngushtë. Nuk do të ishte aspak pa pasoja fatale për legjislacionin dhe për shkencën juridike nëse praktikantët mbeshnin të pa aftë shkencërisht, ndërsa teorikët shkencor pa praktikë.

Kriminalistika ka tre funksione themelore, përkatësisht detyra. Së pari është *njohuria* (gnoseologjia), se dyti *aspekti konstruktiv* (përpunimi i metodave të reja shkencore, mjetet shkencore teknike dhe për veprimet hetimore të nëpunësve operativ dhe të prokurorëve publik, si dhe veprimtaria kriminalistike e ekspertizës), dhe së treti *funkcioni komunikues* (aftësimi profesional i shërbimeve kriminalistike-policore). Në këtë aspekt flasim për kriminalistikën teorike dhe praktike.

3. METODAT E KRIMINALISTIKËS

Nocioni metodë rrjedhë nga fjala greke *methodos* që do të thotë : rrugë, kërkesë etj. Bëhet fjalë për mënyrën e hetimit, mënyrën e zbulimit të së vërtetës etj. Sipas kësaj, në metodologji si shkencë për metodat mund të thuhet se metoda është një procedurë e planifikuar që zbatohet për të arritur një detyrë të caktuar ose për të arritur njohuri sa më të mëdha.

Metodat në kriminalistikë paraqesin mënyrat shkencërisht të bazuara për të njohur, hetuar dhe për manipulim me objektet e trajtimit kriminalistik.

“Kriminalistika, ashtu si çdo shkencë tjetër, për realizimin e qëllimeve të veta hulumtuese shkencore teorike zbaton dhe shfrytëzon metoda përkatëse shkencore, të cilat e përbëjnë bazën e metodologjisë kriminalistike si kornizë përkatëse teorike për trajtim shkencor kriminalistik”, . Ato janë të lidhura ngushte dhe me kushtëzimin e ndërsjellë me objektin e hulumtimit. Objekti i trajtimit kriminalistik i përfshin zhvillimet kriminalistike, në kuadër të cilit duhet të zbulohen, të sqarohen dhe të argumentohen veprat penale dhe kryerësit e tyre.

Metodat në kriminalistikë ndahen në ato që hyjnë në sferën e shkencave natyrore dhe teknike, dhe në ato të cilat nga natyra e tyre paraqesin trajtime të shkencave shoqërore (humanitare). Si për shembull, trajtimet psikologjike, njohuritë e logjikës ose të organizimit të punës, ndërsa shfrytëzohen për nevojat e taktikës, metodikës dhe strategjisë kriminalistike e të tjera.

Duhet të bëhet dallim ndërmjet metodave që i zbaton shkenca e kriminalistikës, që shërbejnë për trajtimin e ligjshmërive objektive në kudër të objektit të studimit të saj shkencor, dhe të metodave të cilat shfrytëzohen në praktikën

kriminalistike për të zgjidhur raste konkrete kriminalistike. Shpesh herë, metodat e këtilla mund të jenë të njëjta për nga titulli (eksperiment, analogjitë, analiza etj), ndërsa dallohen për nga qëllimet, sipas mënyrës së përdorimit dhe sipas subjektit që i shfrytëzon. Por, ndërmjet tyre ekziston edhe një lidhshmëri e ngushtë.

Metodat që përdoren në kriminalistikë ndahen në:

- a) metoda të cilat janë formuar në shkenca të tjera dhe*
- b) metoda burimore kriminalistike.*

Kur bëhet fjalë për të parat mund të thuhet se është i madh numri i shkencave nga të cilat i merr dhe i shfrytëzon kriminalistika gjatë realizimit të detyrave të veta. Kështu, kriminalistika shfrytëzon të ashtuquajturat metoda të përgjithshme (universale) të cilat përdoren në të gjitha shkencat. Në këtë drejtim, kriminalistika i përdor metodat logjike (analizën, sintezën, induksionin, deduksionin, analogjinë, studimin e hipotezave, abstraksionin). Këto metoda kriminalistika nuk i shfrytëzon në mënyrë mekanike, por i përshtat për nevojat e veta. Për shembull, studimet rreth versioneve kriminalistike mbështeten në bazë të hipotezave shkencore. Shkenca e kriminalistikës i shfrytëzon edhe metodat e përgjithshme shkencore (metodat e vërejtjes, matjes, të përshkrimit, të eksperimentimit etj). Edhe këto metoda hasen pothuajse në çdo shkencë, por zbatimi i tyre në kriminalistikë është krejtësisht ndryshe dhe i përshtaten objektit të kësaj shkençe. Vëzhgimi, matja, përshkrimi etj., janë metoda pa të cilat nuk mund të paramendohet kryerja e observimit (inspektim)⁷. Në të njëjtën kategori bien edhe metodat e ndryshme matematikore,

⁷ Nën termin inspektim nënkuptohet aktiviteti hetues, përkatësisht gjyqësor, përmbajtja e të cilit lidhet drejtpërdrejtë, të vërejtur shqisor, verifikim dhe sqarim i rrethanave dhe fakteve të veçanta, që janë me rëndësi për procedurën në rastë të veçanta penale. Sipas LPP, si verpim i plotë, inspektimi ndërmerret kur për shkaqe verifikimi dhe sqarimi të ndonjë fakti të rëndësishëm në procedure nevojitet vëzhgim i dretjtpërdrejtë.

statistikore dhe kibernetike. Disa nga këto metoda përdoren në formë të pandryshueshme në kriminalistikë (statistikore, kompjuterike) ndërsa disa, kriminalistika i modifikon në mënyrë qenësore dhe i përshtat për nevojat e veta (metoda e modelimit kriminalistik shfrytëzohet për të formuar metodën e modelimit kriminalistik i cili mund të jetë; ideor, rikonstruktiv, maket dhe kompjuterik.⁸

Përveç këtyre metodave të përmendura, kriminalistika i fut në përdorim edhe metodat e ashtuquajtura të veçanta (karakteristike për shkenca të ngjashme) dhe metodat speciale (të cilat formohen në shkenca të caktuara ose në një degë të saj të veçantë).

Kriminalistika i fut në përdorim edhe metodat e shkencave humanitare (psikologjinë, sociologjinë), dhe të shkencave natyrore teknike (fizikën, kiminë), por një gjë të këtillë nuk e bënë në mënyrë mekanike. Për shembull, taktika kriminalistike në masë të madhe i shfrytëzon njohuritë e psikologjisë, por intervista psikologjike nuk mund të zbatohet tërësisht gjatë zhvillimit të bisedës informative (jo formale) me të dyshuar dhe gjatë dëgjimit të akuzuarit, prandaj për këtë kriminalistika detyrohet të ndërtojë

⁸ Modeli mundëson njohjen e drejtpërdrejtë të dukurive, proceseve dhe objekteve (ose vetëm të disa elementeve të tyre) në bazë të marrjes së vendimeve sipas metodës së analogjisë. Kjo paraqet prezantim të thjeshtësuar dhe paraqitje të objekteve, proceseve dhe dukurive në formë modeli (foto- incizime, formula, skica) të cilat pjesërisht janë adekuate me origjinalin, por që me studimin e ti jep informacione të caktuara të rëndësishme, kështu që në essence metoda e modelimit është metodë teorike, shkencore dhe praktike. Ekspertologjia kriminalistike në përgjithësi, planifikimi kriminalistik janë lidhur ngushtë me modelimin kriminalistik, që si metodë shkencore paraqet bazën për njohje teorike, por edhe për veprime praktike të nëpunësve kriminalistik. Objekte të modelimit mund të jenë fakte të llojllojshme sporadike, rrethana dhe situatë të sistemit të zhvillimeve kriminalistike, me të cilat zbulohen raportet dhe lidhjet ndërmjet objekteve, proceseve dhe dukurive: pastaj personaliteti i kruesit ose i viktimës dhe të veshjes së tij ose të bathjes.; mjetet për kruejen e veprës penale; mekanizmi për mënyrën e kruejes së veprës etj. Shih, B. Simonoviq, gjithashtu shih edhe M. Angeleskin.

metoda të veta (metoda të ndryshme për të arritur te pranimi real etj.).

Metodat të cilat përdoren në shkencat natyrore dhe teknike kriminalistika i përdor në mënyrë të gjithanshme për zhvillimin e teknikës kriminalistike. Për shembull, në kriminalistikë shfrytëzohet teknika kompjuterike, optike dhe laser. “Prandaj disa autorë konsiderojnë se kriminalistika është kanali themelor nëpërmjet së cilët njohuritë shkencore më bashkëkohore futen në praktikën e procedurës para hetimore dhe gjyqësore (ekspertiza e mikrogjurmëve, ekspertizat gjenetike).

Metodat burimore kriminalistike janë ato të cilat i ka formuar vetë kriminalistika, të cilat janë karakteristike vetëm për të dhe dalin nga ana specifike e objektit të saj. Metodat e këtilla mund të ndahen në dy grupe. Kështu në grupin e parë hynë metodat e përdorimit optimal në një situatë të caktuar kriminale-taktike (planifikimi në procedurën para hetimore dhe penale, metodat e ballafaqimit etj). Në grupin e dytë, kriminalistika ndërton metodat e veta kriminalistike-teknike për të zbuluar, për të fiksuar dhe për të hulumtuar informacionet materiale kriminalistike (traseologjia⁹, grafoskopia¹⁰, balistika¹¹, ekspertiza kompjuterike-kenanikoskopike për përcaktimin e disqeve jo legale kompakte etj.). Përveç kësaj, teknika kriminalistike i përsos

⁹ Ekspertiza trasologjike merret me studimin e gjurmëve të këmbëve, gjurmëve të transportit etj.

¹⁰ Grafoskopia është metod e identifikimit të dorëshkrimit. Sipas objektit të ekspertizës praktika dhe teoria kanë diferencuar disa lloje të ekspertizave të këtilla: ekspertë për dokumenta të falsifikuara, ekspertiza të nënshkrimeve, ekspertiza të shkronjave të mëdha të shtypura, ekspertiza e numrave, ekspertiza e letrave anonime etj.

¹¹ Balistika është degë e teknikës kriminalistike, e cila, me ndihmen e metodave teknike dhe matematike, studjon dhe zbulon mjetet dhe metodat më të përshtatshme teknike me qëllim të humumtimit të ligjshmërive të proceseve dhe objekteve lidhur me kryerjen e veprave penale me përdorim të armës së zjarrit. Balistika kriminalistike ndahet në të brendëshme jashtme të jashtme . Sot gjithnjë e më shumë flitet edhe për pjesën e tretë të balistikës, të ashtuquajtur balistika e cakt (objektivit) ose balistika terminale e cila i studion pasojat e predhes të caktu i qëlluar(të kushtëzuar nga karakteristikat e tij: masa, shpejtësia, forma, lloji i caktut)

dhe i gjen mjetet teknike, aparatet dhe pajisjet të cilat shërbejnë për zbulimin, fiksimin dhe hulumtimin e informacioneve materiale kriminalistike.

4. RELACIONET E KRIMINALISTIKËS ME SHKENCAT TJERA

Me qëllim që të sqarohet objekti dhe detyrat e kriminalistikës është e domosdoshme të vihet në dukje relacioni i kriminalistikës me shkencat tjera. Në këtë drejtim, është e nevojshme që së pari të paraqitet relacioni ndërmjet kriminalistikës dhe shkencave tjera penale, ndërsa pastaj të përmenden lidhjet e kriminalistikës me shkencat e tjera, me të cilat ajo shkëmben informacione dhe metoda.

4.1. Kriminalistika në suaza të sistemit të shkencave penale

Që në fillim të këtij kreu duhet thënë se kriminalistikën dhe shkencat tjera penale i ndërlidh ekzistimi e objektit të njëjtë të përgjithshëm të hulumtimit shkencor. Kjo në fakt është ngjarja kriminale¹², si vepër potenciale penale, përkatësisht përcaktimi i ligjshmërive të cilat dominojnë në krimin e kryer dhe kryerësin e supozuar dhe viktimës.

Në kudër të shkencave penale duhet bërë dallimin ndërmjet shkencave penale-juridike, në të cilat hyjnë e drejta penale dhe e drejta penale proceduese, dhe të shkencave penale-juridike në të cilat bien kriminologjia, mjekësia ligjore, psikologjia gjyqësore, psikiatria gjyqësore, kriminalistika dhe të tjera.

Relacionet ndërmjet kriminalistikës dhe të drejtës penale.
“E drejta penale është një sistem dispozitash ligjore për veprat penale dhe përgjegjësinë penale për ato vepra, pjesë e rregullimit

¹² Në nocionin ngjarje krimi (penale) përmbahen termat : vepër penale, kryerës i veprës penale dhe objekti i mbrojtjes.

juridik, që i përmban të gjitha dispozitat ligjore, me të cilat disa sjellje të njerëzve shpallen si vepra penale dhe shqiptohen sanksione për ato vepra.” Me përcaktimin e veprave penale, e drejta penale, e orienton kriminalistikën drejt veprave penale të cilat duhet t’i zbulojë. Nëse, ndonjë vepër nuk është përfshirë si vepër penale, kriminalistika nuk do të aplikoj metoda për zbulimin dhe zbardhjen e saj. Nga ana tjetër, e drejta penale përcakton elementet esenciale të veprës penale dhe në këtë mënyrë kriminalistikën e udhëzon drejt fakteve të cilat duhet t’i zbulojë. “Sipas kësaj, kriminalistika krijon modelet, mënyrat taktike dhe metodat me ndihmën e të cilave faktet që përbëjnë esencën e veprës penale, do të përcaktohen, me qëllim që të verifikohet dhe të argumentohet ekzistimi eventual i saj.”¹³ Kriminalisti,¹⁴ i cili e zbaton kriminalistikën në praktikë, duhet t’i njohë mirë dispozitat ligjore të elementeve esenciale të veprës penale, me qëllim që të dijë se si të përcaktojë zbatimin e metodave kriminalistike. Nga ana tjetër, njohja e veçorive ligjore të veprave penale nuk do të ishte e mjaftueshme nëse nuk dimë se si përcaktohen ato. Kjo do të thotë se e drejta penale tregon çfarë duhet të përcaktohet, ndërsa kriminalistika studion mënyrën dhe zbatimin e metodave të cilat duhet të bëhet ky përcaktim.

Relacioni ndërmjet kriminalistikës dhe të drejtës penale.
“Me nocionin e drejtë penale proceduese nënkuptohet sistemi i normave juridike (rregullave) me të cilat rregullohet mënyra e implementimit të veprimeve proceduese, nga të cilat përbëhet procesi ndëshkimor (penal) dhe forma e relacioneve tjera penale

¹³ Thelbi i veprës penale është përmbledhje e të gjitha elementeve të veprës penale. Elementet e veprës penale mund të jenë të përgjithshme (të përbashkët për të gjitha veprat penale) dhe të veçanta (që janë karakteristika vetëm për një vepër të veçantë penale (shih:., P. Manev: Leksikoni i së drejtës penale. Shkup

¹⁴ Kriminalisti për ne është çdo njëri që e zbaton kriminalistikën: profesor i kriminalistikës, profesor i së drejtës penale, nëpunës operativ i Policisë ligjore, analist. Gjykatës i procedurës paraprake, prokuror publik,

proceduese në të cilat paraqiten subjektet dhe personat e tjerë gjatë marrjes së veprimeve proceduese.”

Objekti i hulumtimit të kriminalistikës edhe të së drejtës penale proceduese jo rrallë është i njëjtë, por metodat e qasjes janë të ndryshme. E drejta penale proceduese merret me zbatimin e formës së procedurës penale gjatë procesit penal, ndërsa kriminalistika (në kuadrin e vet ligjor) të njëjtat fakte i hulumton me metoda jashtëligjore të cilat nuk duhet të jenë në kundërshtim me procedurën. Ekzistojnë shumë çështje të përbashkëta, përkatësisht objekte të hulumtimit të cilët kriminalistika dhe e drejta penale proceduese i hulumtojnë me metoda tipike për këto shkenca.

Kriminalistika vetëm pjesërisht varet nga e drejta penale proceduese. Objekti i kriminalistikës është krejtësisht i ndryshëm dhe më i gjerë se sa objekti i së drejtës penale proceduese, me ç'rast metodologjitë i kanë të ndryshme. Pa kriminalistikën e drejta penale proceduese do të ishte jo efikase dhe pa ndonjë efekt.

Një kohë relativisht të gjatë dominonte pikëpamja se kriminalistika nuk është disiplinë e pavarur, sikurse është e drejta penale proceduese, në radhë parë, për shkak të faktit sepse bazohet në metodat e shkencave të tjera- natyrore dhe teknike. Kuptohet, i mbështesim ata autorë të cilët e trajtojnë kriminalistikën si disiplinë të pavarur shkencore. “Pa marrë parasysh të gjitha idetë teorike, kriminalistika është pjesë e domosdoshme e çdo procesi penal gjatë gjithë zgjatjes së tij, pra është bashkëvepruese e domosdoshme e të gjitha formave dhe komponentëve të proceseve penale , pa të cilat nuk mund të sillet asnjë vendim në procedurën penale”.

Kriminalistika në mënyrë të pandalshme i përshtatet normave të së drejtës penale proceduese, ndërsa njëkohësisht

gjithnjë zhvillohet, me ç'rast përfiton edhe përvojën e saj. Lidhja e kriminalistikës si veprimtari praktike me procedimin penal është shumë e ngushtë. Në fakt, bëhet fjalë për relacione të normës juridike me përmbajtjen e saj praktike. Me këtë rast si subjekt i procesit penal dhe qasjes kriminalistike paraqiten organet e gjyqësisë penale, prokurori publik, policia gjyqësore etj. Kuptohet, rroli i policisë gjyqësore në procedurën penale nuk është procedues, por ato janë vetëm bartës potencial të disa aktiviteteve para hetuese proceduese.

Lidhja me e ngushtë ndërmjet kriminalistikës dhe së drejtës penale proceduese është në kuadër të dëshmive (e drejta për të dëshmuar). E drejta penale proceduese e studion dhe e përshkruan vetëm anën formale të punës me provat (dëshmitë) ndërsa kriminalistika e studion anën reale informative- gnoseologjike (njohëse) të ndodhisë, të shfrytëzimit dhe të vlerësimit të informacioneve të provave (dëshmive).

Kriminalistika ka sferë më të gjerë të interesit shkencor se sa e drejta penale proceduese. Ajo i studion ligjshmëritë e shfaqjes, të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve operative dhe për zbatimin e aktiviteteve operative në kuadër të procedurës para hetimore. Kriminalistika i hulumton edhe masat preventive, si dhe qasjet strategjike gjatë mënjanimin të kriminalitetit në nivel global, që nga ana e saj është jashtë sferës të interesimit të së drejtës penale proceduese.

Relacioni ndërmjet kriminalistikës dhe së drejtës policore. Gjithashtu, kriminalistika është në lidhje të ngushtë me të drejtën policore, përkatësisht me atë pjesë që në mënyrë normative i rregullon kompetencat dhe veprimet e policisë në kuadër të ballafaqimit me kriminalitetin. Këto norma, realizohen pasi të jenë zbatuar disa masa dhe aktivitete operative-taktike duke zbatuar metodat kriminalistike.

Relacioni ndërmjet kriminalistikës dhe kriminologjisë. Lidhja më e ngushtë ndërmjet këtyre dy shkencave është në kuadër të fenomenologjisë kriminalistike. Kjo ndodh për shkak se edhe njëra edhe tjetra shkencë merren me format e manifestuara të kriminalitetit. Fenomenologjia kriminalistike i mbledh dhe i sistemon: format e manifestuara të veprave penale (teknika dhe taktika e delikuencës); format jetësore të kundërvajtësve dhe informacionet dhe manifestimet e veçanta të të gjitha llojet veç e veç të veprës penale (morfologjia kriminale, kriminografia). Gjithashtu, edhe kriminalistika edhe kriminologjia i studiojnë shkaqet e kriminalitetit dhe aspektin e viktimizimit¹⁵, për qëllime të tjera.

Me rëndësi është të përmendet se kriminologjia dhe kriminalistika dallohen qenësisht sipas detyrave të parashtruara, sipas qasjes strategjike ndaj problemit me kriminalitetin dhe sipas spektrit të shfrytëzimit të metodave. Gjithashtu, kriminologjia paraqet sociologjinë e kriminalitetit dhe ka për qëllim njohjen, të kuptuarit dhe shpjegimin e kriminalitetit si dukuri individuale dhe masive. Ndërkaq, kriminalistika merret me përcaktimin e ligjshmërive të paraqitjes së informacioneve kriminalistike (operative dhe të provave) me metoda të zbulimit, të sqarimit dhe për të gjykuar veprat penale.

Kriminalistika, në kuptimin preventiv të fjalës, merret edhe me marrjen e masave dhe aktiviteteve operative-taktike, qëllimi i të cilave është pengimi veprave penale konkrete ose të veprimtarisë penale të supozuar (për shembull, kontrolli

¹⁵ Viktimologjia të mësuarit për viktimën mund të definohet si një përmbledhje njohurish për viktimën e kriminalitetit, duke përfshirë njohuritë kriminologjike, juridiko-penale, kriminalo politike, terapeutike dhe kriminalistike. Shih më tepër O.Baçanoviq, Ploicia dhe viktima, Shkup, 1997)

kriminalistik¹⁶ në raport me ripërtëritësit e shumëfishtë). Qëllimi themelor është që të mos paraqiten pasoja kriminalistike, ndërsa kjo kërkon një qasje të caktuar kriminalistike. Dallimet ndërmjet kriminalistikës dhe kriminologjisë mund të shihen edhe gjatë realizimit të funksionit për të penguar dhe për të shmangur kriminalitetin.

Relacionet ndërmjet kriminalistikës, psikologjisë kriminalistike, psikologjisë gjyqësore dhe psikiatrisë gjyqësore.

Kriminalistika është e lidhur ngushtë me psikologjinë kriminale e cila studion psikologjinë e kryerësve të veprave penale; me psikologjinë gjyqësore e cila i studion aktivitetet psikike të pjesëmarrësve në procedurën para hetimore dhe penale dhe me psikiatrinë gjyqësore, e cila merret me faktorët psikik që shkaktojnë sjelljen kriminale të të sëmurëve shpirtëror dhe të mundësive për të përcaktuar pjesëmarrjen¹⁷ e kryerësve të veprës penale në procedurën penale. Njohuritë e këtyre shkencave shfrytëzohen si bazë për të formuar metodikën kriminalistike për zbulimin dhe sqarimin e llojeve të veçanta të veprave penale; përsosjen e mënyrave taktike¹⁸ ekzistuese dhe formimin e të rejave për të marrë në pyetje disa tipa të caktuar të akuzuarish, dëshmitarësh dhe pjesëmarrës të tjerë në procedurën penale. Nga

¹⁶ Kontrolli kriminalistik nënkupton sistemin e masave organizative dhe planifikimeve të parapara mire operative taktike për të penguar dukuri të ndryshme të rrezikshme kriminale, si dhe të shkaqeve dhe të pasojave të këtyre dukurive. (shih tek G. Cukleski, Doracak për rrjetin e bashkëpunorëve, Shkup, 2005)

¹⁷ Në teorinë e së dretjës penale dhe rreth çështjes së llogarisë ekziston (pak a shumë skolastikë) kontest rreth faktit se a është supozim për përgjegjësi penale ose element i saj. Megjithatë, pa marrë parasysh se për cilin nga këto dy qëndrime do të përcaktohem, rezultati është diç tjetër; pa aftësi për faj nuk mund të ekzistojë as përgjegjësi penale!

¹⁸ Në literaturën kriminalistike, nën nocionin mënyra kriminalistike-taktike nënkupton mënyrën më racionale dhe më efikase të kryerjes së masave operative-taktike dhe veprimet hetuese, që sipas mendimit të atij që e zgjedh nga arsenalin e taktikës kriminalistike është më adekuat për situatën proceduese konkrete operative-taktike ose teknike. Shih më tepër tek G. Xhukleski, Fshehja e tatimit, Shkupit, 1998

ana tjetër, shkencat e përmendura marrin nga kriminalistika të dhëna empirike për hulumtimet e veta.

Relacionet ndërmjet kriminalistikës dhe mjekësisë ligjore.
Këto dy shkencat plotësohen me njëra tjetrën në lëmin e delikteve të gjakut dhe atyre seksuale. Kështu, Mjekësia ligjore për objekt të studimit të ve t i ka shkaqet e dhunës, të vrasjeve dhe të plagosjeve trupore. Ajo, i shpjegon ndryshimet patologjike-anatomike dhe patologjike-fiziologjike të organizmit të plagosur, manifestimet klinike të plagëve të veçanta. Gjithashtu i studion shkaqet rreth vdekjes dhe të plagëve të paraqitura. Për të bërë analizën kriminalistike të ndonjë delikti gjakësor ose seksual, që të ketë përparim në drejtim të zbulimit të kryerësit të panjohur dhe zbardhjes së veprës, duhet për t'u angazhuar në kohën e duhur eksperti i mjekësisë ligjore; të ruhen dhe në mënyrë të drejtë të mbliidhen gjurmët biologjike etj., është e domosdoshme që praktikanti kriminalistik të ketë njohuri bazë nga mjekësia ligjore. Kriminalisti dhe mjeku gjyqësor në lëmin e delikteve të gjakut dhe seksuale jo rrallë e vëzhgojnë dhe e studiojnë të njëjtën dukuri por, nga aspekte të ndryshme, duke shfrytëzuar metoda të ndryshme.

4.2. Relacioni i kriminalistikës me shkencat (jo penale) të tjera

Relacioni i këtillë ka, në radhë të parë dy dimensione. Së pari, njohuritë që i ka arritur kriminalistika mund t'i përdorin edhe shkencat e tjera, me qëllim të realizimit të mënyrave dhe qëllimeve të tyre teknologjike-zhvillimore dhe praktike. Për shembull, mënyrat taktike për dëgjimin e të akuzuarve dhe të dëshmitarëve, përcaktimi i ekspertizës, zbatimi i observimit etj., mund të shfrytëzohen si rekomandime për qasje të drejtë dhe

optimale në të gjitha procedurat juridike (kontestimi¹⁹, administrative²⁰, jashtë kontestimi²¹, disiplinore²²), me të cilat tentohet të përcaktohet gjendja reale faktike. Metodat kriminalistike për identifikim në histori, art, të drejtën e trashëgimisë etj. Kështu, për shembull supozuar se a e ka shkruar një person i caktuar një tekst (letrar i njohur, kompozitor, personalitet historik, ai që le testament). Së dyti është dimensionimi se kriminalistika në mënyrë permanente ndjek zhvillimin e shkencave natyrore, teknike dhe shoqërore dhe të gjitha arritjet e tyre i përvetëson, i zbaton dhe i përshtat për nevojat dhe detyrat e veta.

¹⁹ Procedura kontestimore i përcakton rregullat e procedurave në bazë të të cilave diskuton gjyqi dhe merr vendim për të dretjtat dhe obligimet themelore të njeriut dhe qytetarëve në kontestet të marrëdhënjëve familjare dhe personale, të mardhënieve të punës, si dhe të mardhënieve të tjera civile-juridike të personave fizik dhe juridik, përveq kur për disa konteste të përmendura me ligj të veçantë nuk është paraparë që për to të vendosë gjyqi sipas rregullave të ndonjë procedure tjetër.

²⁰ Procedura administrative i përcakton rregullat e procedurave në të cilën janë të obliguar të sillen ministrat, organet e tjera të administratës shtetërore, organizatat e përcaktuara me ligj dhe organe të tjera shtetërore kur në punët dretjuese drejtpërdrejtë duke zbatuar dispozitat vendosin për të dretjtat, obligimet ose për interesat juridik të personave fizik, personave juridik ose të palëve të tjerë.


²¹ Procedura jashtë kontestimore paraqet një lloj procedure civile juridike që përmban norma juridike me të cilat rregullohet sjellja e gjyqit në punët juridike jashtë kontestimore. (Gjyqet sillen dhe vendosin për gjendjet dhe marrëdhëniet personale, familjare, pronësore dhe të tjera).

²² Procedura disiplinore i përcakton rregullat për verifikimin e shkeljes së obligimeve të punës dhe të disiplinës së punës.

5. ZHVILLIMI SHKENCOR I KRIMINALISTIKËS

Kriminalistika si disiplinë shkencore ka nisur të formohet nga fundi i shekullit të 19. “Deri atëherë njohuritë shkencore të cilat përdorshin për të zbuluar dhe sqaruar veprat penale dhe kryerësit e tyre kanë qenë, në radhë të parë, episodike, sipas rastit dhe të rralla”. Për këto shkaqe, kriminalistika nuk ka pasur mundësi të formohet si disiplinë shkencore.

Publikimi i parë kriminalistik rrjedh nga H. Gross²³, në vitin 1899, me botimin e veprës së tij kapitale të titulluar “Doracak për gjykatësit hetues, si sistem i kriminalistikës”. Kjo ngjarje në literaturë konsiderohet si fillim i kriminalistikës si disiplinë e re shkencore.



Hans Gross

²³ Lindi në Grac në vitin 1847 dhe vdiq në 1915 . Tridhjetë vjet punoi si gjykatës hetues dhe në këtë mënyrë fitoj përvojë të madhe penale. Ka ligjësuar të drejtën penale, procedurën penale dhe kriminalistikën si profesor i rregullt në Fakultetin juridik në Pragë, Grac e në vende të tjera.

Pas botimit të kësaj vepre, në një periudhë relativisht të skrutë, kriminalistika formoi sistemin e vet dhe nisi të ketë ndikim shumë të madh në praktikë. Këtij procesi iu përshtatën edhe zbulimet shumë të rëndësishme në shkencat natyrore dhe teknike. Kështu, nisën të paraqiten vepra të reja shkencore në fusha të ndryshme kriminalistike. Si autorë më karakteristik të kësaj periudhe në Evropë do të veçojmë: E. Siling (E. Seeling), H. Beleviq, R. Grosberg (R. Grossberger), A. Helving (A. Helvving), A. Bertilon (A. Bertillon), E. Lokard (E. Locard), R.A. Rajs (R.A. Reiss) e të tjerë.

Nën ndikim të madh të Grosit dhe të ithtarëve të tij, vepra penale nisi të trajtohet si problem kompleks ndaj zbulimit dhe sqarimit të së cilës duhet qasur me zbatimin e metodave dhe teknikave shkencore. Trendët, idetë dhe qëndrimet e këtilla të reja posaçërisht u përfshinë në Gjermani, në Austri, në Zvicër dhe në Rusi.

Kështu, Albert Vingart në vitin 1904 e botoi veprën “Taktika kriminalistike” dhe që atëherë daton ndarja e trefishtë e kriminalistikës. Më vonë, në lëmin e kriminalistikës, bëhet një zhvillim i shpejtë, posaçërisht në teknikën kriminalistike. Kështu, për shembull në Francë dhe në Itali bëhet një zhvillim i përshpejtuar i teknikës kriminalistike nëpërmjet Lokardit (Lokard) dhe të ithtarëve të tij S. Sani, P. Cekaldi dhe V. Sarentino (Ch. Sannie, R. Ceccaldi, V. Sarentino). Në SHBA dhe në Angli në qarqet shkencore dhe profesionale tretman të veçantë ka teknika kriminalistike. Emra të rëndësishëm në këtë fushë janë O’Hara, P. Kirk, R. Salivan, M. Bishof dhe të tjerë. Ndarja e trefishtë e kriminalistikës përfshihej edhe në Poloni, P. Horoshevski, B. Holist (P. Horoshevski, B. Holist). Në Çekosllovakia J. Pjesak, M. Protivinski, në Hungari L. Viski, J. Kertesh, në Bullgari, T. Stamatov, G. Georgiev).

Sot në Rusi, kriminalistikën si disiplinë e trefishtë e përfaqësojnë teorikët e njohur R. Belkin, N. Vasile, B. Terziev, A. Virnberg, Konovalova etj.

Në fillim të shekullit 20, me zhvillimin e shkencave ekzakte, formohen ente dhe institucione kriminalistike. Kjo është periudha kur shkenca adekuate ekzakte nisën të transferohen në laboratorë me qëllim që të bëhen eksperimente dhe ekspertiza në kushte të këtitlla. Forma gjithnjë më të ndërlikuara dhe më të organizuara të kriminalitetit, shkaktuan zhvillimin e përsheptuar të laboratorëve kriminalistik dhe policor. Në këtë periudhë u zbulua rëntgeni, rrezet infra të kuqe dhe ultraviolete etj.

Kështu kemi edhe paraqitjen e të ashtuquajturës polici shkencore e cila në punën e saj tani i fut edhe të arriturat shkencore.

Hapen laboratorë policorë të cilët pajisen me mjete teknike. Një nga institutet e këtitlla të parë është themeluar në Lozanë (Zvicër), ndërsa e formoi Rodolf Arçibald Rajs. Pasardhësi i tij Mark Bishof e avancoi institutin e përmendur, por ndihmoi për themelimin e instituteve në Poloni dhe në Brazil. Në vitin 1954, Instituti e zgjeroi veprimtarinë e vet edhe në lëmin e hulumtimeve kriminologjisë. Ky institut ka kryer, në radhë të parë, tre detyra themelore:

- Arsimonte kuadro të kualifikimit të lartë kriminalistik;
- Bënte ekspertiza të ndërlikuara kriminalistike dhe
- Bashkëpunonte ngushtë me policinë, duke futur dhe zhvilluar metoda shkencore në luftën kundër kriminalitetit.

Gjithashtu formohen edhe institute shkencore për hulumtime e kriminalitetit nga aspekti kriminologjik dhe sociologjik dhe për të përparuar praktikat.

Pas Luftës së dytë botërore, në Vizbaden u formua Instituti federal kriminalistik për territorin e atëhershëm të RF të Gjermanisë.

Me interes është për ta përmendur Qendrën e parandalimeve (preventivës) së kriminalitetit që u formua në vitin 1963 nga ana i Ministrisë së punëve të brendshme në Angli. Në këtë qendër arsimoheshin nëpunësit policor, të cilët specializoheshin për të punuar për preventive. Programet që studioheshin dhe organizoheshin, në thelb, përfshinin: mbrojtjen teknike nga kriminaliteti (pajisjet e alarmit dhe mjete të tjera).

Instituti i parë kriminalistik në SHBA është formuar në Los Angeles në vitin 1924 ndërsa themelues është kriminologu, kriminalisti i njohur August Vallmer (August Vollmer). Instituti, ndër të tjera , merrej edhe me ekspertiza kriminalistike dhe me hulumtimin e metodave të reja për zbulimin e gjurmëve të veprave penale. Sipas këtij shembulli, u formuan edhe institute të tjera. Kështu në Detroit (1927) u themelua Laboratori kriminalistik, ndërsa pastaj në Çikago (1929) Instituti për zbulime shkencore të krimeve. Gjithashtu në Nju Jork (1934) u formua Laboratori kriminalistik i policisë, ndërsa FBI e njohur (Byroja hetuese federale) në Uashington u themelua në vitin 1933, me detyrë që të zbulojë vepra penale të cilat paraqesin shkelje të ligjeve federale.

Në ish shtetet socialiste, më vonë formohen institute dhe laboratorë në të cilat me ndihmën e metodave shkencore punohej për pengimin e kriminalitetit. Por, duke u nisur nga filozofia e politikës së Stalinit, një aktivitet i këtillë u pengua dhe u la anash. Kuptohet se qëllimi ishte të fshihet ekzistimi i kriminalitetit dhe të

ruhet pasqyra për një shoqëri socialiste ideale pa kriminalitet dhe pa vese.

Megjithatë, në Moskë në vitin 1946 u formua Instituti shkencor federal në kuadër të Ministrisë të mbrojtjes së rendit publik. Në këtë institut punonin kuadrot e larta shkencore. Ai kishte laboratorë shumë të pajisur, kabinet, laboratorë, si dhe veprimtari të vetë botuese.

Gjithashtu në Moskë në vitin 1963 u formua edhe Instituti shkencor për studimin e shkaqeve të kriminalitetit, por edhe për përpunimin e masave me ndihmën e të cilave do të pengohej kriminaliteti me sukses. “Në të studioheshin shkaqet e kriminalitetit, trajtoheshin problemet teorike të së drejtës penale, të kriminalistikës dhe të shkencave të ngjashme me të.”

Më vonë edhe në vendet e tjera të Evropës lindore themelohen institute të ngjashme. Ndër to me interes është Enti i kriminalitetit pranë Komandës supreme të policisë qytetare në Varshavë, i cili merrej me metodën e identifikimit me ndihmë të zërit.²⁴ Por, hulumton edhe fusha të tjera, si për shembull: traseologjia, bënë hulumtime balistike, fizike-kimike e të tjera. Në kuadër të këtij instituti ka një muze kriminalistik ndërsa përgatiten edhe botime shkencore.

Në ish RSFJ, institutet e këtilla nuk kanë pasur ndonjë traditë të posaçme edhe përkundër faktit se disa prej tyre patën një zhvillim dinamik. Kështu, në fillim të vitit 1946 u formuan seksionet e para kriminalistike-teknike në kuadër të drejtorisë kriminalistike pranë Sekretariatit federativ të punëve të brendshme.

²⁴ Ekspertizat fonoskopike zbatohen në radhë të parë, që nëpërmjet rrugës së tërthortë të zbulohet shkaktari i kërcënimit, vrasësi profesional i cili kryen vepra penale të porositura, për të zbuluar aktivitete spiunimi, për zbulimin e disqeve të piratëve etj(për më tepër shih G. Xhukleski).

Diçka më vonë, në të gjitha republikat dhe krahinat u formuan byrotë kriminalistike-teknike.

Sot në Republikën e Maqedonisë ekspertizat kriminalistike i bënë Sektori i ekspertizës kriminalistike²⁵ pranë Ministrisë së punëve të brendshme. Por, zhvillimi i teknikës kriminalistike në Republikën e Maqedonisë nuk mund të paramendohet pa bashkëpunimin me Lidhjen evropiane të laboratorëve forensik (European Network of Forensic Science Institutes- ENFSI).

Lidhja evropiane e laboratorëve forenzik është themeluar në tetor të vitit 1995 në Holandë.

Laboratorët forenzik të bashkuar policor dhe qeveritar, punojnë për nevojat e policisë, të prokurorive publike dhe të gjyqeve.

Sot, kjo lidhje është bërë një shoqatë gjithë evropiane në të cilin janë përfshirë 43 laboratorë forensik nga 29 shtete evropiane.

Qëllimi i saj është që të gjallërohet bashkëpunimi i laboratorëve forensik, për shkak se bashkëpunimi në kuadër të Interpolit është tepër burokratik, jo efikas dhe për këtë shkak edhe shumë modeste.

Bashkëpunimi përfshinë: bashkëpunimin e drejtpërdrejtë të drejtorëve të këtyre laboratorëve dhe të ekspertëve forensik, në lidhje me: a) çështjet e menaxhimit për shfrytëzimin sa më efikas të teknikës kriminalistike gjatë shqyrtimit të veprave penale; b) ndryshimet e metodave dhe qasjeve gjatë projekteve të përbashkëta hulumtuese-zhvillimore.

ENFSI – bashkëpunon me një numër të madh shoqatash sikurse janë: a) Shoqata amerikane e drejtorëve të laboratorëve

²⁵ Institucioni ekspertizë është shumë me rëndësi edhe për punën kriminalistike-operative dhe për praktikën gjyqësore. Me ekspertizën e gjurmave materiale operative i jepen drejtësimet për të zhvilluar përpunimin kriminalistik, ndërsa për praktikën gjyqësore rezultati i ekspertizës është prove materiale që mund të jetë vendimtar për të marrë vendimin gjyqësor.

kriminalistik, b) Shoqata australiane-Zelandë e re e drejtorëve të laboratorëve fornezietik .

Kjo lidhje është organ këshillëdhënës i Interpolit dhe i Evropolit.

5.1. Zhvillimi i kriminalistikës në Republikën e Maqedonisë

“Nëse i lëmë anash shkrimet e veçanta të autorëve maqedonas për rëndësinë e problemeve kriminalistike-taktike dhe kriminalistike- metodike, të botuara në revistat periodike kriminalistike maqedonase (të cilat zënë vend të merituar në krijimin e teorisë ende të varfër kriminalistike të vendit) fillet e depërtimit të shkencës kriminalistike në Maqedoni, lidhen pikërisht me emrin e profesor Vodineliq”. Në fakt, në vitin 1985 para opinionit maqedonas, ai e botoi veprën e vetë dy vëllimesh të titulluar “Zbulimet dhe provat kriminalistike”.

Në vitin 1988, (në bashkautorësi) Vodineliq dhe Aleksiq botuan në gjuhën maqedonase skriptin “Metodika kriminalistike”. Ndërsa në vitin 1985, pas vdekjes, në botim të Fakultetit të sigurimit në Shkup, doli nga shtypi libri i Vodineliqit “Taktika kriminalistike 1”. Në vitin 1993 u botua libri i parë “Kriminalistika”, në gjuhën maqedonase nga autori M. Angeleski. Pak më vonë, nga i njëjti autor u botuan tre krijime teorike: ”Bazat e kriminalistikës ekonomike”, 1999; “Taktika kriminalistike”, 2003 dhe “Kriminalistika operative”, 2005.

Gjithashtu, në dekadën e fundit pa dyshim shkenca kriminalistika ka bërë një zhvillim të duhur me veprat monografike të autorëve : D. Dimitrov (“Informuesit policor”, 1995) G. Xhukleski (“Fshehjet e tatimeve”, 1998; Piratëria muzikore”, 2004; “Doracak për rrjetin e bashkëpunëtorëve”,

2005; “Hyrje në kriminalistikë”, 2006 dhe 2008; “Kriminalistika ekonomike”, 2007 etj); S. Buxhakoski (“Kriminaliteti turistik”, 1995; “Preventiva nga keqpërdorimi i drogës”, 2002), M. Malish Sazdoska (“Policia kriminalistike dhe kriminaliteti ekonomi”, 2005; “Doracak për ciklin e zbulimit”, 2005), Z. Dimiski (Tregtia ilegale me armë dhe terrorizmi në Republikën e Maqedonisë”, 2005), D. Stojanovski (“falsifikimi i dokumentave”, 2005), S. Nikoloska, “Kriminaliteti i të miturve në Republikën e Maqedonisë”, 2005) e të tjerë.

Në vitin 1995, autori D. Josifovski e botoi librin “Psikologjia kriminalistike” ndërsa në vitin 2005 nga autori S. Aleksoski doli nga shtypi libri “Psikologjia e psikologjisë kriminalistike”.

Në kuadër të Fakultetit të mjekësisë në Shkup në vitin 1952 u themelua Instituti i mjekësisë ligjore dhe kriminalistikës. Gjithashtu, për zhvillimin e kriminalistikës në Republikën e Maqedonisë rrol të rëndësishëm ka luajtur edhe Muzeu kriminalistik i cili u formua në vitin 1957, ndërsa nisi të funksionojë në kuadër të policisë dhe u vendos në lokalet e Sekretariatit të atëhershëm shtetëror të punëve të brendshme të Republikës së Maqedonisë.

Në vitin 1977 Muzeu kriminalistik u transferua në Qendrën e atëhershme për arsimimin e kuadrove në fushën e sigurisë në Idrizovë- Shkup, ku ndodhet edhe sot.²⁶ Sipas thënieve të profesor J. Spaseski, njëri nga themeluesit dhe drejtor shumëvjeçar i QAKFS, muzeu konsiderohej si një nga më të mirët në Ballkan. Por, sot, nevoja për ripërtëritjen e muzeut imponohet si imperativ. Kjo ka të bëjë aq më shumë sepse ai i dedikohet zhvillimit të

²⁶ Për më tepër shih tek M. Angeleski

mësimi praktik dhe të ushtrimeve të studentëve të Fakultetit të sigurisë.

Pyetje për studentët:

- 1. Cili është definicioni për kriminalistikën?*
- 2. Përcakto lëndën, objektin dhe detyrat e kriminalistikës?*
- 3. Cilat nënsisteme e përbëjnë kriminalistikën si shkencë e trefishtë?*
- 4. Theksoi tendencat e reja në kriminalistikë?*
- 5. Shpjego metodat e kriminalistikës.*
- 6. Shpjego relacionet ndërmjet kriminalistikës dhe të drejtës penale.*
- 7. Shpjego relacionin e kriminalistikës dhe së drejtës penale proceduese?*
- 8. Shpjego relacionin ndërmjet kriminalistikës dhe së drejtës policore.*
- 9. Shpjego relacionin ndërmjet kriminalistikës dhe kriminologjisë.*
- 10. Shpjego relacionin ndërmjet kriminalistikës , psikologjisë kriminalistike, psikologjisë gjyqësore dhe psikiatrisë gjyqësore.*
- 11. Shpjego relacionin ndërmjet kriminalistikës dhe mjekësisë ligjore.*
- 12. Shpjego relacionin e kriminalistikës me shkencat tjera (jo penale).*
- 13. Shpjego zhvillimin shkencor të kriminalistikës.*
- 14. Shpjego zhvillimin e kriminalistikës në Republikën e Maqedonisë.*

KREU II

PARIMET THEMELORE TË KRIMINALISTIKËS

1. VËREJTJE HYRËSE

E drejta penale proceduese ka përpunuar disa procese procedurale, që janë me rëndësi esenciale edhe për kriminalistikën. Këto janë parimi i ofiales, i akuzës dhe i legalitetit të ndjekjes penale, parimi i së vërtetës materiale, parimi i transparencës, parimi i vlerësimit të lirë të provave etj.

“Por, pikërisht për faktin se procedura penale nuk është vetëm proceduese por njëkohësisht (në unitet të pandarë) edhe veprimtari teknike-taktike, kriminalistika nuk mund të kënaqej me parimet proceduese si të vetme drejtime për procedim”. Kështu, në punën e vet kriminalisti i zbaton këto parime taktike:²⁷

- 1 Parimin e ligjshmërisë;
- 2 Parimin e të vërtetës
- 3 Parimin e kritikës dhe vetëkritikës;
- 4 Parimin e shpejtësisë dhe befasisë;
- 5 Parimin e objektivës;
- 6 Parimin e planifikimit metodik;
- 7 Parimin e themelores dhe të këmbëngulësisë;
- 8 Parimin e lirisë teknike- taktike dhe parimin e proporcionalës;
- 9 Parimin e udhëheqjes unike dhe të zbatimit të veprimtarisë kriminalistike;
- 10 Parimin e ekonomikes në procedim;
- 11 Parimin e ruajtjes së fshehtësisë zyrtare;
- 12 Parimin e humanizmit;

²⁷ Themelet për studimet e parimeve të kriminalistikës i vuri V. Vodinelij që në vitin e largët 1949.

- 13 Parimin e procedimit aktiv kriminalistik dhe zhvillimin konsekuent të preventivës kriminalistike dhe;
- 14 Parimin e bashkëpunimit ndërkombëtar kriminalistik;

1.1. Parimi i ligjshmërisë

Si vend i parë i parimit të ligjshmërisë konsiderohet Anglia, ndërsa kjo në mënyrë me të plotë dhe më të saktë është proklamuar me *Deklaratën për të drejtat e njeriut* dhe të qytetarëve në kohën e Revolucionit borgjez francez. Sipas tij, nuk mund të pengohet ajo që nuk është ndaluar me ligj dhe asnjë nuk mund të detyrohet të bëjë atë që nuk e rekomandon ai (neni 5). Maksima themelore në të cilën bazohet parimi i ligjshmërisë thotë “nulum crimen, nulla poena sine lege” (nuk ka krim, nuk ka dënim pa ligj).

Parimi i ligjshmërisë vlerësohet si një e arritur e madhe e fitores së borgjezisë ndaj anarkisë dhe autokracisë të shtetit feudal. Kjo e ruan vlerën e saj të plotë deri sot si garanci për të realizuar politikën e një vendi, të përfshirë në ligjet e tij.

Parimi i ligjshmërisë nënkupton , jo vetëm njohje të akteve juridike dhe respektimin e tyre nga ana e personave të autorizuar zyrtar në policinë gjyqësore. Në fakt nëpunësit e policisë gjyqësore i ndërmarrin vetëm ato veprime, masa dhe detyrime të cilët janë paraparë me dispozita. Kështu për shembull, duhet të respektohen (dhe të zbatohen) Kushtetuta, Ligji i procedurës penale, Kodi penal, Ligji i punëve të brendshme, Ligji i policisë ligjore²⁸, Ligji i policisë financiare etj., dhe shumë akte nënligjore (rregullat me forcë ligjore, rregulloret, udhëzimet) etj. Me fjalë të

²⁸ Nënpunësit e policisë ligjore janë nëpunës policor në Ministrinë e punëve të brendshme dhe pjesëtarët e Policisë financiare, Policia ushtarake dhe me ligj të veçantë edhe Drejtoria e doganave të Republikës së Maqedonisë.

tjera marrja e përkohshme e sendeve, mbikëqyrja, ekspertiza, hyrja në banesë të huaj dhe sipas nevojës bërja e bastisjes, mbledhja e njoftimeve të nevojshme, thirrja e dëshmitarëve, fotografimi dhe daktiloskopia e të dyshuarve për kryerje të veprave penale , arrestimi etj, duhet të ndërmerren vetëm kur do të plotësoheshin kushtet ligjore. Në të kundërtën, shkelet ky parim shumë i rëndësishëm. Si rezultat i shkeljes të këtij parimi të rëndësishëm, personi zyrtar i autorizuar mund të suspendohet nga vendi i punës ose kundër tij të bëhet kallëzim penal për kryerje të veprës penale përkatëse etj. Në këtë drejtim, mosrespektimi i ligjit në një shtet duhet të mënjanohet. Një gjë e këtillë ndonjëherë mund të ndodhe edhe nga mosnjohja, por jo rrallë është i pranishëm edhe si rezultat i synimit të qëllimshëm për të kryer veprim të paligjshëm për shkaqe të ndryshme.

Sot, për fat të mirë, me shfrytëzimin sa më të shpeshtë të provave (mënyrave) forenzike në procedurën para hetimore dhe penale krijohen mundësi për respektimin më të madh parimit të ligjshmërisë, ndërsa kjo do të thotë përforsim i kapaciteteve për luftë më efikase kundër kriminalitetit.

Sipas konsekuencës së respektimit të këtij parimi vlerësohet edhe shkalla e demokratizimit dhe e statusit të lirive dhe të drejtave të njeriut në një shtet.

1.2. Parimi i së vërtetës

Sipas asaj që u tha më lartë, kriminalisti gjatë aktiviteteve të veta zyrtare duhet të motivohet nga parimi i së vërtetës. Megjithatë ai mund të marrë ato masa, varësisht nga intenca dhe kreativiteti i vet të cilat janë më të përshtatshme për të përcaktuar të vërtetën. Në këtë aspekt, kriminalisti është i detyruar me të njëjtën përkujdesje dhe duke respektuar të vërtetën t,i përcaktojë

të gjitha faktet e rëndësishme për sqarimin e veprës penale. Qofshin ato që shkojnë në dobi të të dyshuarit, qofshin ato që janë në dëm të tij.

Gjatë sqarimit, zbardhjes së veprës penale dhe gjatë zbulimit të kryerësve të saj, të gjithë organet e procedurës para hetimore dhe penale janë të detyruar që në mënyrë të vërtetë dhe të plotë të vërtetojnë gjendjen faktike.

Rezultatet e aktivitetit operative dhe hetuese duhet të japin përgjigjen përfundimtare rreth asaj se a mund të përcaktohet e vërteta materiale në një drejtim, ose nuk ka mundësi që të harmonizohen të gjitha faktet në një tërësi logjike.

Kur kemi situatë taktike për të mos pasur mundësi të rrumbullakimit të fakteve, atëherë (sipas rregullit) kemi ndërprerje të procedurës penale si rezultat i mungesës së provave.

Parimi për të përcaktuar të vërtetën duhet të jetë i pranishëm, duke nisur që në dyshimet e para se një person i caktuar është kryerës i një veprë penale, deri në përfundimin e procedurës penale- nëse për të mbahet evidencë.

1.3. Parimi i kritikës dhe vetëkritikës

Parimi i kritikës dhe vetëkritikës paraqet vlerësimin e punës të një kriminalisti në aspektin e ndërmarrjes së veprimeve të karakterit kriminalistik- taktik, si dhe shqyrtimit me intencë të të gjitha sinjaleve dhe informacioneve të cilat vijnë nga një akt penal.

Njeri kritik është ai person i cili është i aftë të çmojë vlerën e diçkaje ose të ndonjërit në mënyrë profesionale, si ekspert dhe moralisht. Kur vlerësimi ka të bëjë me veten e tij, kritika bëhet vetëkritik. Kur bëhet fjalë për kritikën dhe vetëkritikën në kriminalistikë si shkencë, pa dyshim, kritik mund të jetë vetëm ai

kriminalist, i cili është i aftë të vlerësojë në mënyrë profesionale në kuadër të kriminalistikës. Por, nga ana tjetër, kritika dhe vetëkritika është një hallkë e pandashme e çdo individi si personalitet dhe me këtë ata paraqiten si parime subjektive.

Ky parim lidhet ngushtë me parimin e metodikës dhe të parimit të objektivitetit, por me rëndësi është që të zbatohet mëvetësishëm, duke marrë parasysh se nga ai shtrihet më tutje nevoja për zbatimin e një numri të madh të veprimeve operative-taktike, me qëllim që të dalë në shesh e vërteta.

Në fakt, kur bëhet fjalë për vepër penale, kriminalistika parasheh një numër të madh të veprimeve, si për shembull: zbulimin dhe fiksimin e gjurmëve, mbledhjen e materialit të provave, përpunimin dhe ndërlidhjen e rezultateve me personin e caktuar- kryerës të asaj veprë. Por gjithnjë nuk janë të sakta indicet evidente. Në fakt, në praktikë ndodh shpesh që informacione të caktuara të mbledhura (njoftimet, sendet nga vet vendi i ngjarjes etj.) të jenë të rreme, përkatësisht të mos rrjedhin nga vetë vepra penale.

Çdo punë e kriminalistit nisë nga dyshimi. Kjo nuk do të thotë dyshim edhe kur gjërat janë evidente. Dyshimin kriminalisti, me një fjalë duhet ta ketë në zbulimin e së vërtetës, të fshehur në gjërat iluzore. Kjo në praktikë do të thotë zbulim i suksesshëm i veprave të rënda penale të cilat të cilat përpiqen që t'i mbulojnë kryerësit me imponimin e provave ose me pranimin e veprave penale më të lehta. Pikërisht për këtë arsye, kriminalisti i mirë duhet të dyshojë dhe në tërësi t'i zbatojë të gjitha veprimet e parapara sipas metodave kriminalistike.

Dyshimet, indicet, metodologjia kanë një ndërthurje reciproke. Nga dyshimet dalin indicet, ndërsa, nga ana tjetër, nuk ekziston vepër penale për të cilën që në fillim nuk ka indice. Domethënë, indicet duhet kërkuar dhe duhet gjetur , ndërsa kjo

nuk mund të ndodhë nëse nuk ekziston dyshimi. . Nëpërmjet dyshimit, gjetja e indiceve dhe me zbatimin e veprimeve operative-taktike, rrol të madh luan qasja kritike ndaj gjithë aktit dhe vetëkritika në vetëdijen tonë.

Nëse në vetëdijen e kriminalistit gjithnjë dominon ideja se qëllimi i punës së tij është të zbulojë të gjitha veprat penale, dhe jo vetëm një ngjarje për vetveten, atëherë ai gjithnjë do të synojë zbulimin edhe të atyre veprave të cilat kanë mbetur pa u zbuluar. Në praktikë shpesh herë hasim me një kryerës së shumë veprave penale. Por një pjesë e tyre ende nuk janë gjetur dhe nuk janë zbardhur. Këtu, me ndihmën e qasjes kritike ndaj veprës dhe ndaj një kryerësi të caktuar mund të arrihet sukses.

Në kriminalistikë ekziston i ashtuquajti *“numri i errët”* i krimit, në të cilin hyjnë të gjitha veprat penale të pazbuluara. Këtu gjithnjë shtrohet pyetja përse kanë mbetur të pa zbuluara këto vepra. Në praktikë dihet mirëfilli fakti se për çdo gjë që ka ndodhur, ekziston ndonjë që e di atë. Pikërisht këtu është e nevojshme të zbatohet mjeshtëria e vlerësimit të punës vetjake të kriminalistit dhe e qasjes kritike ndaj metodave të cilat zbatohen. Me fjalë të tjera, kriminalisti duhet të gjejë burimin e informacioneve të fshehura, t'i përpunojë ato, dhe të arrijë në fund të zvogëlimi i numrit të fshehtë.

Lufta kundër krimit nuk paraqet asgjë tjetër, përveç një gare të pafund të gjetjes së mënyrave të reja për të kryer vepra penale dhe gjetjen e metodave të reja për zbulimin e veprave penale. Në këtë garë, kriminalistët përpiqen të arrijnë “krimin e përsosur” që ata të mos mbesin të pa zbuluar.

Krimi i përkryer është përpjekje e një krimineli për të bërë vepër penale e cila nuk do të shkaktoje dyshime të mjaftueshme që në fund të zbulohet. Në luftën kundër kësaj përpjekje, përveç parimeve të tjera, rrol të rëndësishëm luan parimi i kritikës dhe

vetëkritikë, sepse ky parim zbatohet më shumë kur akti në shikim të parë duket si i thjeshtë, ndërsa pikërisht kjo thjeshtësi pengon, përfaqëson limiton, zbatimin e spektrit të dyshimeve.

Nga e gjithë kjo që u tha më lartë, del se parimi i qasjes kritike dhe vetëkritike bazohet në zbatimin e intencës, gjurmim për atë që fshihet dhe atë sekreten, duke nisur me çdo dozë dyshimi, vlerësimi të qasjeve dhe punës vetjake. Sepse edhe gjatë punës më të kujdesshme ndodhin gabime, ndërsa kriminalisti i cili di (dhe e shfrytëzon) të jetë kritik dhe vetëkritik mund të shohë këto gabime, t'i mënjanojë dhe të gjejë mënyra për të ardhur te e vërteta.

Faktet e veprave penale të cilat janë mbledhur, janë kontrolluar dhe janë ndërlidhur paraqesin provat e besueshme dhe të vërteta. Por, që të gjenden faktet e vërteta, është e nevojshme të hetohen të gjitha bazat e dyshimit.

Vetëm me qëndrim kritik mund të mënjanohet shqyrtimi i gabuar i fakteve dhe ndërlidhja e tyre e gabuar. Shpesh ndodh të ballafaqohemi me kryerës inteligjent dhe të aftë të veprave penale, me dëshmitarë të cilët japin deklaratat të rrejshme etj. Me zbatimin e këtij parimi, kriminalisti mund të hyjë në esencën e sekretit, të mënjanojë iluzionet dhe t'i qaset së vërtetës, sepse kjo do të shërbejë për punën e tij në të ardhmen.

1.4. Parimi i shpejtësisë dhe i befasisë

Ky parim përbëhet nga qasja e shpejtë, efikase dhe e paramenduar mirë sa herë që ekzistojnë kushte për të. Më shpesh vjen në shprehje menjëherë pas kryerjes së veprës penale. Sa më e shkurtë të jetë distanca kohore ndërmjet kryerësit dhe zbulimit të aktit përkatës, aq më të mëdha janë gjasat për sukses. Nëse ndërmerren masa dhe veprime që në angazhimin e parë menjëherë ose vetëm pak kohë pas kryerjes së aktit, kryerësi nuk do të ketë kohë për të sajuar dhe për të realizuar masa mbrojtëse, përkatësisht me zbatimin e këtij parimi arrihet sa vijon:

- ka mundësi reale që të kapet kryerësi në vendin e ngjarjes;
- jepet mundësia për t'u bllokuar vendin e ngjarjes ose rrethi më i gjerë apo të ngrihet pritë me qëllim për të kapur kryerësin;
- të takohen dëshmitarët në vendin e ngjarjes dhe me kohë të merren njoftimet e tyre, gjersa ngjarjen e kanë të gjallë në kujtesë;
- të gjendet vendi i ngjarjes në gjendje ashtu si ka qenë , gjersa gjurmët ende nuk janë prishur ose nuk kanë ndryshuar;
- të përdoret qeni zyrtar;
- të befasohet kryerësi dhe të mos i lejohet që të fshijë gjurmët dhe të formojë alibi.

Shpejtësia do të thotë që edhe gjatë një indikacioni më të vogël të ekzistimit të veprës penale, menjëherë të reagohet dhe ajo të të kontrollohet. Vendimi i shpejtë dhe i drejtë, aspekti operativ, dinamika dhe puna elastike japin garanci për sukses të sigurt. Në të vërtetë, veprimi i shpejtë ndikon në mënyrë befasuese ndaj kryerësit, e habit atë, e bën të shtanget, e bënë të

paaftë, etj. Kryerësi konsideron se nuk do të zbulohet ose nuk do të dëshmohet e vërteta.

Koha mund të jetë aleat më i mirë, por edhe armik i kriminalistit. Por, ashtu si në çdo parim taktik, ekzistojnë situata kur shpejtësia nuk është e dobishme. Në kriminalistikë veprimi operativ i pa përpunuar mirë mund prishë tërë aksionin. Për shembull, tek marrja e ryshfetit, nëse veprohet shumë shpejt atëherë ekziston mundësia të mos zbulohen bashkautorët e marrësit të ryshfetit . Kjo do të thotë se shpejtësia nuk është e njëjtë me shthurjen e shpejtë. Duhet pasur refleks të mirë dhe të sigurt që vendimi të merret shpejt dhe të realizohet me siguri (kur duhet të sajohet) por duhet pasur edhe durim nëse ka nevojë. Por nëse nga momenti i kryerjes së aktit deri në momentin kur kriminalisti është njoftuar për të, ka kaluar një kohë më e gjatë, veprime të shpejta në bazë të të dhënave të reja do të ndërmerren vetëm nëse ekziston rrezik që kryerësi përpiqet të fshijë gjurmët ose me masa të tilla të shpejta nuk mund të priset asgjë.

Befasia dhe shpejtësia janë parime të ndërlidhura shumë ngushtë. Veprimi i shpejtë ndikon në mënyrë befasuese tek kryerësi i veprës penale, e habit, e shtang, e bënë të paaftë për mashtrime dhe gënjeshtër të mtejshme. Pak a shumë , të gjitha masat operative-taktike dhe veprimet hetuese mund të përjetojnë sukses të plotë vetëm me zbatimin e parimit të befasisë.

Racia²⁹, prita³⁰ (kurthi), bastisja³¹, dëgjimi jo formal³², për të cilët kryerësi përgatitet që përpara, shpesh herë nuk kanë efekt

²⁹ Racia paraqet akcion të rrufeshëm policor-operativ që përbëhet nga rrethimi dhe nga bllokimi i një vendi të caktuar që gjendet në ambient të hapët ose të mbyllur, ndërsa zbatohet për arrestim të befasishëm të personaëve të caktuar ose për të gjetur dhe për të përcaktuar identitetin e personaëve të dyshuar, si dhe për qëllime të tjera që dalin nga veprimi aktiv dhe reaktiv kriminalistik.

³⁰ Prita (kurthi) paraqet masën diskrete operative-taktike që përbëhet nga vënja e pritës ose vendosja një numri të caktuar të policëve në një vend kritik të përcaktuar më herët në vend të hapët ose të mbyllur ku me një doze sigurie të madhe pritët të kalojnë delikuentët ose

të madh. Të befasohet dikush do të thotë të ndërmerren masa të cilat ai nuk i pret dhe në kohë që ai nuk do të shpresonte se do të ndodhë diçka e tillë. Goditjet e rrufeshme, të befasishme sigurojnë sukses të plotë. Gjatë pritës arrestohet kryerësi i rrezikshëm, gjatë ndërhyrjes së befasishme gjenden *sogpora delikti* të fshehta, kapet kryerësi në vendin e ngjarjes etj. Befasia në fakt do të thotë marrja e veprimeve në kohë dhe në vendin kur kryerësi i veprës penale e pret më së paku atë, dhe në atë moment arrihet efekti i befasisë, dhe pritet që realisht kryerësi vetë ta pranojë se ka kryer vepër penale.

Të përfundojmë: shpejtësia dhe befasia janë një nga faktorët kyç në zbardhjen e veprës penale. Kështu, për shembull, kur disponojmë informacione për transit (ose për hyrje) të drogës në shtetin tonë, shpejtësia qëndron në faktin që shërbimi ynë duhet të mbulojë të gjithë vendkalimet kufitare ndaj vendit fqinj prej nga duhet të arrijë dërgesa. Pasi ajo të ketë hyrë në Republikën e Maqedonisë, pasi të paraqitet objekti në kontrollin policor, vihet nën mbikëqyrje dhe nis ndjekja deri te caku, destinacioni i fundit. Pasi dërgesa të arrijë në cakun e vet, ndërmerret taktika e pritjes deri në momentin kur ndonjë person do ta pranojë dërgesën dhe atëherë policia vepron befasisht në atë mënyrë, që në momentin e dhënë, i arreston të gjithë personat që i takon në vendin e ngjarjes dhe konfiskohet dërgesa.

Pasi të përpunohet e gjithë kjo, më vonë vijojnë procedurat tjera deri në mbylljen e rastit. Por, në këtë situatë taktike është

persona të tjerë ndaj të cilëve (në baza të ndryshme) është ngritur ndjekje, me qëllim që personat e tillë të kapen befasisht për shkak të veprimit të mëtejshëm kriminalistik.

³¹ Bastisja është veprim hetimor (procedimi) që ndërmerret për të gjetur dhe për të kapur kryerësin e veprës penale ose të sendeve (mjetëve të kryerjes) që janë me rëndësi për procesin penal (prova materiale).

³² Biseda informative paraqet njëfar komunikimi shoqëror që për nevojat e shkencës dhe praktikës kriminalistike definohet si formë themelore për mbledhjen e njoftimeve nga qytetarët.

shumë esenciale që nuk është penguar dërgesa në hyrje në Republikën e Maqedonisë, por është ndjekur deri në destinacionin e fundit, me të vetmin qëllim që të shihet se kush do ta pranojë, përkatësisht kush është porositi. Në këtë mënyrë zbulohet një zinxhir i rëndësishëm i narko-kriminalitetit të organizuar.

1.5. Parimi i objektivitetit

Zbulimi i një të vërtete rreth realitetit objektiv paraqet një proces të ndërlikuar, proces që do të thotë lëvizje nga e vërteta më e vogël drejt asaj të pjesshme dhe të plotë. Me ndihmën e së vërtetës, njeriu e tejkalon karakterin subjektiv të pikëpamjeve të veta. Këtu, duhet nënkuptuar edhe harmonizimi i rezultateve të arritura nga procedura me aktin penal, ashtu si ka ndodhur ai realisht. Kriminalistët, që nga fillimi deri në fund të aktiviteteve, duhet të jenë të qetë, konsekuent, të paanshëm me qëndrim objektiv ndaj njerëzve. Kjo nënkupton tolerancë zero ndaj futjes së presioneve ose të interesave dhe bindjeve personale nga ana e nëpunësve kriminalistik. Ata duhet të zhvillojnë në veten e tyre idenë e paluhatshme për të vërtetën dhe drejtësinë.

Objektives nuk i shkon për shtati dëshira për zgjidhje të shpejtë të rastit dhe për mbledhjen vetëm të atyre fakteve dhe provave të cilat e ngarkojnë të dyshuarin ose të akuzuarin, ndërsa me qëllim i mënjanojnë ose i hedhin ato që shkojnë në dobi të tij. Qëndrime të këtilla janë shumë të dëmshme dhe të rrezikshme, veçanërisht kur kriminalisti ka ndonjë arsyetim personal. Mbledhja e fakteve, njoftimeve, dhe e provave nga kriminalisti duhet të shihen nga aspekti i tyre real. Ose, thënë ndryshe, ato nuk duhet ti nënvlerësojë ose t'i mbivlerësojë. Masat dhe aktivitetet përkatëse operative-taktike duhet t'i orientojë gjithnjë në pajtim me planin operativ dhe me nevojat reale, dhe jo vetëm formalisht

të plotësohet detyra operative ose në mënyrë të panevojshme të shqetësohen persona të caktuar. Për fat të keq, në praktikë ekzistojnë raste të këtilla.

Me qëllim që të sillen në minimum praktikat e këtilla, aspekti objektiv i veprimit kërkon shqyrtim të përhershëm të sjelljes personale, duke lënë anash çfarëdolloj simpatie ose antipatie ndaj kryerësit. Do të ishte edhe më tragjike nëse një sjellje e këtillë e kriminalistit do të bëhej për shkaqe të përfitimeve materiale apo të motiveve të ngjashme. Parimi i këtillë ka rëndësi të madhe edhe për përcaktimin e arsyeshem të informacioneve të njohura në kuptimin se a paraqesin ato bazën për dyshim (ose dyshime të arsyeshme) etj.

Respektimi i këtij parimi lidhet drejtpërdrejtë me profesionalizmin, me kualifikimet, me motivimin dhe me standardet e larta profesionale që duhet t'i ketë çdo kriminalist.

1.6. Parimi i planifikimit metodik

Supozimi themelor i këtij parimi në radhë të parë është profesional, i organizimit të kualifikuar dhe i planifikimit të aktiviteteve kriminale. Ndërmarrja spontane e aktiviteteve kriminalistike, pothuajse gjithnjë, shkakton situata dhe dukuri të padëshirueshme.

Aspekti metodik në punë dhe planifikimi i masave dhe aktiviteteve operative –taktike është kusht për veprim sistematik të çdo kriminalisti. Që nga njohuritë dhe indikacionet fillestare për veprën penale të kryer, kontrollimi i tyre dhe krijimi i versioneve për aktin dhe për kryerësin duhet të zhvillohen në bazë të një plani të hartuar në mënyrë logjike. Kuptohet, planifikimi operativ duhet të jetë në radhë të parë elastik për shkak të papërcaktueshmërisë së njohurive dhe për shkak të situatave të

reja të cilat nuk ka mundësi të planifikohen. Në këtë drejtim, me qëllim të një qasjeje metodike, është e nevojshme që faktet të kontrollohen hollësisht, ndërsa pastaj të bëhet planifikimi i aktiviteteve sipas parimit të metodikës.

Që në fillim akti kriminal mund të duket shumë i ndërlikuar dhe i paqartë. Për këtë kontribuon ndryshimi i vendit të ngjarjes dhe ndryshimi i gjendjes faktike, kryerësi i panjohur, dëshmitarët e pasigurt, mungesa e provave materiale etj. Gjithashtu, vepra penale mund të fingohej. Ose, midis dëshmitarëve okular mund të gjendet ndonjë person me cilësi të ndryshme morale, me tipare të ndryshme të karakterit, me aftësi të ndryshme intelektuale, etj.

Kriminalisti duhet të konfirmojë veprën penale, të gjejë shkakun, të vërtetojë lidhjet shkakore, të zbulojë të vërtetën materiale dhe të përgatisë gjendjen faktike me qëllim të ngritjes së suksesshme të procedurës penale. Rëndom, në fillim, nuk dihet se cilat fakte duhet të eliminohen, ndërsa cilat duhet të ruhen, cilat fakte janë të padobishme, ndërsa cilat janë kryesore dhe kyçe. Dalja nga kjo situatë është e mundshme vetëm nëpërmjet planifikimit operativ. Plani sistemues dhe i shtruar në mënyrë të hollësishme e orienton dhe e disiplinon nëpunësin operativ, siguron qëndrim kritik dhe vetëkritik, mundëson gjetjen me kohë të mangësive dhe zbrazëtime.

Të përfundojmë: kriminalistika bashkëkohore, si ajo represive ashtu edhe ajo preventive, duhet të mbështetet te planifikimi si metodë që është e pranishme, jo vetëm në kriminalistikë por edhe në përgjithësi.

1.7. Parimi i tentimit dhe parimi themelor

Ky parim aspektin e vet të qëndrueshmërisë e merr vetëm me zbatimin e parimit të metodikës si dhe të parimit të shpejtësisë dhe të operimit. Ato njëri me tjetrin plotësohen. Me zbatimin e parimit të themeltë dhe të këmbëngulësisë shmanget aspekti sipërfaqësor dhe jo konsekuent gjatë kryerjes së përditshme të detyrave të punës të kriminalistëve. Këtë parim duhet ta iniciojë kriminalisti që nëpërmjet aktiviteteve të veta të krijojë kushte për lëndën konkrete penale në aspektin e të gjykuarit për të vazhduar ose jo me aktivitetet e mëtejshme. Kuptohet, kjo e dyta mund të vendoset nëse nuk ka elemente për aktivitete penale. “Kriminalisti duhet të përcaktojë dhe të studiojë të gjitha faktet dhe rrethanat e rëndësishme për mbledhjen e provave dhe vërtetimit gjyqësor të së vërtetës, me ç’rast, përveç kriminalistikës, kërkohet njohje e domosdoshme e zbatimit të Ligjit të procedurës penale dhe të Kodit penal.”

Parimi i themeltë dhe këmbëngulja në punën kriminalistike ndihmojnë për hulumtimin me të njëjtën vëmendje të të gjitha fakteve dhe rrethanave, si të atyre që duken të imta dhe të parëndësishme në shikim të parë, ashtu edhe të atyre të cilat janë evidente dhe të rëndësishme. Ky parim, veçanërisht duhet të vijë në shprehje atëherë kur gjatë punës paraqitet mossukses. Në këtë mënyrë, shmanget shpirtngushtësia, pesimizmi, pasiviteti dhe të tjera.

Gjithashtu, nëpërmjet parimit të këtillë zvogëlohet numri i errët i kriminalitetit. Kuptohet, duhet përmendur edhe faktin se ndonjëherë edhe përkundër përdorimit të parimit të këtillë, do të mbetet i pa sqaruar një lëndë e caktuar penale. Në raste të këtilla, është me rëndësi që kriminalisti të ndërmarrë të gjitha masat dhe

aktivitetet, duke vepruar sipas rregullave të kriminalistikës, sipas së drejtës penale proceduese etj.

Për fat të keq, në praktikë ndodh diç tjetër. Në fakt, shumë lehtë nxirren përfundime se nuk ka mundësi të bëhet asgjë më shumë për rastin konkret. Përkundër këtyre mendimeve, veprat penale konkrete zbardhen edhe pas disa vitesh pas punës këmbëngulëse dhe studimit të themeltë të fakteve.³³

Përfundimi me sukses i procedurës penale në masë të madhe do të varet nga marrja e masave dhe aktiviteteve operative taktike, gjatë procedurës para hetimore dhe gjatë hetimit.

1.8. Parimi i lirisë teknike-taktike dhe parimi i proporcionalës

Ky parim, ashtu si ato të parët ka rëndësinë e vet që nuk mund të vihet në dyshim. Në fakt, ky parim jep mundësi që kriminalisti lirisht të zgjedhë masat operative-taktike, veprimet hetuese dhe mjetet e dëshmisë gjatë çdo rasti konkret. “Ai do të zbatojë ato veprime operative dhe hetuese, si dhe do ti zbulojë dhe shfrytëzojë ato mjete dëshmuese që janë më të përshtatshme për përcaktimin e së vërtetës. Kjo ka të bëjë aq më tepër, sepse Ligji i procedurës penale askund nuk i përcakton se cilat metoda teknike-taktike do të zbatohen në atë apo këtë situatë të procedurës taktike. LPP: nëse ekzistojnë baza të dyshimit se është kryer një vepër penale e cila ndiqet sipas obligimit zyrtar, policia ligjore është e detyruar të ndërmarrë masat e nevojshme për të gjetur kryerësin e veprës penale, që kryerësi ose pjesëmarrësit e tjerë të mos fshihen ose të mos ikin, të zbulohen dhe të sigurohen

³³ Gjatë shkrimit të këtyre rradhëve mu kujtua një ngjarje ndërkombëtare e “larjes” së parave të zbuluar nga ana e agjentëve dhe nënpunësve policor gjerman, francez dhe anglez. Në fakt, me punë këmbëngulëse dhe të themeltë u duhej një periudhë prej 8 vitesh. Pas kësaj, agjentët paten një takim gazmor të përbashkët.

gjurmë të veprës penale dhe sendet që mund të shërbejnë si prova, si dhe të mbledhin të gjitha deklaratat që mund të jenë të dobishme për zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale.

Domethënë, shkak për një iniciativë të këtillë është ekzistimi i indikacioneve (baza për dyshim) rreth asaj se është kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare. Por, këtu është me rëndësi të përmendet iniciativa e kriminalistit që e arsyeton çdo burim i njoftimeve dhe çfarëdo intensiteti i shkallës së dyshimit. Në procedurën para hetimore, gjatë zgjedhjes së kombinimit të masave operative-taktike (vënia e kurtheve, pritave, ndjekjeve, angazhimeve (hedhje në prapavijë të informatorëve), privimi nga liria (arrestimi) etj) ka liri më të madhe, kuptohet, duke u nisur nga parimi i dobishmërisë, përkatësisht të përfshirjes së plotë. Por, kjo nuk do të thotë se kriminalisti duhet të mospërfillë të drejtat dhe liritë kushtetuese të qytetarëve. Me fjalë të tjera, parimi i lirisë taktike-teknike nuk ka karakter absolut, ndërsa zbatimi i tij gjithnjë e më shumë po ngushtohet në procedurën e mëvonshme (penale).

Kur bëhet fjalë për veprimet hetuese ato duhet të themelohen kryekëput te ligjet dhe dispozitat e tjera pozitive. Ndërmarrja e *corpora delictit*, e bastisjes, vëzhgimi, marrja në pyetje e të akuzuarit, dëgjimi i ekspertizës dhe i dëshmitarit, arrestimi, të mbajturit në vendin e ngjarjes dhe masat e veprimet të tjera mund të ndërmerren nëse vetëm përcaktohen ose nuk i ndalojnë dispozitat dhe ashtu si lejojnë ata. Në të kundërtën, veprimet e kundërligjshme, shpesh, sjellin në rezultate të pasakta. Në fakt, në praktikën e përditshme kriminalistike dhe gjyqësore shpesh jemi dëshmitarë, se si të dyshuarit/akuzuarit e ndryshojnë deklaratën e tyre në pretekstin se atë të parën që i detyruar ta bëjë nga forca ose kërcënimet që i janë bërë.

I afërt me parimin e lirisë teknike-taktike është edhe parimi i proporcionalës. Ky, nga ana tjetër do të thotë se nuk duhet të jetë mbi masën e domosdoshme për arritjen e qëllimeve të procedurës. Detyrimi i tepruar me forcë është i ndaluar pikërisht me qëllim që i akuzuari të mbrohet nga detyrimi i padrejtë procedural juridik. Për shembu, me saktësi është rregulluar se kur janë plotësuar kushtet për përdorimin e armës së zjarrit nga ana e nëpunësit të autorizuar zyrtar, kur bëhet bastisje etj. Parimi i proporcionalës kërkon që veprimi të shkoj deri atje ku vëllimi, përmbajtja dhe intensiteti i tij mbulohen me qëllimin e procedurës penale konkrete. Kështu, kriminalisti duhet të dozojë mjetet e detyrimit me forcë dhe të gjejë mjetet e provave në atë vëllim që e bënë të pamundshëm shtrembërimin e së vërtetës. Për shembull, rasti me trazirat në Strugë në vitin 2004 ende mbetet enigmë për opinionin në lidhje me përgjigjen ndaj pyetjes se a është përdorur forcë jo proporcionale për të vënë nën kontroll çrregullimet e këtilla. T'u përkujtojmë se pësuan shumë qytetarë, por edhe pasuritë e tyre. Në fakt, masat operative-taktike dhe mjetet hetuese duhet të planifikohen në proporcion real me rëndësinë e veprës penale, qëllimin taktik dhe vlerësimi i situatës. Nuk është e drejtë që për gjëra të vogla të ndërmerren masa të rrepta dhe masive. Gjithnjë duhet të angazhohen forcat dhe mjetet e nevojshme. Që të arrihet kjo, policisë i nevojiten kriminalistë të mirë dhe të edukuar të cilët do të dinë se si ndërtohet strategjia dhe si bëhet planifikimi. Gjithashtu, gjatë marrjes së vendimit duhet të kihet parasysh edhe momenti politik (si do të shprehën masat e ndërmarra në ndërgjegjen e qytetarëve, si do të reagojë publiku).

Dhe plotësisht në fund, të përmendim se parimi i lirisë teknike-taktike është i kufizuar edhe me parimin e aspektit ekonomik.

1.9. Parimi i udhëheqjes unike dhe i zbatimit të veprimtarisë kriminalistike

Parimi i këtillë ka rëndësi të madhe për organizimin e punës operative. Kjo theksohet aq më shumë kur ndërmerren masa dhe aktivitete të shumta operative-taktike dhe teknike. Rregullisht, gjatë aktiviteteve të këtilla paraqitet nevoja për pjesëmarrje më të madhe të një numri të personave zyrtar të autorizuar. Ky është një rast kur bëhet fjalë gjatë angazhimit intensiv të organit të zbulimeve të rasteve kriminale të vështira dhe të ndërlikuara ose për të zbuluar grupet e organizuara kriminale. Gjatë aktiviteteve të këtilla menaxhimi bëhet prej një vendi. Aktivitetet e këtilla kërkojnë formimin e ekipit të përbërë nga nëpunës kriminalistikë me përvojë (operativët, teknikët etj.).

Varësisht nga rajoni i cili duhet të mbulohet formohen edhe ekipet e tillë. Për shembull, në rajonin e një ose më shumë organeve komunale të punëve të brendshme. Nëse ka nevojë për marrjen e aksioneve më të gjera në tërë territorin e Republikës, atëherë formohet shtab³⁴ nga i cili udhëhiqet aksioni. Aksioni zhvillohet sipas një plani të përgatitur më parë, me ç'rast udhëheqësi i aksionit i ndjek rezultatet e secilit operativist të përfshirë në aksion. Udhëheqësi jep detyra dhe orienton aksionin, tek ai mbledhen të gjitha raportet, informacionet dhe të dhënat. Ato studiohen, analizohen, bëhet seleksionimi i tyre, plotësohet ose ndryshohet plani i aksionit etj. Në këtë mënyrë sigurohet aksion unik dhe i sinkronizuar deri në realizimin e aksionit, ose deri në përfundimin e tij.

³⁴ Për shembull, një shtab i këtillë u formua në rastin e tentimit për atentat ndaj Kryetarit të republikës së Maqedonisë z. Kiro Gligorov. (për të shqyrtuar një dukuri të caktuar kriminale si kërcënim i sigorisë në nivel të RM, me qëllim të kryerjes së analizës dhe profilizimit të personave, grupeve kriminale dhe të objekteve zhvillohet aksioni operativ republikan i cili mund të organizohet edhe për shkak të dukrive të rëndësishme të sigorisë nga ana e njësive të ndryshme organizuese të policisë.

Gjithashtu, parimi i unitetit në udhëheqje duhet të zbatohet domosdo edhe në rastet kur ndërmerren aktivitete, kur përveç policisë, është përfshirë edhe prokurori publik.

Nga ana tjetër, ndërmarrja pa lidhje, e izoluar dhe e pa harmonizuar e aksioneve të veçanta, në praktikë mund të shkaktojë ngecje të zbulimit të aktit penal dhe të aktorit.

Parimi i unitetit në udhëheqje, si dhe uniteti gjatë aksionit kriminalistik, janë kushti themelor për punë të suksesshme, duke marrë parasysh kompleksin e veprave të caktuara penale dhe aktiviteteve kriminale në përgjithësi.

1.10. Parimi ekonomik në procedurë

Ky parim jep obligim për përfundim racional të procedurës para hetimore, përkatësisht të përpunimit operativ. Kuptohet, me kusht që kjo të mos ndikojë ndaj efikasitetit gjatë zbardhjes së aktit kriminal dhe gjatë zbulimit të kryerësit të panjohur. Parimi ekonomik ka të bëjë edhe me ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve adekuate. Me këtë rast ndërmerren vetëm ato masa dhe aktivitete që janë të domosdoshme. Ndërmarrja e aktiviteteve nga ana e nëpunësve operativ duhet të shkojë në drejtim të mos shkaktojë dëme të panevojshme ndaj personave të tretë. Gjithashtu, sipas natyrës së këtij parimi, duhet vepruar në mënyrë shumë restriktive ndaj atyre indiceve, fakteve dëshmuese dhe mjeteve të provave të cilat nuk lidhem me lëndën penale. Këto janë faktet që e prolongojnë përpunimin operativ ose kur provat e këtilla janë shumë të shtrenjta, ndërsa nuk ndikojnë esencialisht në rrjedhën e procedurës para hetimore, përkatësisht në procedurën penale. Kështu për shembull do të ishin ato fakte të cilat janë evidente ose të cilat janë përgjithësisht të njohura, prandaj edhe nuk duhet të dëshmohen. Por, edhe vetë mënyra

gjatë mbledhjes së provave mund të jetë e gabuar dhe joekonomike. Duhet të përfshihen edhe informacionet të cilat na shpijnë në prova të cilat është e pamundur që të mblidhen. Gjatë zbatimit të këtij parimi nuk duhet të lehen pas dore edhe disa parime të cilat janë në lidhje të ndërsjellë dhe të ngushtë. I këtillë, në radhë të parë do të ishte parimi i së vërtetës. Kursimi i tepërt dhe ekonomizimi nuk duhet të jenë aleat të iluzioneve gjyqësore, përkatësisht kriminalistike. Ose thënë ndryshe me qëllim që të arrihet në të vërtetën reale duhet të ndërmerren në mënyrë përkatëse masat dhe aktivitetet e nevojshme, qofshin ato të lidhura me shpenzime më të mëdha. Parimi i ekonomizimit, duhet të jetë në lidhje të ngushtë me parimin e: ligjshmërisë, humanizmit, proporcionalës, metodikës dhe të planifikimit.

1.11. Parimi i ruajtjes së sekretit zyrtar

Parimi i këtillë është një nga themelorët të cilit duhet t'i përmbahen kriminalistët. Nocioni i sekretit zyrtar është i paraparë edhe me dispozita ligjore.

Por, parimi i fshehtësisë zyrtare nuk ka të bëjë me të njëjtën masë tek të gjitha masat dhe aktivitetet operative-taktike. Disa ndërmerren në mënyrë tërësisht konspirative, kështu është, për shembull: vëzhgimi special, ndjekja, kontrollimet konspirative, kurthet, shfrytëzimi i të dhënave nga njësitë operative. Të tjerat nga njëra anë zhvillohen haptas(publike), si për shembull, veprimtaria e gatishmërisë dhe e patrullimit, sigurimi i vendit të ngjarjes, përdorimi i qenve zyrtar, verifikimi i alibisë, racioni (vetëm në pjesën e zbatimit, por jo në fazën e planifikimit). Kjo është karakteristike edhe për disa veprime hetimore, si për shembull, kontrollimi, bastisja etj.

Dhënia e fshehtësisë zyrtare nëpërmjet mjeteve të informacionit mund të ketë zhvillim të pavoritshëm për suksesin e hetimit. Gjithashtu edhe informacioni i shpejtuar për ndërmarrjen e masave të veçanta operative-taktike mund të ketë zhvillim të pavoritshëm. Gjatë situatave të këtilla, i dyshuari mund të organizojë mbrojtjen e tij, të përgatisë alibi, ose të ikë jashtë kufijve, të fshijë gjurmët dhe sendet të kryerjes së aktit penal, t'u bëjë instruksione dëshmitarëve, të ndërmarrë edhe aktivitete të tjera të cilat do ta vështirësojnë ose do ta bëjnë të pamundshëm veprimin operativ dhe hetimor. Edhe dëshmitarët qëllimshëm, nëpërmjet deklaratave të tyre të parakohshme mund t'i bëjnë dëm efikasitetit të organeve policore dhe të organeve të gjyqësisë gjatë përfundimit të procedurës para hetimore, përkatësisht penale.

1.12. Parimi i humanitetit

Çdo njeri e ka të qartë se natyra ekziston edhe pa njeriun. Por, është e vërtetë se çdo gjë në botë merr vlerën e vet vetëm kur vihet në raport me njeriun. Të gjitha vetitë negative e shkatërrojnë dinjitetin dhe nderin e njeriut. Dinjiteti është unitet i elementeve intelektuale, emocionale dhe të vullnetit. Për filozofin e madh Kant dinjiteti varet nga arsyeja (intelekti). Pikërisht arsyeja ka bërë të mundshme që njeriu të trajtohet si qëllim, dhe jo si mjet. Pasi elementi racional, emocional dhe i vullnetit paraqiten si pjesë të vetëdijes njerëzore, ato si të tilla janë pjesë përbërëse të dinjitetit.

Çdo kufizim ose presion ndaj funksionimit të tyre është kufizim dhe presion i dinjitetit njerëzor.

Sulmi ndaj këtyre elementeve duke bërë që të pranohet me forcë do të thotë sulm edhe ndaj dinjitetit të njeriut. I dyshuari është subjekt (qenie sociale si bartës i dinjitetit) gjersa kriminalisti

i lejon atij të zgjedhë pa pengesa variantin e sjelljes së tij gjatë bisedës. Nëse kriminalisti sillet në mënyrë antiligjore, ai bënë akt penal, kriminalizohet, e humb dinjitetin e vet etj. Në këtë mënyrë ai bëhet inkuizitor, ndërsa të akuzuarin e degradon duke e shndërruar atë në objekt, duke ia shkatërruar atij vullnetin. Nëse bënë lëshime i dyshuari (pa marrë parasysh faktin se është fajtor ose i pafajshëm) vullneti i tij është përcaktuar nga vullneti i paligjshëm dhe i pamoralshëm i kriminalistit, prandaj e ka humbur dinjitetin njerëzor dhe është bërë objekt i inkuizitorit. Ndërsa, nga ana tjetër nëse ka vullnet të fortë që në mënyrë serioze t'i kundërvihet sulmit ndaj vullnetit të tij, ai ka mundur që të mbrojë dinjitetin e vet³⁵. Dinjitet do të thotë mbrojtje dhe zhvillim i normave dhe idealeve shoqërore. Dinjiteti i njeriut përbëhet nga synimi i personalitetit drejt idealeve të shoqërisë me vendim dhe vullnet të tij. Kryerësi i krimit e humb dinjitetin e vet konkret me bërjen e krimit. Por, edhe atij nuk mund dhe nuk guxohet t'i mohohet përkatësia në gjininë njerëzore për çka ai mbetet të jetë subjekt i procedurës para hetimore dhe penale. Prandaj subjektiviteti i tij mund të kufizohet vetëm në bazë të dispozitave ligjore.

Nocionet e lirisë dhe të dinjitetit janë të lidhura në mënyrë të pandashme edhe me nocionet e mira dhe e keqja. Ata që bëjnë mosrespektim të ligjit (anarki) me pranim të krimit me forcë, e shkatërrojnë dinjitetin e tyre. Ato, jashtë humanitetit kanë keqpërdorur dhe e kanë tradhtuar detyrën e vet, duke shkelur parimin juridik dhe etik të identitetit të dinjitetit të të dyshuarit. Në këtë mënyrë e kanë humbur edhe dinjitetin e vet konkret.

³⁵ Qeveria e Maqedonisë është e thirrur të shqyrtojë të gjitha shkaqet, sjelljet dhe pasojat të arrestimeve, përfshirë edhe zbulimin e informacioneve të besueshme shëndetësore nga ana e policisë dhe të ekspozuarit e të arrestuarve ndaj sjelljes nënçmuese, si dhe mos pasjes së bazës për kallëzim penal të lidhura me transferimin e sëmundjeve infektuese- theksohet në rekomandimin e organizatave jo qeveritare ndërkombëtare”.

Në çdo shoqëri praktika e procedurës para hetimore është indikator i pagabuar se sa një shoqëri e caktuar ka përparuar në rrugën e respektimit të dinjitetit të personalitetit. Për fat të keq, nëpunësit policor, shpesh herë shërbejnë me mënyra taktike makiaveliane. Në këtë arsenal si mjete brutale bien: sjellja e dhunshme, dhuna, dyfytësia, nënçmimet, kërcënimet, mashtrimet, gënjeshtret, mbjellja e frikës etj. Shumë policë në mënyrë intime janë në antagonizëm me zbulimin e veprës penale dhe etikën si gjoja kategori të papajtueshme. Në këtë mënyrë arsyetojnë metodat e tyre johumane dhe të pamoralshme gjatë marrjes së pranimit. Këto qëndrime janë në kundërshtim me etikën profesionale të policisë dhe të kodeksit të sjelljes së nëpunësve policor ndaj subjekteve gjatë kontaktit zyrtar.

Pas pavarësimit të Republikës së Maqedonisë tek ne së pari u vu kodeksi policor, i cili sipas përmbajtjes modeste vetëm mjerisht i plotësonte standardet ndërkombëtare policore deontologjike. Në vitin 2004 u miratua një Kodeks kompleks i etikës policore që përmban 65 dispozita, dhe është shpallur në “gazetën zyrtare” nr. 3 të datës 3 deri 26 01. 2004.

1.13. Parimi i qasjes aktive kriminalistike dhe i zhvillimit konsekuent të parandalimit kriminalistik

Në periudhën e jetës bashkëkohore, tanimë është koha që në ndërgjegjen e të gjitha subjekteve të procedurës para hetimore dhe penale të depërtojë thellë ideja se më mirë është, por edhe më lirë të veprohet në mënyrë preventive se sa të vonuar, përkatësisht post festum. Për shembull, në evidencat kriminalistike dhe në bazat e të dhënave futen të dhëna për kriminelët-ripërtëritës, për delikuentët profesional, për kryerësit që e kanë shprehur, për të miturit të cilët janë regjistruar më si ripërtëritës dhe ndaj tyre

bëhet observim special dhe mbikëqyrje e përforcuar. Ndërsa kjo, nga ana tjetër është e lidhur me përpjekje plotësuese të nëpunësve policor, por edhe me shpenzime plotësuese dhe të paparapara. Prandaj nëpërmjet punës policore duhet të vërehen tendencat më të reja kriminale dhe në mënyrë të organizuar për të bërë përpjekje për ndërprerjen e tyre që në nismë. Në këtë drejtim duhet të përvetësohen dhe të zbatohen mjete më të reja kriminalistike-teknike parandaluese. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme të organizohen kontakte ndërmjet policisë ligjore dhe opinionit të gjerë në formë tribune, nëpërmjet ligjëratave ose nëpërmjet medimeve, me qëllim që qytetarët të edukohen në drejtim të rritjes së vetëmbrojtjes së tyre dhe përmirësimit të bashkëpunimit me policinë ligjore dhe me organet e tjera kompetente. Mbajtja e kontakteve të drejtpërdrejta me qytetarët duhet të jetë punë e përditshme e personave të autorizuar zyrtar. “Ne na duhen policë të edukuar mirë të cilët janë të aftë të komunikojnë me njerëzit në vend se të japin vetëm urdhra pa ndonjë shkak të rëndësishëm. Kështu për shembull, nëpërmjet hapjes së ndonjë këshillimore për qytetarët në lokalet e stacionit policor: mbajtja e takimeve të rregullta në kuadër të bashkësisë lokale dhe të atyre që janë afër; mbajtja e patrullimeve të rregullta në kuadër të programit për mbrojtje të fqinjëve (aksioni “nga dera në derë”) ; vënia dhe kultivimi i kontakteve me të rinjtë, si dhe me kryerësit e regjistruar dhe atyre potencial për vepra penale, si dhe me viktimat potenciale. Në këtë mënyrë rritet siguria e qytetarëve dhe përmirësohet cilësia e jetesës në radhë të parë, në bashkësinë lokale. Gjithashtu, përforcohet partneriteti dhe qasja më aktive e policisë.

1.14. Parimi i bashkëpunimit ndërkombëtar policor

“Gjatë dy dekadave të fundit bota ballafaqohet me një rritje sa më intensive nga kërcënimet e aktiviteteve bashkëkohore ndërkombëtare ose transnacionale, të cilat për qëllime të veta i shfrytëzojnë të gjitha të arriturat e zhvillimit teknologjik bashkëkohor³⁶.

Prandaj, pa një bashkëpunim të ngushtë dhe të gjithanshëm është e pamundur të mënjanohet fenomeni i këtillë shoqëror. Gjithashtu, krimi i organizuar merr forma të reja cilësore të cilat shpien në krimin e organizuar ndërkombëtar. Kriminelët përdorin mjete dhe pajisje të sofistikuara teknike dhe realizojnë profite të mëdha financiare të cilët i tejkalojnë kufijtë e shteteve. Sot, grupet kriminale paraqesin kërcënim për sovranitetin, për qeveritë, për kontrollin shtetëror, si dhe për vlerat demokratike, institucionet publike, ekonominë kombëtare dhe për individët.


Si përgjigje ndaj krimit të ndërlidhur ndërkombëtarisht është bashkëpunimi kriminalistik ndërkombëtar. “Përveç mbajtjes së formave të vjetra të relacioneve ndërkombëtare policore në formë të organizatave ndërkombëtare të policisë ndërkombëtare, janë instaluar dhe zhvilluar forma dhe struktura të reja me qëllim mënjanimin i krimit ndërkombëtar të sinkronizohet dhe të ngrihet në nivel më të lartë.

³⁶ Një nga format e strategjisë parADNaluese është e ashtuquajtura “patrullë civile”. Patrullat e këtilla paraqesin lloje të organizuara për mbrojtje të një rajoni nga zbatimet e aktiviteteve kriminale. Prania e patrullës civile është në baza vullnetare, ndërsa detyra e tyre parADNaluese është të patrullojnë një rajon të caktuar dhe kur do të vërehet aktivitete kriminale ato vetë të intervenojnë ose të kërkojnë ndihmë nga shërbimet policore. Po, veprimi themelor parADNalues i patrullës civile është frikësimi.

1.14.1. *Interpoli*

Organizata e Interpolit e mundëson bashkëpunimin përtej kufijve të një shteti, i përkrahë dhe bën asistencë të gjitha organizatat, autoritetet dhe servilet misioni i të cilave është të luftojnë kundër krimit ndërkombëtar.

Emblema e Interpolit



Flamuri I Interpolit

Nga viti 1989 e këndej, Sekretariati i përgjithshëm u vendos në Lion, Republika e Francës. Organizata deri atëherë ishte e vendosur në Paris, në ripërtëritjen e saj në vitin 1946. Interpoli funksionon 24 orë në ditë, 365 ditë në vjet dhe ka 4 gjuhë zyrtare- anglisht, frëngjishte, spanjisht dhe arabisht. Interpoli gjithashtu përbëhet edhe nga 5 Byro regjionale dhe atë në: Harare, Abixhan, Najrobi, Buenos Aires dhe San Francisko, plus një përfaqësi në Bankok. Këto qendra bëjnë të mundshëm thellimin e njohurive për kriminalitetin në këto rajone, dhe koordinojnë operacionet për mënjanimin e kriminalitetit ndër vendet e këtyre regjioneve.

Çdo vend anëtar ka Byronë e vet kombëtare qendrore (BKQ) që e përbëjnë oficerët policor të vendit. Byroja është edhe organi themelor për komunikim me Sekretariatin e përgjithshëm, me byrotë regjionale dhe me vendet e tjera anëtare të cilat kërkojnë ndihmë gjatë hetimit, gjatë përcaktimit të vendit dhe gjatë arrestimit të kriminelëve sipas ligjit.

Kushtetuta e Interpolit ndalon çdo ndërhyrje ose aktivitet të karakterit politik, ushtarak, religjioz ose racist. Qëllimi i tij është të vendoset kooperim policor edhe ndërmjet vendeve të cilët nuk kanë marrëdhënie diplomatike. Aksionet që ndërmerren në një shtet të caktuar, janë në pajtim me ligjet e tij dhe në frymën e Deklaratës Universale të të drejtëve të njeriut.

Në tekstin e mëtejshëm do të përqendrohemi (në pika të shkurta) në fillimin e punës së kësaj organizate. Ajo daton nga viti i largët 1914, kur në Monako u mbajt Kongresi i parë ndërkombëtar policor, në të cilin merrnin pjesë oficerë policor, juristë e tjerë, nga 14 shtete të ndryshme.

Në vitin 1923 u formua International Criminal Police Commission ((ICPC) me seli në Vjenë, ndërsa me iniciative të dr. Johan Dhober, drejtor i Policisë së Vjenës.

Paraqitja grafike e strukturës organizative të Interpolit



Në vitin 1942, Organizata me forcë u transferua në Berlin, Gjermani, dhe vihet nën ombrellën e regjimit nazist. Së shpejti, veprimtaria e saj shuhet. Por, në vitin 1946, Belgjika shtënë krye të strukturimit të sërishëm të ICPC, me seli në Paris. Tre vjet më vonë u zgjodh edhe emblema zyrtare e organizatës.

Në vitin 1956, ICPC plotësisht e modernizuar e merr emrin e ri ISPO- ose kuptimisht si Interpol. Në vitin 1971 kjo organizatë njihet edhe nga Organizata e Kombeve të Bashkuara si organizatë ndërkombëtare ndërqeveritare.

Në vitin 2002 instalohet sistemi informativ dhe telekomunikues i sigurisë së lartë 1-24/7, i cili e përmirëson dhe lehtëson në mënyrë esenciale qasjen tek informacionet kriminalistike të Byrove kombëtare.

Me Kushtetutën e Interpolit, rregullohet edhe struktura, funksionet, fondet dhe relacionet me organizatat e tjera ndërkombëtare. Sipas saj, Interpoli përbëhet prej: Kuvendi i

përgjithshëm, Komiteti ekzekutiv, Sekretariati i përgjithshëm, Byrotë kombëtare qendrore dhe nga këshilltarët. Të gjitha trupat e Interpolit janë të lidhura në mënyrë specifike dhe funksionojnë në kuadër të Kushtetutës.

Kuvendi i përgjithshëm është trupi suprem i organizatës dhe përbëhet nga delegatë të përcaktuar nga çdo vend anëtarë. Mblidhet një herë në vjet dhe me këtë rast merren vendimet më të rëndësishme të cilat kanë të bëjnë me: politikat, resurset, metodat e punës, financat, aktivitetet dhe programet e Interpolit. Gjatë votimit çdo vend anëtar ka një votë, të barabartë me votat e të gjithë shteteve anëtare të tjera.

Komiteti ekzekutiv zgjidhet në Kuvendin e përgjithshëm, ndërsa përbëhet nga 13 anëtarë (kryetari, tre nënkryetarë dhe nëntë delegatë) të cilët i përfaqësojnë të gjitha regjionet e ndryshme (vendet anëtare janë ndarë në 4 regjione: Afrika, Azia, Amerika dhe Evropa, pastaj ka ndarje edhe sipas zonave gjeografike dhe gjuhësore, që të lehtësohet komunikimi i drejtpërdrejtë).

Kryetari ka mandat 4-vjeçar, ndërsa nënkryetarët mandat 3-vjeçar.



Sekretariatit e përgjithshëm e drejton sekretari gjeneral, i cili gjithashtu bënë menaxhimin e personelit teknik dhe administrativ, të cilëve u janë besuar të gjitha obligimet e punës në organizatë. Gjithashtu, sekretari i përgjithshëm është funksionar në organizatë dhe përfaqësues i saj zyrtar, me mandat prej 5 vjetësh dhe me të drejtë rizgjedhjeje. Ai emërohet nga ana e Komitetit ekzekutiv, ndërsa zgjidhet me shumicë prej dy të tretave të Kuvendit të përgjithshëm.

Kur bëhet fjalë për pjesën tjetër strukturale të Interpolit – këshilltarët, janë ekspertë me rrol të pastër këshillëdhënës. Ato i emëron Komiteti ekzekutiv, ndërsa këtë emërim e vërteton Kuvendi i përgjithshëm.

Interpoli përqendrohet në tre fusha, që i paraqesin funksionet e tij themelor. Këto janë:

- Shërbimet policore komunikuese të sigurisë globale-kushti themelor për bashkëpunim ndërkombëtar policor të realizuar nëpërmjet sistemit të përmendur të komunikimit.
- Bazat operative të të dhënave për policinë- posa policia i një shteti të caktuar vë komunikim ndërkombëtar, asaj i nevojiten informacione, që do t'i ndihmonin në parandalimin e krimit, dhe për të ndihmuar hetimin që është në rrjedhë e sipër. Prandaj Interpoli ka të zhvilluar një bazë të përgjithshme të të dhënave, që mbulojnë fusha të ndryshme të interesit. Nga emrat e individëve, shenjet (gjurmët) e tyre, fotografitë dhe ADN³⁷, deri te –dokumentet e

³⁷ Acidi dezoksidibonuklear paraqet acidin nukleik i cili gjendet vetëm në bërthamën e qelizës, për dallim nga acidit ribonukleik i cili haset edhe në citoplazmë. Struktura themelore e ADN është e njëjtë të të gjithë llojet e organizmit, me përjashtim të disa virusëve. Molekula e ADN ndërtohet nga dy vargje polinukleotid, me përdredhje specifike në një spiralë të dyfishtë. Çdo varg është polimer i njësive monomere- nukleide. Struktura

identifikimit, dokumentet e udhëtimit dhe shumë shënime të tjera të rëndësishme. Informacionet me cilësi të lartë, ndikojnë në avancimin e hetimeve policore dhe ndaj parandalimit të krimit anë e mbanë botës.

- Shërbimet operative përcjellëse të policisë- përparësitë momentale të Interpolit, në lidhje me programet e luftës kundër krimit janë: terrorizmi, krimi i organizuar, kriminaliteti me drogë, kontrabanda me “mall të bardhë”, krimi bashkëkohor financiar i cilësisë teknologjike të lartë. Projektet e tjera që janë në rrjedhë, i përfshijnë edhe pornografinë në Internet, vjedhjet e automjeteve dhe të veprave artistike, bioterrorizmi, trajnimi i policisë dhe bashkëpunimi me organizatat tjera ndërkombëtare.

Funksioni i mëtejshëm i gjetjes së personave të cilët kërkohen për krime të bëra, nëpërmjet lëshimit të urdhrave të arrestimit dhe të ekstradimit, nga të cilët më i njohur është Urdhri (dekreti) i kuq, që e lëshon Interpoli si kërkesë ndërkombëtare drejtuar të gjitha policive, duke u bazuar në urdhrin e lëshuar nga shteti ku është kryer krimi.

Interpoli ka vënë relacione të fuqishme me shumë organizata të ndryshme ndërkombëtare (me organizata jo

themelore e njësisë së ADN paraqet nuleomidom. Ai përbëhet nga dy komponentë kimik me lidhje kovalente. Komponimi i parë paraqet sheqerin pentoz, me të cilin dallohen ADN dhe ARN, përkatësisht deoksiriboza e cila hynë në përbërje të ADN dhe riboza e cila hynë në ARN. Komponenti tjetër është baza atotike e purinit ose e piramidinit i cili ka lidhje kovalente me atomin e parë karbonik (1C) të pentozës, me çrast krijohet nukleoziti. Në molekulën e ADN të bazave të purinit hynë: adeina dhe gvanina, ndërsa nga bazat piramidine: citozina dhe timini. Në molekulën e ARN gjenden të njëjtat baza, por në vend të timinit është uraci. Komponimi i tretë në plukletid paraqet grupin fosforik ose acidin fosforik. Molekulat e ADN dallohen sipas madhësisë (e cila varet nga numri i nukleotideve).kështu, ADN e viruseve ka disa mijëra nucleotide, ADN e kromozomit të bakteve ka disa milion nucleotide, ndërsa në 46 kromozome të njeriut- disa miliarda nukleotide. ADN është prgjegjëse për përcjelljen e vetive të trashëgimisë të organizmave, si dhe të ndryshimit të tyre. Ajo është material bartës i informacioneve të sintezës së proteinave dhe të acideve robine.

(Shih : [http://mk.vvikipedia.org/wiki%D\(\)%94%D\(\)%9D%%9A](http://mk.vvikipedia.org/wiki%D()%94%D()%9D%%9A))

qeveritare dhe qeveritare), me qëllim që të shmanget dublimi i përpjekjeve dhe i mjeteve që shpenzohen në projektet antikriminale.

Burimet primare të mjeteve financiare që i shfrytëzon Interpoli janë kompensimet vjetore të qeverive të vendeve anëtare. Edhe pse i limituar- megjithatë buxheti i Interpolit, shfrytëzohet gjatë asistimit të vendeve anëtare në zgjidhjen e problemeve kriminale shumë bilionësh.

Me manifestimet bashkëkohore të terrorizimit dhe me masivitetin e krimit të organizuar anë e mbanë botës, ekzistimi, funksionimi i drejtë dhe avancimi i organizatës sikurse është Interpoli, është me interes vital për mbajtjen e hapit me strukturat kriminale dhe terroriste.

Në periudhën e re (shekulli i ri), Interpoli hyn me një përcaktim të fuqishëm, në radhë të parë për mënjanimin e kërcënimeve për jetën e njerëzve dhe rregullin juridik të përgjithshëm (global) si dhe për ruajtjen e sigurisë kombëtare të shteteve që janë anëtare.

ROLI I INTERPOLIT NË NDJEKJEN NDËRKOMBËTARE

Ndjekja ndërkombëtare e personave dhe sendeve merr vendin qendror në punën e INTERPOLIT si sistem për bashkëpunim ndërkombëtar. Ndjekja ndërkombëtare kushtimisht mund të ndahet në ndjekje të personave dhe ndjekje të sendeve.

Ndjekja ndërkombëtare e personave

Si një nga funksionet më të rëndësishme të INTERPOLIT është që tu ndihmoj policive nacionale të vendeve anëtare gjatë këmbimit të informatave për çka shfrytëzohet sistemi fletë-arresteve ndërkombëtare dhe shpalljet të njohura si “nota të INTERPOLIT”. Këmbimi i informatave ka të bëjë me: personat që kërkohen për ekstradim për shkak të veprës së rëndë të kryer; persona që duhet të vuajnë dënim më të rëndë me burg; persona të humbur; trupa të paidentifikuar; sende të vjedhura; kërcënime të mundshme; si dhe të dhëna për modus operandi.

INTERPOLI notat e lartpërmendura i lëshon me kërkesë të zyrave nacionale qendrore dhe me kërkesë të Gjykatës së Hagës, ed he atë në katër gjuhë zyrtare të INTERPOLIT: gjuha angleze, arape, franceze dhe spanjolle. Për shkak të zbatimit sa më efikas të këtyre aktiviteteve, notat shënohen me ngjyra të ndryshme, edhe atë: me të kuqe, të verdhë, të gjelbër, të kaltër, të zezë dhe të portokall.

Ndjekja e personave bëhet me fletë-arrest, gjegjësisht me notë e shënuar me ngjyrë e kuq e. Nota e kuqe i përfshin këto informata: të dhëna për përcaktimin e identitetit të personit për të cilin ka të bëjë ajo; të dhëna për pamjen fizike të personit; fotografia dhe gjurmët nga vijat papilare nëse ato janë të arritshme për zyrën nacionale qendrore që ka kërkuar të jepet fletë-arrest; informata relevante për personin (profesioni, cilët gjuhë i flet, etj); të dhëna gjyqësore për veprën penale ose për sanksionin që duhet ta vuaj personi i kërkuar.

Ja se çka përfshin notat që më lartë i përmendëm



NOTA E KUQE – përdoret për ndjekjen e personave që kërkohen me fletë-arrest ndërkombëtare i shpallur nga ana e gjykatës kompetente. Pas zënies, personat arrestohen dhe ekstradohen.



NOTA E VERDHË – përdoret për gjetjen e personave të humbur (veçanërisht të miturve) si dhe të ndihmoj gjatë identifikimit të personave që nuk janë të aftë vet të identifikohen.



NOTA E KALTËR – përdoret për grumbullimin e informatave plotësuese për identitetin e personit ose ngjarjes penale.



NOTA E ZEZË – përdoret për vërtetimin e identitetit të trupave të panjohur.



NOTA E GJELBËR – përdoret për të paralajmëruar dhe për dhënien e të dhënave relevante kriminalistike për personin i cili ka kryer veprë penale, si dhe dyshohet se mund ti përsërit në territorin e shteteve tjera.



NOTA E PROTOKALL – përdoret për paralajmërim të policisë dhe shoganeve tjera shtetërore ose organizatave ndërkombëtare për kërcënim të mundshëm ndaj tyre me armë të fshehur, bomba postare dhe me mjete tjera.

1.14.2. *Evropoli*

Policia evropiane është themeluar me të ashtuquajturën Marrëveshje Shengen³⁸, e cila rregullon çështjet e sigurisë pas bashkimit të Evropës dhe heqjes së kontrollit të kufijve ndërkombëtar.



Qendra e Europolit në Hag - 2009

Evropoli është themeluar nga ana e vendeve anëtare të Bashkimit evropian. Selinë e ka në Hagë, ndërsa punën e ka filluar në vitin 1999. “organizimi i brendshëm i Europolit i përgjigjet pozitës së tij si trup mbinacional të vënë me marrëveshje ndërkombëtare (Konventë). Organi më i lartë është Këshilli drejtues i përbërë prej aq anëtarësh sa ka edhe shtete anëtare. Organ ekzekutiv i Europolit është drejtori, i cili ka katër zëvendës, të gjithë të emëruar me vendim unanim të këshillit me

³⁸ Të motivuar nga dëshira që të realizohet një përparim më i madh nga ai që më është realizuar në kuadër të kontekstit të Bashkimit Evropian, më 14 qershor të vitit 1985 , Belgjika, HolADNa, Luksemburgu, R.F. Gjermanisë dhe Franca e nënshkruan Marrëveshjen e Shengenit për hjekje graduale të kontrollit të kufijve të përbashkët, ndërsa për zbatimin e kësaj u nënshkrua Konventa e veçantë (19 qershor 1990) ose e ashtuquajtura “Konventë implementimi” (Shih për më tepër tek S. Angeleski, “Modeli i Shengenit të integritimit: kërcënim ndaj lirisë së lëvizjes?”).

mandat prej katër vjetësh dhe me mundësi për rizgjedhje së pakur një herë. Drejtori i emëron dhe i shkarkon personat zyrtar (agjentet) e Evropolit, pas një regrutimi tepër seleksionues nga radhët e personave policor të dëshmuar si ekspert në shtetet anëtare (në një numër prej 250 prej të cilëve 50 janë oficerë për lidhje) janë në marrëdhënie pune të përhershme profesionale me Evropolin, me të gjitha privilegjet dhe me imunitetin e funksionarëve të verdhe me obligim për kryerje të pavarur të detyrave të tyre dhe për të ruajtur sekretin (fshehtësinë) zyrtar.

Evropolin e përbëjnë edhe trupat kombëtare, si organe unike për lidhje me Interpolin dhe me strukturat e tjera kombëtare policore. Gjithashtu, duhet përmendur se çdo shtet nënshkrues i Konventës është i obliguar të caktojë edhe organin përkatës për mbikëqyrje të punës së njësitit kombëtar për sigurimin e mbrojtjes së të dhënave personale të drejtave të qytetarëve.

Detyra e Evropolit është përmirësimi i kooperimit ndërmjet policive dhe qeverive të shteteve anëtare dhe rritja e efikasitetit në mënjanimin e formave më të rënda të krimit të organizuar i cili e cenon sistemin e sigurisë në Evropë. Posaçërisht i kushtohet vëmendje tregtisë me drogë; zbulimit të rrjetit të migrimit klandestin në Bashkimin Evropian; mënjanimin e terrorizmit; të vjedhjes dhe tregtisë ilegale me automobila; tregtisë me njerëz përfshirë këtu edhe pornografinë e fëmijëve; falsifikimin e parave (eurove) në Bashkimin evropian; larjes së parave etj. Përveç këtyre që u përmendën, Evropoli merret edhe me mënjanimin e kriminalitetit financiar dhe kriminalistik si dhe të veprave më të rënda kundër personave nëse janë përfshirë në krime në dy ose më shumë shtete –anëtare.

Evropoli nuk ka funksionin e një strukture klasike federale: për të kryer hetime policore në situata konkrete, për të zbatuar masa hetimore speciale policore, të arrestojë etj. Në fakt, Evropoli

është qendër e këmbimit të informacioneve. Aktivitetet operative i ndërmarrin shërbimet policore të shteteve anëtare. Për mënjanimin efikas të detyrave të ndërlikuara, është instaluar sistemi kompjuterik i Evropolit. “Sistemi përmban baza të të dhënave, të cilave mund t’i qasen njësitet kombëtare, Interpoli ose shtete të tjera; dosjet për raste të veçanta, me të dhëna për viktimat, dëshmitarët ose në përgjithësi për personat që mund të japin ndonjë informacion për rastin, nëpërmjet të cilave mund të bëhen analiza të përgjithshme ose përpunime operative; dhe indeksin e të dhënave në të cilin kanë qasje shërbimet e Evropolit dhe oficerët për lidhje.

Duke përfunduar vlen të përmendet edhe fakti se në këtë periudhë të shkurtë të ekzistimit dhe veprimet, Evropoli ka arritur rezultate të rëndësishme.

1.14.3. *Format e bashkëpunimit regional kriminalistik*

Në botë themelohen edhe forma të bashkëpunimit regional me detyrë për të koordinuar luftën kundër formave të ndryshme të kriminalitetit. Kështu, në vitin 2003 nën patronazhin e Komisionit të sigurisë dhe bashkëpunimit evropian (KSBE) u themelua asociacioni policor që i përfshinë shtetet e Ballkanit jugperëndimor (të gjitha shtetet e ish RSFJ, Shqipërinë, Bullgarinë dhe Rumaninë) me detyrë që të organizuar luftën kundër krimit të organizuar që e ka prekur rajonin e përmendur, dhe vendet e Bashkimit evropian. Për një punë sa më efikase, është paraparë edhe stërvitja e kuadrove të policisë, pajisja teknike, formimi i bazave të përbashkëta kompjuterike etj.

1.14.4. *Organizatat e specializuara ndërkombëtare*

Gjithashtu, në botë formohen edhe organizata ndërkombëtare të specializuara që trajtojnë çështje dhe probleme të veçanta në lëmin e kriminalistikës. Qëllimi i tyre është zhvillimi i standardeve për veprim optimal kriminalistik. Një nga këto shoqata është edhe asociacioni për zhvillim të shkencës forenzike (Forensis Science Society). Gjithashtu ekzistojnë edhe shoqata të tjera të specializuara dhe organizata jo qeveritare, qëllimi i të cilave është përparimi i metodave dhe i bashkëpunimit ndërpolicor. Kështu për shembull FATF, Ermont merren me mbrojtjen nga “larja” e parave të tjera.

1.14.5. *Bashkëpunimi bilateral policor*

Ky lloj bashkëpunimi është një ndër bashkëpunimet më të vjetra ndërmjet policive. Në radhë të parë, zhvillohet në nivelin operativ gjatë organizimit të ndjekjeve për kryerës të arratisur të veprave penale dhe gjatë zbulimit të kriminelëve ndërkombëtar. Nga marrëveshjet relativisht të reja do të përmendim Protokollin ndërmjet shteteve të Beneluksit në fushën e ekstradimit³⁹ dhe të ndihmës juridike reciproke të vitit 1962, i cili parasheh mundësinë e ndjekjes dhe kapjes të aktorëve të veprave penale nga ana e policisë në rajonet ndërkufitare të shtetit tjetër, si dhe për ndihmë zyrtare gjatë hetimit të akteve të caktuara penale. Sipas këtij protokollit ndërmjet policisë së Francës dhe të Byrosë së narkotikëve të SGBA të vitit 1971, në të dy vendet eksitojnë përfaqësues të përhershëm të akredituar në të dy shërbimet me

³⁹ Formë më të vjetër të bashkëpunimit reciprok paraqet ekstradimi i kryerësve të veprave penale, që përbëhet nga dorëzimi, me kushte të caktuara dhe në procedure të caktuar, të kryerësit të veprës nga njëri në shtetin tjetër për ndjekje penale ose për mbajtjen e sanksioneve ndëshkuese. (shih V. Kamboski).

qëllim të mbledhjes së njoftimeve dhe për pjesëmarrje në hetime të përbashkëta.

“Bashkëpunimi ndërkombëtar realizohet në bazë të dy tipave të instrumenteve: marrëveshje bilaterale për ekstradim, ndihmë reciproke rreth lëndëve penale, transferimin e procedurave penale dhe të personave të dënuar dhe marrëveshje të posaçme “policore” dhe protokolle të bashkëpunimit. Ta parat janë në suaza të konventave bilaterale, në të cilat bashkëpunimi policor është element sporadik në realizimin e formave të ndihmës reciproke, që bazohet në lëshimin e fletë-arresteve, zbulimin dhe kapjen e personave për të cilët kërkohet ekstradimi, ndihmë gjatë inspektimit ose gjatë rindërtimit ose ofrimit të të dhënave të evidencës penale dhe informacione dhe të dhëna të tjera relevante.

Marrëveshjet policore ose protokollat kanë, gjithashtu, karakter të marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuar sipas procedurës së përcaktuar, me të cilët rregullohet shkëmbimi i informacioneve dhe formave konkrete të ndihmës teknike dhe të ndihmave të tjera, aktivitetet kriminalistike-operative dhe të tjera në pengimin dhe zbulimin e formave të caktuara të krimit.

Republika e Maqedonisë, deri tani ka nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim policor me : Shqipërinë, Bullgarinë, Turqinë, Slloveninë dhe Kroacinë. Në marrëveshjen me Shqipërinë dhe Turqinë bashkëpunimi është kufizuar në veprat me tregti të palejueshme me drogë dhe substanca psikotrope, sende të vlerave kulturore dhe armë, si dhe për pengimin e terrorizmit, dhe përbëhet në shkëmbimin e informacioneve për kryerje të veprave penale, për të dyshimtë dhe të arrestuar dhe lëndë të kateve penale. Marrëveshja me Slloveninë, gjithashtu, parasheh bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, tregtisë së palejueshme me drogë dhe krimit të

organizuar, por kjo përfshinë një diapazon shumë të gjerë të veprimeve: shkëmbimi reciprok i të dhënave për persona të përzierë në vepra të këtitlla, të dhëna për lidhjet ndërmjet kriminelëve dhe grupeve etj; kryerjen e disa veprimeve të caktuara policore me kërkesë të palës tjetër; bashkëpunim gjatë hetimeve; organizimin e takimeve punuese në lidhje me hetime të caktuara etj. Bashkëpunimi me Bullgarinë është vënë në një bazë më të gjerë, kështu që ka të bëjë, përveç këtyre veprave, edhe me translacionet e mëdha financiare, larjen e parave, importi dhe eksporti i paligjshëm i lëndëve të para strategjike dhe të ndaluar, vjedhje të automobilave, falsifikim të dokumenteve etj. Përveç shkëmbimit të informacioneve dhe të përvojave, bashkëpunimi nënkupton edhe marrjen dhe koordinimin e veprimeve policore me interes reciprok. Forma më intensive të bashkëpunimit janë paraparë edhe në Marrëveshjen e bashkëpunimit me Kroacinë, që kanë të bëjnë me vepra të terrorizmit ndërkombëtar, krimit të organizuar, tregti me drogë, mjete pagimi të rrejshme dhe me letra me vlerë, operacione të paligjshme financiare dhe bankare, verifikimi i identitetit të personave të zhdukur dhe të dyshuar, pengimin e delikteve të komunikacionit, tregtinë e palejueshme me armë, municion, helme dhe me materiale radioaktive, vjedhje automobilash, falsifikimi i lejeve(patentave) të shoferëve dhe të komunikacionit etj. Bashkëpunimi përbëhet edhe në marrjen e aksioneve të përbashkëta, ndërsa është paraparë mundësia për dërgimin e personave zyrtar me pëlqim të mëparshëm në territorin e shtetit tjetër, për të koordinuar veprimet gjatë procedurave të caktuara hetimore.

Pyetje për studentët gjatë provimit:

- 1. Çfarë paraqet parimi i ligjshmërisë?*
- 2. Ç'paraqet parimi i së vërtetës?*
- 3. Ç'paraqet parimi kritik dhe vetëkritik?*
- 4. Ç'paraqet parimi aspektit metodik dhe planifikimi i procedurës?*
- 5. Ç'paraqet parimi i themeltë dhe i këmbëngulësisë?*
- 6. Ç'paraqet parimi i objektivitetit?*
- 7. Shpjego parimin e punës unike me veprimet në çdo rast individual.*
- 8. Shpjego parimin e koordinimit dhe të bashkëpunimit.*
- 9. Shpjego parimin e ekonomizimit në procedurë.*
- 10. Shpjego parimin e ruajtjes së sekretit (fshehtësisë) zyrtar.*
- 11. Shpjego parimin e humanizmit.*
- 12. Ç'paraqet parimi i veprimit kriminalistik aktiv dhe i zhvillimit konsekuent të preventivës kriminalistike?*
- 13. Ç'paraqet parimi i bashkëpunimit ndërkombëtar?*
- 14. Shpjego institucionin Interpol.*
- 15. Shpjego institucionin Evropol.*
- 16. Ç'janë format regjionale të bashkëpunimit kriminalistik?*
- 17. Ç'është bashkëpunimi bilateral policor?*

KREU III

VEPRIMTARIA KRIMINALISTIKE-OPERATIVE

1. LLOJET E HETIMEVE KRIMINALISTIKE

Veprimtaria operative e policisë zbatohet në procedurën para hetimore , dhe atë me vetiniciativë ose me urdhër të Prokurorit publik, për të zbuluar veprat penale, të kryerësve të tyre, për të siguruar prova dhe për të mbledhur njoftime të tjera të cilat janë me rëndësi për të ndjekur procedurën penale, me të vetmin qëllim për të penguar kryerjen e veprave penale.

Në organet e policisë gjyqësore ekzistojnë shërbime të specializuara profesionale për zbulimin, ndjekjen dhe pengimin e kriminalitetit. Detyra e tyre themelore është:

- Nxitja, organizimi dhe marrja e masave parandaluese (hulumtimi aktiv kriminalistik);
- Zbulimi dhe dëshmimi i veprave të kryera (hulumtimet rekreative kriminalistike)dhe
- Zbulimi i kryerësve të panjohur të veprave penale dhe dëshmimi i fajit të tyre (hetime rekreative kriminalistike)

Shërbimet për pengimin e kriminalitetit i ndjekin edhe dukuritë e tjera shoqërore negative dhe ngjarjet (narkomaninë, alkoolizmin, prostitucionin, bixhozin) të cilat në një farë mënyre janë në lidhje me kriminalitetin dhe të cilat krijojnë kushte për përhapjen e tij.

Policia gjyqësore, në realizimin e detyrave të veta themelore zbaton parimet e kriminalistikës dhe shfrytëzon mjete dhe metoda të ndryshme. Kështu, për shembull, shfrytëzon informacionet kriminalistike – zbuluese të marrë nga informatorë

dhe bashkëpunëtorë, të dhëna dhe informacione të marrë me zbatimin e masave hetuese ⁴⁰të posaçme e kështu me radhë.

Llojet themelore të veprimtarisë operative (strategjitë) të policisë gjyqësore janë:

- *Profilizimi* ;
- *Kontrolli* kriminalistik dhe
- *Përpunimi* kriminalistik

Për të *profiluar* do të bëhet fjalë më vonë në faqet që vijojnë, përkatësisht në tekstin e mëposhtëm.

Kontrolli kriminalistik nënkupton masat e organizuara dhe të planifikuara operative taktike për të penguar rreziqet e ndryshme (kriminale, dukuritë, si dhe shkaqet dhe pasojat e këtyre dukurive. Do me thënë, këtu bëhet fjalë për iniciativë të përgjithshme e jo konkrete. Në esencë, përmbajtja e kontrollit kriminalistik përbëhet nga mbikëqyrja e objekteve dhe mjediseve konkrete kriminalistike. Këtu hyjnë: patrullimet ditore dhe të natës, vëzhgimet, racionet , mbikëqyrja e rrugëve rrugicave, tregjeve, stacioneve të autobusit dhe atyre hekurudhore, metrotë , vendkalimet kufitare , automjetet, lokalet publike, fushat sportive, ndërtesat, bujtinat, tubimet e mëdha etj.

Për *kontrollin kriminalistik* është karakteristikë dyshimi i përgjithshëm (për mjedise ose persona të caktuar) se në atë vend mund të ndodh krimi, kundërvajtja ose ndonjë aktivitet social-patologjik. Forma e këtillë e veprimit kriminalistik realizohet me kontrollin kriminalistik. Në këtë mënyrë, arrijmë te gjurmët, objektet dhe te indikacionet tjera që manifestohen në këto tre forma:

⁴⁰ Për të siguruar të dhëna dhe prova të nevojshme për zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale të cilat nuk mund të mblidhen në mënyrë tjetër, mund të urdhërohet marrja e masave të posaçme hetimore.

- Gjurmë dhe elemente të gjurmëve të cilat na orientojnë drejt ekzistimit të veprave penale;
- Gjurmë që na shpien në pasoja materiale të kryerjes së veprës penale;
- Gjurmë që na shpien te sjelljet e dyshimta të disa njerëzve, si kryerës të mundshëm të veprave penale (indikacione intuitive).

Detyra e kontrollit kriminalistik është ndjekja sistematike e gjendjeve, dukurive, zhvillimeve , kryerësve të caktuar të veprave penale, si dhe grumbullimi i të dhënave dhe informacioneve për personat të cilët kanë afinitet për të kryer vepra penale dhe dukuri të tjera kriminalistike, me qëllim që të ndërmerren masa adekuate parandaluese represive.

Vënia e kontrollit kriminalistik lejohet nga drejtuesit e njësisë organizuese të policisë ligjore.

Për identifikimin e bërë të personave të grupeve kriminale dhe të objekteve, për të cilat realizohet përpunimi kriminalistik përgatiten këta dokumente analitike: dokumente për përpunimin e profilit të grupit të organizuar kriminal; dokumente për përpunimin e objektit dhe dokumente për përpunimin e subjektit.

Përveç dokumenteve analitike nëpunësi i policisë përgjegjës për identifikimin e personave , grupeve kriminale ose të objekteve (ose udhëheqësi i ekipit operativ që formohet për identifikimin e kategorive të përmendura) së bashku me analizuesin operativ që është përfshirë në ekipin operativ, përgatitin *Raportin e përpunimit të profilit*, përkatësisht për identifikimin e bërë.

1.1. Metoda dhe mjete të kontrollit kriminalistik

Si metoda dhe mjete për kryerjen e kontrollit kriminalistik mund të ndahen këto:

- Ndjekja dhe studimi i formave të manifestuara të kriminalitetit;
- Vlerësimi i rrezikshmërisë potenciale nga sulmet kriminale;
- Vlerësimi i masivizimit dhe i kushtëzimit të kriminalitetit ;
- Bashkëpunimi me qytetarët;
- Shfrytëzimi i të ashtuquajturave metoda të burimeve legale;
- Analogjitë ;
- Aksionet e ndryshme dhe
- Vërejtja e drejtpërdrejtë e nëpunësve të autorizuar.

Gjatë kontrollit të grupeve profesionale dhe të vatrave kriminale zbatohen edhe mjete dhe metoda specifike, si për shembull :

- Teknika operative;
- Lidhjet operative ;
- Aksionet e organizuara (vëzhgimet, mbikëqyrjet, racionet, pritjet, etj.)

1.2. Planet e kontrollit kriminalistik

Planet bazohen sipas strukturës reale, të përshtatshme për nevojat reale dhe kanë funksion orientues për çdo pjesëmarrës në kontrollin kriminalistik. Bëhen shumë plane sipas lëmive të

ndryshme, sipas qasjes territoriale, sipas anëve speciale e tj. Planet e këtilla bashkohen në një plan të vetëm themelor të kontrollit kriminalistik. Nga aspekti praktik, më mirë është që planet të hartohen sipas rajonit të patrullimit dhe sipas rajonit të vëzhgimit (ose të rajoneve).

Plani në esencë, duhet tii përmbajë katër pjesë themelore në të cilat hyjnë shumë elemente esenciale.

Plani i par përfshinë:

- Numrin e veprave të kryera penale ,
- Numrin e kryerësve të veprave penale;
- Lokacionin më të ngushtë të kryerjes së veprave penale;
- Kohën e kryerjes së veprave penale (muaji, ditë, orë);
- Numrin e personave problematik, si kryerës potencial të veprave penale.

Do të ishte mirë dhe shumë e dobishme që vlerësimi i të dhënave analitike për çdo vit të bëhen në mënyrë të veçantë dhe gjithashtu edhe të plotësohen.

Pjesa e dytë e planit përfshinë:

- Kërcënimi potencial i objekteve të sulmit ;
- Vatrast kriminale dhe pikat e përqendrimit;
- Lista e personave të dënuar si dhe i personave të tjerë problematik, persona nën mbikëqyrje të përforcuar etj. (Kjo listë nënkupton adresat e jetesës , punësimet, lidhjet miqësore , familjare kriminale dhe adresat e tyre).
- Pasqyra e vendeve të përshtatshme për kryerjen e aktiviteteve të veçanta kriminale (përdhunime, vjedhje, thyerje të shtëpive etj.)

Pjesa e tretë e planit përmban:

- Detyrat e realizimit të kontrollit kriminalistik;

- Metodat që shfrytëzohen gjatë realizimit;
- Mënyrat e koordinimit;
- Detyra të tjera rutinore.

Në pjesën e katërt të planit :

- Përmenden personat e autorizuar të shërbimit, përgjegjës për kryerjen e planit; dhe
- Realizimi i aktiviteteve të veçanta dhe i detyrave të patrullimeve të veçanta dhe vëzhgimeve të rajonit.

Do me thënë edhe plani i kontrollit të linjës (special) operativ kriminalistik, në esencë, i përmban këto katër pjesë:

- Të gjitha të dhënat analitike që s'kanë të bëjnë me kryerjen e veprave penale , numrin e personave të cilat i kanë kryer veprat penale , numri i personave të cilët mund të bëhen aktorë potencial etj. Vazhdon regjistrimi i vendeve ku takohen dhe i kryerësve potencial (masat e vëzhgimit të përforcuar);
- Vlerësimi i shkurtër i rrezikshmërisë, sipas llojeve të deliktit;
- Regjistrimi i objekteve, me lokacionet e tyre të sakta, i personave , i lidhjeve të tyre etj.
- Mënyra e realizimit të detyrave të kontrollit kriminalistik, si dhe angazhimi konkret i çdo nëpunësi të autorizuar.

1.3. Mangësitë më të shpeshta në organizimin e kontrollit kriminalistik

Në analizën e praktikës në lidhje me organizimin e kontrollit kriminalistik nga ana e organeve të policisë vihet

në dukje shkalla e ulët e organizimit tek kjo veprimtari operative.

Kështu për shembull, nuk janë të rralla rastet kur policisë patrulluese i jepen detyra në lidhje me mirëmbajtjen e rendit dhe qetësisë publike , ndërsa në raportet tre mujore dhe në ato gjysmë vjetore nuk ka asnjë fjalë për personat që janë nën kontroll etj.

Sipas kësaj mund të thuhet se ka një numër të madh mangësish gjatë punës dhe gjatë zbatimit të kontrollit kriminalistik nga ana e organeve të punëve të brendshme, policia. Të shkojmë me radhë:

- Nuk mbahet llogari që të vihen nën kontroll kriminalistik personat më interesant, parë nga aspekti kriminalistik operativ;
- Shpesh kontrolli kriminalistik nuk organizohet sipas sistemit të lidhjeve operative, rezultat i kësaj është mos zbulimi i personave të tillë gjatë 24 orëve;
- Kontrollat e caktuara kriminalistike zgjatin edhe disa vite , por, për rezultatet e saj nuk ka kurrfarë lloj materiali të shkruar, përkatësisht nuk ka gjurmë të shkruara;
- Bashkëpunimi me lidhjet operative, shpesh është joadekuat dhe rregullisht mbështetet në rezultate të përgjithshme dhe të përkohshme por pa rezultate të rëndësishme dhe evidente;
- Sektori i sigurisë në trafik mund të japë më shumë rezultate; për shembull legjitimimi të bëhet për të gjithë personat që gjenden në automobil duke e kontrolluar automobilin dhe bagazhin e tij ;

- Personi i autorizuar, shpeshherë di të angazhojë persona për kryerjen e kontrollit kriminalistik të cilët janë të komprometuar, pensionist etj.
- Ka raste kur nëpunësi i autorizuar, në sektorin e vet nuk e njeh personin që është nën kontroll kriminalistik;
- Gjithashtu, ndodh që të mungojë bashkëpunimi ndërmjet nëpunësve të autorizuar, me obligime për të bërë kontroll kriminalistik të personave konkret dhe nëpunësit operativ të përfshirë në përpunimin kriminalistik. Sipas kësaj ekziston mosharmoni në veprimet e përbashkëta (legjitimim, kurthe, racione);
- Evidencat e personave nën kontroll kriminalistik nuk azhurohen (personi është shpërngulur ose ka vdekur, por edhe më tutje llogaritet si nën kontroll kriminalistik).

2. PËRPUNIMI KRIMINALISTIK

Me *përpunim kriminalistik* nënkuptohet sistemi i organizuar dhe i planifikuar i të gjitha masave operative-taktike , veprimeve hetuese dhe masat speciale hetimore me qëllim që të pengohet kriminaliteti, të orientuara në zbulimin dhe me përcaktimin e veprës penale konkrete, të kryesit të saj dhe të përgjegjësisë së tij, në bazë të indikacioneve të njohura nga më parë.

Përpunimi kriminalistik dallohet nga kontrolli kriminalistik sipas *qëllimit* dhe sipas *metodologjisë*. Në fakt, ndërmarrja e veprimeve hetuese është karakteristike vetëm për përpunimin kriminalistik, ndërsa nga ana tjetër, masat operative-taktike ndërmerren edhe në të dyja veprimtaritë operative (strategji). Përpunimi kriminalistik mund të hapet për kryerës të njohur dhe të panjohur të veprave penale.

Përpunimi kriminalistik hapet dhe zhvillohet: me qëllim të identifikimit dhe të sigurimit të provave materiale për veprën e kryer penale dhe për kryerësit e saj; kur ekzistojnë indikacione për përgatitjen për të kryer ose të kryer të veprës penale nga persona –individ ose grupe kriminale dhe kur ekzistojnë indikacione se grupet kriminale ndërkombëtare , aktivitetin kriminal e ushtrojnë në ose nëpërmjet territorit të shtetit përkatës ose janë të lidhur me grupe kriminale të një shtetit përkatës të cilët janë pjesë e kanaleve ndërkombëtare të kontrabandës etj.

Tek përpunimet kriminalistike objekt është individi ndërsa tek kontrolli kriminalistik dukuria masive. Prandaj dallimi kryesor ndërmjet kontrollit kriminalistik dhe përpunimit kriminalistik është në formë dhe në përmbajtjen e dyshimit.

2.1. Organizimi dhe planifikimi i përpunimit kriminalistik

Përpunimi kriminalistik është karakteristikë me parimin e qasjes ndaj organizimit dhe planifikimit, nga del obligimi për kryerjen e planeve për të zbuluar , për të zbardhur dhe për të dëshmuar vepra të caktuara kriminale. Gjatë planifikimit të masave të caktuara operative-taktike, veprimet hetimore dhe masat speciale hetimore, është e domosdoshme që nëpunësi i autorizuar t'u përmbahet këtyre parimeve taktike: ligjshmërisë , qasjes dhe metodës , shpejtësisë dhe befasisë, esencialitetit dhe këmbëngulësisë, unitetit gjatë drejtimit të masave operative taktike dhe aktiviteteve si dhe parimit të koordinimit dhe të bashkëpunimit.

Plani i përpunimit kriminalistik duhet t'i përmbajë këto elemente esenciale:

- Ekipin operativ me drejtues, i cili mund të përbëhet me përfaqësues të shumë njësive organizuese të policisë gjyqësore, që ka për detyrë të zbatojë përpunimin kriminalistik;
- Masat operative taktike dhe veprimet hetuese që duhet të zbatohen;
- Masat e veçanta hetuese, në pajtim me ligjin e procedurës penale;
- Zbulimet kriminalistike si burim të informacioneve;
- Burime të tjera të informacioneve dhe
- Shkëmbimi ndërresorial apo ndërkombëtar i informative

Para se t'i hyhet realizimit të përpunimit kriminalistik , me prova të siguruara gjatë zbatimit të fazave përkatëse të hetimit kriminalistik (profilizimit, kontrollit kriminalistik) njoftohet prokurori publik kompetent.

Propozimi për realizimin e përpunimit kriminalistik sillet kur :

- Janë siguruar prova për kryerjen e veprës penale të cilat pa kurrfarë hamendje shpjen te kryerësi konkret ose tek grupi i kryerësve;
- Ekziston rrezik nga komprometimi i masave operative-taktike ose masave të posaçme hetimore që zbatohen në përpunimin kriminalistik;
- Ekziston rrezik që provat dhe objektet që dalin nga vepra penale të asgjësohen nga ana e kryerësve;
- Ekziston rrezik nga arratisja e kryerësve dhe
- Janë plotësuar qëllimet për çka është ngritur përpunimi kriminalistik.

Propozimin për realizimin e përpunimit kriminalistik e jep drejtuesi i ekipit operativ ose nëpunësi policor i cili e ndjek atë. Propozimi për realizimin e përpunimit kriminalistik i jepet për pajtim nëpunësit të drejtpërdrejtë drejtues.

Për realizimin e përpunimit kriminalistik përpunohet Plani operativ për realizimin e përpunimit kriminalistik.

Ky plan i përmban këto të dhëna për :

- Qëllimet e përpunimit kriminalistik ;
- Personat për të cilët bëhet përpunimi kriminalistik dhe për veprat penale të kryera;
- Masat e posaçme hetuese që zbatohen për të siguruar prova;
- Vlerësimi i sigurisë së personave të cilët duhet të arrestohen dhe për objektet ku bëhet arrestimi, kontrollimi ose bastisje;
- Koordinatori, ekipi për arrestim, pasqyra ose kontrolli me drejtuesit e emëruar dhe detyrat konkrete për çdo ekip;
- Qendra drejtuese dhe mënyra e komunikimit dhe mjetet e transportit;
- Përdorimi i njësive speciale të policisë;
- Hapësira për mbajtjen dhe dëgjimin e personave të arrestuar;
- Ekipet për intervista me persona të caktuar konkret për të zhvilluar intervista dhe pyetjet e përcaktuara që do të bëhen gjatë intervistës dhe
- Hapësirat për vendosjen dhe sigurinë e sendeve të konfiskuara që burojnë nga kryerja e veprës penale.

Plani operativ i realizimit të përpunimit kriminalistik hartohet nga udhëheqësi i ekipit operativ i cili e bën hetimin. Ai i dorëzohet për miratim udhëheqësit të sektorit përgjegjës varësisht nga përbërja organizative e njësisë konkrete organizative.

Për përpunimet e hapura kriminalistike në njësitë organizuese të policisë mbahen dosje dhe regjistër të përpunimit kriminalistik.

3. VALORIZIMI DHE ANALIZA E HETIMIT KRIMINALISTIK

Valorizimi i hetimit kriminalistik bëhet në bazë të raportit. Raportin e përgatit ekipi operativ i cili e ka zhvilluar hetimin kriminalistik dhe ai sipas radhës kronologjike bën përshkrimin e masave dhe aktiviteteve të planifikuara dhe të ndërmarra, që nga fillimi i hetimit deri në paraqitjen e kallëzimit penal.

Raporti në mënyrë reale dhe objektive e përshkruan hetimin kriminalistik, duke prezantuar dobësitë dhe mangësitë e vërejtura, me qëllim që ato të mos përsëriten, ndërsa njëkohësisht prezantohen edhe sukseset e arritura si praktika të mira të cilat do të zbatohen në hetimet e ardhshme.

Pas përfundimit të hetimit kriminalistik, Sektori i analizës kriminalistike dhe njësitë e tjera organizuese përpunojnë *analizën kriminalistike*, e cila është e fundit me të dhëna përkatëse statistikore.

Raporti dhe analiza kriminalistike paraqesin bazën për *debriefing*. Debriefingun e bën ekipi drejtues i njësisë organizative që ka zbatuar hetimin kriminalistik.

Qëllimi i debriefingut është:

- Vlerësimi i cilësisë së hetimit kriminalistik të zbatuar;

- Përcaktimi i faktit se a e ka arritur qëllimin hetimi i planifikuar;
- A kanë qenë të domosdoshme metodat dhe mjetet e ndërmarra dhe a u përshtaten qëllimeve të parashtuara;
- Masat dhe mjetet e ndërmarra a janë të ligjshme dhe
- Vlerësim për cilësinë e punës të ekipit operativ dhe anëtarëve të ekipit që e kanë zbatuar hetimin kriminalistik.

4. ZHVILLIMI I HETIMEVE TË PËRBASHKËTA KRIMINALISTIKE

4.1. Hetimet të përbashkëta kriminalistike ndërsektoriale

Njësitë për punë kriminalistike në sektorin e punëve të brendshme, zyrat e jashtme për punë kriminalistike në stacionet policore të kompetencave të përgjithshme dhe seksionet e migracionit ilegal dhe të parandalimit, të huajt dhe riadmisioni me qendrat rajonale për punë kufitare gjatë ushtrimit të punëve policore kur është e nevojshme shkallë e lartë e specializimit, me qëllim të kryerjes efektive dhe ekonomike të detyrave të caktuara specifike dhe të ndërlikuara , bashkëpunojnë me njësitë përkatëse organizative për shembull me Shërbimet policore qendrore.

Njësitë për punë kriminalistike në sektorin e punëve të brendshme dhe ato të përmendura më lartë, nëse konstatojnë ekzistimin e elementeve të krimit të organizuar, për identifikimin e veprës penale, përkatësisht kryerësit ose të grupit kriminalistik, me përshkrim të shkurtër të njohurive dhe të provave të fituara materiale, në formë të shkruar menjëherë njoftojnë Seksionin e

krimit të organizuar. Nëse seksioni i krimit të organizuar vlerëson se ekzistojnë elemente për krim të organizuar i ndërmerr këto aktivitete:

Përgatit propozimin për fillimin e hetimit ndërresorial të përbashkët kriminalistik. Propozimi i dërgohet për miratim udhëheqësit të Shërbimeve qendrore të policisë pastaj ai i dorëzohet përsëri për aprovim drejtorit të byrosë të sigurisë publike. Pjesë përbërëse e propozimit është Plani i masave dhe aktiviteteve për zbatimin e hetimit ndërresorial të përbashkët kriminalistik, ndërmjet seksionit të krimit të organizuar dhe Sektorit të punëve të brendshme ose , qendrave rajonale të punëve kufitare në rajonin e të cilave është kryer ose përgatitet të kryhet vepra përkatëse penale;

Formohet ekipi i përzier operativ me udhëheqës i cili është i angazhuar për të planifikuar dhe për të zbatuar hetimin kriminalistik, me ç'rast drejtuesi për punën e vet është përgjegjës i drejtpërdrejtë para drejtorit të Byrosë së sigurisë publike.

Për hetimin e përbashkët kriminalistik në kuadër të Sektorit të analizës kriminalistike formohet dosje ku deponohet materiali i tërësishëm, që ka të bëjë me hetimin kriminalistik.

Hetimi ndërresorial i përbashkët kriminalistik

Me qëllim të pengimit dhe zbulimit të veprave penale dhe ndjekjes së kryerësve të veprave penale me krim të organizuar Sektori i krimit të organizuar pranë MPB zhvillon hetim ndërresorial të përbashkët kriminalistik me organet e administratës shtetërore dhe institucionet përkatëse të tjera për të ndjekur kryerësit e veprave penale në lëmin e krimit të organizuar. Kështu për shembull: Policia financiare, Komisioni i

antikorrupsionit, Drejtoria e doganave, Drejtoria e të hyrave publike etj.

Hetimi ndërresorial i përbashkët kriminalistik realizohet me propozim të dhënë nga ana e organit përkatës të Drejtorisë shtetërore ose të institucionit tjetër përkatës për ndjekjen e kryerësve të veprave penale nga lëmi i krimit të organizuar. Hetimi i përbashkët kriminalistik realizohet në bazë të Memorandumit të nënshkruar, përkatësisht Protokollit të bashkëpunimit , ku përcaktohet mënyra e bashkëpunimit , shkëmbimi i informacioneve dhe zhvillimi i hetimit ndërresorial të përbashkët kriminalistik.

Hetimi ndërresorial i përbashkët kriminalistik , me propozim të MPM nis kur Seksioni i krimit të organizuar në bazë të profilizimit të bërë dhe për shkak të sigurimit të suksesshëm të provave materiale , do të vlerësojë se nevojitet zhvillimi i hetimit ndërresorial të përbashkët kriminalistik.

Hetimi ndërresorial i përbashkët kriminalistik nga ana e MPB-së , zhvillohet me propozim të bërë nga ana e njësisë kompetente organizative në Seksionin e krimit të organizuar.

4.2 Hetimet të përbashkëta kriminalistike ndërkombëtare

Për shkak të pengimit dhe zbulimit të veprave penale dhe të kryerësve të veprave penale në lëmin e krimit të organizuar me elemente transnacionale , si dhe për lëndë hetimi , akuzë ose procedura juridike në një apo më shumë shtete, Seksioni i krimit të organizuar në bashkëpunim me prokurorin publik dhe sektorin e bashkëpunimit ndërkombëtar policor, planifikojnë dhe zbatojnë hetim ndërkombëtar të përbashkët kriminalistik.

Hetimet ndërkombëtare të përbashkëta kriminalistike realizohen në pajtim me : legjislacionin nacional, marrëveshjet bilaterale për bashkëpunim policor, të memorandumëve dhe të protokolleve të bashkëpunimit policor, të konventave të ratifikuara ndërkombëtare, të anëtarësisë në organizatat ndërkombëtare të policisë (Interpol, Evropol, SEKI, Fronteks), si dhe në pajtim me marrëveshje përkatëse që nënshkruhet në rast nevojë për hetime urgjente.

Propozimin për zbatimin e hetimit ndërkombëtar të përbashkët kriminalistik, në bazë të vlerësimit të njësisë organizative në Seksionin e krimit të organizuar ose të Sektorit të bashkëpunimit ndërkombëtar policor, e bën drejtuesi i seksionit. Propozimi i dërgohet për miratim udhëheqësit të Shërbimeve qendrore të policisë, ndërsa pastaj ai i dërgohet për aprovim drejtorit të Byrosë së sigurisë publike.

Propozimi për zbatimin e hetimit ndërkombëtar kriminalistik përmban:

- Të dhëna për identifikimin e grupit kriminalistik dhe të personave që janë pjesë të organizatës ndërkombëtare kriminale ose të kanalit ndërkombëtar të kontrabandës;
- Përshkrimi i shkurtër i njohurive që disponohen ose që janë siguruar si prova nga hetimi i bërë;
- Të dhëna për shtetet që do të përfshihen në hetimin ndërkombëtar të përbashkët kriminalistik dhe
- Organizata ndërkombëtare policore e cila do të përfshihet në organizimin dhe në zhvillimin e hetimit ndërkombëtar të përbashkët.

Pas marrjes së pajtimit nga shtetet pjesëmarrëse në hetimet ndërkombëtar të përbashkët organizohet takim i përbashkët. Në takim (ku mund të marrin pjesë edhe prokurorët përkatës publik merren vesh:

- Qëllimi i hetimit të përbashkët kriminalistik;
- Përcaktimi i pikës nacionale të kontaktit për komunikim ;
- Formimi i ekipeve të përbashkëta;
- Mënyra e komunikimit, informimit dhe shkëmbimit të informatave dhe të provave dhe ;
- Afatet kohore.

5. BASHKËPUNIMI SI METODË OPERUESE NË PUNËN POLICORE

Në njohuritë se po përgatitet ose se është kryer një veprë penale ose një person i caktuar është kryerës i veprës penale etj, personat zyrtarë të autorizuar vijnë edhe nëpërmjet shfrytëzimit të lidhjeve operative dhe nëpërmjet shfrytëzimit të mjeteve dhe masave përkatëse operative – teknike.

Personat me të cilët policia vendos forma të këtilla të bashkëpunimit (shpesh të fshehta) quhen *informatore* dhe *bashkëpunëtorë* (Lidhja operative). Raporti klasik i bashkëpunimit ndërmjet policisë dhe qytetarëve bazohet në parimin vullnetar.

5.1. Informatori

Informatori është person fizik i cili i jep njoftime dhe të dhëna policisë në mënyrë vullnetare, të cilat janë me rëndësi për pengimin, zbulimin dhe për dëshmimin e veprës penale dhe të kruesve të saj.

Për aktivitetin e këtillë angazhohen qytetarë të cilët , në sajë të vendit të vet të punës dhe të profesionit të tyre, të vendit ku jetojnë dhe të mundësive të tjera subjektive dhe objektive , mund

të vërejnë forma të ndryshme të aktiviteteve kriminale, ndërsa gjithashtu edhe fakte të tjera relevante që janë me rëndësi për zbulimin, sqarimin dhe për dëshmimin e veprave penale dhe të autorëve të tyre.

Informatorët ndahen në : *garantë, vigjilentë dhe agjentë provokues*. Grupi i veçantë përbëjnë vëzhguesit e fshehtë policorë. Për agjentët provokues dhe për vëzhguesit e fshehtë policor do të bëhet fjalë më poshtë të kësaj kapitule.

Garantët janë persona të cilët një kohë të gjatë dhe fshehtas i japin të dhëna policisë për aktivitetet kundërligjore të organizatave të caktuara kriminale, të grupeve ose të individëve. Në esencë janë persona të persona të pa porositur të cilëve policia u beson.

Vigjilentët janë persona që bien në mjedisin kriminalistik. Ata kryejnë vepra penale (ose kanë kryer) dhe njëkohësisht e njoftojnë policinë për aktivitetet kriminale të bashkëpunëtorëve të vet kriminale. Këto janë informatorë më të pabesueshëm, por, shumë të rëndësishëm për aktivitetet policore. Duke marrë parasysh faktin se edhe vet janë kriminel, ato disponojnë informata burimore të cilat nuk mund të arrihet në mënyra të ndryshme. Motivet për bashkëpunimin e tyre më shpesh janë për shkaqe jo morale. Njëkohësisht , presin kundër shërbime nga policia , marrin para për informacionet e veta, duan ti hakmerren ndonjërit nga mjedisi i tyre kriminel e të tjera. Gjatë qasjes kriminalistike ndaj informatorëve të këtillë rekomandohet shfrytëzimi i të ashtuquajturit *paralet –vigjilent*. Informacionet e njërit provohen nëpërmjet informacioneve të tjetrit, duke mos pasur njohuri njëri me tjetrin.

Për çdo formë të angazhimit të informatorit duhet të njoftohet udhëheqësi i njësisë organizative ose nëpunësi që është autorizuar për këtë.

5.2. Bashkëpunëtori

Bashkëpunëtori është person fizik i cili në mënyrë të vetëdijshme, të organizuar dhe të fshehtë, me detyra të marra nga personi zyrtar i autorizuar, jep njoftime dhe të dhëna për veprat penale dhe kryesit e tyre, si dhe fakte të tjera që janë me rëndësi për të zhvilluar aktivitetet punuese në sferën e resorit të shërbimit të sigurisë publike. “Do me thënë, bashkëpunëtori gjendet të jetë shumë afër veprimtarisë kriminele, nëpërmjet tij zhvillohet përpunimi kriminalistik, ai në mënyrë permanente dhe të vazhdueshme mbledh të dhëna , i mundëson policisë zbatimin e mjeteve të veçanta operative – teknike etj.

Bashkëpunëtori, kryesisht mund të angazhohet me pajtimin e mëparshëm në forma të shkruar, përkatësisht me leje të udhëheqësit të organit përkatës. “Prej kësaj mund të ketë edhe përjashtime, për shkak të rrethanave adekuate (të situatës të veçantë taktike), nëpunësi operativ nuk ka kohë për të bërë propozim në formë të shkruar, prandaj me gojë e informon udhëheqësin i cili vendos për angazhimin e tij, duke e obliguar në të njëjtën kohë nëpunësin operativ që sa më shpejtë të bëjë propozim në formë të shkruar”.

Nuk është e lejuar që personi zyrtarë i autorizuar në emër të shërbimit, ti japë premtime të cilat nuk mund ti plotësojë.

Terminët e ndryshme të bashkëpunimit kanë lidhje të drejtpërdrejtë dhe varen nga raporti i përgjithshëm ndaj bashkëpunëtorit, motiveve të tyre për bashkëpunim, përmbajtja dhe qëndrimet ndaj vlerave të raportit interakcional të policisë ndaj rrjetit të bashkëpunëtorëve në tërësi, zhvillimit të demokracisë dhe raportit të policisë dhe opinionit në përgjithësi.

Nga ana tjetër nëpunësit operativ duhet të jenë të vetëdijshëm për faktin se te një pjesë e rëndësishme e qytetarëve ekziston ndjenjë negative ndaj kësaj forme të veprimtarisë , që është si pasojë e qëndrimit tradicional negative të trashëguar nga koha e pushteteve të huaja të cilët sundimin e vet e mbështesnin tek bashkëpunimi me qytetarët , përkatësisht tek spiunimi ndaj tyre.

Nëpunësit operativ kanë raport të ndryshëm ndaj kësaj metode operative, ndërsa si pasojë e kësaj paraqiten shumë gabime. Në radhë të parë, për shkak të punës joadekuat me bashkëpunëtorët, pastaj edhe për shkak të qëndrimit joadekuat ndaj rrjetit të bashkëpunëtorëve.

Procesi i realizimit të bashkëpunimit nënkupton informim të përhershëm dhe aktual. Bëhet fjalë për informacione relevante, si rezultat i marrëdhënieve interaksionale të relacionit: nëpunës operativ – bashkëpunëtorë- objekte të interesit- shërbime të policisë.

Duke plotësuar obligimin e vet bashkëpunëtori aktiv është realizues i detyrave operative. Nëpërmjet aktiviteteve të tilla, shpesh bashkëpunëtori barazohet me nëpunësin e operativ , për të vetmin shkak sepse edhe ai është kreator i aktiviteteve operative. Gjithashtu bashkëpunëtori pranon në mënyrë të vetëdijshme dhe me përgjegjësi kryerjen e obligimeve dhe të detyrave të caktuara duke paraqitur edhe mendimin dhe propozimet e veta. Posaçërisht gjatë ndryshimit dhe plotësimit të planit në situatë konkrete operative – taktike.

Sipas saj bashkëpunëtori faktikisht është aktor aktiv dhe faktor i pjesëve të përpunimit operativ gjatë veprimeve taktike nga ana e policisë. Vet iniciativa , mundësia dhe dhuntia për tu gjendur gjatë situatave të ndryshme, marrjes me kohë të vendimeve nëpërmjet kombinimit kreativ e të tjera, janë supozime

elementare gjatë veprimit të bashkëpunëtorit në të gjitha situatat kriminalistike-taktike.

5.3. Përkufizimi dhe karakteristikat e raportit të bashkëpunimit

Përkufizimi i bashkëpunëtorit i përfshinë elementet që janë kusht të rëndësishme për realizimin e bashkëpunimit dhe të marrëdhënieve të bashkëpunimit në tërësi, ndërsa këto janë : *organizimi , fshehtësia, vetëdija, dhe vazhdimësia.*

Organizimi në bashkëpunim del nga pranimi i vetëdijshëm i këtij bashkëpunimi interaktiv i cili paraqet fshehtësi për qytetarët e tjerë.

Është e gabueshme të barazohet bashkëpunëtori me personat të cilët, njëherë ose disa herë , kanë bërë shërbime konkrete për policinë. Një vetiniciativë e këtillë e qytetarëve të caktuar për komunikim me policinë gjyqësore nuk paraqet formë të organizuar të bashkëpunimit dhe të marrëdhënieve të bashkëpunimit në tërësi. Në kushte të këtilla qytetari është realizues , dhurues informacioneve nga fusha e obligimeve të tija morale, të lidhura me bindjet e tija personale.

Fshehtësia është pjesë elementare dhe klasike e nocionit të bashkëpunëtorit pa të cilin nuk ka bashkëpunim të organizuar. Fshehtësia në fakt është parimi themelor taktik në punën operative. Fshehtësia ndërpritet me dekonspiracionin e bashkëpunëtorit.

Vetëdija është pjesë përbërëse e rëndësishme e nocionit të bashkëpunimit dhe kusht për realizimin e bashkëpunimit të organizuar të fshehtë pa përcaktim të vetëdijshëm, nuk ka bashkëpunim klasik që lidhet me grumbullimin e të dhënave dhe

njoftimeve të tjera për të zbuluar dhe penguar veprat penale dhe kryesit e tyre.

Vazhdimësia nënkupton gjithanshmërinë e marrëdhënieve interaksionale ndërmjet policisë ligjore dhe bashkëpunëtorëve. Me fjalë të tjera, puna e policisë gjyqësore me bashkëpunëtorin e përbëjnë tërësinë e marrëdhënieve të bashkëpunimit. Një qëndrim i këtillë dhe punë e këtillë nënkupton vazhdueshmërinë e cila fillon me zgjedhjen e kandidatit për bashkëpunim nëpërmjet angazhimit dhe nëpërmjet vet procesit të bashkëpunimit, deri në ndërprerjen e këtij bashkëpunimi. Kjo nënkupton se çdo kontakt me bashkëpunëtorin përbën segmentin e këtij procesi të vazhdueshëm etj.

Në praktikë ekzistojnë edhe situata të tilla kriminalistike-taktike ku bashkëpunëtori shfrytëzohet vetëm gjatë realizimit të një përpunimi operativ, përkatësisht gjatë realizimit të një detyre konkrete. Për shkak të mundësive të këtilla, afati punues i bashkëpunëtorit mund të zgjasë aq sa edhe përpunimi operativ ose ndonjë segment i tij.

6. LIDHJA OPERATIVE

Lidhja operative është person juridik që paraqet faktorin shumë të rëndësishëm, në radhë të parë , policisë gjatë punës operative me vetëdije , më shpesh të fshehtë dhe të organizuar i jep të dhëna dhe njoftime, për zbulimin, sqarimin dhe dëshmimin e veprës penale dhe të kryerësve të saj, si dhe njoftime të tjera që janë me interes për punën operative.

Kjo kategori, varësisht nga zhvillimi i shërbimit ka terma të ndryshëm: lidhje personale, lidhje miqësore, lidhje njoftimi, lidhje zyrtare, lidhje shoqërore etj.

6.1. Dallimet ndërmjet lidhjes operative dhe bashkëpunëtorit

Të dhënat që i jep lidhja operative, krahasuar me të dhënat e bashkëpunëtorit, në një farë mënyre janë të krahasueshme, përkatësisht pozita e tyre qëndron në rrolin e funksionit ndihmës.

Lidhja operative regjistron disa manifestime që janë me interes të gjerë për pengimin e kriminalitetit, dhe për punën operative në përgjithësi. Duke marrë parasysh pozitën dhe relacionet, Lidhja operative në njëfarë mënyre bën sinjalizimin e lëvizjeve , kontakteve, të manifestimeve të ndryshme të jashtme dhe të aktiviteteve të veprimtarisë kriminale etj.

Gjatë angazhimit të lidhjeve operative në realitet, qëllimi është të merren informacione , të mblidhen ato dhe ti prezantohen të dhëna konkrete policisë, ndërsa ata në fakt nuk duhet të dinë se për çka shërbejnë këto të dhëna. Gjithashtu lidhja operative, për dallim nga bashkëpunëtorët e shumë nuk duhet të njoftohet gjithnjë me metodat taktike dhe me mjetet e policisë, posaçërisht jo për ato që janë të fshehta. Përkundër kësaj, rroli i bashkëpunëtorit është të ndjekë të bëjë përcaktimin faktik të dokumentojë dhe në esencë të zbulojë dhe të pengojë veprimtaritë kriminale e të tjera që janë me interes për policinë.

Për dallim nga lidhja operative puna e bashkëpunëtorit është dukshëm më e theksuar dhe më konkrete. Në shumë raste nëpërmjet bashkëpunëtorit bëhet i tere përpunimi operativ . Është fakt se bashkëpunëtorët e provuar dëshmojnë më së miri në ato mjedise prej nga rrjedhin, përkatësisht atje ku lidhja operative nuk ka mundësi të tilla apo të ngjashme. Bashkëpunëtori i ndjek veprimtaritë e veçanta, individuale apo grupe në planin kriminalistik dhe dokumenton këtë veprimtari, i mundëson

policisë zbatimin e metodave dhe mjeteve operative dhe operative-taktike për zbulimin dhe sqarimin e veprave penale, përkatësisht sigurimin e provave.

Policia gjyqësore i shfrytëzon lidhjet operative për mbledhjen e të dhënave të caktuara gjatë formave të ndërlikuara të punës operative. Më shpesh ato mund të jenë : kontrolli i të dhënave për ndonjë person, përpunimi operativ, aksioni operativ. Është evidente se pozicionet e lidhjeve operative lidhen sipas profesionit, pozitës, vendit të punës, vendit të tubimit , qëndrimit dhe lëvizjes së grupeve të caktuara ose individëve. Ose të hyjë në kontakt me persona të cilët janë në përpunim operativ.

Policia gjyqësore formon dosje për çdo bashkëpunëtorë, ndërsa për lidhjet operative nuk ndodh një rast i tillë. Bashkëpunëtori regjistrohet me pseudonim, që nuk është rast me lidhjen operative. Sipas orientimit të vet lidhja operative mund të jetë:

- Lidhja operative informator;
- Lidhja operative konsultant;
- Lidhja operative observues etj.

7. RRJETI I BASHKËPUNËTORËVE

Rrjeti i bashkëpunëtorëve mund të vlerësohet si një nga mjetet më të rëndësishme operative që i shfrytëzon dhe i zbaton shërbimin në punë e vet. Ky paraqet një përmbledhje të gjithë bashkëpunëtorëve të shpërndarë dhe të orientuar në atë mënyrë që siguron njoftime me kohë dhe të drejtpërdrejta të fakteve që janë me interes për shërbimin dhe zbatimin e shpejtë të tërësishëm dhe efikas të përpunimit dhe kontrollit kriminalistik.

Suksesi i realizimit të detyrave të shërbimit arrihet me aktivitete të njëkohshme dhe me koordinim kriminalistik-taktik dhe teknik, përkatësisht me metoda të punës (mjete dhe metoda të spiunimit, masa të tjera operative-taktike dhe veprime hetuese etj). Bashkëpunëtori është person i cili punon në mënyrë të vetëdijshme të organizuar dhe të fshehtë, me detyrë të dhënë nga shërbimi. “Bashkëpunëtori është person i cili në mënyrë të vetëdijshme të organizuar dhe të fshehtë sipas detyrave të personave të autorizuar zyrtarë, jep njoftime dhe të dhëna për veprat penale dhe kryesit e tyre, si dhe për fakte të tjera me rëndësi për ushtrimin e punës nga fusha e sektorit të sigurisë publike”.

Detyra të bashkëpunëtorit mund të jenë:

- Pengimi i kryerjes së veprave penale;
- Mbledhja dhe sigurimi i dokumenteve, të dhënave e të tjera, të cilat mund të shërbejnë si provë për veprimtarinë e kundërligjshme të personave, të dukurive dhe të ngjarjeve me interes për shërbimin;
- Mbledhja e të dhënave për personat për të cilët interesohet shërbimi;
- Kontrollimi i të dhënave të caktuara, rrethanave dhe fakteve;
- Kontrolli i punkteve operative;
- Krijimi i kushteve për zbatimin e masave të caktuara operative-taktike dhe të veprimeve hetimore; dhe
- Detyra të tjera të posaçme që i jepen bashkëpunëtorit.

Zgjedhja e bashkëpunëtorit mund të bëhet nga mjedise të ndryshme. Kështu për shembull nga njerëzit të cilët janë në kontakt të drejtpërdrejtë me kryerësit e veprave penale, ndërsa vet nuk kanë shkelur ligjet; nga njerëz që nuk kanë vese të cilët janë

në kontakt me shtresa të ndryshme të qytetarëve, përkatësisht me punë të tilla që u japin mundësi për bashkëpunim të frytshëm; me kundërvajtës aktiv ; me persona të dënuar ose të ndëshkuar.

Në bazë të tipareve karakteristike dhe tipareve të tjera personat që angazhohen si bashkëpunëtorë mund ti ndajmë në:

- Bashkëpunëtorë të mjediseve pa vese dhe
- bashkëpunëtorë të mjediseve kriminale.

Bashkëpunëtorët e mjediseve pa vese janë njerëz të cilët zakonisht angazhohen në baza patriotike dhe në bazë të pajtimeve me interesat e përgjithshme në shoqëri, në bazë të besimit të fituar e tj.

Bashkëpunëtorët e mjediseve kriminale janë persona të cilët angazhohen në bazë të materialit komprometues, të interesit material dhe të interesave të tjera.

Që një person të mund të jetë bashkëpunëtorë duhet ti ketë këto tipare:

- Sinqeriteti ndaj shërbimit ;
- Disiplina dhe përgjegjësia ;
- Aftësia për të ruajtur të fshehtë (konspirimin);
- Pasja e para dispozitave për aktivitete spiunimi dhe
- Aftësia për tu aftësuar lehtë dhe shpejtë ndaj mjediseve të reja me qëllim që të fitojë besimin.

Tiparet e përmendura mund të krijohen dhe të kultivohen edhe gjatë bashkëpunimit. Prandaj, detyra e nëpunësit operativ , i cili mban lidhje me bashkëpunëtorët, nëpërmjet punës të përhershme dhe sistematike duhet ti aftësojë ata për kryerjen me sukses të detyrave. Angazhimi është përfitimi i personave të caktuar për bashkëpunim.

Që të mund ti qasesh angazhimit të ndonjë personi për bashkëpunim së pari duhet të kesh qëllimin e qartë dhe të

përcaktuar. Sipas këtij qëllimi, kërkohet personi përkatës për bashkëpunim i cili i përmbush aftësitë (fizike dhe psikike) dhe nivelet (intelektual dhe kulturor) dhe kushtet objektive për bashkëpunim (statusin përkatësinë shoqëri , përkatësisht në mjedisin për të cilin është interesuar shërbimi). Gjatë përcaktimit se një person a mund të jetë bashkëpunëtorë , duhet të marrë parasysh të dhënat e tij biografike , tiparet dhe afinitetet personale dhe të karakterit, statusin material dhe familjar, pozitën në shoqëri dhe lidhjet, përkatësisht ndaj objektit të kontrollit ose të bashkëpunimit kriminalistik etj.

Baza e angazhimit është e ndryshme dhe duhet të kërkohet si e veçantë për çdo kandidat për bashkëpunim. Praktika e deritashme tregon se disa baza janë më të rëndësishme të cilat mund ti ndajmë në sa vijon:

- Identifikimi me interesin e përgjithshëm (patriotizëm, obligim qytetarë etj);
- Interesim personal (ndihmë gjatë zgjidhjes së problemeve personale, shpërblimit material si dhe shërbime të llojeve të ndryshme);
- Materiali komprometues, (nëse ka elemente të veprës penale të veprimtarisë përkatëse, mund të shfrytëzohet si material komprometues vetëm në raste të jashtëzakonshme, por me kusht që në këtë mënyrë të mund të zbulohet ose të pengohet një aktivitet më i rëndësi kriminalistik);

Në të gjitha rastet, për angazhimin e bashkëpunëtorit së pari duhet të sigurohet leja e udhëheqësit të policisë.

Para se të niset të angazhohet një bashkëpunëtor, është e domosdoshme që të bëhet propozim me shkrim që i përmban aspektet gjenerale të kandidatit, qëllimin, bazën dhe mënyrën e angazhimit, përshkrimin e materialit komprometues dhe të dhënave të tjera të nevojshme.

Nëpunësi i cili bën angazhimin është i detyruar të paraqes një raport të shkurtër për atë, me pseudonim që shfrytëzohet në vend të emrit dhe mbiemrit të tij, me të cilin bëhet edhe evidentimi i bashkëpunëtorit.

Në rast nevojë që për bashkëpunëtorë të angazhohet personi që ka vendqëndrim në territor të organit tjetër të punëve të brendshme, atëherë është e nevojshme të merret së pari mendim i organit të punëve të brendshme në territorin e të cilit qëndron dhe jeton ky person.

Lidhjen me bashkëpunëtorin, sipas rregullit e mban nëpunësi operativ i cili ka bërë angazhimin.

Vendi dhe mënyra e mbajtje së takimeve mund të jetë e tillë që të përjashtojë çdo mundësi për komprometim të bashkëpunëtorit dhe të objektit të kontrollit apo të përpunimit.

Koha e mbajtjes së takimeve me bashkëpunëtorët caktohet sipas kushteve dhe nevojave konkrete. Me këtë rast, për shkak të mbajtjes jo të rregullt të kontakteve, duhet pasur llogari të mos ndërpritet bashkëpunimi.

Nëse është angazhuar ndonjë bashkëpunëtorë në bazë të materialit komprometues, është e nevojshme të bëhet propozim për çregjistrimin e tij. Udhëheqësi kompetent do të vendos se si do të silllet në rastin konkret. Në raportin për ndërprerjen e bashkëpunimit, paraqitet edhe vendimi i udhëheqësit.

Nëse paraqitet nevoja sërish për të vënë bashkëpunim me bashkëpunëtorin (me të cilin është ndërprerë lidhja), atëherë pas pajtimit të dhënë nga udhëheqësi sërish do të vendoset bashkëpunimi. Rreth kësaj do të njoftohet edhe shërbimi i njërive operative.

Stimulimi dhe motivimi i bashkëpunëtorit, zakonisht është kusht për bashkëpunim të suksesshëm.

Format dhe mënyrat e stimulimit janë të ndryshme (fletë lëvdata, shërbime personale, shpërblime, materiale etj). Forma e stimulimit varet nga çdo rast konkret. Në radhë të parë nga personaliteti i bashkëpunëtorit dhe tiparet e tij, nga baza e angazhimit , nga detyrat e të tjera. Është mjaft me rëndësi të mbahet kujdes për bashkëpunëtorin dhe ti jepet ndihmë kur kjo është e domosdoshme .

Duke marrë parasysh personalitetin nëse ai rrjedh nga mjedisi kriminalistik, prej nga angazhohen numri më i madh i bashkëpunëtorëve shpërblimi material si stimul , duhet të zbatohet në mënyrë reale dhe me kujdes të madh sepse ekziston mundësia që bashkëpunëtori të provokohet dhe të japë njoftime të gabuara, me qëllim që të fitojë privilegje.

8. EVIDENCA E PËRPUNIMIT OPERATIV DHE E RRJETIT TË BASHKËPUNËTORËVE

Organizatat policore gati në të gjitha vendet e botës gjithnjë konsideroheshin si krijues , klasifikues dhe përsosje e të dhënave të regjistruara të cilët do tu mundësojnë në mënyrë të organizuar të zhvillojnë luftën kundër kriminalitetit. Në fillim në kushte mjaft primitive ndërsa tani në kushte bashkëkohore dhe në mënyrë të sofistikuar elektronike janë krijuar evidenca dhe përdoren evidence të ndryshme kriminalistike.

Evidencat kriminalistike në fakt, paraqesin vendosje të caktuar , grupuar dhe shfrytëzim operativ të objekteve të ndryshme konkrete të regjistrimit kriminalistik (dosje, albume, kartoteka, evidence etj), për nevojat e veprimtarisë operative.

Më poshtë do të vazhdojmë të flasim për evidencën e përpunimit operativ dhe evidencën e rrjetit të bashkëpunëtorëve.

8.1. Evidenca e përpunimit operativ

Për të marrë ndonjë vendim në lidhje me zbatimin e përpunimit operativ ndaj personit përkatës , ose për përpunim operativ të një ngjarje apo dukurie bëhet një shënim i shkurtër dhe në bazë të tij shërbimi i njësisë operative krijon dosjen përkatëse për mënyrën e zhvillimit të evidencës operative. Këtu përfshihen edhe shërbimet statistike-analitike për pengimin e kriminalitetit, policia e të tjera. Në njësitë operative mbahet regjistër i veçantë për përpunime të hapura operative. Regjistri duhet ti përmbajë këto të dhëna: numrin rendor, datën e hapjes së përpunimit operativ, të dhënat personale të personit për të cilin është hapur përpunimi operativ numri i dosjes së personit , shkaqet për të cilat bëhet përpunimi operativ (vepër penale për çka është i dyshuar personi), emri i personit zyrtar i cili e bën përpunimin , rezultatet e përpunimit operativ dhe data e përfundimit të përpunimit operativ.

8.2. Evidenca e rrjetit të bashkëpunëtorëve

Për çdo bashkëpunëtorë shërbimi për pengimin e kriminalitetit formon dosje. Gjatë formimit të dosjes për bashkëpunëtorin bëhet kartela për kartotekën e përgjithshme, sipas rendit të alfabetit. Në kartelë shkruhet vetëm mbiemri dhe emir i bashkëpunëtorit, emir i babës, data dhe vendi i lindjes së tij dhe numri i dosjes së tij. Nëse, përveç numrit të dosjes ka edhe shenjën (O) atëherë kjo do të thotë se dosja është nën embargo.

Për rrjetin e bashkëpunëtorëve në territorin e caktuar mbahet kartotekë e rrjetit të bashkëpunëtorëve në organin përkatës për mbajtjen e evidencës operative.

Shërbimet e policisë mund të mbajnë evidence për informatorët që kanë dhënë të dhëna të dobishme për të cilat mund të supozohet në fakt shërbimi në momente të caktuara mund ti drejtohet sërish ose të angazhojë përsëri.

9.VËZHGUESIT E FSHEHTË POLICOR DHE OPERATORËT E FSHEHTË

Me rëndësi të veçantë për veprimin operativ , gjithsesi është edhe aktiviteti kriminalistik-taktik i vëzhgimit të fshehtë. Këto aktivitete janë të rëndësishme për zbulimin dhe pengimin e kryerësve të organizuar të veprave penale. Në radhë të parë, për lidhshmërinë e tyre për ndërlikueshmërinë , si para kryerjes së veprave penale të ndërlikuara ashtu edhe gjatë kryerjes së këtyre veprave, por edhe më vonë. Detyra primare e policisë ligjore (në kuadër të kësaj edhe e policisë kriminalistike) është të neutralizojë kriminalitetin e organizuar dhe format e manifestimit . Kjo në fakt është preventivë adekuate policore, si në fazën e kontrollit kriminalistik ashtu edhe gjatë përpunimit kriminalistik. Metodatat e deritashme klasike operative të veprimit të policisë, të orientuara kryesisht në delikte konkrete, nuk janë mjaft të afta të njohin strukturën , logjikën , aspektin ndërshtetëror dhe interkontinental kriminalistik të ndërlidhur, ti zbulojnë udhëheqësit e grupeve të organizuara kriminele të cilat fshihen thellë në prapavijë , organizatorët dhe financuesit e aktiviteteve të kriminalitetit me organizim të lartë.

Një moment mjaft i rëndësishëm kriminalistik-taktik i veprimit operativ është pengimi i kriminalitetit, nëpërmjet

orientimit ndaj kryerësve potencial të supozuar. Ashtu siç do veprimtari kriminalistike-operative edhe vëzhgimi i fshehtë fillon nëpërmjet aktivitetit të planifikuar me qëllim të marrjes dhe mbledhjes dhe pastaj edhe të analizimit dhe të vlerësimit të informacioneve. Që të arrihet kjo është e nevojshme të fitohet besimi i mjedisit , e pastaj të njihet strategjia dhe sjellja e kryerësve potencial të veprave penale. Në mënyrë sistematike , duhet të mblidhen të gjitha faktet për operacionin e ardhshëm të planifikuar operativ-taktik. Këtu në radhë të parë bie: lidhshmëria organizative e kryerësve, vendi dhe koha e takimit, mjetet e komunikimit dhe marrja e tyre, *modus operandi*, masa e konsipariconit reciprok gjatë realizimit të aktiviteteve kriminale , si dhe organizimi i pjesëmarrësve dhe i tregut. Ky vëzhgim i organizuar diskret të observimit të fshehtë policor do të mundësojë për të arritur në kulmin e piramidës së kriminalitetit të organizuar. Vëzhgimi i fshehtë i mundëson vëzhguesve të fshehtë policor të arrijë te figurat kyçe të kriminalitetit të organizuar të cilët nga pamja e jashtme asnjëherë nuk paraqiten si kriminel.

Veprimi i vëzhgimit të fshehtë policor (VFP) duhet të dokumentohet që në fillim të dhënies së detyrës deri në realizimin e saj. Raporti, në çfarëdo lloj forme duhet të përqendrohet në dokumentacionin përkatës dhe të rruhet me shenjën (top sekret) fshehtësi e besueshme. Duhet bërë dallim (në lidhje me strategjinë e zbulimit post deliktum) , sepse çështjet klasike dhe relacioni : vepër penale – viktimë- paraqitje-përpunim kriminalistik-kallëzim penal te prokuroria, këtu nuk ekzistojnë te pika e mbështetjes në këtë formë të veprimit kriminalistik operativ bazohet tek dyshimi themelor dhe tek eliminimi i një numri të të dyshuarve derisa përpunimi kriminalistik operativ të të arrijë në një ose në më tepër kryerës.

Gjatë definimit të strategjisë për pengimin e krimit të organizuar duhet dalluar qartë dy aspekte:

- Pengimi policor (preventivë);
- Pengimi nëpërmjet ndjekjes penale

Në këtë kontekst , pengimi policor preventive i kriminalitetit nënkupton mbrojtje nga rreziqet që nuk janë të njëjta me reagimin e vetëm të rrezikut akut. Një veprimtari policore preventive e kuptuar në këtë mënyrë duhet të ketë prioritet gjatë pengimit të krimit të organizuar. Me vet këtë , edhe shpërblimi i policisë, si dhe vlerësimi i punës së policëve nuk do të vareshin më nga sukseset e masave represive. Në këtë drejtim, përvoja na tregon se disa veprime të caktuara të këtilla të planifikuara operative mund të vazhdojnë me vite të tëra.

Duhet bërë dallim ndërmjet UCA (Under cover agent) dhe VFP (vëzhgimit të fshehtë policor) sepse bëhet fjalë për dy natyra të ndryshme esenciale. Në radhë të parë UCA merret me të ashtuquajturën “gjuajtje e lirë” në mjediset kriminale, punon pa kontrollin, është future në nëntokën për një kohë të caktuar. Por, aktivitetet e saj janë të orientuara edhe ndaj kryerjes së veprave penale.

Përkundër kësaj , vëzhgimi i fshehtë policor (VFP), është orientuar në qëllime të caktuara konkrete, ka një ose dy udhëheqës që është në lidhje të pandërprerë dhe rregullisht informon, në aksion është vetëm për një kohë strikte të përcaktuar dhe nuk guxon të hyjë në kryerjen e veprave penale. VFP përdoret vetëm për zbulimin e veprave të rënda penale (të krimit të organizuar), dhe atë në kushte që vijnë:

- Kur metodat e tjera kriminalistike –taktike në situatë të caktuara operative nuk mund të merren parasysh dhe

- Kur metodat kriminalistike-taktike që kanë qenë të planifikuar janë zbatuar, por nuk i kanë dhënë rezultatet e pritura.

Vëzhguesi i fshehtë policor (VFP) është nëpunës policor i cili me pretekst dhe me identitet të rrejshëm vë kontakte me mjedisin kriminal me qëllim për të zbuluar strukturën kriminale organizative, në radhë të parë udhëheqësit e saj.

Në fakt bëhet fjalë për procedurë kriminalistike-strategjike pa të cilën nuk ka zbulim të suksesshëm të kriminalitetit në radhë të parë të ndërlikuar , të organizuar dhe ndërkombëtar. VFP zgjidhen në mënyrë të posaçme janë të arsimuar dhe polic të pajisur mirë. Ata, me pretekste të argumentuara, me biografi të rrejshme, me dokumente false e te tjera , mbajnë lidhje me mjediset kriminale duke ngritur fortifikata për ndërmarrje të masave dhe aktiviteteve të planifikuara. VFP jetojnë sipas mënyrës së mjedisit përkatës kriminal , shfrytëzojnë zhargonin e tyre, emetojnë kriminelët etj. Që të bëjnë këtë , ata duhet të njohin mirë psikologjinë kriminale, në të kundërtën dekonspirimi paguhet me jetën e tyre. VFP duhet të jetë vullnetare, të kenë guxim dhe të aftë , nga njëra anë , por edhe me moral të lartë nga ana tjetër. VFP gjithnjë duhet të veprojnë në kuadër të ligjit. Pas kryerjes së detyrës VFP braktis rrolin e vet të pranuar në mënyrë vullnetare. Për punën e operuesit të fshehtë nuk kërkohet ndonjë individ i tipit të posaçëm, kur bëhet fjalë për pamjen e tij të jashtme. Në mënyrë të fshehtë mund të punojë çdo operativist, me kusht që të jetë inteligjent dhe i gjindshëm, nëse ka veti të domosdoshme, sikurse janë: iniciativa, energjetik, guxim, vetëbesim, gjykim të mirë dhe të drejtë etj. Operativisti i fshehtë duhet të njohë gjuhë të huaja, gjuhët e fshehta , të gjitha dialektet dhe nëndialektet, duhet të mbajë mend mirë emrat fizionomitë dhe të dhënat të cilat i vërejnë dhe i dëgjon. Gjithashtu ai duhet ta

njohë mirë *modus operandit* e grupit kriminalistik, të ketë pasione e tj.

Zbatimi i VFP duhet të rregullohet me ligj, përkatësisht saktë të përkufizohet : shfrytëzimi, mbrojtja dhe obligimet e agjentit.

Pyetje për studentët:

- 1. Cilat janë llojet më të shpeshta të veprimit kriminalistik operativ?**
- 2. përmendi metodat dhe mjetet e kontrollit kriminalistik.**
- 3. Shpjego format e zbatimit të kontrollit kriminalistik.**
- 4. Shpjego planet e kontrollit kriminalistik.**
- 5. Cilët janë mangësitë më të shpeshta në organizimin e kontrollit kriminalistik?**
- 6. Shpjego organizmin dhe planifikimin e përpunimit kriminalistik.**
- 7. Shpjego valorizimin dhe analizën e hetimit kriminalistik.**
- 8. Cilët janë hetimet e përbashkëta ndërsektoriale të kriminalistikës?**
- 9. Shpjego hetimet e përbashkëta ndërsektoriale kriminalistike.**
- 10. Shpjego hetimet e përbashkëta ndërkombëtare kriminalistike.**
- 11. përkufizo informatorin dhe shpjego llojet e informatorit.**
- 12. përkufizo bashkëpunëtorin.**
- 13. Shpjego karakteristikat e marrëdhënieve me bashkëpunëtorin.**
- 14. Shpjego dallimet ndërmjet lidhjeve operative dhe bashkëpunëtorit.**

15.Ç'është rrjeti i bashkëpunëtorit.

16.Shpjego evidencën e përpunimeve operative dhe të rrjetit të bashkëpunëtorëve.

17.Ç'janë vëzhguesit e fshehtë policor dhe operativët e fshehtë.

KREU IV

MËNYRAT E KUPTIMIT (NJOFTIMIT) TË PËRGATITJES OSE EGZISTIMIT TË VEPRAVE PENALE

1. SHËNIME TË PËRGJITHSHME

Funksioni i policisë ligjore gjatë mënjanimit të kriminalitetit zhvillohet në radhë të parë, në procedurën para hetimore. Me rëndësi për punën e policisë ligjore janë aspektet kriminalistike dhe proceset penale të cilat janë komponentët të zbatimit praktik të masave dhe aktiviteteve të veçanta në bazë të autorizimeve që përcaktohen në ligjin e procedurës penale, në ligjin e punëve të brendshme, në ligji e policisë, në ligjin e policisë financiare e të tjera.

Në lidhje me këtë me rëndësi janë pyetjet se në çfarë mase realizohet me sukses bashkëpunimi në procedurën para hetimore ndërmjet policisë ligjore, prokurorit publik, gjyqit dhe subjekteve të tjera shoqërore.

Faza e zbulimit të veprave penale dhe të kryerësve të tyre nga ana e policisë ligjore në procedurën para hetimore është rregulluar me dispozita të ligjit të procedurës penale. Sipas dispozitave të ligjit të procedurës penale kusht i domosdoshëm për ngritjen e aktiviteteve të policisë ligjore, në aspektin e marrjes së masave dhe aktiviteteve të nevojshme për zbulimin e veprave penale dhe të kryerësve të tyre, është marrja e njoftimeve se është kryer vepër penale e cila ndiqet sipas autorizimit zyrtar. Ky njoftim mund të jetë i shkallëve të ndryshme të besueshmërisë apo të realitetit. Por, që policia ligjore të mund të veprojë janë të domosdoshme dyshimet e arsyeshme. Një obligim i këtillë përbëhet nga marrja e masave dhe aktiviteteve operative-taktike, me qëllim të zbardhjes së veprës penale dhe zbulimit të aktorit të saj. Gjithashtu bërja e pamundshme e fshehjes së saj ose të ikjes, si dhe mbledhja dhe sigurimi i sendeve dhe gjurmëve të cilat

mund të shërbejnë si prova. Përkatësisht të mblidhen njoftime të cilat mund të jenë të dobishme për zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale. Cilat masa do ti zbatojë policia ligjore, është çështje relative që varet jo vetëm nga përmbajtja e informacionit paraprak, shkalla e saktësisë, por edhe nga burimi i njoftimit. Sipas kësaj, nëse njoftimi bëhet përmes vet vetiniciativës së policisë ligjore, masat dhe aktivitetet e mara edhe më tutje do të vazhdojnë nëpërmjet iniciativës të vet njërive organizuese. Në këtë fazë fillestare më shpesh merren masa dhe aktivitete të përgjithshme operative: kontrollime, përcaktimi i identitetit, vëzhgime, mbledhja e njoftimeve, racioni, prita e të tjera.

Kjo do të thotë se bazat e dyshimit krijojnë obligime te organet e zbulimit në drejtim të përcaktimit se a ekziston veprë penale dhe nëse ekziston në bazë të fakteve të tilla të angazhohen për zbardhjen e të gjitha fakteve që lidhen me veprën penale dhe me kryerësin. Kështu, bazat e dyshimeve paraqesin mbështetjen në të cilën ndërtohet përpunimi operativ me qëllim të zbulimit të veprës penale dhe të kryerësit. Bazat e dyshimit mund të jenë të ndryshme:

- Baza të dyshimit që tregojnë për kryerjes e veprës penale, por kryesi është ende i panjohur;
- Bazat e dyshimit të cilat përveç veprës penale vënë në dukje edhe kryerësin;
- Bazat e dyshimit të cilat vënë në dukje një person të caktuar si kryerës i ndonjë veprë penale tiparet themelore të së cilës ende nuk janë zbuluar. (për shembull, sjellja e dyshimtë e një aktori të shumëfishtë në kuptimin e harxhimit të pakontrolluar dhe me bollëk të parave, pasja e sendeve shumë të shtrenjta e tj).

Për dallim nga bazat e dyshimit, LPP e njeh edhe nocionin *dyshim themelor*, që paraqet shkallën më të lartë të saktësisë dhe

jep shkaqe për ngritjen e hetimit. Në momentin kur bazat e dyshimit do të shndërrohen në dyshime themelore, atëherë plotësohet kushti për ngritjen e hetimit nga ana e prokurorit publik. Nëse këto baza të dyshimit rriten në dyshime themelore, policia ligjore është e detyruar që prokurorit publik përkatës t'i paraqes kallëzim penal ku do të theksonte provat që i ka të njohura dhe do të marrë masa për ruajtjen e gjurmëve të veprës penale, të gjësendeve nëpërmjet të cilave është kryer vepra penale dhe prova të tjera.

2. VEPRIMTARIA KRIMINALISTIKE-INFORMATIVE

Njësitë organizuese të policisë ligjore gjatë zbulimit dhe pengimit të kriminalitetit orientohen nga ndihma e besueshme e qytetarëve. Qytetari ka obligim moral, në kuadër të mundësive të veta të bashkëpunojë me shërbimet policore dhe me organet e procedurës penale për zbulimin e veprës penale dhe të kryerësve të saj. Kjo ka të bëjë aq më shumë sepse nga numri i madh i hetimeve kriminologjike-kriminalistike mund të thuhet se kriminelët- kryerësit e veprave penale, gjithnjë e më shumë po edukohen dhe pajisen teknikisht, kështu që është vështirë të zbulohet akti, ndërsa aq më vështirë është të zbulohet kryerësi. Nëpunësit operativ kriminalistik, përveç metodave dhe mjeteve të shumta për zbulimin e delikteve dhe të delikuentëve, përdorin edhe rrjetin e bashkëpunëtorëve si mjet i rëndësishëm pa të cilin nuk mund të paramendohet veprimtaria e suksesshme kriminalistike-operative.

Informatorët dhe bashkëpunëtorët, pothuajse në tërë botën policia i shfrytëzon si mjet i pazëvendësueshëm për zbulimin dhe pengimin e krimit.

Sot, nevoja e domosdoshme e shfrytëzimit të informatorëve dhe bashkëpunëtorëve, në radhë të parë shihet në ndjekjen e formave të manifestuara të krimit, në zbulimin e tyre, në mënyrën e vërejtjes dhe në mbulimin hapësinor dhe kohor të pasojave materiale, përkatësisht të gjurmëve të veprës penale. Së këndejmi, me të drejtë thuhet se informatorët dhe bashkëpunëtorët janë mjete të fshehta të punës kriminalistike dhe janë bartës kryesor (por jot ë vetmet) të veprimtarisë kriminalistike që japin kontribut të madh në parandalimin, zbulimin dhe dëshmimin e zhvillimeve të caktuara kriminale. Një kontribut i këtillë do të jetë edhe më i madh dhe më i dukshëm nëse të punësuarit në shërbimet për pengimin e kriminalitetit orientohen në formimin dhe në shfrytëzimin e rrjetit të bashkëpunëtorëve. Fakti për të cilën çdo gjë dihet dhe çdo gjë është e qartë do të thotë asgjë nuk dihet dhe asgjë nuk është e qartë. Ky konstatim ka dëshmuar edhe gjatë përvojës sime personale si nëpunës shumëvjeçar operativ në strukturat e sigurisë të shtetit.

Në këtë libër , siç duhet ta dijë edhe lexuesi pedant dhe i kujdesshëm , informatorëve dhe bashkëpunëtorëve, i është kushtuar kreu i mëparshëm (pjesa e tretë) dhe për këto shkaqe këtu nuk do të elaborohet kjo mënyrë e të kuptuarit të përgatitjes ose të ekzistencës të veprës penale.

3. FLETPARAQITJE E PJESËTARIT TË STRUKTURAVE TË SIGURISË

Në literaturën kriminalistike policët e uniformuar trajtohen si nëpunës themelor operativ. Ata marrin masa përkatëse, preventive dhe represive.

Në masat preventive radhiten të gjitha llojet e njoftimeve për: manifestime të ndryshme shoqërore të rrezikshme, shkaqe

dhe pasojat e këtyre manifestimeve, vështirësitë, njerëzit e dyshuar, personat e panjohur e kështu me radhë. Në grupin e dytë të masave preventive bien mbikëqyrja dhe vëzhgimi i punës dhe lëvizjes së personave të dyshimtë, të të dënuarve, të atyre që janë liruar me kusht, pijanecëve , bixhozxhinjëve, të papunëve dhe rrugaçëve. Pastaj vizitat ditore dhe të natës , pritrat, racionet ; mbikëqyrje ndaj: rrugëve, shesheve, panairove, stacioneve të hekurudhave, lokaleve publike, automjeteve, tubimeve më të mëdha etj.

Gjatë situatave kur vepra penale është kryer , nëpunësi i uniformuar policor është i detyruar të njoftojë nëpunësin përkatës operativ. Me këtë rast ai duhet të marrë masa përkatëse represive dhe preventive , si për shembull: të sigurojë vendin e ngjarjes, të mbajë kryerësit apo personat e dyshimtë, të mbajë dëshmitarët, të shënojë të dhënat e përgjithshme të personave të pranishëm, të ndjek kryerësin, të ruajë pasurinë e dëmtuar etj. Gjithashtu nëpunësi i uniformuar duhet të sillet sipas të gjitha urdhrave që do t'ia jap nëpunësi operativ. Rreth të gjitha këtyre aktiviteteve polici i uniformuar në një afat kohor sa më të shkurtër duhet të përgatis materialin zyrtar i cili do të shërbejë për aktivitetet e mëtejshme të nëpunësve operativ.

4. FLETPARAQITJA E INSPEKSIOENEVE, E SHËRBIMEVE TË REVIZORIT DHE TË SUBJEKTEVE EKONOMIKE

Dihet se shërbimet e policisë ligjore në punën e përditshme bashkëpunojnë me një numër të madh shërbimesh. Kështu për shembull , me inspektorin e punës , me inspektorin e tregut, me inspektorin e ndërtimit, me inspektorin sanitar, me inspektorin e veterinarisë, me inspektorin e devizave , me inspeksionin

ekologjik, me inspektorin e doganave e tj. Roli i tyre gjatë mënjanimit të kriminalitetit është shumë i rëndësishëm. Duke marrë parasysh kompetencat e tyre, autorizimet që ato kanë marrë për sipër si dhe rrethanat e tjera që e karakterizojnë punën e tyre mund të përfundojmë se ato gjenden në pozitë që të jenë faktorë mjaft të rëndësishëm, si gjatë zbulimit të formave të veçanta të krimit, ashtu edhe gjatë dëshmimit të tyre dhe sigurimit të provave.

Shërbimet e këtilla janë të obliguara të bëjnë mbikëqyrje të ligjshmërisë së punës së ndërmarrjeve dhe të enteve, mbikëqyrje mbi ligjshmërinë e akteve të ndërmarrjeve dhe të enteve; mbikëqyrje inspektimi etj.

Mbikëqyrjen e inspektimit e bëjnë ministritë nëpërmjet inspektorëve. Gjatë ushtrimit të këtyre aktiviteteve inspektorët kanë obligimet e veta që janë faktor i rëndësishëm për mënjanimin e kriminalitetit.

Në fakt, inspektorët kanë detyrë dhe obligim:

- T'i kontrollojnë aktet e përgjithshme dhe të veçanta, evidencat dhe dokumentet e tjera;
- T'i dëgjojë dhe të marrë deklarata (sqarime) nga personat përgjegjës dhe të interesuar;
- Të kontrollojë hapësirat afariste, objektet, pajisjet, sendet dhe mallrat;
- Të marrë mostra nga malli dhe sendet e tjera për analizë, ekspertizë etj.;
- Të marrë masa dhe aktivitete të tjera për të cilat është i obliguar me ligj ose me dekret.

Përveç kësaj inspektori është i obliguar të bëjë flet paraqitje te organi përkatës për vepër penale të kryer, të japë urdhra, përkatësisht ndalesa në pajtim me ligjin dhe të njoftojë organin tjetër që është kompetent për të ndërmarr masa përkatëse.

Nga ajo që u tha më lartë mund të përfundojmë se obligimet e veçanta të inspektorëve janë mjaft të ngjashme me obligimet e policëve në procedurën para hetimore. Kjo posaçërisht vlen për kontrollin e dokumentacionit, marrjes së deklaratave (sqarimeve, kontrollit të hapësirave, objekteve etj).

Me reformat në sistemin fiskal në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar

sipas shembullit të shteteve me ekonomi të zhvilluar të tregut , në sistemin administrative tatimor të vendit është vënë policia financiare, si njësi e veçantë organizative për të bërë kontrollin në lëmin e të ardhurave publike.

Policia financiare është përgjegjësi për kontrollin gjatë llogaritjes dhe pagimit të tatimeve, të detyrimeve dhe të të ardhurave të tjera publike. Gjatë realizimit të kësaj veprimtarie , ajo zbaton procedura dhe shqipton masa me të cilat është autorizuar me ligj. Kështu ndër të tjerat ajo zbulon kundërvajtjet, vepra penale në lëmin e të ardhurave publike e tj.

Me qëllim që të kryejë me sukses detyrat, inspektori i policisë financiare mund:

- Të bëjë kontrollin e regjistrave afarist të dokumentacionit të punës dhe të evidencave të tjera;
- Të bëjë kontrollin e shpenzimeve dhe të gjendjes së rezervave të inventarit, të materialeve të lëndëve të para, të gjysmëfabrikateve, të prodhimeve të gatshme etj.;
- Të kontrollojë pagesat e xhirollogarive, pagesave të gatshme, mënyrën e pagesave, pagesën e tatimit, taksave dhe detyrimeve të tjera;
- Të bëjë kontrollin e hapësirave afariste dhe të tjerave ku zhvillohet njëfarë veprimtarie ose rruhet malli apo prodhime të tjera;

- Të bisedojë, përkatësisht të marrë shpjegime me shkrim nga njerëzit e obliguar dhe nga dëshmitarët, në lidhje me përcaktimin e të ardhurave publike;
- Përkohësisht të konfiskoje mallin;
- Të bëjë kontrollin e paraqitjes së qarkullimit të realizuar të pasurisë së paluhatshme dhe të së drejtave etj.

Për çdo aktivitet të ndërmarrë nga ana e policisë financiare bëhet materiali zyrtar (proces verbali ose diç e ngjashme) që mund të jetë burim i mirë i provave në procedurën penale për veprën penale në lëmin e të ardhurave publike.

Jemi të mendimit se analiza e policisë financiare e përfshirë në procesverbalin e kontrollit të kryer duhet të ketë forcën e provës në procedurën penale, por jo edhe atë absolute. Në rast kontestimi serioz , aim und ti nënshtrohet revizionit, përkatësisht ekspertizës.

Në kuadër të subjekteve ekonomike, gjithashtu bëhen vepra të ndryshme penale (ose ndaj pasurisë së tyre) për të cilët njoftohen të punësuarit, personat përgjegjës etj. Në situatë të këtilla, përkatësisht të veprave penale ose të dyshimeve themelore njoftohen organet përkatëse shtetërore, veçanërisht policia kriminalistike.

Në vazhdim do të prezantojmë një shembull të praktikës operative . *Më 5 . 9. 2003 , drejtori i fabrikës “Setkom Rent A Kar” nga Shkupi OPB Gazi Babë- Shkup, i paraqiti njoftim me shkrim për vjedhjen e automjetit, përkatësisht të huazuar, por sipas kontratës ajo ende nuk i është kthyer nga ana e I.P. shtetas i huaj.*

Në fakt I.P. më 25.8.2003 , nga kompania e përmendur më lartë me (me kontratë të shkruar) mori me qira një automjet “Ford focus”. Automobili pas tre ditësh duhej të kthehej në kompaninë e Rent A Kar-it, ndërsa për shërbimin e dhënë të

paguajë 300 euro. Por, I.P. jo vetëm që nuk e ktheu automjetin por me të , shkoi dhe qëndroi në Ohër. Ndërsa nga kontrolli operativ i ndërmarre nga mbikëqyrja e bërë në dokumentacion për automobilin, nga bisedat e bëra me të dëmtuarin (si në Shkup ashtu edhe në Ohër), është vërtetuar se I.P. jo vetëm që nuk ka pasur për qëllim të plotësojë kontratën , por në mënyrë të paligjshme e bëri për veten automobilin . Ndërsa më vonë (nëpërmjet mashtrimit) , me shitjen e këtij automobili nga një person fizik nga Ohri fitoi edhe mjete në para. Në këtë mënyrë I.P. i realizoi qëllimet e veta mashtruese dhe u largua për në Mal të Zi. Kundër kryesit të këtij akti penal nga ana e OPB- Gazi Babë – Shkup është bërë kallëzim penal për veprë penale (tjetërsim) ndërsa automobili nga ana e policisë i është kthyer pronarit.

5. FLETPARAQITJE TE TË DËMTUARIT OSE E DËSHMITARËVE TJERË

Një nga mënyrat më të shpeshta të kuptuarit e ekzistimit të veprës penale është paraqitja nga i dëmtuari. Rëndomë kjo mënyrë është mjaft e sigurt. Por, megjithatë në praktikë ndodhin edhe paraqitje⁴¹ të rrejshme. Teprimi ose ngritja shumë e lartë e ngjarjes janë shpeshherë ka elemente përcjellëse të paraqitjes reale. Pse themi se kjo mënyrë është mjaft e sigurt. Nga i vetmi shkak se i dëmtuari është i interesuar për zbardhjen e gjendjes

⁴¹ Më 8.8. 2003 në lokalet e OPB “Gazi baba” –Shkup është zhvilluar një bisedë informative me I.P., në lidhje me akcidentin rrugor dhe largim nga vendi i ngjarjes, me ç’rast ishte dëmtuar personi A.B. Në bisedë I.P shpjegoi se më datë 19.07. 2003 rreth orës 13.30 minuta ishte duke drejtuar automjetin e udhëtarëve “Zastava 101” prone e babait të tij. Me automobilin ishte duke lëvizur nga lagja “Çento” për në “Maxhari” dhe kur arriti nja dhjetë metra para vijaduktit pa pritmas nxitoi një vajzë të cilën ai e goditi me anën e përparme të majtë të automobilin, dhe pa u ndalur (për shkak të frikës dhe drojës) është larguar në drejtim të autoservisit “Uvo”, ku e ka lënë automobilin dhe shkoi në shtëpinë e vet. Kur arriti në shtëpi, nënës së vet i tha se ia kanë vjedhur automobilin. Pas kësaj, ai dhe nëna e tij shkuan në polici dhe e paraqitën automoblin të marrë nga person i panjohur.

faktike, sepse me veprën penale janë cenuar interesat e tij vitale: pasuria, integriteti fizik dhe nderi e morali i tij. Paraqitja do të ketë ngjyrë subjektive, por në vetvete do të përmbajë bërthamën objektive e cila duhet të kontrollohet dhe të konfirmohet .

Por sipas parimit të skepsës, kriminalisti duhet të ketë parasysh gjithnjë se paraqitësi do t'i lë anash ose do t'i deformojë faktet e paraqitura të cilët nuk e prezantojnë në dritë të plotë personalitetin e tij apo rrolin në lëndën penale. Në rastet kur i dëmtuari paraqet një kryerës të njohur, kjo pothuajse çdo herë është si rregull.

Gjithashtu, në praktikë paraqiten dëshmitarë të cilët për veprën penale kanë dëgjuar prej të tjerëve. Në fakt, bëhet fjalë për të ashtuquajtur dëshmitarë që kanë dëgjuar dhe ato paraqesin kategorinë më të keqe të dëshmitarëve, të cilët mund të jenë me qëllime të mira dhe të vetëdijshme, por, paraqitjet e tyre janë të ngarkuara me shpjegime të gabuara dhe plot gabime. Por, gjithashtu, kriminalisti nuk duhet të harrojë se qytetari mund ta paraqes veprën për arsye të ndryshme, në radhë të parë, motive të ulëta (hakmarrje, urrejtje, xhelozia, et.) prandaj gjithnjë duhet të përcaktojë motivin e paraqitjes.

Ekziston një grup paraqitësish të cilët njoftojnë për sjellje jot të zakonshme të fqinjëve, por nuk janë në gjendje të detektojnë veprën penale për të cilën kanë dyshime. Prandaj, këto njoftime duhet të analizohen dhe të veçohet ajo që është me interes për shërbimin, por duhet të vazhdohet me mbledhjen e informacioneve të reja gjersa të fitohet pasqyra e qartë për vlerën e informacionit. Paraqitja mund të bëhet me gojë, me shkrim, nëpërmjet telefonit⁴², me telegram etj.

⁴² Vrasje e zbuluar nëpërmjet telefonit: Një gjerman që e kishte vrarë bashkëshorten e tij për pak do të kishte mundur t'i shmanget ligjit nëse nuk kishte ndodhur një thirrje nga një agjenci telemarketingu. Në fakt, bashkëshorti e kishte sulmuar gruan e tij me thikë, por kur telefoni cingërroi gruaja e kapi telefonin dhe bërtiti me zë të lartë: Ju lutem , më ndihmoni, burri im do të më vrasë”, para se ta vriste ai ja mori gruas dëgjuesen nga dora. Nën punsja e

Gjatë marrjes së paraqitjes policia shfrytëzon ekzemplarë të ndryshëm , me qëllim të pasqyrimin sa më të shpejtë të gjendjes faktike dhe të marrjes së masave për të siguruar gjurmët dhe ndjekjen.

Nëse paraqiten baza për dyshim se paraqitësi është kryerësi i mundshëm ose pjesëmarrës në vepër penale, atëherë biseda orientohet në këtë drejtim, por në mënyrë diskrete menjëherë kontrollon edhe alibi⁴³ i tij.

Paraqitjet mund ti ndajmë në të vërteta , mashtrime (objektivisht të pavërteta, qëllimmira) dhe gënjeshtër⁴⁴.

6. DENONCIME ANONIME DHE ME PSEUDONIM

Nuk janë të rralla rastet në praktikë kur për ekzistimin ose për përgatitjen e veprës penale kuptohet nëpërmjet denoncimeve të këtilla. Paraqitja anonim nuk është e nënshkruar, ndërsa me pseudonim ka nënshkrim të rrejshëm. Paraqitjet e këtilla mund të jenë *të vërteta* dhe *të pavërteta*. Paraqitjet e vërteta i bëjnë qytetarët të cilët kanë frikë nga hakmarrja nga ana e kryerësit të veprës penale. Për shembull, kur është në pyetje organizata kriminale ose kur veprën penale e ka bërë një që i është nënshtruar paraqitësit. Paraqitjet e pavërteta bëhen si rezultat i

paidentifikuar e agjencisë ka menduar se këta njerëz dëshirojnë në këtë mënyrë të refuzojnë shërbimin e saj, por megjithatë e thirri policinë dhe ua dha numrin e telefonit. Policia e alocoj adresën e telefonit në qytetin Gislengen të Gjermanisë ku e gjeti këtë burrë se si përpiqet të hedhë trupin e bashkëshortes 27 vjeçare. Ai u akuzua për vrasje.

⁴³ Nocioni alibi, në përkthim të lire do të thotë “diku në ndonjë vend tjetër”.

⁴⁴ Denoncim i rrejshëm për hajni në Koçanë (“ u plagos dhe tregoi dhunën horror”). Më 19.10. 2005 S.GJ denoncoi në polici se në shtëpinë e saj në Koçan është sulmuar, maltretuar dhe pastaj e kanë vjedhur dy hajna të cilët pasi e kanë mbyllur në banjë ikën. Policia pas paraqitjes së ngjarjes dhe pas hetimit të bërë konfirmoi se S.Gj e ka paramenduar ngjarjen, me ç’rast kundër saj u ngrit kallëzim penal për vepër penale denoncim i rrejshëm. U vërtetua se gruaja që e bëri denoncimin në polici ka regjistruar një film për çka u konstatua se ajo është e sëmurë psikike.

shumë motiveve. Për shembull, për hakmarrje ndaj ndonjë personi, me qëllim që ti shkaktohen vështirësi në jetën e tij e të tjera. Ose , kryerësi i vërtetë dëshiron që ta orientojë gabimisht veprimtarinë operative. Gjithashtu, sëmundje të ndryshme mund të paraqiten si shkak i paraqitjeve të pavërteta anonime dhe me pseudonime. Për shembull nga paranoja⁴⁵ ose ndonjë lloj tjetër histerik.

Njësitë organizative të policisë ligjore nuk duhet ti hedhin kallëzimet anonime dhe me pseudonim, por në kuadër të përpunimit kriminalistik të verifikojnë vërtetësinë e tyre. Do të ishte gabim që kallëzimi anonim të hidhet për shkak të fatit se nuk dihet autori i tij. Hedhja në këtë mënyrë e të kuptuarit do të thoshte ta asgjësojmë nga mjeti ndihmës i çmueshëm , të mbetemi të shurdhër ndaj një sinjali vetëm nga fakti se nuk e dimë se kush e jep. Nëse kallëzimi tregohet si i vërtetë, atëherë nuk duhet gjurmuar paraqitësin.

Megjithatë , kur do të vërtetohet se përmbajtja e kallëzimeve të këtilla është e pasaktë atëherë duhet organizuar gjurmim rreth paraqitësit, me qëllim të gjetjes së tij dhe të paraqitjes së kallëzimit penal për veprë të kryer penale kallëzim të rrejshëm. Në kushte të këtilla duhet të planifikohet edhe versioni se kallëzuesi i rremë mbase është kryerës i veprës penale për të cilën e ngarkon tjetrin.

Në situatë të këtilla kallëzimi i rrejshëm duhet ti tregohet qytetarit të paraqitur se duke e pyetur se cili person nga rrethi i tij mund të ketë motive për ta paraqitur atë. Njëkohësisht , duhet të bëhet edhe ekspertizë kriminalistike-teknike të kallëzimit të

⁴⁵ Është një çrregullim shpirtëror tek të cilët për shkak të brendëshme zhvillohet sistemi i përhershëm i padyshimtë marrëzor, por te i cili megjithatë mbetet një qartësi dhe një radhitje mendimesh, në vullnet dhe në aktivitete. Në këtë mënyrë, paranoiku në mënyrë të plotë e ndryshon stilin e vet të jetesës, pikpamjet e veta për botën, ndërsa për mjedisin jo sugjektiv ai është i marrë.(Shih tek L. Novotni, Psikiatria gjyqësore, Shkup, 1990

rrejshëm. Kështu për shembull, të bëhet ekspertiza e shkrimit, analiza e tekstit, analiza e letrës, analiza e shkronjave, të gjurmëve të gishtave, analiza e pështymës që të mund të bëhet ADN, të vërtetohet njolla e postës prej ku është dërguar letra në bazë të kësaj të planifikohen versionet e nevojshme.

7. THASHETHEMET (BISEDA PUBLIKE)

Me thashetheme në kriminalistikë nënkuptohet përcjellja e lajmeve se është kryer ndonjë vepër penale për të cilën ka nisur ndjekja në mënyrë zyrtare , dhe se një person i caktuar është kryerës i veprës penale, ndërsa me këtë rast nuk dihet se a është e saktë dhe prej nga ka rrjedhur ky lajm. Lajmi për vepër penale mund të jetë i saktë ndërsa thashethemet për kryerësin të jenë të pasakta. Nuk është e thënë që gjithmonë të ekzistojnë bashkë të dy elementet e thashethemes .

Thashethemet mund të jenë *të vërteta ose të pavërteta*, nga ana tjetër , lajmi që transmetohet nëpërmjet opinionit ndryshon, shtrembërohet etj.

Por, policia ligjore duhet i pranojë thashethemet e këtilla dhe ti verifikojë. Nëse vërtetohet se thashethemet janë të vërteta, atëherë nuk duhet gjurmuar rreth burimit të informacioneve të tilla. Por, nëse vërtetohet se informacioni nuk është i vërtetë , sipas përmbajtje së tij paraqet vepër penale, atëherë nis veprimi për zbulimin e burimit. Burimi , në qytetet më të mëdha është shumë vështirë të zbulohet, prandaj procedura për zbulimin e burimit të thashethemeve duhet të nis nga personi i fundit i cili ka dëgjuar për këtë informacion, pastaj të bisedohet me personin para tij (që ka dëgjuar për informacionin) , duke vazhduar kështu

derisa të arrihet te burimi i parë. Sipas nevojës zbatohet edhe masa operative- taktike ballafaqim.⁴⁶

8. VETËPARAQITJA (DORËZIMI) E KRYERËSIT TË VEPRËS PENALE

Një burim i këtillë e të kuptuarit për vepra penale të bëra janë rraste të rralla, por megjithatë ekzistojnë. Për këto arsye do të bëjmë fjalë edhe për këtë. Që në fillim do të thoshim se vetë paraqitja mund të jetë e vërtetë dhe jo e vërtetë. Praktika na mëson se janë të mundshme këto situata: vetë paraqitja është e vërtetë; vetë paraqitja është e pavërtetë, dhe vetë paraqitja është e rrejshme⁴⁷. Është e ditur se vetë paraqitja e lehtëson punën e policisë ligjore, por disa nga nëpunësit operativ janë të prirë të shkojnë drejt linjës e rezistencës së vogël dhe menjëherë i besojnë qorrazi i besojnë rastit. Pastaj, thonë se vetë paraqitja mund të jetë gjest taktik i kryerësit me qëllim që procedura të marrë kahe të gabuar. 'Kriminalisti i cili nuk e njeh sa duhet taktikën dhe psikologjinë e delikuentëve udhëhiqet nga arsye e ashtuquajtur "rezon i shëndoshë". Prandaj, parimi i qasjes kritike edhe këtu duhet të zbatohet pa kurrfarë rezervash. Çdo deklaratë e vetë paraqitësit duhet të vërtetohet me kujdes. Pasi të jetë dëgjuar vetë paraqitësi duhet të bëhet shikimi dhe të merret të gjitha masat e nevojshme operative-taktike dhe veprimet hetuese. Gjithashtu,

⁴⁶ Ballafaqimi përqendrohet në shpjegimin e të dhënave të dyshimta ose kontradiktore, ndërsa bëhet nëpërmjet shqyrtimit të njëkohshëm të një ose dy personave të pyetur ose të dëgjuar më pare, kur deklaratat e tyre për nga përmbajtja janë të ndryshme, përkatësisht kontradiktore në raport me ndonjë fakt të rëndësishëm.

⁴⁷ Vetëparaqitja e rrejshme e pavetëdishme ekziston kur personi paraqet veten se është kryerës i veprës penale, duke menduar me këtë rast se e ka bërë atë gabimisht. Për shembull, gjatë një përleshje burri e ka shtrënguar të shoqen për fyti, me ç'rast ajo pastaj ka vdekur. U paraqit se ka bërë vrasje. Por, nga obdukcioni u vërtetua se shkak i vdekjes nuk është gulfatja por infarkti.

vetë paraqitësi duhet në vetë vendin e ngjarjes edhe një herë të përshkruaj aktin e kryer. Një përshkrim i këtillë dhe ai i dhënë më parë, nëpunësit operativ duhet t'i krahasojnë. Pastaj nxirren konkluzione për veprimin e mëtejshëm.

Më shpesh kryerësit e aktiv e paraqesin të vërtetin sikur e kanë bërë në gjendje të çrregullimeve psikike, ose kur është penduar për aktin e kryer, nëse është i madh ndikimi psikik ndaj personalitetit të tij, nëse është i përgatitur për të mbajtur dënimin që do ta merrte etj. Një sjellje e këtillë është karakteristike për kryerësit e rastit dhe për kryerësit nga pakujdesia. Ose, për personat nevralgjik të cilët nuk mund t'i qëndrojnë presioneve shpirtërore (depresioneve). Nëse krimineli profesional ose kryerësi e ka bërë këtë për shkak të pasionit, atëherë kjo është bërë për qëllime dhe motive krejtësisht të tjera. Faktikisht, viktimizohen për një të keqe më të vogël për shkak nga një e keqe më e madhe. Realisht, dëshirojnë të fshehin organizatën që qëndron pas tyre, ose për të përmirësuar pozitën e tyre para gjyqit, veçanërisht nëse ndodhen në pozitë për t'u zbuluar ose për t'u arrestuar.

Kur bëhet fjalë për vetë paraqitjen e rrejshme, këtë mund ta bëjnë njerëz plotësisht të shëndoshë shpirtëror, ashtu edhe persona të sëmurë psikik. Rëndom kjo bëhet për: vepër penale që nuk ekziston dhe për vepër penale që ekziston por që e ka bërë ndonjë tjetër. Kështu për shembull, personat të shëndoshë psikik vetë paraqiten të rrejshme për ndonjë vepër penale më të lehtë me qëllim që të fshehin atë me të rëndën. Gjithashtu, në praktikë ndodh që në kryerës i pasur nga ana financiare ta blejë një person të varfër që ia të marrë fajin mbi vete. “Motivet fisnike, gjithashtu mund të shkaktojnë vetë paraqitje të rrejshme: dashuria ndaj prindërve dhe ndaj fëmijëve, vëllezërve, bashkëshorti, partneri i dashurisë, ndjenja e shokut, dhe e miqësisë, e keqardhjes etj.

Vetë paraqitja, padyshim paraqet aktin e kundërt të instinktit natyror të vetëmbrojtjes. Prandaj duhet pasur kujdes të madh gjatë situatave të këtilla dhe gjithnjë të kihet parasysh mundësia e ballafaqimit adekuat me persona të sëmurë psikik.

Një shembull i marrëzisë tek paranojat, të marrë nga materiali empirik i L. Novotni.

A dhe S kanë qenë shok. Kanë lindur në të njëjtin qytet, janë rritur dhe plakur së bashku. Një natë A i propozoi S të shkojnë për gjueti lepujsh. S nuk kishte kurrfarë shkakut për të dyshuar në qëllimet e mira të shokut. Dhe u nisën. Gjatë rrugës e morën edhe shokun e tretë K. Nja njëzet kilometra nga qyteti A tha: "Vetura ka defekt. S të lutem dil dhe shtyje me tërë forcën nga prapa në pjesën e djathtë. Aty është bllokuar rrota. S bëri ashtu si tha dhe gjersa po vepronte kështu si iu tha, A iu afrua nga prapa dhe zbrazi dy plumba pistolete në kokën e S, përpara syve të K. Ai mbeti i vdekur në vend.

Ndërsa tani tha: "Unë këtë nuk e bëra me iniciativën time, por i zbatova urdhrat e sigurimit të shtetit. Mua m'u bë e ditur nëpërmjet sinjalizimit se S është armik i shtetit dhe se duhet të likuidohet. Bile më këshilluan që e gjithë kjo të duket si një vetëvrasje..."

Pastaj thotë se më shumë se dhjetë vjet mbanë lidhjen ndërmjet qeverisë dhe njerëzve që punojnë në Gjermani dhe në Austri dhe se ka ende njerëz në listë të cilët duhet t'i likuidoje. Ai gjerësisht rrëfen për të gjitha sekretet që janë me interes vital për shtetin. Ndërsa problemet e shtetit është i thirrur t'i zgjidhë ai dhe askush tjetër ".

Sipas rezultateve të ekspertizës psikiatrike, personaliteti i tij nuk ka rënë poshtë, sepse ai për laikun, duket shumë i sistemuar, dhe kështu paranoja e tij, pr fat të keq është zbuluar pasi e kreu

aktin penal (rimin). Por, për rrethin e tij të afërt ai gjithnjë konsiderohej si i marrë.

9. MEDIUMET SI MËNYRË PËR TË KUPTUAR PËR VEPRËN PENALE

Një nga mënyrat për të kuptuar se është bërë vepër penale, e cila për fat të keq është lënë anash në praktikën kriminalistike maqedonase janë gazetatat dhe mediumet tjera masive.

Në fakt, nëpërmjet shfletimit të përditshëm, nga ana e nëpunësve operativ (dhe të personave të tjerë zyrtar) të gazetave, të revistave etj., mund të merret vesh për ndonjë formë të manifestuar të sjelljes kriminale. Për shembull, ankandet për shitje të automobilave, mallit teknik, akustik e të tjera mund të na orientojnë në ekzistimin e këtyre veprave penale: marrje të automjetit, vjedhje,, tregti e paligjshme etj. Gjithashtu, në gazeta hasen shpallje me të cilat ofrohen shërbime të ndryshme (pushime verore në botën e jashtme, udhëtime turistike, punësime të ndryshme) që në fakt bëhet fjalë për vepër penale mashtrim ose ndërmjetësim në prostitucion.

Ja një shembull të tillë nga praktika operative e një nëpunësi zyrtar: *personi Xh. A., drejtor dhe pronar i AT "Interimes " nga Shkupi gjatë vitit 2003 në mënyrë të vetëdijshme dhe me qëllim të përcaktuar më parë, shumë herë në gazetën e përditshme "Dnevnik" bënte shpallje për udhëtime turistike dhe verime. Me qëllim që të tërheqë vëmendjen të qytetarëve aranzhimet e tij ishin më të lira nga njëzet deri tridhjetë për qind nga agjencitë e tjera turistike, veçanërisht në Shkup.*

Me qëllim që ai të jetë më i bindshëm, më 24.6.2003 me personin P.B. lidhi një kontratë për një lokal afarist me qira në Shkup.

Pasi i siguroi kushtet për të realizuar qëllimet e tij mashtruese, gjatë korrikut dhe gushtit të vitit 2003 i futi në huti nja njëzet qytetarë nga tërë shteti ynë. Faktikisht ai u premtonte duke i mashtruar se do të kenë të siguruar aranzhime të agjencisë- verime në Turqi, në Greqi dhe në Bullgari nëpërmjet agjencisë së tij.

Nga kontrollet operative të kryera, nga inspektimi i bërë në kartelat e fletëpagesave, vauçerëve, biletave të autobusit dhe të dokumenteve të tjera ; dhe nga biseda që zhvilluar me personat e dëmtuar u verifikua se personi XH.A. nuk ka pasur aspak për qëllim t'i plotësojë premtimet e veta, po nëpërmjet mashtrimit ka realizuar dobi materiale. Kundër XH.A është bërë kallëzim penal.

Personat zyrtar të autorizuar (ose një pjesë e tyre) duhet të bëjnë kërkime edhe në Internet me qëllim që të gjejnë informata për çdo lloj të krimit, bile edhe për krimin e organizuar dhe terrorizmin. Në këtë drejtim, veçanërisht Seksioni i krimit të organizuar pranë MPB të RM dhe pranë prokurorisë publike, mund t bashkëpunojnë me shumë Internet⁴⁸- prouajderë, të cilët kur do të hasin fajle të këtitllë, duhet t'i regjistrojnë nga Interneti dhe sipas marrëveshjes së mëparshme s'ia dërgojnë Seksionit.

⁴⁸ Shitja e drogës që organizuar dhe nëpërmjet internetit, ka pasur lidhje me persona nga Maqedonia, ku përfundonin edhe paratë. Heroina transportohej nga Maqedonia në Austri me autobus, i cili qarkullonte në menyre të rregullt në këtë relacion. Transportin e bënin djem të rij të cilët me pasaporta falce me anije udhëtonin deri në Itali, ndërsa prej atje shkonin në Austri, destinacion i fundit i zinxhirit të drogës”. Gazeta Vreme e 16.01.2009.

10. KURTHET KRIMINALISTIKE SI MJET PËR ZBULIMIN E VEPRËS PENALE DHE TË KRYERËSIT

Një nga mënyrat për zbulimin e kryerësve të akteve penale është edhe me ndihmën e kurtheve. Ato janë mjetë efikase dhe të qenësishme kriminalistike operative për të zbuluar kryerësin e panjohur. Kuptohet, nëse janë vënë me kujdes dhe në mënyrë pedante në kohën e duhur dhe në mënyrën që nuk e pret kryerësi. Në praktikë ngrihen shumë lloje kurthesh, por ato mund të grupohen në sa vijon: kurthet teknike (kurthe fotografimi etj); kurthe fizike (prita, ndjekje, vëzhgime speciale); kurthe kimike (duke bërë me pluhur ose duke lyer sendet me mjete kimike) dhe me kurthe daktiloskopike (kurthe në formë të gjurmëve të vijave të prekjes)..

Kurthet e veçanta mund të adaptohen me sukses në sende të rëndomta të cilat janë për përdorim të përditshme (kamufliimi i fotoaparateve, mikrofonave etj). Për ngritjen e kurtheve, me sukses mund të shfrytëzohet sistemi me kamera televizive.

Për shembull: rrëmbimi (kidnapimi) i Hajnekenit është rast i shkëlqyer për ta analizuar. Hajnekeni ishte pronar i kompanisë së birrës që e mbanë emrin e tij. Ai kishte një pasuri kolosale, jetonte në mënyrë shumë luksoze dhe ishte shumë i njohur në atdheun e tij, Konsiderohej si njeri me ndikim ekstrem në politikën e Evropës perëndimore për shkak të marrëdhënieve të tij të afërta me familjen mbretërore të Holandës. Sipas kësaj, ai në mënyrë të jashtëzakonshme përputhej me profilin e viktimave të terrorizmit.

Hajnekeni e dinte se ekzistonte rrezik edhe para se të rrëmbehej (kidnapohej).. Ai e dinte këtë sepse një gjë e këtillë i ndodhi edhe mikut të tij, industrialistit holandez, zotëri Karansa.

Karansa u rrëmbye në tetor të vitit 1977 kur dilte nga një hotel në Amsterdam. Ai pas pesë ditësh u lirua sepse zhvilloi bisedime për lirimin e vet. Rrëmbyesit nuk u arrestuan asnjëherë. Aq më shumë paratë e ofruara nuk u kthyen asnjëherë. Gjatë hetimit për rrëmbyesit e Karansit policia gjeti listën e viktimave të mundshme të ardhshme në të cilën ishte edhe emri i Hajnekenit. Kur Hajneken e zbuloi se është në këtë listë, ai mori një varg masash kujdesit të lartë për mbrojtjen personale, me blerjen e pajisjes së ndryshme teknike etj.

Por, edhe përkundër kësaj, Hajneken u rrëmbye në mbrëmjen e 9 nëntorit të vitit 1983, duke dalë nga zyra e tij, gjersa ishte duke shkuar në automobilin e vet, ku e priste shoferi i tij personal. Në momentin e rrëmbimit Hajneken mbante një transmetues të vogël elektronik, të fshehur në rripin e tij, Një ri nga rrëmbyesit pa dashje ia mori rripin Hajnekenit si suvenir, kështu që policia kishte mundësi t'i hyjë në gjurmë dhe ta ndjek atë.

Më 1 dhjetor të vitit 1983, policia duke ndjekur gjurmët arriti në një firmë sharrash. Dryni ishte thyer me forcë me ç'rast policia hasi në një mur të rrejshëm. Kur muri u rrëzua policia e gjeti Hajnekenin dhe vozitësin e tij ende të gjallë në disa qeli të ndara betoni.

Mbikëqyrja me video për shembull, mund të shfrytëzohet për të dokumentuar ngjarjen e vërtetë nga jeta që paraqet vepër penale. Për këtë qëllim shfrytëzohen kamera të fshehta, me qëllim të sigurimit të bankave nga vjedhjet, të supermarketëve, të shtëpive të mëdha të mallrave, vënies së zjarreve etj.

Për shembull: Në praktikën kriminalistike (dhe gjyqësore) maqedonase është për të shënuar rastin me piromanin Zendeloviq, i cili në vitin 2005 ia vuri zjarrin ndërtesës së banimit të vendosur në komunën e “Kisela Vodës”, në Shkup.

Si pasojë të kësaj humbën jetën katër veta, ndërsa shumë banuesve iu shkaktua dëm i madh material. U identifikua nëpërmjet video kamerës (në radhë të parë për nevoja zyrtare të kompanisë në oborrin e Kazanit të nxehjes të SHA “Toplifikacija” të Shkupit. Piromani i përmendur, nga gjyqi kompetent i shkallës së parë në Shkup u dënua me 14 vjet burg efektiv.

Për të njëjtin qëllim shfrytëzohen edhe pajisje të dritës të cilat shfrytëzojnë rreze infra të kuqe. Këto pajisje janë shumë të përshtatshme për sigurimin e urave, magazinave, lokaleve për ruajtjen e dokumenteve të besueshme (sekrete) bankave, objekteve ushtarake dhe policore etj.

Pajisjet e alarmit janë mjete teknike të cilat, në rast të qasjes së personave në vendet ku janë instaluar mjetet, reagojnë me zë ose në mënyrë vizuale (ose në të dyja mënyrat) paralajmërojnë për praninë e personave.

11. “AKTI I FRESKËT”

Mënyra e këtillë e marrjes vesh se ekziston veprë penale, në esencë është e rrallë por megjithatë është e pranishme në praktikë. Në fakt bëhet fjalë për situatë in flagranti, përkatësisht kapja e kryerësit në momentin e kryerjes ose menjëherë pas kryerjes së aktit. Njeriu i kapur gjatë kryerjes së veprës penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, mund ta arrestojë jo vetëm personi i autorizuar zyrtar i policisë ligjore por edhe çdo qytetar. Me kapje gjatë kryerjes së veprës penale nuk nënkuptohet vetëm momenti gjatë kryerjes (për shembull, thyerjet gjatë vjedhjeve të shtëpive etj) por edhe pikasjen gjatë kryerjes së aktiviteteve të tjera që janë të afërta me aktin penal (për shembull, pikasje të sendeve që rrjedhin nga kryerja e aktit penal etj). Nëse një qytetar e ka

arrestuar një person që e ka gjetur duke kryer vepër penale atëherë menjëherë duhet t'ia dorëzojë policisë ose prokurorit publik. Nëse nuk ka mundësi ta bëjë një gjë të tillë, në raste të këtilla duhet t'i njoftojë këto organe. Nëse qytetari e arreston të dyshuarin dhe ia dorëzon policisë, atëherë personi zyrtar i këtij organi duhet të verifikojë identitetin e qytetarit dhe të personit të arrestuar, dhe pastaj të marrë njoftimet e nevojshme nga qytetari dhe t'ia dorëzojë të arrestuarin prokurorit publik për veprimet e mëtejshme.

“Përveç se është i rastësishëm, ai në zbulimin e kriminalitetit mund të jetë edhe ,mënyrë sistematike e njohjes, kështu që kryerësi gjatë aktit penal mund të kapet edhe gjatë marrjes së masave operative-taktike(kurtheve, pritave, vëzhgimi i fshehtë etj).

Shembuj nga praktika: më 30.10 2005 rreth orës 4 të mëngjesit në fshatin Debresh të Gostivarit N.I u përpoq të vjedhë automobilin “Opel kadet”, pronë e D.S nga i njëjti fshat. Por hajni u zbulua nga pronari i cili nisi të bërtasë ndaj tij. N.I u frikësua se do ta kapin duke bërë aktin e hajnisë u përpoq të ikë. D.S hyri brenda, e mori çiftin (pushkën e gjuetisë) dhe me të gjuajti një patron në drejtim të hajnit që po ikte. Me patronin e gjuajtur N.I u godit dhe ra për tokë. Atëherë pronari e thirri policinë dhe ndihmën e shpejtë, me ç’rast i plagosuri u dërgua në spital.

Nga kontrollet operative, të bëra nga ana e policisë u vërtetua se N.I është kryerës i njohur i hajnive të renda, vjedhje dhe marrje të automjeteve.

Më 27.10. 2005 rreth orës dy pas mesnate N.V sulmoi pompën e benzinës (pronë e “Makpetrolit”) që ndodhet në Bulevardin “Ilinden” në Shkup. I maskuar, ai ia drejtoj revolen të punësuarit M.T, dhe iu kërcënua se do ta vrasë, pas së cilës me

shpejtësi ia morë torbën me paratë dhe u përpoq të ikë. Këtë e vërejtën pjesëtarët e ekipit mobil të policisë “Alfa” që ishin shumë afër. Menjëherë u vunë në aksion.. Zbulimi ishte flagrant, kur të maskuarit ia hoqën maskën, panë se kanë arrestuar një-koleg të tyre. Pastaj, pastaj e dërguan në stacionin e policisë në “Karposh”.

Gjatë marrjes në pyetje (në bisedë informative), polici e pranoi se gjatë ditës ishte polic ndërsa natën hajn.

Pyetje për studentët:

- 1. Shpjego karakteristikat e përgjithshme, më shesh mënyrat e të kuptuarit për përgatitje ose të ekzistimit të veprës penale.***
- 2. Ç’është veprimtaria kriminalistike-informative?***
- 3. Shpjego dukurinë e policit të uniformuar si mënyrë e të kuptuarit të ekzistimit të veprës penale.***
- 4. Ç’paraqet kallëzimi i inspektimeve, i shërbimeve të revizorëve dhe të subjekteve ekonomike?***
- 5. Shpjego kallëzimin e të dëmtuarit ose të dëshmitarëve të tjerë.***
- 6. Ç’paraqet kallëzimi anonim dhe kallëzimi me pseudonim?***
- 7. Shpjego thashethemet publike.***
- 8. Shpjego vetë paraqitjen.***
- 9. Shpjego mediumet si mënyrë për të kuptuar se është bërë vepër penale.***
- 10. Shpjego kurthet kriminalistike, si mjet për zbulimin e veprave penale dhe të kryerësve të tyre.***
- 11. Ç’është “akti i freskët” përkatësisht situata in flagranti (në flagrancë)?***

KREU V

PLANIFIKIMI I VEPRIMTARIVE KRIMINALISTIKE

1. NOCIONI, PARIMET DHE QËLLIMET E PLANIFIKIMIT

Planifikimi paraqet sistemin e metodave standardizuese dhe procedurave për zbulimin dhe zbardhjen e ngjarjeve kriminale, analizat e kryera të gjendjes faktike etj.

Planifikimi taktik merret me zbardhjen e ngjarjeve konkrete të kryerjes së veprave penale. Gjatë planifikimit mund të bëhet fjalë për planifikim në procedurën para hetimore, në hetim dhe në seancën kryesore. Gjithashtu, planifikimi mund të ndahet sipas specifikave të zbulimit dhe të paraqitjes së provave të veprave penale të caktuara. Për shembull, planifikimi në rast përdhunimi, planifikimi në rast të vjedhjeve, planifikimi në rast mashtrimesh etj.

Planifikimi kriminalistik ka dy nivele: planifikimi i veprimtarisë kriminalistike në tërësi dhe planifikimi i aktiviteteve kriminalistike të caktuara (operative dhe dëshmuere).

Për zbardhjen e veprave penale konkrete janë të domosdoshme dituritë dhe përvojat kriminalistike, kombinimi kriminalistik, posedimi i intuitës, si dhe i aftësisë për mendime logjike.

Parimet themelore në të cilat bazohet çdo planifikim janë: parimi i aspektit *konkret* të planifikimit, parimi i *individualitetit* dhe parimi i *dinamikës* së planifikimit.

Aspekti i konkretes gjatë planifikimit nënkuptojnë: a) përcaktimi konkret i qëllimeve, detyrave të planifikimit, synimi i tyre etj. Kjo arrihet me studim të hollësishëm të gjendjes faktike: b) përcaktimi konkret i rrugëve, mënyrave të zgjidhjes së detyrave nënkupton hartimin e projektit për çështjet kontestuese të cilat duhet të zgjidhen, versionet të cilat duhet të planifikohen etj. Për

shembull, cilat dokumente financiare dhe afariste duhet të studiohen;

c) përcaktimi konkret i afateve të ndërmarrjes së aktiviteteve operative dhe dëshmuere; d) aspekti konkret gjatë përcaktimit të obligimeve ndërmjet udhëheqësit dhe bashkëpunëtorëve të tij; g) përcaktimi i personave profesional të cilët duhet të angazhohen; e) të bëhet regjistrimi i pajisjeve dhe mjeteve teknike të cilat duhet të zbatohen.

Individualiteti i planifikimit lidhet me karakteristikat e një ngjarje konkrete kriminale. Planifikimi nënkupton hartimin e planit në veprimtarinë operative dhe gjyqësore. Ai nuk mund të jetë një skemë e ngurtë dhe e pandryshueshme e cila vlen për të gjitha rastet. Individualiteti i çdo ngjarje kriminale gjithnjë kërkon një qasje kreative ndaj përpilimit të planit, një analizë të mirë si të ligjshmërive shoqërore, ashtu edhe të specifikave të ngjarjes së hetuar. Me fjalë të tjera, bashkë me qasjen algoritmike është e nevojshme edhe ajo krijuese.

Dinamika paraqet qasjen ndaj hetimit dhe ndaj planifikimit të tij si proces i veçantë. Aspekti dinamik i planifikimit jep mundësinë, gjatë gjetjes së fakteve të reja plani të korrigjohet, të plotësohet ose të ndryshohet. Në fakt prandaj thuhet se plani nuk është dogmë. Përkundrazi, gjatë veprimtarisë operative – hetimore pa ndërprerë jepen informacione të reja, sqarohen rrethanat e reja etj.

Planifikimi siguron objektivitetin, aspektin ekonomik në kohë, të forcave, të mjeteve, mundëson qasje themelore gjatë punës me provat. Gjithashtu planifikimi është negacion i anës stih, spontane, i qasjes kaotike gjatë pengimit, zbulimit dhe dëshmimit të veprës penale. Qasje planifikuese nënkupton analizën precize të situatave ekzistuese, parashikimin e zhvillimit të ardhshëm të ngjarjes, si dhe aktivitetet personale (proгноза).

2. ANALIZA E GJENDJES FAKTIKE DHE PYETJET E ARTA KRIMINALISTIKE

Analiza e gjendjes faktike paraqet fazën fillestare të procesit ideor kriminalistik. Kjo nisë me mbledhjen e informacioneve të para për veprën penale dhe të zbatimit të aktiviteteve gjatë aksionit të parë (observimi, biseda informative me dëshmitarët okularë etj.).

Nëpërmjet analizës të veprës penale bëhen përpjekje të rikonstruktimit për fazat e veçanta të paraqitjes së saj. Në bazë të analizës jepet mundësia për tu formuar një ose më shumë pasqyra për veprën penale (versione) me qëllim të rikonstruktimit të paraqitjes së saj, të sjelljes dhe të karakteristikave të personaliteteve të kryerësit dhe të viktimës.

Qëllimi i analizës është shqyrtimi i gjithanshëm i fakteve të lidhur drejtpërdrejtë ose tërthorazi me veprën penale.

2.1. Pyetjet e arta të kriminalistikës

Pyetjet (“arta”) themelore të kriminalistikës janë në lidhje me anën objektive dhe me elementet subjektive të veprës penale në fazën e zbardhjes, të sqarimit dhe të gjykimit. Në anën objektive bien pyetjet: *çka ndodhi* (vepra penale, kundërvajtje, ngjarja e zakonshme etj.), *ku ndodhi* (vendi i ngjarjes dhe çdo vend tjetër ku mund të gjenden gjurmët dhe objektet që lidhen me veprën penale), *si ndodhi* (mënyra e përgatitjes, e kryerjes dhe e mbulimit (fshehjes) së veprës penale), dhe me *çka është kryer* (mjetet e ekzekutimit).

Pyetjet që kanë të bëjnë me anën subjektive të sqarimit të veprës penale janë: me cilin është kryer (shprehin bashkëveprimtarët), përse është kryer (ka të bëjë me motivin), ndaj kujt është kryer (cila është viktima) dhe kush është kryerësi. Në fakt, numri më i madh i këtyre pyetjeve ka të bëjë me zbulimin e kryerësit.

1. ÇKA (KA NDODHUR)?

Kjo pyetje paraqet pyetjen e parë dhe themelore e cila bëhet menjëherë që në fillim dhe kërkon sqarim.

Duke iu përgjigjur kësaj pyetje vërtetohet se a ekziston vepër penale në rastin konkret, kundërvajtje, shkelje disiplinore, fatkeqësi rasti ose diçka tjetër. Për shembull, vdekja mund të jetë e dhunshme dhe të paraqesë vepër penale, mund të jetë e natyrshme, mund të jetë vetëvrasje, ose e rastësishme ku nuk ka elemente të veprës penale. Në praktikë, ndonjëherë nuk është lehtë të caktohet se a ekziston vepër penale në rastin konkret. Nga përgjigja rreth kësaj pyetje varet se a do të ngrihet procedurë para hetimore ose penale. Nëse dëshmohen bazat e dyshimit për kryerje të veprës penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, personat e autorizuar zyrtare të policisë gjyqësore janë të detyruar të marrin masa konkrete përkatëse me qëllim që gjetjes së kryerësit të veprës penale dhe të pengohet ikja e tij, të zbulohen dhe të sigurohen gjurmët e veprës penale dhe sendet të cilat mund të shërbejnë si prova, përkatësisht të grumbullojnë të gjitha njohuritë që janë me interes për zhvillim të suksesshëm të procedurës penale.

Nëse bëhet fjalë për vepër penale e cila ndiqet sipas akuzës private, atëherë i dëmtuari duhet të njoftohet rreth kësaj.

Rezultatet e hetimeve empirike tregojnë se shpeshherë nuk bëhet diagnoza diferenciale kriminalistike në fazën e parë, por menjëherë i hyhet një versionit tendencioz të veprës penale, që e dëmton ndonjëherë cilësinë, efikasitetin dhe aspektin operativ të përpunimit kriminalistik (ndiqet kryerësi i veprës penale që në fakt nuk ekziston). Në praktikë njihen shembuj ku përcaktohen që përpara veprat penale (vrasje, përdhunim, vjedhje) dhe menjëherë ngrihen versionet për kryerësit.

2. KU (NDODHI)?

Në vendin e ngjarjes kriminale mund të gjenden sende dhe gjurmë të kryerjes përkatësisht të gjenden dhe të kapen njerëz që kanë lidhje me ngjarjen (i dëmtuar, dëshmitarë okularë, kryerësit, viktimë). Vendi i ngjarjes paraqet kuadrin hapësinor ku ndërmerren një varg masash dhe aktiviteteve kriminalistike-taktike, kriminalistike-teknike. Kështu për shembull, sigurohet personi dhe vendi, mblidhen njohuritë e nevojshme, bëhet observim, bëhet rikonstruktimi i ngjarjes, bëhet ekspertizë, bëhet kufizimi i lirisë së lëvizjes, bëhet bastisje, bëhet legjitimim, bëhet vëzhgim, ngrihen prita etj. Gjithashtu në kuadër të përpunimit teknik të vet vendit merren shumë aktiviteteve në bazë të të cilave arrihet të indikacionet ose të provat që janë me rëndësi për ngritjen dhe përkryerjen e procedurës penale. “Tek disa vepra penale të veçanta, vendi i kryerjes paraqet pjesën përbërëse të MOS (mënyrë specifike e kryerjes)⁴⁹. Tek vepra penale të veçanta vendi i kryerjes paraqet karakteristikën themelore të veprës. Për

⁴⁹ Kompetent vendor, sipas rregullit, është gjyqi në rajonin e të cilit është kryer ose tentuar të bëhet veprë penale. Vepra penale është realizuar ose është tentuar të bëhet si dhe në vendin ku kryerësi i ka ndërmarrë aktivitetet përgatitore për kryerjen e veprës penale, si dhe vendi ku ka ndodhur pasoja e ndaluar. Një shembull i mirë për këtë nocion do të ishte vepra penale terrorizëm, ose vdekja e porositur.

shembull, te shkelja e pacenueshmërisë së banesës – ose të lokaleve të mbyllura. Vendi ku është kryer vepra mund të vëzhgohet edhe nga aspekti i rrethanave sasiore. Për shembull gjatë shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm – vendi ku janë mbledhur një numër më i madh njerëzish; gjatë fyerjeve dhe shpifjeve – në vend publik etj. Përmbajtja e përgjigjeve të këtyre pyetjeve lidhet edhe me kompetencën vendore të gjyqit dhe të prokurorit publik.

3. KUR (KA NDODHUR)?

Përcaktimi i kohës së saktë ose të përafërt është shumë me rëndësi, në radhë të parë, për shkak se lidhet me atë kohë të ndërmarrjes së aktiviteteve të veprës penale. Ose thënë më ndryshe, mund të përcaktohen ekzistimi i indikacioneve të veprës penale dhe për kryerësit. Më saktë mund të përcaktohet motivi i kryerjes, plotësimi i vullnetit për ta kryer, veprimi psikik i kryerjes së veprës penale, ekzistimi i sendeve përkatëse, njohja e rrethanave të caktuara etj.

Gjithashtu, koha e kryerjes tek disa vepra penale të veçanta është element i MOS. Edhe kontrolli i alibisë mund të zhvillohet me sukses nëse më parë nuk është përcaktuar koha e kryerjes së veprës penale për çka personi i caktuar është i dyshimtë ose është akuzuar.

Koha është kriteri i rëndësishëm edhe gjatë situatave kur te kryerësit përcaktohet mosha, qëndrimi i tij, ose momenti se kur ka filluar vjetërsimi i ndjekjes penale. Koha mund të jetë edhe një nga tiparet esenciale të veprës penale (për shembull, gjatë mosparaqitjes së kryerjes së veprës penale – koha kur ende mund të pengohet vepra penale). Koha e kryerjes mund të jetë edhe rrethanë cilësore tek disa vepra penale të caktuara (për shembull,

dhënia e sekretit shtetëror – koha e gjendjes ushtarake; tek vjedhjet e rënda gjatë zjarreve, përmbytjeve ose fatkeqësive të tjera etj.). Nga ana tjetër disa vepra penale mund të kenë forma të privileguara kur është plotësuar edhe kushti se janë kryer në një kohë të caktuar (për shembull, vrasja e një fëmije gjatë lindjes – pas lindjes ose pasi të ketë kaluar pak kohë; vrasje çasti – menjëherë pas sulmit ose pas fyerjeve të shkaktuara, pa fajin e tij, në gjendje të ngacmimeve të forta).

4. SI (NDODHI)?

Nëpërmjet kësaj pyetje dëshirohet të përcaktohet mënyra e kryerjes së veprës penale dhe e manifestimit të formave të saj. Forma e manifestuar e mënyrës së kryerjes së veprës penale rrjedh nga lloji dhe nga natyra e veprës penale dhe atë si element i veçantë i tërësisë sistematike-strukturale të veprës penale.

Mënyra e kryerjes së veprës penale duhet të zbardhë rrjedhën e veprës penale duke përfshirë të gjithë elementet e angazhimit gjatë kryerjes.

Nga aspekti kriminalistik, mënyra e kryerjes nënkupton MOS, i cili mund të paraqesë specifikën në kryerjen e veprës penale. Kjo nga ana e saj nënkupton shkallën përkatëse të specializimit, profesionalizimit në kryerjen e veprës penale.

Planifikimi dhe kontrollimi i versioneve në kuadër të sqarimit të kësaj pyetje përbëhet në krijimin – mbarështimin e konstruktit ideor të ngjarjes (mënyra, mjetet) si dhe kontrollimi i tyre nëpërmjet veprimtarisë së shqisave.

Metoda më efikase e përcaktimit të mënyrës së kryerjes së veprës penale është rikonstruktimi i ngjarjes dhe eksperimenti kriminalistik.

Planifikimi dhe kontrollimi efikas i versioneve për përcaktimin e mënyrës së kryerjes së veprës penale mund të kontribuojë për sqarimin më të shpejtë dhe efikas të veprës penale dhe për zbulimin e kryerësit, duke shfrytëzuar MOS – *modus operandi sistem*. Kjo realizohet nëpërmjet përcaktimit preciz të mënyrës së kryerjes së një vepre penale konkrete dhe nëpërmjet krahasimit dhe kontrollimit të saj sipas evidencës MOS. Në fakt MOS – mundëson, kur është kryer vepra penale, ndërsa kryerësi ka mbetur i panjohur me observim të njësive të këtilla të bëhet seleksionimi i personave të cilat kanë bërë vepra penale konkrete identike, përkatësisht në mënyrë të ngjashme, që shpie përsëri me një qark më të vogël të kryerësve të mundshëm dhe bën të mundshme mbarështimin e versioneve dhe synimeve të punës së mëtejshme operative të përcaktimit të kryerësit dhe të mbledhjes së provave.

Përveç rëndësisë kriminalistike, mënyra e kryerjes së veprës penale ka edhe rëndësi juridike penale. Kështu për shembull, nëpërmjet saj përcaktohen elementet dhe format kualifikuese – vrasje në mënyrë të vrazhdë dhe të pamëshirshme etj.

5. ME ÇKA (NDODHI)

Kjo pyetje ka të bëjë me përcaktimin e mjetit me të cilin është kryer vepra penale. Përgjigja ndaj kësaj pyetje në fakt shpie në *modus instrumentarium*.

Është e ditur se veprat penale kryhet me mjete të ndryshme të cilat mund të jenë materiale ose të natyrës tjetër. Këto mund të jenë sende të ndryshme të cilat janë në përdorim të përditshëm gjatë jetës (thika, çekan, eksploziv) deri te mjetet të veglave të ndryshme të qëllimta që shfrytëzohen për kryerjen e veprave

penale (vegla shpërthyesë, tophyerës⁵⁰, vula falsifikuese etj.) Sendi i përdorur paraqet indikacionin e rëndësishëm material (shfrytëzimi i një mjeti të përcaktuar, siç është thika e kasapëve, kalibri i përcaktuar i municionit, vegla speciale etj.) japin bazën për dyshime të planifikuara dhe të kontrollimit të versionit kriminalistik për të përcaktuar mjetin me të cilin është kryer vepra penale.

Gjithashtu, mjeti për kryerjen e veprës penale mund të jetë si shenjë që tregon kryerësin e veprës penale, pjesëmarrësit në të, fshehtësit e saj ose persona të tjerë të cilët kanë njëfarë lidhje me veprën penale.

Tek veprat penale ku mund të gjendet mjeti aty për aty gjatë kryerjes, por ku mund të gjenden dhe të fiksohen gjurmë të caktuara të mjeteve, mund të mbarështohen versione të ndryshme për identifikimin dhe gjetjen e mjetit të kryerjes së veprës penale. Për shembull, personit i janë shkaktuar plagë vdekjeprurëse me ndonjë me ndonjë send të fortë. Ky indikacion jep mundësinë të shtrohen shumë versione për atë send si mjet për kryerjen e veprës penale.

Nëse me siguri përcaktohet mjeti i kryerjes, atëherë mbarështohen versionet nga aspekti i lidhjeve ndërmjet mjetit të gjetur dhe personit të caktuar ose më shumë personave, me qëllim identifikimi të kryerësit të veprës penale. Prandaj, me sqarimin e kësaj pyetje, jepet një kontribut për sqarimin e çështjes kyçe kriminalistike, se kush është kryerësi.

6. ME CILIN (NDODHI)?

⁵⁰ Paraqet një vegël më masive që përdoret për thyerje dyersh. Është shumë efikas (për dhjetëra sekonda e thyen derën e hekurt) dhe shumë i thjeshtë për përdorim. Bëhet fjalë për një cilindër çeliku me profil që i përshtatet patentës cilindrike të bravës.

Kjo pyetje bëhet me qëllim të përcaktimit, në radhë të parë se a është kryer vepra penale nga një njeri apo më shumë veta. Për këtë qëllim, që në nismë të çdo përpunimi kriminalistik duhet të shtrohen dy versione: a) veprën penale e ka kryer një person; b) veprën penale e kanë bërë shumë veta.

Nëse informacionet fillestare vë në dukje faktin se veprën penale e ka bërë një person, nuk ka nevojë që të shtrohen versione për pjesëmarrje. Nga ana tjetër, nëse konfirmohen baza të dyshimeve se veprën penale e kanë kryer më shumë veta, atëherë mund të shtrohet pyetje në llojin e pjesëmarrjes, domethënë, për rolin e çdo individi në pjesëmarrje (nxitje, ndihmë, kryerje dhe fshehje).

Rëndësia kriminalistike e sqarimit të kësaj pyetje përbëhet në faktin se pas vërtetimit se ka pjesëmarrës në kryerjen e veprës penale, mund të zhvillohen hetimet të orientuara në shumë veta, në veti të ndryshme (nxitje⁵¹, ndihmë⁵², bashkëkryerje⁵³, fshehje). Në përpunimin kriminalistik mund të shtrohen versione për persona të cilët paraqiten si të dyshimtë në veti të ndryshme, për të ardhur më në fund tek ata që ekzistojnë dyshime themelore për pjesëmarrje të tyre.

7 PSE (NDODHI)?

Kjo pyetje bëhet me qëllim që të fitohet përgjigjja për motivin e kryerjes së veprës penale. Motivi përcaktohet në bazë të karakteristikave esenciale të veprës penale (lloji, objekti, vendi, koha, mënyra, mjetet e kryerjes etj.).

⁵¹ Nxitja është shkaktim i paramenduar ose inkurajim për të marr vendim për një njeri që të bëjë vepër penale,

⁵² Ndhimja është kontributi për të realizuar një vepër penale të huaj

⁵³ Bashkëkryerje është veprimtari e përbashkët e vetëdijshme dhe me vullnetin e shumë personave.

Motivi për kryerjen e veprës penale kriminalistikës i shërben si udhërrëfyes për gjetjen e personave që mund të merren parasysh si të dyshimtë potencial, për të cilët do të mblidhen informacione të caktuara dhe fakte indikative me krahasimin, kombinimin dhe analizën e të cilave do të bëhet eliminimi i personave tek të cilët ekzistojnë baza më të dobëta të dyshimit.

Duke u nisur nga logjika e supozimit se çdo veprim i njeriut normal është i motivuar, gjithsesi është i qartë supozimi se çdo vepër penale është bërë me një motiv të caktuar. Por, duhet pasur parasysh faktin se ekzistojnë edhe motive patologjike, nëpërmjet të cilave vështirë sqarohet lidhja shkak-pasojë e veprës penale (aviatori në Zagreb ka vrarë një grua të panjohur në mes të rrugës, kur e kapën impulse të forta për ta bërë atë). Ndërkaq, motivet mund të jenë të ndryshme, si për shembull: urrejtja, hakmarrja, xhelozia, shfrytëzimi, motive politike etj.

Delikte më të rënda janë ato që janë bërë pa motive, të ashtuquajtura motive patologjike. Gjithashtu, të vështira janë edhe situatat kur në fillim të përpunimit kriminalistik nuk disponohen kurrfarë indikacionesh për motive e veprës penale. Gjithsesi nuk është mirë të disponohen edhe të dhëna për motivet e shumta të veprës penale, sepse mund të komplikojë përpunimin kriminalistik në praktikë. Në rastin e vrasjes së mitur në Banja Llukë, në kontekstin e zhvillimeve politike si motive dominuese për vrasje, për çka vë në dukje edhe familja, ka qenë motivi i natyrës politike. Megjithatë, më vonë u konfirmua se ky motiv nuk ka lidhje me veprën penale por vrasjen e ka bërë djaloshi i vajzës, ndërsa motivi ka qenë i natyrës së xhelozisë.

8. KUSH (ËSHTË KRYERËSI)?

Përgjigja rreth kësaj pyetje ka të bëjë me kryerësin e veprës penale dhe ai paraqet synimin qendror në përpunimin e tërësishëm kriminalistik. Kjo është mjaft me rëndësi në rast se bëhet fjalë për vepër penale me kryerës të panjohur.

Duke marrë parasysh faktin se janë bërë një përqindje e madhe e veprave penale nga ana e kryerësve të panjohur, ekziston interesi i veçantë, që ai të gjendet, kuptohet se kjo ka të bëjë edhe me kryerësit e njohur.

Në teorinë kriminalistike ekzistojnë pikëpamje të ndryshme në aspektin e radhitjes së të gjitha të ashtuquajturave pyetje të arta. Kështu profesori Vodineliq këtë pyetje e ka vënë menjëherë pas pyetje çka ndodhi. Ne e përkrahim këtë ide të autorit Matijeviq sipas të cilit është diskutabile se përgjigjja cilësore rreth kësaj pyetje mund të fitohet para se të merret përgjigje për pyetjet tjera (ku, kur, pse, si). Në llogari të kësaj teze shkojnë rezultatet e hulumtimeve empirike të cilat na çojnë në konkluzionin se (veçanërisht tek veprat më të rënda penale) përgjigjja për pyetjen e këtillë fitohet në fund të aktiviteteve kriminale – operative.

Gjithashtu, me rëndësi është të theksohet edhe fakti se përgjigjja ndaj të gjitha pyetjeve “të arta” përbëjnë një tërësi të veprës penale dhe të kryerësit. Nga ana tjetër, mungesa e përgjigjes për çdo pyetje tjetër paraqet boshllëk strukturor që shprehet në cilësinë e sqarimit të veprës penale dhe të zbulimit të kryerësit.

9. CILI (OSE Çka është dëmtuar)?

Kjo pyetje ka rëndësi të jashtëzakonshme kriminalistike-teorike, por edhe operative-praktike. Në fakt, duke u nisur nga fakti se një numër i madh i të dëmtuarve dhe i viktimave janë të interesuar për të ndjekur penalisht, atëherë ata janë burimi më i çmueshëm i informacioneve fillestare, dhe prandaj kësaj pyetje duhet kushtuar vëmendje e veçantë.

“Më shpesh, viktimat ose të dëmtuar janë të njohur që në fillim, megjithatë, ka raste kur në mënyrë plotësuese do të dihet për ta ose asnjëherë nuk do të vërtetohet i dëmtuari apo viktimë (rasti i vrasjes në Dobojë ku nuk është gjetur viktimë e veprës penale).

Nga aspekti është me rëndësi që të nisin nga viktimë ose nga i dëmtuari në mbledhjen e informacioneve për shkaqet, përkatësisht për motivet e veprës së kryer penale. Megjithatë, nga aspekti i planifikimit dhe i kontrollimit të versioneve duhet të marrë parasysh faktin për kontributin e viktimës për kryerjen e veprës penale ose për paraqitjen e veprës penale dhe të kryerësit.

Praktika tregon se procesi i zbulimit të veprës penale dhe i kryerësit, shpeshherë niset nga viktimë nëpërmjet studimit të strukturës së saj si personalitet, ku vërtetohen rrethanat esenciale të kryerjes së veprës penale, veçanërisht të ashtuquajturat marrëdhënie interaktive ndërmjet viktimës dhe kryerësit të veprës penale.

Gjithashtu, mund të risin madhësinë e veprës penale për shkak të rrethanave të ndryshme (hakmarrje, urrejtje, fshehjes së veseve individuale, të përfitimeve etj.), që gjithsesi mund të ndikojë dukshëm në rrjedhën dhe në cilësinë e përpunimit kriminalistik. Kuptohet, gjatë sqarimit të ngjarjeve konkrete nuk duhet lënë anash as kontributin e mundshëm të personit i cili

nëpërmjet sjelljes së vet në masë të vogël apo të madhe ka provokuar veprimin e kryerjes së veprës penale.

3. PËRMBAJTJA E PLANIFIKIMIT

3.1. Definicioni i nocionit version

Nocioni version shpeshherë përdoret në fusha të ndryshme të jetës shoqërore. Ky nocion posaçërisht përdoret në shkencë, në teknikë, në legjislacion, në sferat juridike etj.

Nga aspekti etimologjik, nocioni version ka prejardhje prej fjalës së latinishtes së re versio që në përkthim të lirë do të thotë rrotullim, kthim, e të tjera.

Sipas shpjegimit themelor, versioni paraqet një nga shpjegimet e mundshme të faktit, dukurisë, ngjarjes.

Si sinonime të mundshme të nocionit version shfrytëzohen edhe shprehjet: variant, kombinacion, variacion, mundësi, modalitet, model, hipotezë etj.

Sipas kësaj që u përmend mund të konstatohet se nocioni version ka përdorim shumë të gjerë në jetën shoqërore dhe në fushat e tjera. Lidhja e nocionit të versionit në fushën e kriminalistikës vetëm një pjesë e rëndësishme së gjithanshme dhe komplekse të këtij nocioni.

3.2. Nocioni i versionit kriminalistik

Versionet kriminalistike janë konkluzione të organeve kompetente të procedurës para hetimore ose penale, për të gjitha elementet relevante kriminalistike të një ngjarje të caktuar penale, që mbështeten në informacionet gjatë formulimit të tyre të kapshme për kriminalistikën. “Në kuadër të versioneve kriminalistike disa fakte përcaktohen si të domosdoshme, ndërsa ekzistenca e të tjerëve ka domethënie supozuese në nivel të besueshmërisë, kështu që në bazë të këtyre konkluzioneve përcaktohen edhe mënyrat e kontrollimit të të gjitha aktiviteteve, me ç’rast përcaktohen aktivitetet e mëtejshme operative dhe procedurale , për sqarimin e plotë të veprës penale dhe për zbulimin e të vërtetës.

Definicioni i versionit kriminalistik bazohet në këto elemente:

- Versionet kriminalistike janë konkluzionet;
- Këto konkluzione i nxjerrin organet kompetente në procedurën para hetimore;
- Konkluzionet kanë të bëjnë me të gjitha elementet relevante kriminalistike të një ngjarje penale të caktuar;
- Versionet kriminalistike bazohen në të gjitha informacionet e njohura gjatë momentit të mbarështimit të tyre që janë të rëndësishme nga aspekti i kriminalistikës;
- Versionet kriminalistike përbëhen nga dy elemente themelore (i pari: përbëhet nga faktet ekzistenca e të cilëve është konfirmuar në mënyrë të padyshimtë, i dyti: përbën elemente hipotetike, domethënë ka të bëjë me faktet ekzistenca e të cilëve ka bazë vetëm sipas supozimeve);
- Versionet kriminalistike bëhen për shkak të sqarimit të veprës penale (aktit) dhe zbulimit të së vërtetës, që arrihet

nëpërmjet planifikimit e pastaj nëpërmjet realizimit të të gjitha aktiviteteve operative-teknike dhe proceduese me të cilat provohen të gjitha elementet hipotetike (supozimet).

Për realizimin e versioneve kriminalistike, përveç aftësive intelektuale dhe organizative janë të nevojshme edhe vetë kritika, fleksibiliteti, intuïta. Gjithashtu nevojiten edhe njohuri kriminalistike në lidhje me metodikën e kryerjes së llojeve të caktuara të veprës penale si dhe të gjurmëve tipike dhe atipike. Por me rëndësi është edhe nevoja jetësore.

Gjatë realizimit të versioneve duhet kultivuar punën ekipore. Në të vërtetë, versionet asnjëherë nuk duhet ti bëjë vetëm një nëpunës operativ të cilit i është dhënë rasti. Përvoja e kriminalistëve të tjerë, ekspertëve, shkencave dhe specialistëve mund të jetë me dobi të çmueshme, prandaj duhet të shfrytëzohen.

Të gjitha versionet duhet të hidhen në letër dhe posaçërisht të analizohen në kuadër të fakteve të njohura materiale apo të karakteristikave psikike të kryerësit të veprës penale – sipas gjurmëve, mënyrës së kryerjes etj. Për shembull, kontrollon deklarata e qytetares për grabitjen nga ana e një burri të panjohur, të cilit ajo i është kundërvënë. Gjatë marrjes në pyetje (arrestimit) të të dyshuarit shtrohet edhe versioni i pjesëmarrjes së tij në grabitje. Nëse versioni është i vërtetë atëherë: 1) në veshmbathje dhe në trupin e të dyshuarit duhet të gjenden gjurmë të kundërvënies së viktimës – të dëmtuarës; 2) tek i dyshuari duhet të gjenden paratë dhe vlerat e tjera të marra nga e sulmuara; 3) në vendin e ngjarjes duhet të kenë mbetur gjurmë të ngjarjes etj.

Versionet duhet të formulohen në mënyrë konkrete, të kenë mbarështim alternativ dhe të ndahen qartë nga njëri-tjetri. Ata duhet të jenë konkret, të shkurtë dhe të kontrollueshëm me

ndihmën e metodave kriminalistike. Kjo ka të bëjë me shkaqet që ato paraqesin bazën e planifikimit të veprimtarisë hetimore.

Versionet planifikohen sipas aspektit të pyetjeve “të arta” të kriminalistikës. Në lidhje me çdo pyetje të artë duhet të shtrohen dhe të kontrollohen të gjitha versionet e mundshme. Për shembull, me rastin e gjetjes së trupit, duhet të shtrohen shumë versione: vrasje, vetëvrasje, rast fatkeqësie, vdekje e natyrshme.

“Planifikimi i versioneve ka dy funksione në procedurën para hetimore dhe penale. Së pari shërbejnë si metodë me ndihmën e së cilës gjenden fakte të reja, dhe së dyti japin shpjegime për ato që janë gjetur.

Subjektet të cilët mund të shtrojnë versione në procedurën para hetimore dhe penale, mund të ndahen në primar dhe në sekondarë. Në primare hynë: personat e autorizuar zyrtar të policisë ligjore, prokurorit publik dhe gjykatësi i kontrollit kryesor. Në grupin e dytë hynë: i dyshuari/ i akuzuari, mbrojtësi, dëshmitari, eksperti. Këta në fakt janë palë në procedurë.

Subjektet primare janë të detyrë ti marrin parasysh versionet e subjekteve sekondare.

3.3. Verifikimi i versioneve kriminalistike

Pjesëtarët e policisë ligjore, prokurori publik dhe gjykatësi të çështjes të cilët shtrojnë versione të caktuara ende nuk e dinë se cila nga to është e saktë, e cila jo. Me qëllim që të arrihet te e vërteta ata duhet të marrin aktivitete adekuate me të cilat, në fakt, duhet ti verifikojnë versionet e planifikuara. Planifikimi dhe verifikimi i versioneve janë në lidhje të pandashme.

Në fillim duhet të planifikohen një maksimum versionesh si sqarime të mundshme të çdo ngjarje. Nëse menjëherë bëhet e

qartë se të gjitha këto nuk mund të jenë të sakta, ose disa prej tyre përjashtojnë njëra tjetrën, atëherë vetëm njëri mund të merret si e saktë. Duhet pasur parasysh se versionet nuk paraqesin të vërtetën, edhe kur i përgjigjen të vërtetës. Ato gjithnjë kanë vetëm karakter hipotetik. Ato nuk janë prova, por vetëm një shkallë që shpie te provat.

Gjatë verifikimit të fakteve të caktuara dhe të rrethanave, në bazë të mbledhjes graduale të provave, disa versione bien vet, ndërsa shkalla e besueshmërisë tek të tjerët rritet. Në fakt verifikimi i versioneve është në funksion të metodave për eliminim (të cilat përpunohen më poshtë në këtë punim). Kështu qarku i sqarimeve të mundshme ngushtohet deri sa të mbetet vetëm një sqarim i ngjarjes.

Metoda e eliminimit duhet të zbatohet për të krijuar unitet me metodën e përcaktimit pozitiv të fakteve. Me provat të cilat eliminojnë versionet tjera duhet të lidhen faktet pozitive të përcaktuara, vërtetimet pozitive për të vërtetën e versioneve të mbetura. Vetëm kështu mund të arrihet të vërteta objektive në procedurën penale dhe të kapet një siguri më e madhe.

Versionet kriminalistike duhet të verifikohet në të njëjtën kohë. “Nuk është e pranueshme teoria e radhitjes sipas së cilës së pari duhet të verifikohen versionet më të besueshme, sepse gjatë qasjes së këtillë do të humbnin prova të rëndësishme, kështu që versionet të cilat në shikim të parë dukeshin më pak të besueshme, më vonë nuk do të kishte mundësi të verifikohen”.

Versionet verifikohen me ndihmën e të ashtuquajturit *instrumentalium policor*, përkatësisht me marrjen e një numri të madh masash dhe aktiviteteve operative-taktike (teknike) dhe dëshmuere.

3.4. Klasifikimi i versioneve kriminalistike

Sipas qarkut të shpjegimit të fakteve, më e pranueshme do të ishte ndarja e trefishtë e versioneve si të përgjithshme, të veçanta dhe individual. Versionet e përgjithshme e përfshinë ngjarjen penale në tërësi. Versionet e posaçme janë supozime për subjektin, anën subjektive, për objektin dhe për anën objektive të veprës penale. Versionet individuale janë supozime për faktet veç e veç etj.

Në literaturë përmenden edhe versionet tipike si nën lloje të versioneve të përgjithshme. Versionet tipike shtrohen në bazë të një minimum informacionesh (për shembull, ndonjë qytetarë i ka kumtuar policisë se ka gjetur një trup të një njeriu). Ato i përfshinë të gjitha shpjegimet e mundshme (tipike) të veprës konkrete penale (për shembull, bëhet fjalë për vrasje, vetëvrasje, vdekje të natyrshme, rast fatkeqësie). Çdo një nga këto versione është hipotetik, komentim i pa sigurt, por të gjitha së bashku japin shpjegimin e vetëm të mundshëm për ngjarjen konkrete.

“Versionet tipike bëhen në bazë të: njohjes së pjesës së posaçme të ligjit penal në të cilin janë përcaktuar anët esenciale të veprave të veçanta penale; metodika kriminalistike për zbulimin dhe për dëshmimin e llojeve të veçanta të veprës penale dhe të përvojës konkrete kriminalistike të nëpunësit operativ ose të gjykatësit hetues (tani prokurori publik).”

Të përmendim se versionet tipike japim orientime të rëndësishme dhe synime gjatë organizimit të aktiviteteve

kriminalistike në angazhimin e parë, vënë në dukje potencialin njerëzor i cili duhet të angazhohet që në fillim etj. Këto mund të shndërrohen në versione të përgjithshme dhe të veçanta.

Sipas kohës në të cilin bie rrethana e supozuar versionet ndahen në *retrospektivë* dhe *prognozues*. Të parët, ngjarjen penale e shpjegojnë nga aspekti i të kaluarës (në tërësi ose në mënyrë fragmentare). Për shembull, çka ka ndodhur. Të dytët, kanë të bëjnë me faktet dhe me rrethanat të cilat duhet të vërtetohen ose të konfirmohen në të ardhmen veprimtarinë kriminale. Për shembull, ku duhet të bëhet bastisje e të tjera. *Versionet hetimore*, gjithashtu, janë një lloj versionesh prognozues. Për shembull, versionet për vendin e fshehjes së kryerësit në bazë të të cilëve ndërmerren aktivitete operative dhe gjyqësore – kurthe, arrestimi etj.

Nga aspekti i pajtueshmërisë reciproke, versionet ndahen në *përputhësh* dhe *konkurrente*. Të parat pajtohen me njëri tjetrin dhe plotësohen në kuadër të një versioni të përgjithshëm. Të dytët përjashtojnë reciprokisht njëri tjetrin dhe bien në versione të ndryshme të përgjithshme. Si lloj i veçantë i versioneve konkurrente janë kontrovers . “Kontraversët përmbajnë udhëzime të rëndësishme metodike të cilat duhet të merren parasysh: ka ndodhur akti kriminal pak më ndryshe apo jo siç paraqitet nga vëzhgimi në vet vendin e ngjarjes dhe deklaratat e dëshmitarëve”. Në lidhje me subjektet që i shtrojnë versionet, ato ndahen në: *operative, hetimore dhe versione të çështjes kryesore*. Të parat i planifikojnë personat e autorizuar të policisë gjyqësore, të dytat i shtron prokurori publik, ndërsa të tretat kryetari me anëtarët e këshillit gjyqësor gjatë zhvillimit të seancës kryesore. Ekzistojnë edhe të ashtuquajturat versione *ekspertize* të cilat shtrojnë gjatë ekspertizës për të sqaruar krijimin e gjurmëve përkatëse apo

veçorive karakteristike të objektit për të sqaruar shkaqet e lënies së gjurmëve apo të veprës penale.

Sipas objektit të dëshmisë versionet mund ti ndajnë në: *versione të akuzës dhe versione të mbrojtjes*.

4. MUNDËSITË E REJA TË RRITJES SË CILËSISË SË PLANIFIKIMIT TË PROCEDURËS PARAHETIMORE DHE PENALE.

Kontribut të rëndësishëm për rritjen e cilësisë dhe të efikasitetit në planifikimin e procedurës para hetimore dhe penale ka zhvillimi i kibernetikës, përkatësisht zbatimi i teknologjisë kompjuterike në këtë fushë. Bazat bashkëkohore dhe të kompjuterizuara të të dhënave japim një mundësi që gjatë planifikimit të veprimtarisë kriminalistike në mënyrë të shpejtë dhe të lehtë të fitohen të dhëna të rëndësishme që paraqesin bazën e marrjes së vendimeve me mjaft rëndësi për analizë të hollësishme dhe precize të aktit penal, si dhe të dhëna të rëndësishme për parashikim të suksesshëm kriminalistik të veprimit policor dhe procedural (për shembull, baza e të dhënave për identifikimin e të pastrehëve, baza e të dhënave për aktet penale dhe mënyrat e kryerjes të veprave penale, baza e të dhënave për forcat disponuese, radhitja e tyre momentale, disponimi i teknikës dhe i mjeteve kriminalistike).

Tani më ekzistojnë programe për përpunimin e hartave topografike precize të cilat gjenden në bazat kompjuterike të të dhënave, që mundëson gjetje të shpejtë dhe këmbëngulëse të gjurmëve nga ana e policisë që është mjaft e rëndësishme për planifikimin e suksesshëm, për shembull, të observimit, vënies së

pritate kriminalistike, të pasqyrave të ndryshme, hulumtim të terrenit.

Simulimi kompjuterik i disa proceseve ose të zhvillimit të ngjarjeve të caktuara, me mundësi për ti parashikuar në variante dhe versione të ndryshme dhe verifikimi i tyre në bazë të simulimit kompjuterik mundëson mundësi të reja ende të pa hulumtuara në planifikimin e veprimeve policore dhe gjyqësore në një mënyrë krejtësisht të re (për shembull zbatimi i teorisë së lojërave⁵⁴, grafiku kompjuterik dhe modelimi kompjuterik).

Kombinimi i teknologjisë bashkëkohore kompjuterike dhe zbatimi i mjeteve bashkëkohore të lidhjeve dhe komunikimit, hap mundësi të reja për planifikimin dhe zbatimin e veprimit kriminalistik.

4.1. PROFILIMI I PERSONALITETIT TË KRYERËSIT TË VEPRËS PENALE

4.1.1. Nocioni i profilizimit

Përcaktimi i profilit të kryerësit është një metodë relativisht e re kriminalistike e planifikimit, ndërsa nënkupton vlerësimin e personalitetit të kryerësit dhe të stilit potencial të jetës të një tipi të caktuar të kriminelëve të cilët e kanë shprehur nëpërmjet kryerjes së veprës penale⁵⁵. Profilizimi nënkupton krijimin e

⁵⁴ Teoria e lojërave strategjike është degë shkencore e disiplinës matematikore-kibernetike e cila i studion modelet abstrakte të situatave konfliktuoze.

⁵⁵ Sektori për tregti me njerëz dhe i kotrabandës së klandestinëve në kuder të Seksionit për krim të organizuar pranë MPB të RM me qëllim të ballafaqimit sa më me sukses me problemin e tregtisë me njerëz, në metodologjinë e vet të punës tanimë e zbaton metodën aktive të ndjekjes së hetimit kriminalistik. Qëllimi i kësaj metode është që nëpërmjet zbatimit të masave operative-taktike të identifikohen tregtarët në fazat e hershme para se të shfrytëzohet viktimat. Nëpërmjet zbatimit të metodës së profilizimit, identifikohen grupe dhe individë kriminel të cilët përgatisin dhe planifikojnë kryerjen e veprës penale dhe objektet

versionit të kryerësit potencial të bazuar në informacionet që rrjedhin nga konteksti i veprës penale, me qëllim që në kuadër të përpunimeve aktuale policore të bëjë të lehtë gjetjen e të dyshuarit ose të hartojë listën e të kryerësve të mundshëm.

Duhet bërë dallim të profilizimit si veprimtari, të ashtuquajtur procedurë e profilizimit të personalitetit të kriminelit dhe profilizimit të personalitetit të kryerësit (të ashtuquajtur fantom psikologjik i figurës), si dhe prodhimin final të procedurës së tillë e cila bazohet në formimin e profilit të kryerësit të panjohur.

Sipas kësaj, profili i personalitetit të kryerësit është tipar teknik i konstatuar i personalitetit dhe modeli i sjelljes së personalitetit të panjohur në bazë të analizës së veprës penale, e cila duhet të individualizojë. Ai përbëhet nga gjetja dhe konstatimi i tipareve të sjelljes së lidhura për kryerësin e panjohur, që janë mjaft sinjikative (karakteristike, të rëndësishme) për personalitetin që ka kryer vepër penale dhe mund të dallohet qartë nga njerëzit e tjerë. Profilizimi nuk synon identitetin specifik të të akuzuarit të panjohur, por në bazë të analizës së sjelljes dhe të karakteristikave personale që janë shprehur gjatë kryerjes së aktit, ai na shpie në llojin, tipin e personit i cili mund të ketë kryer vepër penale konkrete. profilizimi e orienton veprimin kriminalistik-operativ. Profili i kryerësit është pak a shumë pamje e saktë e kriminelit edhe më tutje të panjohur i cili duhet me ndihmën e profilit të përpiluar të gjendet. Profili ka status të versionit. Me ndihmën e profilit të bërë ngushtohet qarku i kryerësve potencial, veçanërisht në raste kur numri i personave

ku kryhet vepra penale. Grupet, individët kriminel dhe objektet e këtitilla të profilizuara janë lëndë e hetimit kriminalistik, për të siguruar prova materiale për ngritjen e procedurave penale para gjyqeve kompetentë.

të dyshuar është i madh apo i pacaktuar, kështu që nuk mund të zbatohen metoda të tilla klasike kriminalistike.

Varshmëria teorike e profilizimit gjendet në njohuritë se vepra penale dhe krijuesi në mënyrë specifike janë të ndërlidhur njëra me tjetrën. Këta tregojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë njëri-tjetrit. Çdo vepër penale përmban pamjen e kryerësit dhe jep orientime drejt tij. Në bazë të gjurmëve të ndryshme dhe shenjave në vendin e ngjarjes mënyra se si është dëmtuar viktimja dhe prova të tjera, rikonstruktimit të rrjedhës së veprës penale, me ç'rast arrihet në përfundim për motivet, tiparet e personalitetit dhe për karakteristikat tjera psikologjike dhe jo psikologjike të kryerësit.

Profilizimi zbatohet (si metodë e domosdoshme) në rastet kur me metoda klasike kriminalistike të planifikimit nuk mund të shkohet përpara në zgjidhjen e rastit, kur nuk ka mundësi të gjenden apo të sqarohen motivet e kryerjes së veprës penale, si dhe kur nuk ka pasur ndonjë marrëdhënie të mëparshme ndërmjet kryerësit dhe viktimës ose ai ka qenë mjaft sipërfaqësor (për shembull, në rast kur vrasësi nuk e ka njohur të vranin).

Profilizimi zbatohet në praktikë për të sqaruar veprat e rënda penale, për shembull, vrasjet, vrasjet serike, vepra penale me motive seksuale, shantazhe⁵⁶ dhe rrëmbime⁵⁷ (kidnapimi). Metoda bazohet në zbatimin e procedurave analitike të

⁵⁶ Sipas karakteristikave të veta, shantazhi definohet si vepër penale pronësore që përfshin grumbullimin jo ligjor të dobisë pronësore në këtë mënyrë: Kryerësi e detyron të dëmtuarin të bëjë ose të mos bëjë diçka në dëm të pasurisë së vet ose të huaj nëpërmjet kërcënimeve se për të ose ndonjë person të tij të afërt do të zbulojë diçka që do të dëmtonte nderin ose autoritetin e tij.

⁵⁷ Rrëmbimi (kidnapimi) paraqet akt terrorist me të cilin, duke përdorur forcë ose kërcënime serioze ose do të përdoret një gjë e këtillë, mbahen individë ose një grup njerëzish si pengje me qëllim, që nëpërmjet shantazhit se do të sjellin në pyetje jetën e tyre, për të arritur një qëllim të caktuar. Rrëmbime bëjnë grupet ose organizatat terroriste, individë ose kriminelë të tjerë dhe motivet e tyre mund të jenë të shumta (dobi materiale, lirim nga burgu, arritja e ndonjë qëllimi politik etj).

kualifikuara që mundësojnë formimin e bazës (versionet) me të cilin do të orientohet veprimi operativ dhe hetimor. Me ndihmën e këtyre metodave duhet të arrihet: përcaktimi i kronologjisë së lindjes së veprës penale (paradelikte, delikte dhe faza postdelikte); rikonstruktimi preciz i veprës penale, zbardhja e veprës penale, vënia në dukje e orientimeve deri atëherë të pa orientuara të veprimtarive operative, vendet e paqarta dhe pikat kuqe të cilat duhet të sqarohen, përcaktimi i prioriteteve në veprimtarinë operative analiza e rrezikut shoqëror të aktit dhe mundësia e përsëritjes së tij, tipizimi i kryerësve, konkluzionet për karakteristikat e mundshme personale të kryerësit. Zinxhiri i konkluzioneve dhe i analizave bëhet sipas kësaj radhitje: analiza e gjendjes së kryerjes së aktit – përfundim për marrjen e aktiviteteve rreth kryerjes së veprës penale dhe sjelljes së kryerësit – analiza, - vlerësimi i motivit (versioni i motiveve), - vlerësimi i karakterit të kryerësit (tiparet e karakterit), - profilizimi i personalitetit të kryerësit (tipit të mundshëm të personalitetit), - planifikimi se ku duhet nisur ndjekja e kryerësit (në kuadër të cilit rreth njerëzish), - planifikimi ku dhe kur përsëri mund të pritët kryerja e veprës penale që të ngrihet kurthi. Thënë thjeshtë planifikimi mbështetet në modelet: çka ka ndodhur, - pse ka ndodhur, - kush është kryerësi, - përkatësisht si duket kryerësi (cilat janë karakteristikat e tij, prej nga është etj.).

Rëndësi më e madhe gjatë profilizimit qëndron në faktin se ai ka strukturë interdisciplinare. Në fazën e veprimtarisë zbuluese dhe në përpunimin e rasteve kriminale angazhohen ekspertë dhe zbatohen njohuri jo vetëm nga lëmi i: kriminologjisë, psikologjisë forenzitike, psikiatrisë, psikologjisë, mjekësisë ligjore; duke i dhënë karakter krejtësisht të ri analizës të veprimit dhe analizës dhe planifikimit të procedurës parahetimore.

4.1.2. Analiza e gjendjes faktike dhe procedura e profilimit

Procedura e profilizimit përbëhet nga këto faza: *faza e parë*: mbledhja dhe sigurimi i provave dhe informatave të tjera nga vendi i ngjarjes, nga viktimë, fotografitë (hapësira më e ngushtë dhe më e gjerë e vendit të ngjarjes, plagët e viktimës), skica, analiza të gjurmëve, konstatimet e mjekësisë ligjore dhe ekspertiza të tjera, të dhëna gjeografike, dëshmitarët, dëshmitarët okular etj.; *faza e dytë*: rikonstruktimi i rrjedhës së veprës penale, analiza e çdo gjurme veç e veç e që lidhet me gjurmët tjera. Vepra penale analizohet në tërësi, bëhen të gjitha versionet e mundshme, bëhet analiza profesionale e veprës penale, bëhet dallimi i veprimit primar (që ka domethënie juridike penale) nga veprimet me karakter sporadik, vërehen dhe bëhet dallimi i rrethanave kryesore dhe sporadike krijohen rekonstruksione kronologjike të rrjedhës së veprës penale (regjistrohen të gjitha procedurat, fazat a analizës dhe veprime të ndërmarra). Versionet e parashtruara verifikohen në raport me gjurmët e verifikuara të padyshimta, ndërsa ideja rrjedhëse korrigjohet); faza e tretë është analiza kriminalistike me ç'rast pikënisja bëhet nga gjurmët ekzistuese dhe ndryshimi i vendit të ngjarjes, analiza e raportit të kryerësit me viktimën, motivet e mundshme dhe tipi i mundshëm i kryerësit, emocionet e tij të brendshme në kontekst të sqarimit të disa gjurmëve, si dhe niveli i planifikimit dhe i kontrollimit të sjelljes së kryerësit gjatë kryerjes së aktit penal; faza e katërt: planifikimi i veprimeve dhe aktiviteteve konkrete taktike si dhe masave kriminalistike-teknike të cilat duhet të ndërmerren për të organizuar hetimet në drejtim të gjetjes tipa të personaliteteve që i

përgjigjen kryerësit të mundshëm, që të hartohet lista e personave të dyshimtë dhe që të bëhen verifikime.

Për të krijuar profilin personal të kryerësit të panjohur me rëndësi të veçantë janë të dhënat që mblidhen nga përpunimi i vendit të ngjarjes. Në bazë të tyre përpilohen modele të ndryshme të cilët analizohen nga aspekti i teorisë, përvojës dhe njohurive kriminalistike, kriminologjike dhe psikologjike, të intuitës kriminalistike dhe përfundimeve logjike si dhe zbatimit të të dhënave statistike dhe të dhënave nga bazat e të dhënave (MOS dhe baza të tjera që janë dhënë në tekstin e mëposhtëm), me punë ekipore të detyrueshme.

Modeli tipik dhe ekskluziv i gjurmëve kriminalistike – analiza e vendit të ngjarjes mund të tregojë ekzistimin e gjurmëve tipike (të rëndomta) dhe gjurmë atipike. Te modeli tipik hasen gjurmë të cilat janë karakteristike për një ditë të caktuar të veprave penale. Ato, sipas rregullit, gjithnjë gjenden tek veprat penale të të njëjtit tip. Modeli ekskluziv haset tek gjurmët, format e tyre apo të raporteve (të situatës së vendit të ngjarjes që nuk vë në dukje modele dhe mënyra të njohura të kryerjes së aktit. Ato vënë në dukje ose tipin e ri ose tiparet e kryerësit të panjohur.

Dy modele të perversionit – në kryerjen e veprave penale me mënyra të zgjedhura të veprimit dhe të gjurmëve që mbesin pastaj, njihet personaliteti i kryerësit. Specifikat në mënyrën e kryerjes janë shprehje e perversionit të kryerësit (tek veprat serike penale kryerësit mbeten besnik në të njëjtën mënyrë ose të ngjashme të kryerjes së aktit). Për zbatimin praktik të profilizimit mund të dallohen dy modele të perversionit. Modeli i parë i perversionit është rezultat i sjelljes racionale të kryerësit që del nga dëshira për kryerje sa më efikase të veprës penale (mënyra e kryerjes e cila sjell sukses dhe që nuk ndryshon, por vetëm përsoset). Modeli tjetër i perversionit (mbetje në mënyrën e njëjtë

të kryerjes) del nga detyrimi psikologjik i veprës penale që të bëhet në mënyrë të caktuar. Shkaktohet nga specifika të caktuara të personalitetit të kryerësit (më shpesh të pavetëdijshëm) të cilat kanë shkakun e vet në ç'rregullime të caktuara, frustrime ose motive të pavetëdijshme dhe shprehen në plotësimin specifik të agresionit, llojeve të ndryshme të perversionit⁵⁸, tortura specifike të viktimës etj., ose në zgjedhjen e objektit specifik të sulmit. Në bazë të vërejtjes dhe vlerësimit të këtyre specifikave është e mundshme të bëhen versione për karakteristikat e caktuara psikologjike të kryerësit që janë të rëndësishme për ndjekje.

Model: kriminelët të organizuar (sistematik) dhe jo të organizuar (josistematik). – në bazë të hulumtimeve që i ka bërë FBI është arritur në përfundim se ekziston dallim në sjelljen kriminale ndërmjet vrasësve sistematik dhe josistematik (si dhe kriminelëve të tjerë në aspektin se për çfarë vepra penale bëhet profilizimi). Në pyetje është modeli që zbatohet në Amerikë. Çdo shtet formon modelin e vet në bazë të të dhënave statistikore të praktikës personale.

Kriminelët e organizuar (sistematik) që janë personalitete sociopatik sipas strukturës së personalitetit të vet, e planifikojnë hollësisht që përpara veprën e vet penale. Ata e vizitojnë vendin e ardhshëm të krimit dhe veprën penale e bëjnë në mënyrë profesionale. Në mënyrë sistematike përpiqen të fitojnë besimin e viktimës. Në vendin e aktit nuk lënë gjurmë dhe nuk e mënjanojnë trupin e viktimës. Jo rrallë në vendin e aktit lënë gjurmë të rrejtshme. Interesohen për rrjedhën e veprimit – aktivitetit policor.

⁵⁸ Perversion (latinisht perversio) degjenerim, i degjeneruar, anomali seksuale (jo të natyrshme) në jetën seksuale të njeriut që përfshinë shmangie nga qëllimi normal seksual. Shih S. Frojd. Një kujtim nga fëmijëria e Leonardo da Vinçit.

Karakteristikat tipike të kriminelit sistematik janë: inteligjenca e lartë, relacione normale sociale, sjellje normale, punë të përhershme dhe të cilësuar, jetë aktive seksuale, në familje janë fëmijë më i vjetër ose fëmijë i vetëm, nuk kanë pasur disiplinë të rreptë në fëmijëri, gjatë kryerjes së veprës penale kontrollojnë veten, shfrytëzojnë alkool para kryerjes së aktit. Stresi shkaktuar nga paratë (në bashkëshortësi ose në baza të tjera) e shton kryerjen e veprës penale. Jetojnë me partnerin. Janë kriminel mobil (kanë automjet të mirë në gjendje të mire). I ndjekin raportet e medimeve për krime. Mund të ndryshojnë vendin e jetesës dhe vendin e punës. Viktima i takon një tipit të caktuar. E kontrollojnë fjalën e vet, me analizën e vendit të ngjarjes të caktohet se vepra penale është e përgatitur. Para kryerjes së aktit manifestojnë agresivitet. E fshehin ose e varrosin trupin. E mënjanojnë armën nga vendi i ngjarjes dhe nuk lënë prova.

Kriminelët josistematik nuk e planifikojnë në thellësi kryerjen e aktit penal, që duket nga gjurmët e lëna. Sipas strukturës të personalitetit të vet kryesisht janë skizofren⁵⁹. Nuk kanë mundësi të kontrollojnë fantazitë dhe emocionet impulsive të tyre gjatë kryerjes së aktit penal, kështu që në vendin e ngjarjes lënë ndryshime krejtësisht tjera se sa kriminelët sistematik. Gjatë kryerjes së veprës penale dhe pas saj janë nën stres të madh. Viktimat e këtyre kriminelëve më shpesh jetojnë pranë tyre (në të njëjtin mjedis). Qëndrimi ndaj viktimës është brutal dhe i pa frenuar. Papjekuria seksuale dhe emotive manifestohet me aktet primitive në vendin e ngjarjes. Në vendin e ngjarjes lënë gjurma të mëdha. Nuk e heqin viktimën e të tjera.

⁵⁹ Është e ditur se skizofrenia do të thotë shkapërderdhje e personalitetit, që do të thotë se tek këto psikoza bëhet fjalë për çrregullime serioze psikopatologjike të funksioneve psikike të personalitetit.

Veçoritë tipike të kryerësve kaotik (josistematik): kanë inteligjencë mesatare, sjellje të papjekur sociale, nuk kanë arsimim të kualifikuar dhe shpesh kanë vend të përhershëm të punës. Kanë vështirësi seksuale. Kanë qenë fëmijë më të vegjël në familjen e tyre. Babai shpesh ka qenë pa punë. Kanë prindër të rreptë. Mbështeten ndaj reagimeve gjatë të cilave shprehin frikën në kryerjen e veprës penale. Gjatë kryerjes së aktit penal shfrytëzojnë alkool. Sipas rregullit jetojnë vet. Jetojnë dhe punojnë pranë vendit të aktit penal. Nisin me kryerje spontane të veprës penale (nuk e kanë planifikuar më parë). E njohin viktimën dhe vendin e ngjarjes. Nuk bisedojnë me viktimën ose e bëjnë me mjaft vështirësi. Në vendin e krimit lënë kaos me shumë gjurmë, shfryhen seksualisht ndaj viktimës, lënë prova dhe armën në vendin e krimit.

Në tabelën 1 janë dhënë dallimet në variabilitetin të aspektit të gjendjes në vendin e krimit tek aktet penale, vrasje nga motive seksuale që i kanë kryer tipa kriminalistik sistematik dhe josistematik.

Mënyra e sjelljes	tip i organizuar	tip jo i organizuar
josisistematik	Sistematik	
Planifikim i veprave penale 44%	86%	
Lidhshmëri të viktimës, 10	49%	
Gjëra seksuale ndaj viktimës së gjallë 24%	64%	
Përdorimi i alkoolit para kryerjes		

Hyrje në kriminalistikë

Së veprës penale ose gjatë kryerjes	56%
19%	
Sjelljes sadiste	32%
43%	
Lënie e armës në vendin e krimit	18%
57%	
Ndërhyrje në pozitën e kufomës (fshehje, këthyerje përmbys etj)	
55%	22%
Veprim seksual ndaj kufomës	34%
74%	
Lëndime pasi ta ketë vrarë viktimën	27%
76%	

Në tabelën 2 janë dhënë dallimet në variabilitetin të aspektit të tipareve të personalitetit të vrasësve sistematik dhe josistematik nga motive seksuale

Tiparet e personalitetit	tip i organizuar	tip jo i organizuar
	sistematik	jositematik
Profesion të kualifikuar	50%	0%
Ndërrimi i banesës pas vrasjes	11%	0%
Ndërrimi i vendit të punës pas vrasjes	8%	0%
Ndjekje e raporteve në medime,	51%	24%

Pengesa seksuale, kryerësi e një viktimën 24%
47%

Pas analizës mund të jepet përgjigje shumë pyetjeve të rëndësishme se çka tregon gjendja në vendin e krimit të sjelljes së planifikuar (të organizuar) ose të paplanifikuar (të sistemuar) të kryerësit gjatë aktit penal. Në bazë të kësaj mund të nxirren përfundime për inteligjencën dhe të lidhshmërisë së saj me rrethanat jetësore të personalitetit të kryerësit (aftësim profesional, gjendja familjare, pamja). *Duhet nënvizuar se këto supozime kanë vetëm vlerë hipotetike kështu që nëse ndonjë i dyshuar nuk i përgjigjet profilin të tij të kryerësit, atë nuk duhet përjashtuar në asnjë mënyrë ose të lihet anash gjatë përpunimit kriminalistik.*

4.1.3. Llojet themelore të profilimit

Në bazë të qasjes metodologjike ndaj kësaj problematike, në praktikë dallohen dy lloje profilizime: a) përcaktim praktik – deduktiv i profilin të kryerësit dhe b) përcaktim shkencor – induktiv i profilin të kryerësit. Duhet theksuar se këto plotësojnë njëra-tjetrën dhe zbatohen në praktikë.

a) *procedura praktike – deduktive e orientuar e profilizimit.* Pikënisje për profilizim gjithnjë është një akt penal konkret ende i pasqaruar. Në bazë të informacioneve që janë mbledhur në vendin e ngjarjes (procesverbalet e vëzhgimit, ekspertiza, fotografitë etj.), analiza e hollësishme e marrëdhënieve të viktimës dhe informacionet e tjera që disponohen (për shembull deklarata të dëshmitarëve, me zbatimin e analizës kriminalistike, kriminologjike dhe psikologjike (në bazë të përvojës dhe teorisë në nivel më të lartë dhe më të ulët), përpunohet *fantom figura* e

kryerësit të panjohur ose tipit personal ndaj të cilit duhet të fillojë ndjekja. profilizimi deduktiv kërkon qasje multidisiplinare, bashkëpunim të ngushtë dhe analizë të përbashkët të ekspertëve – specialistëve kriminalistik të delikteve të gjakut dhe seksuale si dhe të mjekëve gjyqësor me ekspertë me arsim special me orientim psikologjik të ashtuquajtur profajler me përvojë të madhe forenzike. Disa autor i ja zënë për të madhe kësaj metode si jo mjaft sistematike dhe në bazë jo aq të fortë shkencore. Suksesi i metodës mbështeten në përvojën e ekspertëve që e përpunojnë profilin dhe nga aftësia e imagjinatës së tyre.

Shembuj nga praktika: rasti i zbulimit të delikuentit serik seksual duke zbatuar njohuritë e profilizimit. Në një vend janë bërë një varg përdhunimesh. Ka pasur pak prova që policia të mund të ngushtojë qarkun e personave të dyshimtë dhe të identifikojë kryerësit. Atëherë rasti i është dërguar njësive të specializuara për profilizim të FBI. Në bazë të provave që disponoheshin është konstatuar profili psikologjik i kryerësit. Mendimi ka qenë se të gjithë shtatë rastet e përdhunimit i ka bërë i njëjti person. Supozohet se kryerësi është person mashkull, i bardhë në vitet e vonshme të 20 ose në vitet e para të 23. Me siguri i ç'kurorëzuar nga gruaja e tij partnere, me siguri nuk ka vend të përhershëm të punës, mbase është punëtor argat e kështu me radhë. Supozohet se ka përgatitje të lartë shkollore dhe se jeton në vendin ku janë kryer përdhunimet. Supozohet se ka një kompleks vlerash të ulëta dhe se nuk ka pasur kontakt me organet e policisë apo të kundërvajtjes për shkak të shqetësimeve të vogla seksuale. Njësia *Bihej viorale* e FBI supozonte se ai mund të kapej së pari nga ana e policisë në rrugë në rajonin ku ka ndodhur përdhunimi në orët e hershme të mëngjesit. Në bazë të këtij profili, policia lokale e ngushtoi qarkun e listës së të dyshuarve nga 40 bura, banorë të asaj ane, që i përgjigjeshin profilit të

përmendur. Duke shfrytëzuar edhe informacione të tjera të marrë nga ekspertët e profilizimit, nëpunësit operativ të terrenit, e përqendruan dyshimin tek një person. Së shpejti, ky person u arrestua dhe në gjyq u dëshmua se ka kryer vepra penale.

b) *Hartimi induktiv i profilin të kryerësit*. Përcaktimi i një profilin mbështetet në një numër të madh analizash që bëhen në lidhje me zbardhjen e veprës penale të të njëjtit lloj. Karakteristikat psikologjike të kryerësit të zbuluar verifikohen, analizohen, tregon në mënyrë statistike dhe përshtaten në kompjuter në kuadër të bazës së automatizuar të të dhënave. Qëllimi i analizës statistike është që të verifikohen tiparet psikologjike që janë tipike për llojin konkret të veprës penale dhe të kryerësit të saj. Në bazë të konstatimeve empirike mund të përshkruhet kryerësit tipik nëpërmjet kuantifikimit dhe tipareve empirike të sjelljes. Shkencëtarët kanë përcaktuar dhe kanë përshkruar profilet tipike të kryerësve tek delikte të ndryshme, (vrasje, delikte seksuale etj.). Përpilimi shkencor-induktiv i orientuar i profilin psikologjik të kryerësit paraqet përpjekje që ajo që është vërejtur, të klasifikohet jo si statistikë e rëndomtë dhe të lidhet me teorinë e besueshmërisë për shkak të veprimeve operative. Në kuadër të klasifikimit, kryerësit ndahen në disa klasë dhe grupe në bazë të tipareve psikologjike (për shembull, agresiviteti), duke nënvizuar pamjen e tyre (për shembull, i ulët, mesatare, i lartë). Me këtë rast, për shembull të gjithë kryerësit me agresion të lartë janë kualifikuar me një grup, ndërsa të gjitha kryerësit me shkallë të ulët të agresivitetit në grupin tjetër. Pas klasifikimit të përcaktuar në bazë të kritereve të zgjedhura në kuadër të një grupi, bëhet përpunimi i mëtejshëm i të dhënave duke zbatuar metodat matematike-statistike. Procesi i analizës përbëhet nga gjashtë hapa. *Hapi i parë*: mbledhja e informacioneve. Informacionet mblidhen nga burime primare

(intervista me kryerësit) dhe zbatimi i hulumtimeve të ndryshme psikometrike të kryerësve (teste të llojeve të ndryshme dhe hulumtime) dhe nga burime sekondare (procesverbale të përgatitur gjatë mbledhjes së deklaratave para policisë dhe para gjyqit, aktet gjyqësore, ekspertiza e të tjerë). *Hapi i dytë:* përfshinë zbatimin e instrumenteve shkencor për përpunimin e të dhënave që janë grumbulluar në hapin e parë dhe grupimi i tyre në pajtim me specifikat e elementeve të shprehura veç e veç që janë tipike për sjelljen e kryerësit tek veprat penale tipike të veçanta. Për shembull, kur janë në pyetje vepra penale me elemente të dhunës hulumtohen 45 tipare psikologjike të cilat grupohen në shtatë grupe themelore: 1) shkalla e sjelljes agresive në parahistorinë e veprës penale (stabilitet në kryerjen e agresionit); 2) sjellje tipike në situata konflikti (analiza psikologjike e proceseve kognitive e të tjera; 3) tipa të faktorëve negativ social (veprim në faktorë tipik social negativ të formimit të personalitetit dhe të sjelljes së kryerësit, për shembull, familja, shoqëria, shkolla, puna si dhe marrëdhëniet specifike ndërmjet kryerësit dhe viktimës); 4) ndër reaksionet ndërpersonale; 5) parahistorie delikumente; 6) planifikimi i veprës penale; 7) niveli i kontrollit të sjelljes të shprehur gjatë kryerjes së veprës penale. Faktori 3: përfshinë krahasimin dhe vlerësimin e informacioneve të mbledhura. *Hapi i 4* nënkupton përpunimin statistikë dhe validitetin e të dhënave. *Hapi i pestë:* përfshinë formimin përkatësisht përcaktimin e profilin tipik psikologjik për një kategori të caktuar kryerësish të veprave penale. Hapi i gjashtë nënkupton verifikimin dhe harmonizimin e profilin empirik të kryerësit sipas rasteve të ardhshme që paraqiten në praktikë.

Gjersa nga njëra ana profilizimi deduktiv është orientuar rreth përcaktimit të tipareve sinjifikative të kryerësit konkret por ende të panjohur, që janë shprehur edhe gjatë ndërmarrjes së

veprimeve të kryerjes ose të disa sjelljeve atipike në vendin e ngjarjes (specifika në torturimin e viktimës, veprim ndaj kufomës, procedura rituale etj), nga ana tjetër profilizimi induktiv orientohet në përcaktimin e vlerave të mesme statistikore, që do të thotë veçorive tipike të kriminelit të llojit të caktuar, në hapësirën e caktuar dhe në kohën e caktuar. Duke marrë parasysh këto dallime metodologjik, disa autor vënë në dukje disa mangësi sistimore të profilizimit induktiv. Së pari theksojnë së vlера mesatare statistikore (empirike) e profilit mbështetet në përgjithësimin statistikor që sipas rregullit është jo i kompletuar sepse përfshinë vlера mesatare vetëm të kriminelëve të kapur (numër i kufizuar i informatave) ndërsa këto rëndomë e përbëjnë numrin më të vogël të popullatës së përgjithshme së tipit të caktuar kriminal. Kriminelët e kapur, megjithatë, janë reprezentuesit më të këqij të llojit të vet, më të marrë ose u takojnë atyre që nuk kanë fat. Kriminelët e shkathët dhe inteligjent zbulohen shumë rrallë, Sipas kësaj profilizimi induktiv e përfshinë vlerën statistikore të mesme vetëm të pjesës më të keqe të popullsisë kriminele dhe është gabim që në bazë të tyre të nxirren përfundime të përgjithshme. Profilizimi induktiv bëhet në mënyrë statistike në kompjuter ndërsa për përpilimin e tij nuk nevojiten ndonjë profesionalizëm i madh, apo njohuri psikologjike, kriminalistike dhe kriminologjike në një farë mënyrë synon drejt sipërfaqësore. profilizimi induktiv që nuk është i fokusuar edhe për specifikat dhe sjelljen kriminele të tipareve relevante mund të paraqesë vlerën e mesme të karakteristikave jospesifike dhe në këtë mënyrë zgjerohet fusha e dyshimeve edhe të personave të pafajshëm. Prandaj, është me rëndësi që këto dy metoda të profilizimit të kombinohen dhe gjatë

hartimit të vlerës së mesme statistikore (profili empirik) të përfshihen edhe ekspertë profajler⁶⁰ dhe kriminolog të cilët janë specializuar për këtë lloj analize. Në këtë mënyrë me analizë cilësore do të korrigjohen të dhënat jospecifike statistikore (makina, domethënë kompjuteri nuk mund në tërësi të zëvendësojë ekspertin as në këtë fushë).

Shembull nga praktika: Profili i trafikantit tipik të drogës në linjat ndërkombëtare të aviacionit në SHBA. Të gjithë policët dhe doganierët që punojnë në linjat ndërkombëtare janë paralajmëruar për karakteristikat e këtij profili dhe u është dhënë urdhër gjatë kontrollit të kenë kujdes veçanërisht ndaj udhëtarëve që i kanë këto karakteristika: janë të rijë, kanë bagazh pa kartelë identifikimi, bagazh të zbrazët ose udhëtojnë pa të, menjëherë pas aterritimit bëjnë telefonat, janë nervoz, shfrytëzojnë transportin publik, vijnë në doganë menjëherë pas aterritimit të avionit ose janë të fundin në radhën e kontrollit, blejnë biletë avioni me pare të gatshme, me prejardhje janë kryesisht nga Amerika jugore, blejnë biletë në një drejtim, udhëtojnë në linja që nisen nga rajone të njohura të prodhimit të drogës. Ekzistojnë edhe të dhëna plotësuese, për shembull, qëndrim i shkurtër në botën e jashtme si dhe kriteret të cilat nuk janë shpallur.

4.1.4. Zbatimi i profilizimit

profilizimi shpeshherë nuk mund ti japë zgjidhje veprës penale. Metoda duhet të shihet si armë që më tepër mund të përdoret për të shfrytëzuar gjatë paramendimit të strategjisë të planifikimit të veprimit operativ. Në një numër të madh të profilizimeve kriminalistët mund të gjejnë ndihmën për të ngushtuar qarkun e numrit të të dyshuarve dhe për t'iu shmangur

⁶⁰ Japin pamjen anësore të dikujt ose të diçkaje

shpenzimit të energjisë dhe kohës për të menduar rreth synimeve që nuk premtojnë rezultate. Në disa raste profili mund të vë në dukje ndonjë person i cili tani më është i dyshuar me çka i bëhet e mundshme policisë të koncentrojë punën e vet tek personi më i dyshuar. Profili mund të tregojë se prej ku duhet të nisë hetimi, nga cili rajon, nga cilat lloje të personaliteteve ose nga personat që janë dënuar më parë. Këto tipare, sipas rregullit, mund të paraqesin supozime në bazë të profilizimit të: vjetërsisë, gjinisë, përkatësisë etnike, profesionit (orientimit profesional), gjendjes familjare, shkallën e pjekurisë seksuale, reagime të ndryshme gjatë dëgjimit në polici, potenciali i përsëritjes së veprës penale, dënimi i mëparshëm, inteligjenca, kushtet e përgjithshme të jetës, vendi i jetesës, karakteristikat fizike (lartësia, forca e trupit). Këto karakteristika përkrahen me analizën e sofistikuar statistike të raportit dhe të lidhjeve ndërmjet faktorëve të ndryshëm dhe tipave të veçantë të delikuentëve. profilizimi dhe angazhimi i ekspertëve të kësaj fushe gjithnjë e më shumë po shfrytëzohet për grumbullimin dhe vlerësimin e deklaratave të të dyshuarve. Në bazë të analizës së personalitetit të kryerësit të panjohur ekspertët u sugjerojnë hetuesve se cilat pyetje duhet t'ua parashtrojnë të dyshuarve potencial me qëllim që të shfrytëzohen dobësia emocionale dhe prekshmëria e kryerësve. Ekspertët angazhohen në fazën e përgatitjes të taktikës së hulumtimit, si dhe gjatë dëgjimit të të dyshuarit kështu që e ndjekin rrjedhën e tij nga një lokal i afërt me ndihmën e video-sistemit. Në rast nevojë, gjatë dëgjimit të të dyshuarit i jepet ndihmë personit zyrtar i cili e kryen këtë punë.

4.1.5. Përkrahja kompjuterike e profilizimit: sistemi viklas

Në botë si përkrahje logjistike e profilizimit zbatohen programet analitike kompjuterike dhe bazat e të dhënave. Ka shumë programe të këtij lloji. Sistemi i parë është përpiluar për nevojat e FBI, në vitin 1983, nën titullin VICAP (Violent Criminal Apprehension Program). Programi kompjuterik në bazë të llogaritjeve statistike llogarit korrelacionet ndërmjet fakteve të konfirmuara dhe vendit të ngjarjes dhe personaliteteve të kryerësve të mundshëm, në bazë të kësaj nxirret supozimi për profilizimin e mundshëm, përkatësisht tipin e kriminelit të cilit mund ti takojë kryerësi konkret i veprës penale. Në bazë të programit VICAP në Kanada është formuar ViCLAS bazë e të dhënave. Në Angli shfrytëzohet baza e ngjashme të dhënave. Në këtë tekst do të prezantohet sistemi ViCLAS i Kanadasë (Violent Crime Linking Analise Sistem), sepse ky sistem është marrë nga një numër i madh shtetesh (Angli, Belgjik, Holandë, Australi).

Futja e të dhënave në sistem themelohet në bazë të pyetësorit prej 263 pyetjesh me të cilat përfshihen të gjitha hollësitë esenciale të fazave të ndryshme të veprës penale. Në bazë të të dhënave të memoruara, një personel i aftësuar në mënyrë speciale i analizon elementet veç e veç nga aspekti i veprave penale të njëjta ose të ndryshme (akti – kryerësi – raporti), duke bërë krahasimin e të dhënave të ndryshme që pastaj të shfrytëzohen për qëllime operative. Verifikohen elementet e përgjithshme të cilat përsëriten në shkallën më të madhe të besueshmërisë statistike. Në bazë të analizës verifikohet i ashtuquajti “nënshkrimi mental” i kryerësit i shprehur në

kryerjen e aktit penal (mental script) dhe atë në radhë të parë, nga ata që e përsërisin aktivitetin e vet kriminal. Ka mundësi që të krahasohen gjurmët dhe provat tjera të akteve tjera penale. Në bazë të analizës të shumë veprave të pazgjidhura penale mund të përpilohet profili personal me karakteristika të mundshme të kryerësit të panjohur me çka dyshimet orientohen në një drejtim të caktuar.

Në bazë të vlerave të mesme statistikore fitohet profili empirik si vlerë e mesme e të gjitha rasteve të cilat janë futur në bazën e të dhënave. Profili empirik krijohet për tipa specifik të llojeve të veçantë të kryerësve të veprës penale të cilët janë regjistruar në një territor të caktuar. Këto vlera të mesme statistikore nga të cilat krijohet profili i kryerësit tipik të llojeve të caktuara të veprave penale në territor të caktuar dhe në kohë të caktuar, duhet ti ndihmojnë policisë për të ngushtuar numrin e të dyshuarve potencial. Sistemi e llogarit vlerëson numerike se sa persona të dyshuar i përshtaten tipit të mundshëm të kriminelëve për veprën përkatëse penale.

Struktura e bazës kompjuterike të të dhënave. Baza e të dhënave është strukturuar në disa fusha themelore: 1) kryerësi i veprës penale; 2) viktimja; 3) sjellja; 4) dinamika e lindjes së veprës penale; 5) rrjedha e veprës penale; dhe 6) shkaqet e veprës penale. Bëhet i mundshëm hetimi dhe krahasimi i elementeve dhe të dhënave të ndryshme. Në sistemin e futjes së të dhënave për forma të ndryshme të zgjedhura dhe të pa zgjedhura të vrasjes, përdhunime të zgjedhura dhe të pazgjedhura, si dhe për format e atyre veprave penale, rastet e të gjitha keqpërdorimeve seksuale të fëmijëve, të personave të humbur (kur ekziston dyshim se janë viktimja të aktit penal), për kufoma trupash të paidentifikuar nëse ekziston dyshimi se është në pyetje vrasje, rrëmbime të kryera ose përpjekje për rrëmbime. Të dhënat krahasohen sipas kritereve të

hetimit dhe të krahasimit: 1) organi zyrtar që kanë punuar në këtë rast; 2) lloji i veprës penale (në bazë të ndarjes kriminologjike); 3) vendi i kryerjes; 4) koha e kryerjes; 5) të dhëna personale të të dyshuarit për veprën penale; 6) përshkrimi i veprës penale; 7) efektet e arritura nga vepra penale (vlerësimi i dëmeve dhe pasojave); 8) gjurmët e siguruara dhe prova të tjera; 9) arma e përdorur, mjeti, automjeti i përdorur; 10) të dhënat personale të viktimës; 11) përshkrimi i trupit. Në sistem futen të dhëna për të gjitha veprat penale të kryera gjatë dhjetë vjetëve të fundit. Vlera e sistemit varet nga të dhënat e mbledhura konkrete. Në mënyrë statistike të gjithë segmentet e përmendur të pyetjeve ndahen me nën pyetje të cilat janë përpunuar dhe sipas të cilave mundësohet hetimi.

4.1.6. Profilizimi gjeografik

4.1.6.1. Nocioni dhe zbatimi i profilizimit gjeografik

Me profilizim gjeografik nënkuptohet disiplina e re kriminalistike e formuar në fushat shkencore anglosaksone të hetimeve policore, që bazohen në verifikimin e lidhjes ndërmjet orarit hapësinor të veprave penale të tjera dhe modelit psikologjik të sjelljes së tipave të veçantë të kriminelëve, që ka të bëjë në radhë të parë me zgjedhjen e viktimës dhe zgjedhjen e lokacionit – vendit për të realizuar sulmin kriminal. Metoda mbështetet në paraqitjen grafike dhe lokacionin e ndërlidhur për kryerje të

veprës penale, ndërsa në bazë të kësaj bëhet analiza, bëhen përpjekje për të vërtetuar qendrën e aktiviteteve kriminale dhe planifikohen versionet për vendin e mundshëm të jetesës të kryerësit të panjohur. Zbatohet modelimi matematikor dhe llogariten lokacionet e mundshme, lëvizjet ose jetesa e kryerësit të panjohur për plotësimin e tij, zbulimin dhe arrestimin. Pikënisja është nga supozimi se kryerësi nuk zgjedh rastësisht vendin e kryerjes së aktit penal, por ai kushtëzohet nga mundësitë, motivet, lëvizjet dhe mundësia për të vërejtur objekte konkrete për sulm dhe viktima potenciale. Analiza gjeografike bëhet në bazë të numrit minimal të informacioneve, ndërsa me zbatimin e saj hapen horizonte të reja dhe perspektiva në planifikimin dhe parashikimin kriminalistik. Që të zbatohet me sukses profilizimi gjeografik është e nevojshme të bëhet një analizë e hollësishme e veprave penale në një hapësirë dhe në bazë të kësaj të vërtetohet, sipas mënyrës së kryerjes dhe sipas karakteristikave tjera, ato vepra penale, gjithsesi i ka kryer i njëjti kryerës në seri. Në bazë të lidhshmërisë së vendit të ngjarjes, analizës së gjurmëve që janë lënë nga kryerësi i panjohur, pa marrë parasysh dhe komponentin kohore përpilohen versione për hapësirën jetësore të kryerësit. Në këtë fazë të analizës geoforenezike bëhet përpjekje të rindërtohet rruga e lëvizjes së vrasësit dhe të viktimës para veprës penale, si dhe lëvizja e vrasësit pas kryerjes së aktit penal. Bëhen përpjekje maksimale për përpilimin e të gjitha drejtimeve rrugore të të gjithë personave të përfshirë në veprën konkrete penale. Në analizë futen edhe të dhëna për kryerësit e regjistruar për vepra të ngjashme penale që jetojnë në hapësirën konkrete përpilohet lista e të dyshuarve, përcaktohen territoret në të cilat duhet të përfshihen edhe qytetarët për të dhënë ndihmë dhe për të grumbulluar informacionet e nevojshme. Me profilizimin gjeografik veprimtaria operative merr karakter optimal kështu që

përcaktohet vendi ku duhet të ndiqet kryerësi. Me zbatimin e kriterëve shkencore zvogëlohet efekti i rastësisë i pasigurisë në ndjekje ndaj tij. Suksesi i metodës vlerësohet në çdo rast konkret në bazë të raportit ndërmjet zonave të përgjithshme të përfshira me sulme kriminale dhe sipërfaqes së zonave që janë me shkallë më të lartë vërtetësie, të vlerësuara si zona prej ku duhet të nisë ndjekja. Nëse përqindja është më e vogël dhe nëse regjioni i locuar është karakterizuar me numër më të vogël, atëherë më tepër profilizimi gjeografik në masë më të madhe është i përqendruar (optimal). Me zbulimin e kryerësit merret vërtetësia përfundimtare për suksesin e profilizimit në rastin konkret.

Qëllimet e profilizimit gjeografik janë: bërja e analizës dhe zbulimi i rregullave dhe ligjshmërive në zgjedhjen e objektit të sulmit, krijimin e versionit për territorin në kuadër të të cilit duhet të kërkohen kryerësit potencial për të ndërmarrë aktivitete të veçanta operative (vëzhgim i fshehtë⁶¹, kurthe, legjitimime⁶², biseda informative etj.). Me analizën e drejtimeve rrugore përpilohen versione për dëshmitarë të panjohur të cilët kanë pasur mundësi të vërejnë rrethana të caktuara me rëndësi për veprimet operative dhe menjëherë gjurmohen ato. Metoda zbatohet edhe për shkak të parashikimeve të ardhshme të sjelljes kriminale të kryerësit që mund të vërehen drejtimet e mundshme të lëvizjes dhe të sulmit dhe të bëhet orari i drejt dhe koncentrimi i forcave

⁶¹*observimi i fshehtë* paraqet vëzhgim sistematik, të stacionuar ose të lëvizshëm optik ose akustik të personave, sendeve dhe vendeve, ndërsa përbëhet nga mbledhja dhe fiksimi i fakteve në mënyrë të përkohshme ose të vazhdueshme diskrete (fshehtas) të rëndësishëm për të zbuluar dhe për të penguar veprën penale.

⁶²*Legjitimimi* paraqet veprimin zyrtar që e ndërmarrin nëpunësit policor, për të marrë të dhëna dhe për të verifikuar identitetin e qytetarëve. Legjitimimi mund të ndërmerret vetëm kur është në pyetje kryerja e detyrës zyrtare. Identifikimi i personave verifikohet duke parë letrën e njoftimit dokumentet e udhëtimit, dhe dokumente tjera valide me fotografi të pronarit, me vulë dhe nënshkrim nga organi kompetent, sikurse janë leja e vozitjes (patenti) librezat e nxënësit, indeksi, legjitimacioni zyrtar ose ushtarak etj. Përveç dokumenteve, kur është në pyetje vetëm legjitimimi, identiteti i qytetarit mund të bëhet edhe nëpërmjet njerëzve që e njohin.

policore, për kapjen e tij ose preventivën e kryerjes së ardhshme të akteve penale.

Ekzistojnë shumë hulumtime empirike anembanë botës edhe për raste të llojllojshme të veprave penale serike (vrasje serike, përdhunime dhe të gjitha llojet tjera të dhunës, vjedhja e automobilave etj.), të cilat vë në dukje faktin se ekziston lidhje ndërmjet vendit të jetesës dhe lokacionit ku është kryer akti penal. Zgjidhja e objektit të sulmit nuk është e rastësishme dhe shpeshherë tipizohet me disa karakteristike gjeografike. Rregullisht ky është kushtëzuar në një farë mase me strukturën hapësinore (drejtimet rrugore, si dhe objektivat dhe ato që dalin nga këto objektiva të hapësirës jetësore të kryerësit dhe drejtimet e lëvizjes), shkalla e rrezikut për kryerjen e veprës penale, dobia që pritet, si dhe mundësia e të shënuarit dhe të zgjedhurit të viktimave apo të qëllimeve të përshtatshme. Thënë më thjeshtë, kriminelët seria kërkojnë objekte për sulm në ambiente që i kanë të njohur dhe më shpesh në afërsi të vendit të jetesës (ose të punës). Megjithatë, është vërejtur se ekzistojnë edhe distanca të caktuara ndërmjet banesës së kriminelit dhe objektit të sulmit. Më shpesh shmangen sulme ndaj objektit në afërsi të drejtpërdrejtë të lokalit të jetesës (frika nga njohja), kështu që ekziston e ashtuquajtura zona e sigurisë (tampon) rreth banesës së kriminelit. Duke u larguar nga banesa e kriminelit rritet potenciali i përcaktimit të objekteve të veçanta të sulmit. Hulumtimet tregojnë se kriminelët profesional, rëndomë, përcaktohen për objekte të sulmit të cilat gjenden në një ose më shumë lokacione në qytet. Sipas rregullit zgjedhin pjesët e qytetit që i njohin mirë dhe të cilët gjenden rëndomë në marshutën e tyre, për shembull duke shkuar në punë, në rekreim, rruga për në shtëpi të tij ose te ndonjë i njohur etj. Vrasësit e shumëfishtë kanë zgjedhur vende për fshehjen e viktimës pikërisht në këto lokacione. Këto njohuri

japin baza të mjaftueshme për përpilimin e listës së aktiviteteve kriminale dhe planifikimin e punëve operative policore.

Te profilizimi gjeografik dallohen analizat kuantitative dhe kualitative. Qasja kuantitative në analizë bëhet në bazë të zbatimit të softuerit kompjuterik me allogaritëm ⁶³ të zhvilluar special. Metoda kualitative e profilizimit bazohet në analizat kualitative sipas rasteve të veçanta kriminale dhe hartohet lista e lëvizjes së kryerësit.

Analiza deskriptive dhe analitike e kartave gjeografike kriminale –gjeografike. Analiza deskriptive (përshtkruese) e mapës së kriminelit nuk mjafton por vetëm vë në dukje faktin se aktet kriminale grupohen sipas rajoneve të caktuara. Ajo vetëm vë në dukje lokacionet në qytet ku kryesisht ndodhin vjedhje, vjedhje të automobilave, shitet një farë lloj droge ose mund të locohen rajone me shkallë të lartë të dhunës. Karta deskriptive mund ti përgjigjet pyetjes “ku” dhe “kur”, por jo edhe pyetjes “pse”. Vetëm përgjigjja ndaj pyetjes “pse” mund të bëjë të mundshme që praktikantët të gjejnë informacionet e nevojshme për zbatimin e masave efikase për gjetjen e përgjigjes më të mirë të kriminalistit, me ç’rast mund të zvogëlojë përqindje e suksesit dhe përfundimet e gabuara si dhe shpërndarjen e panevojshme të forcave dhe aktiviteteve policore. Kërkesa për ti dhënë përgjigje pyetjes “pse” disa rajone janë të goditur nga vepra të caktuara kriminale, mund të vë në dukje kushtet dhe shkaqet e krimit dhe të japë indikacione për krijimin e programit preventiv. Kështu, analiza analitike është mapë e fazave që vazhdojnë menjëherë për përpilimin e mapës deskriptive, ndërsa kjo kërkon sigurimin e të dhënave plotësuese nga baza të tjera dhe analizë të mëtejshme për

⁶³ Algoritmi është model i aktivitetit dhe mënyrës taktike. Shkenca e kriminalistikës ka për detyrë të përhershme të gjejë algoritme për rritjen e efikasitetit të menaxhimit të procesit të zbulimit të veprave penale dhe të kryerësve të tyre dhe të kushteve të situatave të krizës.

të kuptuar trendin dhe modelin të lidhur me veprën kriminale. Karta gjeografike analitike nënkupton edhe ekspertë të aftësuar për tu bërë analizë, programe analitike kompjuterike, zbatim cilësor të hulumtimeve kriminologjike. Në këtë mënyrë realizohen mundësitë jo vetëm për përshkrimin e manifestimeve por edhe për parashikimin e rasteve kriminale dhe për orientimin e forcave dhe masave policore për tu dalë përballë zhvillimeve të parapara (orari i patrullimeve policore, themelimi i stacioneve policore, programe të parandalimit etj.).

Profilizimi gjeografik nuk mund “të zgjidhë” rastin për shembull të vrasjes. Kjo është një metodë me anë të së cilës në radhë të parë sigurohet një qasje plotësuese në hulumtimin shkencor të krimit. Kjo është vetëm një nga metodat e shumta speciale forenzetike që mund ti japin ndihmë të konsiderueshme në hetimin e akteve penale serike. Teknika geoforenetike mund të sigurojë perspektivë plotësuese e cila mund të ndihmojë gjatë zbatimi të veprimeve operative në hetimin e vrasjeve serike kur trupat e viktimave fshihen në një rajon më të madh gjeografik. Metoda mund të vë në dukje faktin se a i takojnë sekuencat e krimit të njëjtit seri, edhe kur policia përjashton një mundësi të tillë. profilizimi gjeografik mund të jetë i dobishëm edhe gjatë mbrojtjes së të akuzuarit në rast akuze për akte të kryera penale serike, ku vepra të caktuara të këtij seriali (ose të gjitha) nuk hynë në rrugën normale të lëvizjes së tij, të sjelljes dhe të jetesës. Kjo metodë dhe teoria në të cilën mbështetet është në fazë fillestare të zhvillimit shkencor dhe nevojiten hulumtime të mëtejshme për të bërë testimin e validitetit të saj.

Profilizimi gjeografik është armë e fortë në punën e policisë, si sistem i pavarur ose në kombinim me sistemet që dalin nga veprat e veçanta penale – për shembull, sistemi VICLAS. Viclas mund të vë në dukje faktin se çka ka bërë kryerësi i

panjohur (ndërlidhje me veprat penale të mëparshme). profilizimi psikologjik mund të vë në dukje faktin se kush është kryerësi i mundshëm (karakteristikat dhe tipat personale, veçoritë e kryerësit të panjohur). profilizimi gjeografik mund të na orientojë drejt lokacionit se kur duhet të zhvillohet hetimi (vendi ku jeton ose qëndron përkohësisht). Karta gjeografike gjeografike e veprave penale të kryera është çelësi i cili nëse është dekoduar drejt, mund të vë në dukje drejtimet nga duhet të gjurmohet për kryerësin.

Shembuj në praktikë: policia në disa fusha ka gjurmuar hajnin e panjohur i cili ka sulmuar institucione financiare në qendër të Anglisë. Një burë pak i moshuar (i bardhë, ka bërë 32 hajni nga shtatori i vitit 1996 deri në qershor të vitit 1998). Bankat e sulmuara kanë qenë në vende të vogla ose në fshatra në një sipërfaqe prej 20 kilometra.

Me zbatimin e profilizimit gjeografik hetimi u orientua në një rajon prej një sipërfaqe prej 2,015 km. Në bazë të kësaj të dhëne me zbatimin e programit për bashkëpunim me popullsinë, u zbulua kryerësi (i dënuar edhe më parë për lloj të këtillë të veprës penale), i cili ka jetuar në një fshat në rajonin që ishte profilizuar me profilin gjeografik si zonë objektive.

Operacioni “Luniks” paraqet gjuajtjen më të madhe të njeriut që nga rasti i përdhunuesit të Jokshirit. Policia ka pasur ADN dhe gjurmë të pjesshme të gishtit. ADN e kryerësit të panjohur nuk ka qenë e regjistruar në bazën kombëtare të ADN-së, ndërsa fragmenti i gjurmës së gishtit ka qenë shumë i vogël për të bërë identifikimin me zbatimin e AFIS.⁶⁴ Analiza kriminalistike sugjeroi se kryerësi edhe më herët ka bërë akte

⁶⁴ AFIS është sistem për përpunim automatik të shenjave të gishtave. Me instalimin e këtyre sistemeve praktikisht ndërpritet nevoja e ndjekjes së evidencave të deritashme monodaktiloskopike.

penale, vjedhje dhe mashtrime por jo edhe përdhunime. Rajoni ku është kryer vepra penale përfshinte disa milion njerëz. Në bazë të profilizimit gjeografik u ngushtua sipërfaqja ku janë kryer vepra penale. Veprimi operativ u fokusua në disa rajone të cilat në bazë të potencialit kanë qenë vende të jetesës së kryerësit (3.3 për qind e popullsisë së përgjithshme ku kanë ndodhur veprat penale). Pastaj është krahasuar shenja fragmentare e gishtit me të gjitha gjurmët e hajnave dhe mashtruesve të regjistruar në këto rajone. Identifikimi pozitiv i gjurmëve të gishtit është bërë në stacionin tjetër policor të listës. Ekspertiza e ADN-së vërtetoi identitetin e personit që i ka bërë përdhunimet serike.

Rastet e përdhunimeve që ka ndodhur në të ashtuquajturën “rrugë e gjelbër” në Knohvile – Tenesi në fakt u zbardhën duke zbatuar teorinë e informimit hapësinor (cognitive spatial awareness theory). Karta gjeografike e përpiluar tregoi se gjashtë kriminel të regjistruar seksual jetojnë afër vendit të përdhunimit. Policia i gjeti fotografitë e tyre dhe i vendosi njëra pranë tjetrës. Dy prej viktimave menjëherë e identifikuan të njëjtin përdhunues seksual që ka jetuar afër vendit të sulmit.

4.1.5. Profilizimi gjeografik me zbatimin e sistemit informativ gjeografik

Hartat e librarive dhe legjendat e tyre nuk janë të përshtatshme për profilizim sepse mund të paraqitet vetëm një material i limituar. Paraqitje e shumë hollësive nënkupton mbingarkesë dhe pasqyrë jo të drejtë. Nga ana tjetër është shprehur edhe nevoja për aktualitet. Hartat tradicionale vështirë të plotësohen dhe të aktualizohen. Këto probleme zgjidhen me zbatimin e kompjuterëve dhe të teknikës bashkëkohore të profilizimit gjeografik. Programet kompjuterike në bazë të disa

veprave penale mundet nga vet vendi i ngjarjes (rezultati është më i saktë nëse ka së paku pesë), ti parashohin lokacionet e mundshme të banimit të kryerësit të panjohur. Ata shfrytëzojnë modele matematikore dhe funksione ekspozuese dhe në bazë të llogarive të lokacioneve të vendeve të ngjarjes dhe distancës japin të dhëna për vendin e mundshëm të banimit të kryerësit të panjohur. Programet përbëhen nga skema dhe paraqitje tredimensionale rapide me ngjyra të ndryshme që klasifikohen me shkallë të ndryshme të validitetit për lokacionet e mundshme të banimit të kriminelit të panjohur. Rëndësia e profilizimeve gjeografike qëndron në atë se e ngushton qarkun e lokaliteteve të mundshme ku duhet të bëhen hetime policore nga dera në derë ose të zbatohet në mënyrë masive testimi i ADN-së apo i masave të tjera operative.

Mënyra e funksionimit të sistemit. Sistemi informativ gjeografik (SIG) përbëhet nga këto komponentë: harduer, softuer dhe të dhëna. Për nevojat e harduerit dhe për punën e softuerit sot nevojiten aftësitë e standardeve bashkëkohore. Pjesa më e rëndësishme e sistemit të të dhënave SIG i integron të dhënat digjitale hartografike që lidhen me një hapësirë nga burime të ndryshme ekzistuese, si dhe të bazave policore të të dhënave ashtu edhe të burimeve të tjera relevante jo policore. Për shembull, në pajtim me detyrat e dhëna në hartë në mënyrë kompjuterike paraqiten të dhënat për shkolla, stacione, automatëve për para, rrugët e komunikacionit etj. Për kuptuar funksionimi i këtyre sistemeve duhet përmendur dy parime. Tipari themelor esencial i SIG është mundësia që të dhënat e ndryshme ti radhisë sipas shtresave dhe ti tregoj në një kartë themelore (për shembull, karta topografike e një komune) sipas kriterëve të dhëna më parë. E ashtuquajtura teknik e paraqitjes nëpërmjet shtresave (leere) mundëson që të dhënat e burimeve të

ndryshme të paraqiten dhe të krahasohen në relacione të ndërsjella. Korrelacionet e mundshme vizuale paraqiten, analizohen dhe në mënyrë statistike llogariten. Elementi tjetër qendror i SIG është aftësia e gjeokodimit, domethënë të dhënat e ndryshme të një hapësire të caktuar, siç janë, adresa, numrat e telefonave, lokalet e objekteve të veçanta, të mund të kodohen dhe të paraqiten në kartë, pa marrë parasysh faktin se a janë të njëjtë apo të burimeve të tjera ose të bazave të të dhënave.

Mundësia për zbatimin e praktikës policore: - sistemi mundëson paraqitjen e kriminalitetit në tërësi ose në lloje të veçanta në kohë dhe hapësirë të caktuar, paraqitjen e vatrave të krimit, lëvizjen e trendëve kriminale, paraqitjen dhe analizën e veprave penale serike (në bazë të karakteristikave të njëjta ose të ngjashme). Në bazë të kësaj është e mundshme të supozohet zhvillimi i kriminalitetit. Me zbatimin e llogaritjes së validitetit mund të simulohen modele të ndryshme dhe supozohen pika e ardhshme të sulmit. Nëpërmjet analizës të karakteristikave të vendit dhe të kohës së kryerjes së aktit penal vlerësohen edhe faktorët e rrezikut, planifikohen programet preventive me pjesëmarrje të qytetarëve në to. Në bazë të këtyre projekteve bëhen analiza strategjike të një varg veprave penale, të trendëve, shpeshtësisë së veprave penale, përcaktohen pikat qendrore të llojeve të veçanta të krimit. Në bazë të të dhënave strategjike të fituara përpilohen edhe analizat operative në raste të veçanta (për shembull, ndërlikohen pikat ku është kryer vepra penale me adresa të njohura të banimit të kriminelëve të regjistruar dhe të personave të dyshuar), ose për lloje të veçante të veprave penale sipas karakteristikave të mënyrës së kryerjes apo të karakteristikave të tjera (për shembull në rast vjedhje, marrjes së automjetit, hajni nëpër banesa).

Dobia e zbatimit të sistemit SIG. – Në bazë të këtij sistemi është e mundshme të verifikohet orari i përqendruar i kriminelit në periudha të ndryshme (për shembull, ditor, javor, mujor). Paraqitjet vizuale: lehtëson analizën; planifikim të masave preventive policore; mundëson koordinimin më të lehtë të forcave të ndryshme policore; krijimin e parashikimeve kriminalistike-strategjike por edhe operative. Pasqyra e karakteristikave kohore dhe hapësinore mundëson planifikimin e masave policore në një periudhë afatshkurtër, por edhe planifikim afatgjatë të masave strategjike policore, për shembull, hapjen e stacioneve policore.

4.2. MENDIME KRIMINALISTIKE

Planifikimi i procedurës penale dhe para hetimore është veprimtari e ndërlikuar që nënkupton proceset specifike intelektuale (aftësi për mendime kriminalistike), aktivitete të organizuara, si dhe përvetësimi i metodave dhe mjeteve kriminalistike-taktike dhe teknike. Në esencë që në fillim të planifikimit vjen në shprehje veprimtaria intelektuale, kështu që është e domosdoshme të vihen në dukje disa tipare të saj.

Mendimi kriminalistik është veprimtari e ndërlikuar intelektuale që kushtëzohet nga detyra që kriminalisti e ka para vetes gjatë zbardhjes së aktit konkret penal. Veprimtaria kriminalistike ka karakter të theksuar konfliktual (kryerësi i veprës penale i fsheh gjurmët, bën fingim të rrejshëm, dëshmitarët

mund të mashtrojnë), shkalla e pasigurisë dhe e mos njohjes në aspekt të fakteve dhe të natyrës së aktit në fillim të veprimit operativ është e madhe (për shembull, tek veprat penale me kryerës të panjohur). Veprimi kriminalistik karakterizohet me karakter të theksuar problematik.

Veprimtaria kriminalistike në esencë, është proces i njohjes që nis nga e panjohura dhe nga e pasigurta tek e njohura dhe e sigurta, me zgjidhje të domosdoshme fillestare të një varg situatash problematike, me ç'rast njohuria duhet të zhvillohet në pajtim me normat e përcaktuara ligjore.

Duke marrë parasysh këtë, mendimi kriminalistik i ka këto tipare: 1) *paraqet njohurinë e veprimit* që nis me baza të dyshimit, me ç'rast karakterizohet me qasje kritike dhe vet kritike të zgjidhjes së problemeve. Të menduarit kriminalistik paraqet aftësinë e formimit të modeleve intelektuale (modele të të menduarit) dhe prezantim ideor figurativ të varianteve të ndryshme (versione). Ndonjëherë mbështetet në nxjerrjen intuitive të konkluzioneve. Nënkupton aftësinë e të vërejturit të hollësive dhe të intësive; 2) *kategoritë logjike* vijuese ndërtojnë bazën e të menduarit (të menduar analitik dhe sintetik, aftësi për të bërë kombinimi, abstraksione, ndërlidhje, shfrytëzim të analogjisë dhe të përvojës së mëparshme gjatë zgjidhjes së rasteve të reja); 3) *para dispozitat psikologjike* të të menduarit kriminalistik përbëjnë aftësimin për të kuptuar emocionet psikologjike të tipave të ndryshëm të delikuentëve me mundësi për të parashikuar reagimet dhe sjelljet e tyre të ardhshme (aftësia e empatisë⁶⁵ dhe të menduarit reflektiv); 4) *paradispozitat*

⁶⁵ Termi empati lindi në estetikë i cili përshkruan mundësinë e kënaqjes së vëzhguesit me natyrën dhe me veprën letrare. Sipas kësaj analogjie shfrytëzohet edhe në psikologji, ku tregohen kënaqësitë e vëzhguesit me botën psikike të personit tjetër. Për te patur aftësi për empati është shumë me rëndësi gjatë zhvillimit të bisedës, dëgjimit të prokurorit dhe dëgjimit të dëshmitarit. Kjo mundëson që personi zyrtar të vë raport të drejtë dhe të

sociale-psikologjike janë mënyra e komunikimit (aftësia për të dhënë dhe për të mbajtur kontakte me kategoritë të ndryshme sociale, nacionale, të seksit dhe të moshës së atyre që hulumtohet), pasja e inteligjencës sociale, mundësia për reagim të shpejtë në situata të reja, aftësia për të bashkëpunuar në punë ekipore; 5) *karakteristikat e motivimit dhe të vullnetit* krijojnë dëshirën e përhershme për të njohur të panjohurën, për të njohur të vërtetën, puna të kryhet deri në fund, ambicie, këmbëngulja dhe qëndrueshmëria në punë; 6) *paradispozita morale* janë ndjenjat për drejtësi, objektivitet dhe paanshmëri; ndershmëria personale dhe profesionale, guximi, korrektësia në raportet me të nënshtruarit, të akuzuarit dhe të dyshuarit; mbajtja e premtimit.

Aftësia e të menduarit kriminalistik në disa segmente mund të zhvillohet dhe të merret vesh. Siç paraqet kushtin e domosdoshëm për planifikim dhe zbatim të suksesshëm të veprimtarisë kriminalistike në procedurën para hetimore dhe penale, është e nevojshme të punohet në formimin dhe kultivimin e tij. Baza në të cilin themelohet të menduarit kriminalistik është njohurit e modeleve teorike dhe instrumentet kriminalistike që i ka në disponim kriminalisti gjatë zbardhjes së lëndëve të ndryshme penale (taktike kriminalistike, taktika dhe metodat e zbulimit, zbardhjes dhe dëshmimit të llojeve të veçanta të veprave penale, përvoja solide profesionale). Kur do të bëhet një sintezë ndërmjet njohurive dhe përvojës, me karakteristikat për të cilat u bë fjalë më lartë, fitohet një bazë solide për zbatim të suksesshëm të të menduarit kriminalistik në praktikë. Me rëndësi të madhe për kultivimin e të menduarit kriminalistik është edhe zgjidhja e detyrave kriminalistike praktike. Të studiuarit e ngjarjeve nga praktika (qofshin ato të huaja, të vendit apo të jashtme) si dhe të

zhvillojë strategjinë më adekuate të komunikimit me personin me të cilin e zhvillon bisedën, përkatësisht të cilin e dëgjon.

lexuarit e romaneve të mira kriminalistike (në radhë të parë të atyre klasike).

4.3. ZBATIMI I PARASHIKIMIT GJATË VEPRIMIT SISTEMATIK DHE TË PLANIFIKUAR TË POLICISË

Parashikimi i zhvillimit të manifestimeve të sigurisë, posaçërisht në këtë fazë të zhvillimit shoqëror të bashkësisë shoqërore, paraqet punën shumë të rëndësishme si në teori ashtu edhe në praktikë të të menaxhuarit. Praktika e udhëheqjes në të gjitha fushat (kështu edhe në polici) sot është e paparamenduar pa parashikime shkencore, përkatësisht prognozimeve. Parashikimet për të ardhmen si informacione adekuate për të, që shprehen nëpërmjet prognozës, janë element i domosdoshëm i menaxhimit.

Një nga qëllimet e përgjithshme të parashikimit është përcaktimi i alternativave të ndryshme në zhvillimin e të ardhshmes si bazë e fuqishme për marrjen e vendimeve në lidhje me ndryshimet e sigurta si në sistem të menaxhimit, ashtu edhe në qarkun përreth. Kjo posaçërisht ka të bëjë me nevojat gjithnjë në rritje, që imponohen në sistemin e planifikimit shoqëror, veçanërisht në planifikimin dhe parashikimin shoqëror të proceseve që zhvillohen në shoqëri dhe identifikimi i atyre problemeve që lidhen me rreziqet potenciale, në radhë të parë me sigurinë e brendshme të shteteve.

Parashikimi shkencor, si element i patjetërsuar gjatë realizimit të planit të vendimeve të parapara, në periudhën shoqërore të kaluar nuk është trajtuar si pjesë përbërëse e menaxhimit. Megjithatë, rrethanat që lidhen për ndërtimin e shteteve demokratike juridike, na shpie në faktin se roli i parashikimit jo vetëm që është rritur, por është bërë pjesë e domosdoshme e menaxhimit. Sot, ai me të drejtë shihet si

funksion i pavarur i menaxhimit. Funksioni i parashikimit është në lidhje me funksionet tjera të menaxhimit, në radhë të parë me ato që janë orientuar ndaj të ardhmes siç janë: projektimi, programimi dhe planifikimi.

Procedura e parashikimit mund të ndahet në shumë periudha të ndërlidhura ndërmjet veti, me të cilat zgjidhen obligime konkrete të pavarura, karakteristike për nga mënyra dhe metodat specifike. Çdo njëra nga këto periudha është e domosdoshme që të përcaktojë qëllimin dhe detyrat e parashikimit, e pastaj edhe intervalet kohore të përcaktimit të detyrave deri në momentin e fillimit të ngjarjes ose manifestimit të parashikuar. Pastaj, nis mbledhja dhe përpunimi i informacioneve që e karakterizojnë gjendjen e objektit të prognozimit në të kaluarën dhe ndryshimet në të ardhmen. Në fazën e verifikimit të formave të konkludimeve dhe të provave, vjen marrja e vendimit për zgjedhjen e metodave dhe të përpunimit të algoritmeve në zgjidhjen e parashikimit. Për përpunimin e parashikimit shërbeheni rëndomë me metodat kuantitative. Periudha përfundimtare finalizohet me përpunimin prognozës, me alternativat e mundshme: *pesimiste*, *optimiste dhe realiste*. Në fund vjen vlerësimi i validitetit të prognozës nëpërmjet verifikimit, përkatësisht përpunimit të prognozës në variante të ndryshme dhe me ndihmën e metodave të ndryshme. Me kusht që rezultatet e fituara në këtë mënyrë të jenë në kufi të normales dhe të së lejueshmes, verifikohen si të përdorshme dhe e kundërta.

Sipas Martin Kadorik (Sllovaki) në linjat e programimit bien sa vijon: parashikimi i ndryshimeve të jashtme, përfshirë parashikimet kriminologjike (ndryshimet në evidencën penale);

Prognozat organizative në menaxhim;

Parashikimet e situatave konkrete në menaxhim dhe

Parashikimet në fushën e edukimit dhe arsimimit të policëve.

Parashikimi i ndryshimeve të jashtme, sipas këtij autori përfshinë ekonominë, urbanizmin, numrin e banorëve dhe migracionin e tyre, numrin e të papunëve dhe të strukturës së tyre dhe disa tregues të tjerë në kufijtë e atij rajoni. Nëse kemi në diskonim të dhëna, të cilat e bëjnë prapavijën e parashikimit, vetëm në këtë rast jemi në gjendje të përpunojmë prognoza të thella të domosdoshme për MPB.

Parashikimi i menaxhimit të organizuar në organet e MPB-së fokusohet në përcaktimin e qëllimeve dhe detyrave optimale, të cilat në të ardhmen mund të paraqiten në lidhje me faktorët kriminologjik ekonomik, shkencor-teknik, demografik. Parashikimi i menaxhimit organizues është i lidhur me veprimtarinë kriminologjike dhe planifikuese në organet e MPB. Lidhja midis tyre, sipas Kadorik, shprehet në këtë mënyrë: parashikimi kriminologjik (përcaktimi i trendëve në strukturën dhe dinamikën e veprimit penal) – parashikimi i menaxhimit organizues – planifikimi dhe relacionet e masave në luftë kundër veprimeve kriminalistike.

Parashikimi në zhvillimin e sistemit të menaxhimit në organet e MPB dhe parashikimi i situatave në interes të marrjes së masave optimale menaxhuese janë pjesë shumë e rëndësishme në procesin e parashikimit të menaxhimit të organizuar dhe të planifikuar. Përsosja e sistemit të menaxhimit në organet e MPB nënkupton përmirësim cilësor të të gjitha elementeve të këtij sistemi dhe atë:

- Strukturat organizative të cilat duhet të përpunohet në atë mënyrë që do të jenë fleksibile dhe do të jenë në gjendje të njohin dhe të zgjidhin veprimin e ardhshëm kriminal. Qëllimi përfundimtar i

strukturës organizative të tillë të shërbimit policor është që sa më shumë tu afrohet qytetarëve dhe të ketë pajisje materiale dhe teknike, në radhë të parë sisteme bashkëkohore të informimit etj,;

- Përsosje e procesit të informimit, përkatësisht mbledhjes dhe analizës së informacioneve dhe
- Sistem i ndërlidhjes me njësitë organizative në MPB, por edhe të organeve dhe enteve të tjera që marrin pjesë në ndjekjet penale.

Sipas kësaj, parashikimi i situatës, me qëllim të marrjes së vendimeve optimale për menaxhim është i domosdoshëm.

Sipas dr. Peter Nikush (Sllovaki), struktura organizative duhet ti plotësojë këto kushte: të krijojë kushte për faktin, se është i mundshëm vetëm ai aktivitetet, i cili është në pajtim me dispozitat aktuale juridike, të cilat janë të ratifikuara me marrëveshje ndërkombëtare dhe të krijojë kushte për implementimin e të drejtave të Bashkimit Evropian dhe të zbatimit të tyre në praktikë; të jetë në pajtim me organizimin territorial të drejtorisë;

- Të reagojnë shpejtë dhe në mënyrë shembullore ndaj ndryshimeve në fushën e sigurisë;
- Të krijojë kushte të mira për pranimin e objekteve që participojnë në formë të bashkëpunimit ose të koordinimit;
- Të jetë në gjendje të ndikojë pozitivisht ndaj rrethit;
- Të orientohet drejt transformimit të nëpunësve shtetëror dhe të policisë, nga organi i pushtetit në organ në shërbim të popullit;
- Ti lë vend aspektit parandalues në krahasim me atë represive;
- Të sigurojë dhe të garantojë aktivitetin e policisë të liruar nga varshmëria politike;

- Të jetë në gjendje ti mënjanojë faktorët problematik në sistemin e vet, të cilët kanë lindur me ndikimet negative të rrethit ndaj sistemit;
- Të jetë në gjendje mjetet që i ka në disponim ti shpërndajë në mënyrë optimale dhe funksionale;

Të orientohet drejt decentralizimit të aktiviteteve dhe transferimit të autorizimeve nga niveli qendror në atë regional dhe

Të jetë stabil në mënyrë adekuate.

5. PARASHIKIMI I KRIMINALITETIT

Parashikimi në lidhje me kriminalitetin, që mbështetet në kushte të ndryshimeve të theksuara shoqërore janë jo aq valid në raport me ato të kushteve të sigurisë stabile. Me ndihmën e metodës së ekstrapolimit⁶⁶ presim për shembull që rritja e rëndësisë së kompjuterëve në të ardhmen të shkaktojë rritjen e kriminalitetit kompjuterik.

⁶⁶ Eksploporimi është metodë shkencore në teorinë kriminalistike që gjen zbatim në parashikimin kriminalistik për ndryshimet strukturore dhe strukturale të mënyrave të kryerjes së disa veprave penale, të cilat priten të kryhen në një kohë të caktuar dhe në një vend konkret, me parashikim të faktorëve që ndikojnë në paraqitjen e tyre dhe me projektimin e masave në fushën e profilimit kriminalistik.

Çdo ekstrapolim parasheh se do të vëzhgohet procesi edhe në të ardhmen, do të zgjasë tepër ashtu që do të shërbejë si bazë për të nxjerrë gjykime të ndjekjes. Megjithatë, mund të ndodh supozimi, për shkak të ndikimeve faktorëve të ndryshëm të paparashikuar të mos verifikohet në të ardhmen. Prandaj, është e domosdoshme të bëhet dallimi ndërmjet prognozës nëpërmjet ekstrapolimit dhe prognozave programore. E para paraqet pandryshueshmërinë e mekanizmit dhe të ligjshmërisë së menaxhimit të dhëna me procese, edhe pse menaxhimi mund ti nënshtrohet ndryshimeve. Prognoza programore, përveç prognozës me ekstrapolim nënkupton edhe ndryshimet e pashmangshme të mekanizmit dhe të ligjshmërisë së menaxhimit, ashtu që gjatë procesit të japë orientime konkrete. Droje reale gjatë formulimit të prognozës programore dalin nga fakti se ato shpeshherë paraqiten në mënyrë jo adekuate. Kjo ka të bëjë aq më shumë se nuk merren parasysh dy elemente: 1) njohja solide e kushteve dhe kufizimi i aftësive për të menaxhuar proceset konkrete dhe 2) dallimi preciz ndërmjet qëllimeve të programeve dhe rezultateve të realizuara.

Parashikimin e kriminalitetit e bën çdo tezë e cila deklarohet në lidhje me aktet penale të ardhshme, dhe që ka dalë si përfundim i përshkrimit të mëparshëm të këtyre manifestimeve (masë statistikore) dhe rregullit që përcakton relacionin e radhitjes së gjendjeve që e definojnë këtë manifestim. Kështu, parashikimi i kriminalitetit mund të ndahet në dy grupe themelore:

- Parashikimi i kriminalitetit primar (vepra penale që bëhen për herë të parë) dhe
- Parashikimi i kriminalitetit të përsëritur (vepra penale që i kanë kryer ato të cilët kanë qenë të dënuar edhe më parë).

Çdo njëri nga këto grupe mund të ndahet në fushë të ndryshme të parashikimit. Kështu disa teza të veçanta mund të

merren me: 1) strukturën e ardhshme të kriminalitetit, 2) me shkaqet e shumta të manifestimeve dhe dukurive kriminale, 3) efikasiteti i pritur nga mjetet e parandalimit të kriminalitetit, 4) të përmasave të popullatës kriminale të të moshuarve, 5) të popullatës të kryerësve të të mitur etj.

Në formën e pavarur të parashikimit të kriminalitetit bie edhe parashikimi individual i sjelljeve kriminale.

Parashikimi i krimit të përgjithshëm mund të bëhet vetëm nëse në perspektivë të afërt (kjo është një periudhë prej 3 deri 5 vjetësh) situata politike dhe ekonomike nuk i nënshtrohet ndryshimeve esenciale. Sipas kësaj, vëmendjen tonë e meritojnë parashikimet afatshkurtra. Parashikimet në afate të gjata për organet e ndjekjes dhe të jurisprudencës përdoren shumë pak. Një shembull i mirë për këtë është Republika e Maqedonisë, në mënyrë analogjike me këtë edhe vendet e ish-socializmit realist. Në fakt, viteve të fundit të shekullit 20-të shteti federativ – RSFJ pësoi shumë ndryshime. Luftërat e zhvilluara pothuajse në të gjitha shtetet federale, konfliktet lokale dhe recesioni ekonomik shkaktuan përhapjen e varfërisë, migracionit të popullsisë, që të gjitha së bashku nuk krijuan kushte adekuate për përpunimin e parashikimeve të veçanta të kriminalitetit. Kjo periudhë pati ndikim të madh në dinamikën dhe në strukturën e krimit në shtetin tonë. Kryerësit e veprave penale gjithnjë e më shumë i shfrytëzonin ndryshimet politike dhe ekonomike për të realizuar qëllimet e tyre të errëta. Dobësia e aparatit shtetëror, jo konsekuenca për tu përshëndetur njëherë e përgjithmonë me mbeturinat e të së kaluarës, zbraznit në sistemin juridik, çrregullimet shoqërore e sociale, ndikuan fuqishëm në rritjen e kriminalitetit në përgjithëso. Si pasojë e gjithë kësaj është edhe ekspansioni i krimit të organizuar.

Përkundër gjithë kësaj, MPB e RM-së nuk përpunon parashikime të kriminalitetit. Si rezultat i kësaj shtrohet pyetja: realizimi i nevojave të këtilla a kërkon organizim të hulumtimeve shkencore, të lidhura me parashikimin e kriminalitetit?

Në shumë shtete të Evropës, hulumtimet që lidhen me parashikimin e kriminalitetit, janë në kujdes të drejtpërdrejtë të këtyre shteteve.

Pyetje për studentët:

- 1. Shpjego nocionin e planifikimit kriminalistik.*
- 2. Shpjego parimet e planifikimit kriminalistik.*
- 3. Cilët janë qëllimet e planifikimit kriminalistik?*
- 4. Çfarë paraqesin “pyetjet e arta” në kriminalistikë?*
- 5. Shpjego pyetjen – çka ndodhur.*
- 6. Shpjego pyetjen – kush e ka kryer aktin penal.*
- 7. Shpjego pyetjen – kur është kryer akti.*
- 8. Shpjego pyetjen - ku është kryer akti.*
- 9. Shpjego pyetjen – si është kryer akti.*
- 10. Shpjego pyetjen – me çka është kryer akti.*
- 11. Shpjego pyetjen – me cilin është kryer akti.*
- 12. Shpjego pyetjen – pse është kryer akti.*
- 13. Shpjego pyetjen – cilin ose çka ka sulmuar kryerësi i veprës penale.*
- 14. Ç’është nocioni version?*
- 15. Përkufizo nocionin version kriminalistik?*
- 16. Cilat lloje të versioneve ekzistojnë sipas qarkut të shpjegimit të fakteve?*
- 17. Cilët janë versionet tipike dhe në çfarë bazash parashtrahet?*
- 18. Çfarë versione ekzistojnë sipas kohës ku bien rrethanat e supozuara?*

- 19. Ç'është versioni hetues?*
- 20. Si ndahen versionet sipas subjekteve të cilat i mbarështojnë?*
- 21. Si ndahen versionet sipas lëndës së të dëshmuar?*
- 22. Shpjego nocionin profilizim.*
- 23. Në çfarë faza kalon analiza e gjendjes faktike dhe procedura e profilizimit?*
- 24. Cilat janë llojet themelore të profilizimit?*
- 25. Shpjego zbatimin e profilizimit.*
- 26. Shpjego sistemin viclas – si mbështetje kompjuterike të profilizimit.*
- 27. Shpjego nocionin dhe zbatimin e profilizimit gjeografik.*
- 28. Çfarë paraqet teknologjia SIG?*
- 29. Çfarë paraqet të menduarit kriminalistik?*
- 30. Çfarë paraqet parashikimi gjatë veprimit sistematik dhe të planifikuar të policisë?*

KREU VI

INDICJET DHE METODAT INDIKATIVE GJATË ZBULIMIT DHE ARGUMENTIMIT TE KRIMIT

1. NOCIONI, BURIMET DHE LLOJET E INDICJEVE

Në literaturë mund të hasen një numër i madhe definicionesh të ndryshme pikëpamjesh dhe idesh për vlerën valide dhe për nocionin “*provë e tërthortë*” përkatësisht *indicet*. Në këtë rast nuk do të lëshohemi në debatin teorik rreth ideve të këtilla, në radhë të parë, për shkak të qëllimit të këtij punimi.

Në esencë mund të thuhet “*indicet*” (bazat e dyshimit) paraqesin fakte të cilat vënë në dukje ekzistencën ose mos ekzistencën e veprës penale apo të lidhjes më të afër ose më të largët të kësaj vepre me ndonjë person.

Në bazë të fakteve të këtilla e mbështesin dyshimin se është kryer vepër penal dhe se një person i caktuar është kryerës ose pjesëmarrës në këtë akt. *Indicet*, padyshim kanë rëndësi të madhe gjatë mbledhjes së provave për aktin dhe për kryerësit.

Karakteristikë themelore e indiceve është fakti se forca e tyre dëshmuese nuk qëndron vetëm në to, por është në bashkësi me faktet tjera, me ç’rast gjatë zbatimit të tyre me rëndësi është të verifikohet pikërisht lidhja e një fakti me tjetrin.⁶⁷

Indicet paraqesin fakte të llojllojshme të cilët mund të ndahen në disa grupe (sipas rrethanave drejt të cilave është orientuar veprimtaria kriminalistike, sipas natyrës, sipas kohës së kryerjes, sipas vlerës).

Sipas *burime më të shpeshta të indiceve* për krim të kryer mund ti përmendim sa vijon: mbikëqyrje në dokumentacionin afarist; deklarata nga dëshmitarët; padi; bastisje e banesave,

⁶⁷ Hulumtimi i praktikës policore tregon se më shpesh bëhet fjalë për një grumbull provash të një rëndësie sporadike (të dorës së dytë) por siç e dimë, juridikisht nuk ka dallim ndërmjet këtyre provave në aspektin e vlerës së tyre njohëse; të dyja llojet (provat e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë) mund të shërbejnë barabar për verifikimin e fakteve në procedurë.

hapësira afariste e të tjera; bastisje e personave dhe mjeteve të transportit; gjetja e sendeve të kryerjes së veprës penale (armë, drogë, materie shpërthyes, dërgesa, fatura, deklarata doganore, mall etj.); ekspertizë (balistike, mekanoskopike, grafoskopike, mjekësia ligjore, financiare-materiale); evidencat operative kriminalistike; mbikëqyrjet; biseda me persona të dyshuar; kontrolli i mallit që është si objekt eksporti ose importi; mbledhja e deklaratave nga vozitës, punëtorë në shpediton; shkëmbimi ndërkombëtar i informatave dhe të dhënave; tampon doganor, vula etj.; gjurmë të krijuara nga shqepja e shenjave të caktuara (etiketa, deklarata të prodhimit, numra të fabrikës, mungesa e dokumentacionit të caktuar që duhet ta shoqërojnë mallin (lista e ngarkesës, flet dërgesa e doganës etj.), paraqitja e dokumentacionit të dyfishtë (fatura të dyfishta, certifikata për prejardhjen e mallit, listat e ngarkesës etj.).

Indikacionet mund të manifestohen para, gjatë dhe pas kryerjes së veprës penale. Ja disa prej tyre: dituria, profesioni dhe përvoja profesionale; motivi, vetitë trupore dhe psikike (kjo posaçërisht vjen në shprehje në vendkalimet kufitare, kur bëhet kontrolli i mallit gjatë procedurës doganore, gjatë kontrolleve dhe mbikëqyrjes të inspektorëve, gjatë kontrollit të kontabilitetit dhe të dokumentacionit tjetër); mënyra e kryerjes; kënaqësitë e fryteve të fituara gjatë kryerjes së veprës penale; pjesëmarrje gjatë kryerjes së veprës penale, alibi dhe dhënia e alibisë të rrejshëm e të tjera. Të gjitha nga këto indice të përmendura dhe të papërmendura nuk kanë forcë dhe vlerë të njëjtë. Kjo kushtëzohet nga lloji, ashtu nga burimi i indiceve , përkatësisht nga lidhja e indiceve të veçanta me indicet tjera. Detyrë themelore me këtë rast është – çdo indice e marrë në mënyrë të veçantë duhet të verifikohet në mënyrë të vërtetë, ndërsa pastaj ndërmjet më tepër

indiceve të ekzistojnë lidhje e ngushtë dhe logjike dhe varshmëri ndërmjet tyre.

Siç dihet ka shumë vepra penale të cilat bëhen në mënyrë latente, ndërsa edhe pasojat e këtyre veprave fshihen dhe janë të padukshme (kontrabanda, fshehja e tatimit, larja e parave, korrupsioni etj). Në shumë raste nuk mund të mblidhen informacione si prova të drejtpërdrejta (për shembull, për dëshmitarët okular të ngjarjes) dhe as faktorët vendimtar të verifikohen menjëherë. Prandaj nëpunësit e autorizuar detyrohen domosdo të mbledhin informacione për indice të ndryshme, përkatësisht fakte nga të cilat nëpërmjet rrugës logjike do të nxjerrin përfundime për ekzistimin ose mosekzistimin e fakteve që e përbëjnë veçorinë e veprës penale.

Në tekstin e mëtejshëm do të përqendrohemi në disa indice më specifike karakteristike për zbulimin e krimit.

Dituria, profesioni dhe përvoja profesionale. Gjatë kryerjes së veprave penale të caktuara, shpeshherë vjen në shprehje profesioni dhe përvoja profesionale. Kështu për shembull nga gjetja e dokumentacionit afarist dhe kontrollit të bërë në të, mund të verifikohet se kryerësi i mundshëm i aktit penal fshehje të tatimit një kohë të gjatë ka mundur me sukses dhe në mënyrë profesionale të fsheh tatimin (ose të pastrojë para) dhe me këtë rast të mos zbulohet nga organet kompetente shtetërore. Thjeshtë, në mënyrë shumë perfide i është shmangur të gjitha kontrolleve. Kjo na shpie të përfundojmë se personi i këtillë ka përgatitje të mirë (financiare dhe kontabiliste) dhe se ka edukatë solide në lëmin e shkencave ekonomike, përkatësisht e njeh mirë zanatin dhe profesionin e vet.

Motivi, tiparet trupore dhe psikike si indice. Motivi paraqet dëshirat e brendshme dhe të jashtme, që një personalitet i caktuar i shpreh gjatë kryerjes së veprës penale. Më shpesh, nevoja,

dëshira, pasione dhe interes të ndryshim e të tjera, shkaktojnë motivin.

Për shembull, si motiv më i rëndësishëm për kryerjen e akteve penale në lëmin e krimit ekonomik mund të theksojmë këto: dëshira për pasurim të shpejtë, vetëdije të ulët tatimore dhe mentaliteti tatimor i ndonjë personi, dobia, pikëpamjet për sistemin juridik të tatimit, ndjenja e përkatësisë ndaj një komuniteti të caktuar shoqëror etj. Gjithashtu mund të thuhet se tek fshehja e tatimit, aktori është i motivuar edhe nga mundësia për ti neutralizuar efektet negative që dalin nga pagimi i të ardhurave fiskale të cilat nga ane tyre janë si barë e forcës së tij ekonomike. Gjatë verifikimit të motivit për kryerje të veprës penale duhet pasur kujdes faktin se ekziston mundësia për fingimin e veprës (kryerësi përpiket të bëjë evidente veprën penguar, mënyra dhe mjetet e gjoja realizimi, dhe në këtë mënyrë i mënjanon gjurmët e vërteta duke lënë të reja, të cilat duhet të vënë në dukje motivin e kryerjes edhe të ndonjë personi tjetër si kryerës⁶⁸). Kuptohet, e gjithë kjo lidhet me tiparet trupore dhe psikike të çdo njeriu.

Vullneti për të kryer vepër penale si indice. Përveç motivit, edhe vullneti është një nga indicet vendimtare ku bëhet fjalë për indikacionit para kryerjes së veprës penale. Kryerësi, këtë indikacion, përkatësisht vullnetin mund ta shpreh në disa mënyra, dhe atë:

- Deklaratë me gojë;
- Deklaratë me shkrim;
- Mimikë, pantomima dhe gjeste dhe

⁶⁸ Duhet bërë një dallim të qartë vepra penale të fshehura dhe të fingura. Gjersa veprat penale të fshehura me të vërtetë janë kryer, ato të fingura nuk janë kryer. Kryerësi vetëm dëshiron që të krijojë iluzionin e kryerësit të vërtetë që të mashtrojë nëpunësin operativ dhe në këtë mënyrë të pengojë zbulimin e veprës dhe të kryerësit, Bëhet fjalë për falsifikim të gjendjes faktike.

- Veprime përgatitëse e të tjera.

Më vet paraqitjen e çfarë do lloji shenjë të këtij vullneti, kriminalisti i mirë mund të bëjë asociacione se këtu bëhet fjalë për kryerës potencial të ndonjë vepër penale. Por, nëse ato janë të papërfillshme puna e kriminalistit vështirësohet tepër.

Megjithatë, se me këto shenja të vullnetit vështirë se do të zbulohet me kohë për të mundur të parandaluar nëse për këtë qëllim nuk merren informacione nga informatorë dhe bashkëpunëtorë.

Shembuj të këtillë në praktikë mund të gjenden me bollëk. Posaçërisht bien në sy deklaratat me gojë të cilat shpeshherë mund të shndërrohen në kërcënime ndaj një personi të caktuar ose komunikimi me pjesëmarrësit, me familjen dhe të afërmit e të tjerë, si dhe interesimi jo i zakonshëm dhe pyetjet për një person të caktuar ose objekt.

Deklaratat me shkrim janë më të rralla se ato me gojë, por nuk mund të mospërfilljet edhe ndikimi i tyre. Në fakt, këtu më shpesh bëhet fjalë për kërcënime drejtuar bashkëshortes, dashnores ose ndaj ndonjë funksionari etj. Gjithashtu, mund të drejtohen edhe ndaj pjesëmarrësve në formë të planit tekstual, vizatimit, skicës etj. Kështu për shembull kur bëhet fjalë për vjedhje kur nëpërmjet kartave gjeografike dhe skicave përkatëse përshkruhet vendi i planifikuar për kryerjen e veprës penale.

Mimika, gjestet dhe pantomimat janë të shprehura posaçërisht tek delikuentët jo profesional përkatësisht pa përvojë, sepse janë më të ngarkuar në aspektin psikik se sa profesionistët, prandaj janë të shqetësuar nga rrjedha e veprës penale të planifikuar, që shkakton pasiguri tek ata që e shprehin nëpërmjet lëvizjeve jo të zakonshme të trupit, të duarve apo nëpërmjet shprehjes së fytyrës. Këtë posaçërisht do të vërejnë personat më të

afërt të kryerësit për shkak se (logjikës së gjërave) i kanë të njohura mirë reagimet e tij të rëndomtë.

Veprimet përgatitëse janë më të dukshme kur për shembull një person blenë armë për të vrarë ose për të bërë vjedhje; të falsifikojë dokumente personale me qëllim që të fsheh identitetin e vet; të kërkojë alibi nga përpara; të ndryshojë pamjet e tij të jashtme që me këtë rast do të thotë të blejnë pajisje përkatëse (shumë rrallë por ka edhe njerëz të tillë të cilët i ekspozohen edhe operacioneve estetike për këtë qëllim etj.

Karakteri i kryerësit si indice. Shprehja e karakterit përdoret në psikologji në raste të shumta. Ndonjëherë identifikohen nocionet personalitet dhe karakter, megjithatë, konsiderohet se personaliteti është nocion më i gjerë, i cili i përfshinë të gjitha tiparet e individit, ndërsa karakteri është nocion më i ngushtë dhe përfshinë tiparet esenciale të një personi, ato që janë më karakteristike për individët.

Shpesh me shprehjen karakter shprehen tiparet e vullnetit (psikologjia ruse) dhe të moralit), (psikologjia amerikane) të njeriut. Në fakt, kur bëhet fjalë për tiparet e karakterit më shpesh përmendet këmbëngulësia, vendosmëria, konsekuencat, iniciativa, respekti, vetëmohimi, modestia, ndërgjegjja etj. Gjithashtu, në tiparet karakteristike bien vlerat, qëndrimet, interesat, motivet sociale etj.

Akti i kryer, në masë më të madhe ose më të vogël mund të jetë tregues i personalitetit të kryerësit. Kështu për shembull, ashpërsia, brutalitetit, mizoria, sadizmi, ana perfide, gjakftohtësia, dhelpëria, hamendja, shkaqet për ta bërë krimin e të tjera. Një rrethanë e këtillë është me rëndësi të madhe gjatë zbulimit⁶⁹ dhe

⁶⁹ Me zbulim nënkuptohet depërtimi nga e panjohura në të njohurën; zbulimi i një akti penal të fshehur – ekzistimi i veprës penale dhe zbulimi i kryerësit të saj.

gjatë zbardhjes⁷⁰ së veprës penale. Në situata të këtilla, rëndomë, më me rëndësi është ti jepet përgjigje pyetjes, se kush ka qenë në situatë të kryejë përkatëse penale. Nga ana tjetër, kryerja e veprave tjera dhe sjellja korrekte mund të jetë vetëm si paravent prapa së cilit fshihet dikush, personaliteti i vërtetë dhe sjellja e tij e fshehtë kriminale.

Të përjetuarit e akteve të kryera pas veprës penale si indice. Vëmendje të veçantë gjatë zhvillimit të përpunimit kriminalistik (ose hetimit financiar – policor) tek veprat penale ekonomike, duhet ti kushtohet pasojave materiale nga kryerja e veprës penale si indice. Kryerësit e veprave të këtilla penale dhurojnë sende, para, blejnë gjëra të ndryshme ose të paluhatshme (shtëpi, banesa, shtëpi vikendi) etj. Paratë i shpenzojnë për nevoja të ndryshme dhe për kënaqësi të ndryshme shpeshherë të pakontrolluara (bixhoz, prognoza sportive, udhëtime në botën e jashtme etj.). Ky moment në bashkëveprim me faktorë dhe indice e tjera, vë në dukje mundësinë e bërjes së veprës penale, por njëkohësisht paraqet edhe provën e llojit të vet për aktin e kryer penal (në këtë rast) në lëmin e krimit ekonomik.

Prania në vendin e kryerjes së veprës penale si indice. Prania në vendin ku është kryer vepra penale është një nga indicet e rëndësishme. Kjo mundëson orientimin e drejtë gjatë zbulimit të kryerësit dhe eliminimin e suksesshëm të personave, të cilët për çfarëdo lloj arsye janë vënë si të dyshimtë në lidhje me kryerjen eventuale të këtij akti.

Faktet për praninë e ndonjë personi në radhë të parë, gjatë dhe pas kryerjes së aktit, në vendin ku është bërë ky akt, e bëjnë të lidhet me këtë vepër penale.

⁷⁰ Zbardhje (sqarim) është të pohuarit se realisht ekzistojnë fakte relevante, përkatësisht se kanë ekzistuar, dhe se kanë vetëm një kuptim dhe se me faktet e tjera të kësaj lënde penale kanë një lidhshmëri të caktuar.

Një person se ka qenë i pranishëm në vendin e kryerjes së aktit vërtetohet dhe verifikohet në bazë të: sendeve që janë lënë ose që janë marrë nga vendi i ngjarjes, gjurmët të cilët kanë mbetur në vendin e kryerjes së aktit, përkatësisht gjurmët e trupit në vendin e ngjarjes, të veshjes, mbathjet të një personi të caktuar dhe njoftimet të fituara nga ana e qytetarëve (dëshmitarë okular, të dëmtuar).

Është e ditur se gjatë inspektimit gjenden sende të cilët para kryerjes së veprës penale nuk kanë qenë aty. Sendet e këtilla mund të jenë shumë të rëndësishme, bile edhe vendimtare për zbulimin e kryerësit. Kështu, për shembull, në vendin e kryerjes mund të gjendet pulla të ndryshme, kapela, torba, faculeta ose pjesë tjera të gardërobës, sende të ndryshme me të cilat është kryer akti etj.

Gjatë gjetjes së sendeve të përmendura dhe gjërave të tjera, me rëndësi është të përcaktohet se këto sende a kanë qenë në vendin e ngjarjes edhe para kryerjes së veprës penale, i kujt është ai send, a ka mbetur nga kryerësi i veprës penale. Disa kryerës me qëllim lënë gjësende (nga paragjykimet, për të vështirësuar, të dezorganizojnë dhe ta pamundësojnë hetimin). Me qëllim të përcaktimit të prejardhjes së gjësendeve përkatëse dhe të identifikimit të personit që këto sende i takojnë, merren masa dhe aktivitete përkatëse dhe përdoren metoda përkatëse teknike. Për shembull, në kapelë mund të gjendet pluhur, fije floku e të tjera. Gjithashtu mund të bëhen pyetje ndaj të tjerëve për sendet e gjetura.

Megjithatë, fakti se një person posedon gjësendin që është marrë në vendin e ngjarjes nuk dëshmon se ky person është kryerësi i aktit, por e bën atë që të ketë lidhje me kryerësin e mundshëm. Prandaj, duhet të vërtetohet se si ka ardhur ky send në dorën e këtij personi.

Prania në vendin e kryerjes së veprës penale mund të vërtetohet edhe në bazë të gjurmëve që kanë mbetur në vendin e ngjarjes nga kryerësi ose gjurmët e kryerësit që kanë mbetur si rezultat i qëndrimit të tij në vendin e ngjarjes (gjurmë të vijave papilare, gjurmë të këpucëve, gjurmë të automjetit, pjesë e veshjes së kryerësit etj.). Gjithashtu, njoftimet e të dëmtuarve, e dëshmitarëve okular, mund të shërbejnë në mënyrë të suksesshme për përcaktimin e pranisë në vendin e ngjarjeve ose për përcaktimin e pjesëmarrjes gjatë kryerjes së veprës penale. Tek disa vepra penale, pothuajse çdo i dëmtuar e ka parë kryerësin (mashtime, përdhunime, hajni në shtëpi), prandaj mund të jetë si pjesëmarrës në njohjen e tij.

Veprimi psikik i veprës penale ndaj kryerësit si indice. Veprat penale mund të shkaktojnë shqetësime psikike tek kryerësi. Gjendjet e këtilla rezultojnë nga raporti i kryerësit ndaj veprës penale. Kryerësi e di se ka bërë vepër penale, e ndjen fajin, ka një brengë në vetëdije⁷¹, frikësohet nga dënimi dhe nga pasojat tjera dhe si rezultat i kësaj ndryshon shprehitë e veta dhe mënyrën e jetës dhe kjo në fakt e zbulon atë. Ndikimi psikik i veprës penale ndaj kryerësit manifestohet në mënyra të ndryshme dhe me intensitet të ndryshëm. Kjo varet nga personaliteti i kryerësit si konstitucion psikologjik. Psikopatët e ftohtë⁷² reagojnë në mënyrë tjetër ndërsa personalitetet emotive në tjetrën e mënyrë.

Ndjenja e fajit, brengosja nga ndërgjegjja, shqetësimet mund t'i nxisin kryerësit e aktiviteteteve të caktuara. Prandaj ndodh që disa individë vetë t'i paraqesin ose ti jepen një jete të kënaqshme, pinë shumë, shpesh udhëtojnë, ndryshojnë vendin e jetesës, drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë bisedojnë me të

⁷¹ Ndjenja e fajësisë është një kompleks ndjenjash të : turpit, përgjegjësisë, pendimit, frikës dhe vlerës së ulët. Ndjenja e fajit del nga konflikti ndërmjet instinktit të socializimit dhe instinktit të vetëpërmbytjes.

⁷² Delikuenti asocial nuk ka ndjenja të fajësisë ose e ka ngulfatur atë tërësisht.

dëmtuarit që të heqin dorë nga ndjekja, u kërcënohen, bëjnë kallëzime anonime duke vënë persona të tjerë si kryerës të aktit, përgatisin alibi të rrejshëm, marrin pjesë gjatë inspektimit etj. Manifestimet e këtilla dhe të tjera janë si pasojë e ndikimit psikik të veprës penale ndaj kryerësit.

Njohja e rrethanave të cilët të tjerët nuk i din ose mosnjohja e rrethanave që shumë të tjerë i ka të njohura. Gjatë vlerësimit të fakteve që kanë të bëjnë me njohjen përkatësisht mosnjohjen e rrethanave duhet pasur kujdes në të kundërtën, operacioni në angazhimin e parë do të jetë i gabuar. Kriminelët profesional posaçërisht ato që bëjnë vepra të përsëritura, rëndomë përgatiten për aktivitete më serioze kriminale, ndërsa ndër të tjera, përpiqen ti njohin kushtet dhe rrethanat tjera që bëjnë të mundshëm realizimin më efikas dhe të shpejtë të aktit penal. Përveç kësaj, dikur manifeston dhe gjendje të jashtëzakonshme gjatë kryerjes së aktit. Për shembull, hajni special i banesave me lehtësi të madhe i gjen paratë, stolitë dhe gjësendet tjera, prandaj duket sikur ai i ka njohur nga me parë disa rrethana.

Pjesëmarrje gjatë kryerjes së aktit penal si indice. Indicet e këtilla rrjedhin si rezultat i shumë faktorëve gjatë kryerjes së aktit penal në përgjithësi. Kështu për shembull, ndodh edhe në fushën e ekonomisë, Për shembull, tek shumë partnerë afarist janë gjetur flet dërgesa dhe fatura fiktive të cilat, me marrëveshje të tyre të mëparshme janë dërguar tek njeri dhe tjetri (nga një ndërmarrje te ndërmarrja tjetër), me të vetmin qëllim që të fshihet tatimi. Malli, në fakt iu është shitur personave që kanë bërë pagesë me pare në dorë. Këto indice dhe indice të tjera, shpien në konkluzione logjike se gjatë aktiviteteve të këtilla kriminale kanë marrë pjesë shumë veta.

Mënyra e kryerjes së indice. Mënyra e kryerjes, gjithashtu mund të paraqesë indice, por, vetëm tek kriminelët e specializuar

të cilët përgatisin *modus operandi* të vet. Për shembull, praktika e deritashme kriminalistike dhe gjyqësore na tregon se disa kryerës të caktuar fshehjes së tatimit përdorin të njëjtat mjete, teknik etj. (malli shpeshherë importohet nga jashtë, ndërsa pastaj shitet në territorin e Republikës së Maqedonisë, me ç'rast nuk përpilohet ose nuk evidencohet dokumentacioni dalës afarist).

Gjithashtu, mënyra e kryerjes mund të na shërbejë si indice edhe në rastet kur i dyshuari është person i dënuar më herët për të njëjtën ose për vepër të ngjashme në lëmin e krimit ekonomik. Në situata të këtilla, me interes të veçantë për nëpunësit operativ, duhet të jetë mënyra e tij e specializuar e kryerjes së aktit penal.

Mjetet e kryerjes së aktit penal si indice. Për llojin dhe për karakteristikat e mjeteve për kryerjen e veprës penale mund të tregojnë sa vijon: mënyrë e kryerjes së aktit, gjurmët e gjetura dhe pjesë të mjeteve të përdorura, por edhe deklaratat e dëshmitarëve okular, e të dëmtuarve, e viktimave dhe e personave të tjerë. Me këtë rast, me rëndësi është tu jepet përgjigje këtyre pyetjeve: si janë ato mjete, a është përdorur ndonjë profesionalizëm i veçantë për përdorimin e tyre, kush i ka prodhuar dhe kush i ka shitur, kush i ka pasur ose ende i ka, përkatësisht se si kanë arritur dhe ai ka poseduar i dyshuari e të tjera.

Mjeti, për cilin supozohet se është përdorur gjatë kryerjes së aktit penal, mund të gjendet gjatë inspektimit të vendit të ngjarjes, duke e shikuar ose duke bastisur, nëpërmjet përdorimit të qenve zyrtar, në bazë të deklaratave të dhëna se ku gjendet ai, kujt i është dorëzuar ose i është lënë në dorë, ku është hedhur ose asgjësuar. Pas gjetjes të mjeteve të tilla, është e domosdoshme të vërtetohet sa vijon: pasojat e aktit të kryer a ka pasur mundësi të shkaktohen nga mjeti i gjetur (për shembull, substanca e helmuar) sipas përbërjes së vet kimike dhe karakteristikat e tjera identike me materialin e gjetur në vendin e ngjarjes; gjurmët e gjetura në

vendin e ngjarjes a janë kryer nga mjete i gjetur; mjete i gjetur ose ambalazhi i tij a ka gjurmë të vendit të ngjarjes dhe gjurmë të kryerësit; dëshmitarët okular gjatë njohjes a mund të identifikojnë mjetin e përdorur, për shembull pistoletën, pushkën, thikën etj.

Por, në bazë të mjeteve të gjetura nuk duhet nxjerrë konkludime lehtë për identitetin e kryerësit. Kjo aq më shumë për shkak se kryerësit mund të përdorin mjete që nuk janë pronë e tyre, ose nuk i kanë pasur përgjithmonë ose përkohësisht, por i imponojnë për shkak fingimi. Gjatë zbardhjes së veprave penale në praktikë mund të gjenden edhe sende të tjera të cilat mund të na tregojnë për paramendimet e kryerësit, për përkatësinë e tij në ndonjë profesion të caktuar, për karakteristikat etnike dhe mikrogjeografike të rajonit prej nga rrjedh etj.

Sjellja e dyshimtë e personit të caktuar si indice. Sjellja e dyshimtë, që paraqitet si pasojë e ndikimit psikologjik ndaj kryerësit nuk manifestohet në të njëjtën masë dhe të njëjtën mënyrë te të gjitha personat. Kështu për shembull ndryshon reagimi kur nëpërmjet aktit të kryer kryerësi ka nxjerrë ndonjë dobi përkatëse, ka zgjidhur ndonjë problem të vështirë, ka realizuar ndonjë qëllim të lartë etj. Është shumë me rëndësi të theksohet se kjo indice është karakteristike gjatë kthimit të kryerësit në vendin e krimit dhe hase më së shumti tek veprat penale të rënda: vrasje, përdhunim, forma të rënda të hajnive e tjerë. Kryerësi kthehet në vendin e ngjarjes edhe nga dëshira për të mësuar se a është zbuluar vepra penale, a ka mbetur ndoshta ndonjë gjurmë që do të mund ta zbulonte etj. Kryerësi kthehet në vendin e ngjarjes edhe gjatë bërjes së inspektimit dhe mund të gjendet midis qytetarëve të mbledhur dhe me kujdes e ndjek inspektimin. Rëndonë, sjellja e tij nuk është ajo e zakonshme. Ai

është nervoz⁷³, shikimin e ka të shqetësuar, mund që tek ai të shihen edhe gjurmë të freskëta të veprës penale etj. Prandaj, një anëtar i grupit të inspektimit duhet të mbikëqyrë me kujdes sjelljen e qytetarëve.

Gjithashtu, kryerësi mund të tërheq vëmendjen edhe në këto raste: ikje, fshehje, mbajtjes së dokumenteve të falsifikuara, ndërrimi i shpeshtë i adresës së banimit, ndryshimi i pamjes fizike, ndryshimi i shprehive; vetë paraqitje ose vetë dorëzim; marrëveshje e fshehtë me personat e tjerë të dyshuar, gjetja e blerësve për mallin e caktuar; vënia e gjurmëve të rrejshme; të shkruarit e letrave anonime; nevoja e pamposhtur që gjithnjë të flasë për aktin kriminal; shmangie e takimeve me policinë; shtirrje (simulim) i sëmundjeve gjatë marrjes në bisedë informative; paraqitje të hollësive që mund ti dinë vetëm kryerësit ose bashkëkryerësit e tjerë.

Duhet vërë në dukje edhe faktin se udhëtimet e shpeshta të një personi të caktuar pa ndonjë shkak të dukshëm, paraqet sjellje të dyshimtë e cila nuk mund të jetë si pasojë e shqetësimeve psiko-motorike të kryerësit, por kusht esencial për kryerje të suksesshme të akteve ndëshkuese të veçanta (hajni të dhunshme, mashtrime, kontrabandë, shpërndarje të parave të falsifikuara, thyerje të objekteve etj.).

⁷³ Më 25. 12.2004 gjatë një kontrolli të komunikacionit dhe gjatë rregullimit të trafikut nga ana e personit të autorizuar zyrtar (PAZ) në rrugën rajonale Dibër Gostivar është ndalur taksi automobil Volksfagen – furgon, drejtuar nga S.S nga Dibra. Gjersa PAZ (personi i autorizuar zyrtar) i kontrollonte dokumentet e automjetit dhe lejen e vozitjes pronari i furgonit ishte i qetë dhe i sjellshëm. Por pasi iu urdhërua të hap bagazhin për kontroll rutine ai filloi të belbëzojë gjatë komunikimit, kundërshtoi urdhrin e këtillë, nisi t'i ndryshojë ngjyra e fytyrës, me nervozizëm i lëvizte duart etj. Një sjellje e këtillë ishte një sinjal që PAZ të dyshojë se behet fjalë për ndikim psikik të kryerjes së veprës penale si indice dhe nisi kontrollin e vërtetë të bagazhit. Dyshimi i tij u vërtetua. Në fakt, në bagazh gjeti një thes, me një peshë prej 6 kg marihuanë. Më vonë, S/S nga ana e Gjyqit themelor të Gostivarit u dënua me 2,5 vjet burg.

Alibi dhe dhënia të alibisë së rrejshme. Alibi është fjalë latine dhe në përkthim të lirë do të thotë “diku në vend tjetër”. Kjo është provë që i dyshuari/i akuzuari e ofron që të dëshmojë se gjatë kryerjes së aktit penal ka qenë në vend tjetër, dhe jo në vendin e krimit. Alibi i shprehur është bazë e sigurt se i dyshuari nuk është kryerës i drejtpërdrejtë i veprës penale, por gjatë kësaj ende nuk përjashtohet mundësia se ai është pjesëmarrës i aktit. Nëse alibi është dhënë si i rrejshëm, atëherë kjo është indice dhe jo provë se i dyshuari është kryerës i aktit penal. Kjo ka të bëjë aq më shumë kur personi që nuk ka marrë pjesë gjatë kryerjes së aktit penal, për shkaqe dhe interesa të ndryshme mund të japë alibi të rrejshëm. Për shembull, qëllimi i alibisë së rrejshme mund të jetë fshehja e ndonjë vepre penale tjetër (kontrabanda etj.), ose që të mos komprometohet ndonjë person i tretë. Megjithatë, kur do të vërtetohet se i dyshuari gjatë kohës kritike ka qenë në vendin e ngjarjes por edhe përkundër kësaj jep alibi të rrejshëm atëherë vlera e indiceve rritet. Këtu bëhet fjalë për bashkimin e dy indiceve: alibi i rrejshëm dhe prania në vendin e aktit kriminal. Indice të këtilla në kombinim me prova të tjera plotësojnë dhe mbështetin materialin tjetër dëshmues.

Verifikimi dhe vërtetimi i alibisë është me rëndësi të madhe për përcaktimin e qarkut të personave të dyshuar. Në këtë drejtim si burim i vetëm për të vërtetuar dhe për të përcaktuar alibinë, nuk duhet të jetë vetëm i dyshuari. Këtu duhet të mblidhen të gjitha informacionet nga personat të cilët kanë ndonjë njohuri për lëvizjen e të dyshuarit, të vërtetohet nëpërmjet evidencave dhe dokumenteve të ndryshme (paraqitja e vendqëndrimit, dokumentet e udhëtimit, faturat hoteliere, evidenca për automjete të marra me qira, rent a car, evidenca e personave të legjitimuar etj.). Alibi vërtetohet: 1) nëpërmjet bisedës përkatësisht nëpërmjet dëgjimit të personit i cili thirret në alibi; 2) nëpërmjet bisedës

(dëgjimit) të dëshmitarit të alibisë; 3) nëpërmjet rikonstruksionit⁷⁴; 4) nëpërmjet analizës së dokumenteve që ofrohen si prova dhe 5) nëpërmjet analizës së sendeve dhe të gjurmëve që janë gjetur në vendin e aktit penal. Gjithashtu duhet kushtuar vëmendje edhe mbledhjes së informacioneve për alibi, duke marrë parasysh shfrytëzimin e mjeteve bashkëkohore të komunikacionit nga ana e kriminelëve dhe mundësinë e transferimit të shpejtë nga një vend në tjetrin. Në praktikën policore janë shënuar në numër i madh i mënyrave të ndryshme të përgatitjes së alibisë së rrejshme. Ja një shembull i këtillë nga koha e hapësirës së ish-Jugosllavisë. *Një zotëri ofroi dokumentacionin nga i cili mund të dilte se gjatë kryerjes të deliktit (hajni me dhunë) ka qenë në Trieste të Italisë. Ka pasur edhe dokumentin e udhëtimit nga i cili mund të vërtetohen të dhënat për kalimin e kufirit jugosllav-italian. Në Trieste është vendosur në hotel, atje si zakonisht është paraqitur. Por, gjatë natës kritike nuk ka fjetur atje, por në mënyrë ilegale ka kaluar kufirin dhe ka vjedhur me dhunë në Riekë, ndërsa pastaj sërish në mënyrë ilegale është kthyer në Trieste. Atje paret e gjetura (devizat) i ka futur në librezë kursimi në një bankë përkatëse dhe në mënyrë legale kthehet në shtëpi.*

2. METODAT E TË DËSHMUARIT TË TËRTHORTË

Puna me indice kryhet më ndihmën e metodave të caktuara, që quhen metoda të eliminimit. Në tekstin që vijon do të

⁷⁴ Rekonstrukcioni paraqet përsëritjen përkatësisht imitimin e situatës në vendin e veprës penale ose të disa rrethanave dhe sendeve të kësaj gjendjeje, si një imitim i disa elementeve të ndikimit të kryerjes, me të gjitha sendet që kanë figuruar aty në momentin e kryerjes, me korpora delikti dhe gjurmë, ashtu si është gjetur në momentin e kryerjes së veprimit kriminal që të mund të jetë i ngjashëm me situatën origjinale.

përqendrohemi në disa metoda më karakteristike të indiceve të gjejnë zbatimin e tyre në përpunimin kriminalistik dhe në hetimet financiare.

2.1. Metodat e eliminimit gjatë zbulimit të akteve penale të veçanta

Mund të thuhet lirisht se puna me indice, në procedurën parahetimore dhe në hetim, nuk është gjë tjetër, përveç zbatim i metodës së eliminimit. Metoda e eliminimit i zgjidh pyetjet kriminalistike-taktike:

- a) Çka ka ndodhur (a ekziston vepër penale ose nuk ekziston)?
- b) Çka e bën karakteristikë kryerësin?
- c) A është i dyshuari (i akuzuari) person që ka bërë aktin penal?

Gjatë realizimit të procedurës eliminuese duhet pasur kujdes dhe të mbisundojë arsyeja për dy shkaqe. I pari: shumë persona mund ti ndajnë rolet si bashkëpjesëmarrës (bashkëpjesëmarrës është kontributi i një personi me një vepër të huaj, e ndëshkuar vetëm nëse ekziston vepra e tjetrit), prandaj te secili nga to do të qëndrojë ndonjë bazë e dyshimit. I dyti: një fakt indikativ mund të ketë shkaqet e ndryshme, (të fshihet akti tjetër ndëshkues ose të fshihet personi i tretë) dhe nga ky aspekt edhe shpjegimet e ndryshme, përkatësisht versione.

Për të gjetur të vërtetën është e nevojshme të planifikohen dhe të vërtetohen të gjitha versionet e mundshme, që paraqesin në fakt metodën e eliminimit. Personat kundër të cilit nuk flasin të gjitha faktet themelore të indiceve, do të eliminohen nga

procedura e mëtejshme e zbulimit. Ata persona që do të mbeten pas eliminimit, do të konsiderohen si të dyshimtë themelor.

Kjo metodë më së miri mund të shpjegohet nëpërmjet shembullit të veprës penale vrasje. Aq më shumë se vetëvrasje, rastet e vdekjes, ndërsa ndonjëherë edhe vdekja e natyrshme – shpesh janë të ngjashme ose shumë të njëjtë me ato vdekje të qëllimshme ose nga pakujdesia nga ana e dorës së huaj. *Nën një urë hekurudhore në binarë është gjetur një trup i shkelur. Këtu është e pamundshme, por në shikim të parë edhe gabim të pohohet se ky ose ai është si shkak i vdekjes. Ekziston mundësia (supozimi, versioni, hipoteza) se i shkeluri është hedhur nga ura në binarë me qëllim vetëvrasje, është shkelur për vdekje nga ana e trenit, ekziston mundësia që i vdekuri me qëllim të jetë shtyrë nga ndonjë dorë tjetër ose si i vdekur është vendosur në binarë. Ose mund të jetë rrahur me shkop, të jetë varur, të jetë vrrarë me plumb, shpuar me thikë, të jetë helmuar dhe pastaj të jetë vënë në binarë me qëllim të paraqitjes së aktit kriminel si rast fatkeq ose të rastësishëm apo si vetëvrasje. Mundet që bashkudhëtari ta shtyjë drejt trenit i cili ka qenë në lëvizje. Mund të ketë rrëshqitur kur ka kaluar nga një vagon në tjetrin. Ekziston mundësia të ketë rrëshqitur nga ura për shkak se ajo ka qenë shumë e rrëshqitshme (shi, borë, akull, etj). Siç shihet nga ky shembull, teorikisht ekzistojnë mundësi shumë të gjëra të cilat duhet ti kemi parasysh. Prandaj, me verifikim të fakteve një nga një, eliminim ose vërtetim të tyre do të ngushtohet rrethi i versioneve rreth pyetjes së çka ka ndodhur. Ky qark do të bëhet gjithnjë më i vogël, ndërsa shkak i aktit më i qartë dhe më i afërt, gjersa në fund të mbetet vetëm një version dhe ngjarje reale.*

2.2. Metoda e shfrytëzimit të kryerësve të regjistruar të akteve penale sipas mënyrës së kryerjes – MOS

Tek shumë vepra penale, në praktikë, është vërtetuar se kryerësi ka metodën e vet të punës. Kjo është si prodhim, jo vetëm i tipareve të tij trupore dhe psikike por edhe i zanatit që e ka mësuar ai. Kështu për shembull: nëpunësi financiar, kontabilisti ose komercialisti mund të zhvillohet më lehtë (shndërrohet në kryerës të akteve penale fshehje tatimore ose në kryerës të veprës penale larje parash). Ekziston një lidhje e ndërsjellë ndërmjet aktit penal dhe profesionit të kryerësit, nga njëra anë dhe ndërmjet kryerësit dhe armës së profesionit të tij nga ana tjetër (deklarata importi dhe eksporti doganor, flet dërgesa, fatura, mjete të pagesës etj.). Sprova për të bërë vepra penale është më e madhe, nëse aftësia është më e madhe që ajo të bëhet.

Në bazë të mënyrës së kryerjes, shpeshherë mund të bëjmë konkluzione për dituritë, aftësitë dhe për profesionin e kryerësit të panjohur. Në këtë mënyrë ngushtojmë qarkun e personave që vijnë parasysh si kryerës. Kryerësi nuk e ndryshon aq lehtë mjetin e kryerjes nëse ka formuar *modus operandi* të vet. Megjithatë, sa më i specializuar të jetë kryerësi aq më tepër do të kryejë akte penale dhe do të zbatojë të njëjtën metodë të punës, dhe kjo do të thotë se kjo metodë individuale do ta zbulojë atë sikur të ketë lënë vizitkartën e vet në vendin e ngjarjes. Duhet ditur vetëm ti lexohet kjo vizitkartë. Kjo do të ishte shumë e rëndësishme, veçanërisht kur vepra penale fshehja e tatimit bëhet edhe në bashkëpunim me akte të tjera penale, si për shembull kur blerja e një sasive të madhe të mallit bëhet nëpërmjet mashtrimit, me ç'rast jepet instrument i rrejtshëm për pagim, ndërsa malli i

blerë shitet pa përgatitur dokumentacion ose për të fshehur aktin përgatiten faturat për një pjesë të mallit që është shitur me tatim të llogaritur.

Më shpesh, në teorinë dhe praktikën kriminalistike, si model merret: mënyra e kryerjes së aktit penal, objekti i sulmuar i aktit penal, llojet dhe mjetet individuale të kryerjes, vendi i kryerjes, koha e kryerjes etj.

Për këto shkaqe, gjatë angazhimit të parë (angazhimi i parë është faza në veprimin kriminalistik, që shërben për shfrytëzimin e të gjitha teknikave dhe metodave kriminalistike-taktike, metodat dhe veprimet e mbledhjes dhe shfrytëzimit të shpejtë dhe të gjithanshëm të potencial ekzistues të informacioneve), të gjitha elementet e fituara dhe modelet duhet të kontrollohen dhe të krahasohen në kartotekën MOS. Ndoshta atëherë mund të nxirren konkluzion sipas ngjashmërisë – analogjisë, e cila do ti ndihmojë kriminalistit (përkatësisht policit financiar) në procesin e zbulimit.

Metoda – MOS ndihmon gjatë zbulimit edhe të të ashtuquajturve kriminel mobil, të cilët udhëtojnë nga një vend në tjetrin.

Për shembull: 14 veta nga Shkupi, Velesi dhe Ohri qenë dëmtuar nga një banor i Shkupit, i cili me mashtrim u mori atyre 15 mijë euro nga fundi i janarit të vitit 2004.

Ai (duke udhëtuar) iu është prezantuar atyre se gjoja ka qenë i punësuar në Kryqin e Kuq dhe në Qeverinë e RM-së dhe pasi ka njohur shumë njerëz të pushtetit dhe të ambasadës italiane u premtoi atyre (kuptohet të të interesuarve) se do tu nxjerrë viza pune për në Itali. Nëpërmjet bindjes këmbëngulëse, të dëmtuarit pranuan që t'ia japin dokumentet e nevojshme dhe një sasi të caktuar parash.

Mashtruesi u premtoi se do tu paraqitet me telefon që ti njoftojë se kur duhet të vijë në Shkup për të marrë dokumentet e tyre të udhëtimit.

Pasi personat kuptuan se janë mashtruar e paraqitën rastin në polici.

Shembull tjetër, një banor nga Shkupi, duke u prezantuar si polic apo si doganier, nga firma dhe individë nëpërmjet mashtrimit ka marrë rreth 2 milion denarë. Rasti është zbuluar nga policia dhe kundër A.B (29) është bërë kallëzim penal për mashtrim.

I dyshuari nga Maji deri në tetor të vitit 2005 ka kontaktuar me shumë firma dhe persona fizik në Koçan dhe në Shkup të cilëve u është prezantuar si pjesëtar i njësitit elitar në MPB ose si nëpunës i lartë doganor. Ai u ka premtuar atyre se ka mundësi tu ndihmojë për të gjetur punë apo favore të tjera. Në këtë mënyrë ai nga një firmë e Shkupit, gjoja për nevoja të policisë dhe të doganës, ka marrë 86 prodhime me një vlerë prej 1 milion denarë, pastaj nga një banor tjetër i Shkupit ka marrë 2000 euro me premtimin se do ta punësojë. Nga persona të tjerë ka marrë para, duke pohuar se mund t'ua bëjë të mundshme që të qarkullojnë me automjete që u janë konfiskuar për shkak të parregullsive doganore. Ka marrë para me pretekstin se do ti bëjë të lirë nga obligimi për pagimin e tvsh (tatim).

Me mashtrime të këtilla ai ka përvetësuar më se 2 milion denarë.

2.3. Metoda e përpilimit të listës të indicjeve për shumë vepra penale dhe për shumë persona.

Kjo metoda përbëhet nga fakti sepse për çdo rast të veçantë përcaktohen ato indice që e bëjnë të mundshëm qarkun e tij e kryerësve potencial. Mund të ndodh një ose disa indice të përputhen me disa ose më shumë pjesëmarrës, por ajo vetëm për raste të veçanta mund të jetë e besueshme, por jo edhe indice e nevojshme. Për këto shkaqe nuk mund të arsyetohet ngritja eventuale e procedurës penale. Por, mund të bëhet lista, për çdo rast të veçantë, e personave të dyshuar dhe të fillojë gjurmimi në drejtim të asaj se një person i caktuar paraqitet në një ose në të gjitha listat e regjistruara. Ai që paraqitet gjithnjë në shumë lista të veçanta si kryerës eventuale, bëhet i dyshimtë themelor.

Për shembull: janë marrë njohuri fillestare dhe të përgjithshme se shumë ndërmarrje private të Shkupit, Tetovës, Ohrit, Shtip, Strumicë dhe Kumanovë furnizohen me naftë kontrabande dhe derivate të saj. Nga marrja e masave operative-taktike (mbledhja e njoftimeve nga pjesëmarrësit në biznesin e këtillë ose nga dëshmitarë; ndjekja; angazhimi i informatorëve etj.), është konstatuar se nafta dhe derivatet e naftës blihen nga një ndërmarrje private e njëjtë me seli në Shkup, ndërsa për të nuk ekziston dokumentacion afarist, ose ai është i falsifikuar.

Në këtë rast (kur përsëritet i njëjti person si shitës), duhet të eliminohen të gjithë persona tjerë të dyshimtë për të cilët kemi bërë listën përpara si kryerës të mundshëm të akteve të këtilla kriminale, (të paktën për një kohë të caktuar) dhe të orientojmë veprimin operativ (përpunimin kriminalistik, hetimin financiar) në drejtim të atij personi me dyshim se nuk i ka llogaritur dhe nuk i ka paguar akcizat dhe detyrimet tjera ndaj shtetit, përkatësisht se

është kryerës i mundshëm i aktit penal kontrabandë të mallrave dhe fshehje të tatimit.

Kjo do të thotë se indicet (baza për dyshim) janë shndërruar në prova (dyshime themelore). Para se të kalojmë në metodën që vijon do të përmendim një rast të paradokohshëm të në një vend fqinjë, i cili rezultoi me aktvendim gjyqësor. *Në fakt, një gjyq në Selanik në janar të vitit 2004 i shqiptoi dënim të përjetshëm biznesmenit lokal Evangelos Isakibis (53) i cili ka kryesuar zinxhirin e tregtisë ilegale me derivate të naftës gjatë së cilës, në bashkëpunim me përfaqësues shtetëror të korruptuar është shmangur pagimi i rreth 2.1 milion euro tatime dhe detyrime të tjera.*

Isakibisu shpallet fajtor si drejtues i 158 dërgesave të naftës me një vlerë të përgjithshme prej 2,1 milion euro që duhet të eksportoheshin të pa tatuara në Bullgari.

Me ndihmën e dokumenteve të falsifikuara dhe korruptimin e përfaqësuesve të doganës kufitare, nafta nuk e ka kaluar kufirin por është shitur në mënyrë ilegale në pompat e benzinës në Greqi. Zinxhiri i kontrabandës në këtë mënyrë i është shmangur pagimit të tatimit dhe detyrimeve të tjera me një vlerë prej 1.6 milion euro.

Gjyqi, gjithashtu e dënoi Iraklisi Antemidis (49) me 15 vjet dhe doganierin Kriston Anastasiadis (56) me shtatë vjet burg. Antemidis u shpall si fajtor edhe për 48 dërgesa naftë që sipas dokumenteve, i është dedikuar Bullgarisë por nuk e kanë lënë të dalë nga Greqia. Me këtë Antemidis e dëmtoi shtetin për më se 500 mijë euro.

2.4. Metoda e vërtetimit të neto-vlerës

Metoda e dëshmimit të vlerës-neto⁷⁵ mbështetet në prova të bazuara në indice. Kjo metodë shfrytëzohet gjatë zhvillimit të hetimeve për tatimet dhe për mos tatimet (të ardhura jo legale). Zbatimi i metodës është i njëjtë në të dy rastet. Ajo që e bën të dallohet është përqendrimi i hetimit- te të ardhurat e pa lajmëruara përkatësisht të ardhurat jo legale. Me metodën e dëshmimit të vlerës-neto matet rritja ose zvogëlimi i vlerave neto të personave. Çfarëdo lloj rritje e padëshmuar kualifikohet si e ardhur e paparaqitur ose jo legale, varësisht nga natyra e hetimit. Sipas teorisë së kësaj metode individ i me paratë mund të veprojë sa vijon: t'i shpenzojë, t'i deponojë diku ose t'i ruaj si të gatshme. *Metodat indice i ndjekin transaksionet financiare dhe kanë të me mjetet që janë shpenzuar, janë investuar ose janë mbledhur. Metoda e të dëshmuarit të vlerës neto llogarit se çka shpenzuar personi, çka investuar dhe çka ka ruajtur gjatë një viti dhe atë shumë e krahason me shumën mjeteve të njohura që ka paraqitur për atë vjet. Teprica e mjeteve konsiderohet se paraqet të ardhura të paparaqitura ose jo legale.*

Metoda e dëshmimit të vlerës neto shfrytëzohet kur: nuk ka provë të drejtpërdrejtë për të ardhurat, kur regjistrat afarist dhe dokumentet janë të pakapshme ose jo adekuat (nuk i kanë organet kompetente ose janë të pasaktë) dhe kur personi i dyshuar gjithnjë akumulon mjete.

Kështu, për shembull është e pa mundur të ndiqen transaksionet të bizneseve nëpërmjet regjistrave afarist ose dokumenteve, në të cilat qarkullojnë para të gatshme (të

⁷⁵ Metoda e vlerës-neto është përpunuar në vitet e tridhjeta të shekullit të kaluar në SHBA nga ana e agjentëve special të IRS (Drejtoria e të hyrave publike) për ndjekje penale të personave të krimit të organizuar.

ashtuquajtura “kesh” para). Më shpesh kjo ndodh në bare, restorante, kazino e të tjera, ku dokumentet në përgjithësi nuk përmbajnë emra- përbëhen vetëm prej datave dhe vlerës. Inspektori nuk mund ta lidhë emrin me shumën. Identiteti i personit që ka marrë pjesë në një transaksion nuk mund të verifikohet. Ndërsa edhe vëllimi i transaksionit nuk mund të verifikohet (duhet të dokumentohen një numër i madh transaksionesh, sepse, më shpesh shumat janë minimale.

Gjithashtu, personat e përzierë në aktivitete jo legale rrallë i tregojnë të ardhurat e tyre, ndërsa gjithashtu, nuk i tregojnë edhe regjistrat e tyre afarist dhe dokumentet. Në thelb ata do ta mohojnë ekzistencë e tyre dhe do të përpiqen që t'i eliminojnë dokumentet për t'i shmangur zbardhjes së tyre. Si masë plotësuese e kujdesit, i koordinojnë dokumentet që të sigurohen se policia (kriminalistike dhe financiare) të mos i kuptojë, nëse ato do të konfiskoheshin.

Hapi i parë që duhet të ndërmerret është llogaritja e vlerës neto e personit të dyshuar. Numri më i madh i personave dhe i biznesmenëve e përfundojnë vitin afarist më 31 dhjetor. Inspektori duhet ta krahasojë vlerën neto të 31/12 në vitin për të cilin bëhet hetimi me vlerën neto të një viti më parë i cili ka përfunduar më 31/12. Kjo bëhet që të përcaktohet se a është rritur ose jo vlera neto e të dyshuarit. *Në realitet, mjetet minus obligimet është e barabartë me vlerën neto.* Rritja e vlerës neto është si rezultat i përfitimit të mjeteve (përfshirë këtu edhe rritje e parave kesh., zvogëlimin e obligimit ose kombinim i të dyjave.

Rritja e vlerës neto shihet nëpërmjet parave të shpenzuara për blerje ose nëpërmjet zvogëlimit të obligimeve. Një person, gjithashtu, shpenzon para zëra të kategorizuara si shpenzime për jetesë (shpenzime personale). Kjo përfshinë: ushqimin,

komunalit, sigurimin, benzinën, etj. Këto zëra, gjithashtu duhet të shqyrtohen gjatë përcaktimit të mjeteve totale të shpenzuara.

Puna tjetër që duhet të shqyrtohet është çdo lloj humbje që është si rezultat i shitjes së pasurisë personale (për shembull, shitja e automobilit etj).

Hapi i fundit tek kjo metodë është të përcaktohen mjetet e burimeve të panjohura. Kjo do të përfshijë rrogat, dhuratat, trashëgimitë, pensionet, fitime nga shitja e mjeteve etj. Huaja nuk shqyrtohet në llogaritjen e vlerës neto, sepse është radhitur në kategorinë e obligimit. Dallimi ndërmjet “mjeteve disponuese të përgjithshme” dhe “mjetet e burimeve të njohura” i paraqesin të aprudhurat e padeklaruara ose jo legale.

Kujt duhet kushtuar kujdes gjatë përdorimit të kësaj metode?

- Përcaktimit të vlerës neto fillestare (viti fillestar) me siguri logjike;
- Të bazuarit e hetimit është me rëndësi themelore, veçanërisht në përcaktimin se a e ka konfirmuar inspektori vlerën neto fillestare të të dyshuarit/akuzuarit me siguri të arsyeshme (logjike).
- Mohimi i arsyeshëm i shpjegimeve logjike nga personi i dyshuar i cili kundërshton se është fajtor, por ndjekja e çfarëdo lloj gjurme që do të shpinte në drejtim se i dyshuari është i pafajshëm;
- Të tregohet burimi i besueshëm i të ardhurave (në raste të tatimeve më të vogla, inspektori duhet të sigurojë prova se personi i dyshuar ka pasur burim të të ardhurave; në rast mos tatimi inspektori duhet të dëshmojë se i dyshuari është përfshirë në aktivitete ilegale). Kjo mund të dëshmohet nëpërmjet deklaratave të dëshmitarëve, pranimeve të bëra, bisedave të incizuara etj.

*

*

*

Asnjëra nga indicet e përmendura më lartë (as metodat) nuk janë universale, apo të mund të thuhet se janë vendimtare në zbulimin e kriminalitetit. Këto indice dhe metodat individuale paraqesin vetë një pjesë të kriminalitetit të aktiviteteve të paramenduara dhe të organizuara nga subjektet të cilat janë të obliguara për zbulimin dhe parandalimin, të cilat përdorin edhe metoda të tjera operative dhe mjete shkencore-teknike. Gjatë aktiviteteve operative përkatësisht gjatë procedurës para hetimore asnjëherë nuk jemi në gjendje t'i zbatojmë të gjitha metodat e përmendura. Nga ana tjetër, çdonjëra nga këto metoda ka mangësitë e veta në aspektin e organizimit në kohë dhe në hapësirë. Më mirë është që të bëhet kombinimi i tyre gjatë përdorimit, duke marrë parasysh edhe faktin se ata ndërmjet veti kanë një ndërlidhje, janë të kushtëzuara në mënyrë të ndërsjellë në procesin e ndërlikuar të zbulimit, zbardhjes dhe të dëshmimit të delikteve. Me këto indice dhe metoda, shpesh herë plotësohet pamundësia e zbulimit të drejtpërdrejtë të kriminalitetit (në mënyrë analogjike me këtë edhe krimi i organizuar dhe terrorizmi).

3. MËSIMI KRIMINALISTIK MBI TË DHËNA

2.2. Zhvillimi, nocioni dhe llojet e informacionit kriminalistik

Kriminalistika i studion ligjshmëritë e formimit, krijimit të provave në përgjithësi, natyra e tyre informative dhe esenca gnoseologjike (njohëse), sekretit i informatës kriminalistike etj. Në bazë të ligjshmërive gnoseologjike të cilat kanë të bëjnë me mekanizmin e formimit, sekretit dhe cilësisë së llojeve të caktuara të provave, hetimeve kriminalistike dhe zhvillon metodat për zbulimin, fiksimin, mbledhjen, hetimin dhe vlerësimin e vlerës së provës.

Çdo vepër penale e bërë shkakton ndryshime në botën e jashtme. Ndryshimet mund të jenë në sferën materiale dhe paraqesin objekte (sende) dhe gjurmë të veprës penale. Ndryshimet materiale krijohen nëpërmjet kryerjes së veprës penale, por edhe nëpërmjet përgatitjes ose fshehjes së saj. Ndryshimet e krijuara nga bërja e aktit penal mund të jenë edhe në sferën e ideale (kujtimet e dëshmitarit, kujtimet e viktimës, kujtimet e kryerësit etj). Ndryshimet e këtilla, në vete përmbajnë informacione për veprën penale, për kryerësin, për mënyrën e kryerjes, për mjetet e kryerjes, për motivet e kryerjes etj.

Bartësit e informacioneve kriminalistike quhen sinjale dhe kanë natyrë materiale dhe ideale (psikike). Bartësit material të informacioneve kriminalistike janë objekte (sende) dhe gjurmë të kryerjes së veprës penale. Me zbulimin, fiksimin dhe deshifrimin e tyre, në radhë të parë, merret teknika kriminalistike (përkatësisht traseologjia). Bartësit ideal (psikike) të informacioneve kriminalistike paraqesin kujtimet e personave që kanë qenë në kontakt me veprën penale. Me zbulimin, deshifrimin

dhe fiksimin e tyre merret taktika kriminalistike, por edhe psikologjia gjyqësore dhe psikiatria gjyqësore. Informacionet kriminalistike kanë sinjali.

Sinjalet, si bartës të informacioneve kriminalistike (pa marrë parasysh a janë materiale ose ideale) kanë dalë për shkak të kryerjes së veprës penale dhe si rezultat i kësaj ato kanë fatin e pavarur, ekzistojnë në mjedisin e jashtëm dhe i përmbajnë në vete informacionet për aktin dhe për aktorin të cilët më shpesh janë të fshehur.

Sipas kësaj, informacioni kriminalistik paraqet ndryshimin i cili ka dalë si rezultat i kryerjes së veprës penale , e cila me zbatimin e metodave kriminale, mund të zbulohet dhe të shoqërohet këto, kriminalistin e shpien në drejtim të zbulimit dhe të dëshmimit të veprës penale dhe të kryerësit.

Duhet theksuar se akti kriminal si një dukuri reale jetësore nuk gjendet në situatë statike, por në çintegrim dhe dezorganizim të shpejtë dhe të përhershëm. Kur në momentin e paraqitjes së sinjaleve të veprës penale, ato nisin të ndryshojnë, të transformohen dhe të humbin. Bartësit material të informacioneve i shkatërron rrjedha e kohës, kushtet e këqija të motit, kryerësi i cili përpiqet t'i fshijë gjurmët etj. Bartësit psikik të informacioneve, përkatësisht kujtimet zbehen dhe ndryshojnë me kalimin e kohës. Aktin e krimit e karakterizon *entropia*⁷⁶, rënia e sistemit, humbja e informatës. Prandaj, është e nevojshme që veprimtaria kriminalistike të ndërmerret në pajtim me parimin e shpejtësisë dhe të befasisë, me qëllim që me kohë të zbulohen dhe të fiksohen informacionet kriminalistike.

⁷⁶ Entropia e zbatuar në kriminalistikë definohet si masë e moskzistimit të informacioneve për veprën penale, si masë abstrakte për moszbulimin. Entropia është një shtresë e fshehtë e kriminalitetit, ndërsa zbulimi e përcakton si negentropi

Informacionet kriminalistike ndahen në operative dhe dëshmuese.

Informacionet kriminalistike zbulohen me aktivitete operative taktike në procedurën e mëparshme. Ato i zbulojnë personat kompetent të organeve të punëve të brendshme (policia).. Informacionet operative nuk kanë karakterin e provës në kuptimin juridik të fjalës. Prandaj, nuk mund të paraqiten si të tilla në procedurën penale dhe nuk mund të paraqesin bazë për të marrë aktvendim gjyqësor, Por, informacionet informative kanë karakterin e provës logjike. Ato janë provë në kuptimin heuristik (njohuri) të fjalës. Ato, paraqesin indice operative eliminuese. Informata operative mund të ketë karakter preventiv ashtu edhe represiv.

Informatat dëshmuese ose provat janë informacione të cilat janë fiksuar në formë dhe në mënyrën e përcaktuar me LPP. Aktivitetet dëshmuese mund të jenë hetimore dhe ato sipas rregullit i ndërmerr prokurori publik ose persona zyrtar kompetent të policisë gjyqësore. Aktivitete dëshmuese janë edhe aktivitete që ndërmerren gjatë seancës kryesore. Ato i ndërmerr kryetari dhe anëtarët e këshillit gjyqësor.

Me aktivitetet operative-taktike arrihet vetëm zbulimi i informacioneve kriminalistike. Por, me qëllim që të ruhen më gjatë nga asgjësimi, ndryshimi ose nga harresa është e nevojshme informacionet operative të sigurohen duke zbatuar aktivitetet dëshmuese. Sigurimi i informacioneve kriminalistike dëshmuese bëhet me kryerjen, përkatësisht me prezantimin e përmbajtjeve dhe formave të tyre dhe në mënyrë të përcaktuar me dispozitat e LPP dhe me fiksimin e përmbajtjes së nxjerrë nga to.

3.2. Faktet (të dhënat) dhe vërtetimi i tyre

Prova paraqet lidhjen e konfirmuar, të konstatuar dhe relevante ndërmjet proceseve që drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndikojnë në krijimin e veprës penale, të gjurmëve, sendeve dhe njerëzve. Në teori ekzistojnë pikëpamje se nën nocionin provë duhet të kuptohet çdo fakt që paraqet bazë me të cilën verifikohet e vërteta e ndonjë fakti tjetër që ka domethënie të caktuar juridike relevante në procedurën penale. Shikuar nga ana njohëse provat paraqesin të gjitha ndryshimet në mjedisin e përgatitjes, kryerjes, fshehjes dhe kënaqësive në frytet e veprës penale, që janë në lidhje relevante me aktin. Kështu për shembull, nuk është çdo shenjë e gishtit në thikë si provë. Që të jetë dëshmi ai duhet të lidhet me kryerjen e vrasjes gjatë përdorimit të kësaj arme të ftohtë. Provë është vetëm fakti që është lidhur nga brenda me veprën penale. Në këtë aspekt, prova nuk mund të krijojë organi i procedurës penale nëpërmjet aktivitetit të vet procedues. Atë e shkakton kryerja e veprës penale në procesin e veprimit të ndërsjellë, lidhjeve reciproke ndërmjet kryerësit, mjetit për kryerje, objekti i sulmit, vendi i ngjarjes. Organi i procedurës penale vetëm konstaton ekzistimin e një lidhjeje të tillë, dhe atë në bazë të ndryshimeve të cila janë shprehur tek bartësit e informacioneve kriminalistike.

Nga ky aspekt, prova mund të definohet si ndryshim material ose psikik i të krijuar në lidhje me kryerjen e veprës penale e cila në vete bart informacione për veprën penale, për kryerësin e saj dhe për faktet e tjera penale juridike relevante, të

fiksuar në formën dhe mënyrën e paraparë me LPP dhe nga ana e subjekteve kompetente.

Burimi i provës është bartësi i informatës dëshmuese, i cili mund të jetë i natyrës materiale (gjurmë sende(objekte) të veprës penale) ose të natyrës psikike (dëshmitari).

Mjete dëshmuese janë sendet dhe njerëzit të cilat në gjyq nëpërmjet vërejtjes shqisave, mundësojnë për të ardhur te njohuria për faktin që është si objekt i të dëshmuarit. Këto mjete janë paraparë dhe nga afër të përcaktuara me ligj. Në legjislacionin tonë ato janë: inspektimi, dëshmimi, ekspertiza, pranimi ose mospranimi nga ana e të akuzuarit dhe dokumentet. Indicet dhe betimi nuk paraqesin mjet prove.

Dëshmimi paraqet përdorimin e provave në procedurën penale për të verifikuar faktet. Ose ndryshe, faktet të cilat tanimë janë verifikuar dhe nga të cilat nxirret përfundim për ekzistencën e tyre, quhen prova (baza për provë) ndërsa konfirmimi i së vërtetës së thënieve të palëve dhe verifikimi i së vërtetës së provave të tjera për faktet juridike relevante quhet dëshmi. Dëshmia paraqet veprimtarinë me anë të cilës duhet të verifikohet e vërteta e pohimeve të palëve për të fituar bazën faktike të vendimit gjyqësor.

Objekti i të dëshmuarit është përmbledhja e fakteve të cilat në procedurën penale verifikohen me ndihmën e provave dhe së këndejmi paraqesin objektin e të dëshmuarit. Me këtë rast është me rëndësi të theksohet se fakti nuk mund të jetë i pavërtetë, sepse kjo do të thotë t'i japësh këtij nocioni tipare që ai asnjëherë nuk mund t'i ketë: për shembull, ujë i thatë ose katror i rrumbullt. E pa vërtetë mund të jetë vetëm një pohim faktik.

Supozimet faktike janë ato fakte për ekzistencën e të cilave fletë rrjedha natyrore i gjërave, prandaj së këndejmi nuk verifikohen në procedurën penale, përveç se kur do të paraqiten

dyshime në ekzistimin e tyre. Së këndejmi, në procedurë tonë penale faktikisht supozohet se i akuzuari është i shëndoshë shpirtërisht dhe prandaj shëndeti i tij nuk verifikohet. Por, nëse paraqiten dyshime se i akuzuari është i sëmurë psikik, gjendja e tij shpirtërore duhet të verifikohet me ndihmën e ekspertizës.

3.3. Ndarja e fakteve të rëndësishme për kriminalistikën

Ekzistojnë klasifikime të provave të cilat kanë rëndësi të madhe për kriminalistikën, sepse vënë në dukje natyrën e ndryshme të burimeve të veçanta të informatave dëshmuere.

Ndarja e provave *materiale* dhe *personale* vë në dukje natyrën e ndryshme të burimeve të informatave dëshmuere.

Provat personale paraqesin njohje e drejtpërdrejtë ose e tërthortë të individit ose të shumë personave. Ndërsa, provat e vërteta (reale) paraqesin sendet materiale (dokumentet) që lidhen me veprën penale dhe me kryerësin dhe së këndejmi janë të përshtatshme të ofrojnë informacione për aktin dhe për kryerësin.

Provat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Kriter për një ndarje të këtillë është raporti i provave ndaj faktit kontestues në lënën penale. Provat e drejtpërdrejta (direkte) janë ato që fitohen vetë nga mjetet e provave, përkatësisht në mënyrë të tërthortë flasin për vërtetësinë ose pavërtetësinë e fakteve kontestuese. Për shembull, deklarata e një dëshmitari okular të aktit penal, pranimi i të akuzuarit dhënë para gjyqit në procesin kryesor etj. *Provat e tërthorta* (indirekte) janë ato që vënë në dukje të vërtetën dhe të disa fakteve të tërthorta, me të cilat mund të përfundohet se njëfarë fakti i kontestuar është i vërtetë ose jo i vërtetë. Për shembull, deklarata e dëshmitarit i cili nuk ka qenë dëshmitar që nuk e ka parë aktin penal, ndonjë person bënë shpenzime enorme se sa janë

të ardhurat et ij të rregullta, gjetja e sendeve të vjedhura tek i akuzuari, shenja (gjurmë) daktiloskopike të gjetura në vendin e kryerjes së veprës penale.

Prova në kuptimin më të gjerë dhe prova në kuptimin më të ngushtë. Kjo ndarje haset tek disa autorë, ku prova flet për të vërtetën dhe të pavërtetën e faktit kontestues. E plotë është ajo provë që në tërësi e vërteton të vërtetën dhe të pavërtetën e faktit kontestues, ndërsa prova jo plotë (gjysmë e plotë) e bënë këtë në mënyrë të pjesshme.

Kjo dhe ndarja e mësipërme e provave kishte rëndësi të madhe në sistemin e vlerësimit ligjor të provave. Megjithatë, kjo domethënie humbet në tërësi në sistemin bashkëkohor të vlerësimit të lirë të provave.

Prova origjinale dhe të sajara. Si kriter për këtë ndarje është burimi (mjete dëshmues) nga i cili merret prova. Origjinale është ajo provë e cila merret drejtpërdrejtë nga burimi. Për shembull, dokumenti nëpërmjet të cilit është bërë falsifikimi, deklarata e dëshmitarit i cili e ka parë ngjarjen etj. Dëshmi e sajuar është ajo dëshmi, që edhe pse nuk është marrë nga burimi megjithatë vë në dukje burimin e vërtetë. Për shembull, deklarata e një dëshmitari i cili për ngjarjen ka dëgjuar nga persona të tjerë ose pranim i të akuzuarit, të bërë para personave të tjerë ose në burgun hetimor.

Provat e akuzës dhe të mbrojtjes. Kriteret për këtë ndarje është cilësia e provave duke marrë parasysh natyrën e kërkesës së palëve në lëndën penale. Akuzuese janë ato prova të cilat e mbështesin akuzën, ndërsa ato të mbrojtjes e bëjnë të kundërtën. Vlera e kësaj ndarje është relative, së këndejmi natyra e dëshmimeve në linjë të fundit varet nga vlerësimi i gjyqit gjatë marrjes së vendimit për aktin penal.

Pyetje për studentët:

- 1. Shpjego nocionin e indiceve \.**
- 2. Përmend burimet më të shpeshta të indiceve.**
- 3. Si manifestohet dituria, profesioni dhe përvoja profesionale si indice?**
- 4. Shpjego motivet, tiparet trupore dhe psikike si indice.**
- 5. Si manifestohet vullneti për të bërë veprë penale si indice?**
- 6. Shpjego karakterin e kryerësit si indice.**
- 7. Ç'paraqet përjetimi i fryteve të arritura me kryerjen e veprës penale si indice?**
- 8. Shpjego pjesëmarrjen në kryerjen e veprës penale si indice.**
- 9. Shpjego mënyrën e ekzekutimit si indice.**
- 10. Ç'janë mjetet e ekzekutimit të veprës penale si indice?**
- 11. Shpjego sjelljen e dyshimtë të një personi të caktuar si indice.**
- 12. Ç'është alibi dhe ç'paraqet alibi i rrejshëm?**
- 13. Si provohet alibi?**
- 14. Shpjego metodën e eliminimit gjatë zbulimit të veprës së veçantë penale?**
- 15. Shpjego metodën e shfrytëzimit të kryerësve të regjistruar të veprave penale sipas mënyrës së kryerjes (MOS).**
- 16. Shpjego metodën e përpilimit të listës së indiceve për shumë vepra penale dhe për shumë persona.**
- 17. Shpjego metodën e dëshmimit të vlerës neto.**
- 18. Shpjego nocionin dhe llojet e informacionit kriminalistik.**

19.Ç'paraqesin provat dhe dëshnimet?

20.Shpjego ndarjen e provave që janë të rëndësishme për kriminalistikën.

KREU VII

RROLI I RI I POLICISË NË BASHKËSINË LOKALE

1. SHËNIME TË PËRGJITHSHME

Është evidente se tanimë nuk mund të mbështetemi në format tradicionale të punës së policisë. Gjatë viteve të fundit filozofia policore dhe roli i policisë gjithnjë vlerësohen nga fillimi, gjithnjë pak a shumë në mënyrë intensive ose radikale. Përpjekjet për një efikasitet më të madh, idetë për një menaxhim të ri publik dhe për ndryshime në filozofinë ndaj vendit të punës e kanë detyruar policinë në shumë demokraci liberale të vendeve perëndimore të ndërpresin njëherë përgjithmonë me qasjen militariste të kaluar të policisë. Që nga vitet e tetëdhjeta të shekullit të 20, duhet ta dimë se policia nuk e kontrollon, ose as që mund ta kontrollojë në mënyrë efikase krimin ose strukturat kriminale edhe nga fakti se “parandalimi” (preventiva) nëpërmjet represionit është tepër e pasuksesshme. Si rezultat i gjithë kësaj policia ka nisur me plane ideore për vlerësimin e efektit të policisë në bazë të hulumtimeve lokale të krimeve dhe hulumtimeve të aktiviteteve policore, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së policisë në nivel lokal.

Në fillimet e viteve të tetëdhjeta projektimi i drejtimeve të reja të policisë, të njohur si “veprimtari policore në bashkësinë lokale”, nisi të shfaqet dhe të rrënjoset në SHBA dhe në shumë vende të tjera. Që atëherë interesi për policinë dhe bashkësinë lokale u rrit shpejt dhe policia në shumë kompetenca të veta

zhvilloi dhe zbatoi disa forma të veprimit policor në bashkësinë lokale. Operacionet policore ishin të dukshme (transparente) me çka u rrit përgjegjësia e policisë ndaj opinionit të gjerë; operacionet decentralizohen që të plotësohen nevojat e grupeve të ndryshme të njerëzve. Qytetarët tani më janë inkurajuar të ndërmarrin iniciativa për të penguar krimin dhe të bëhen partnerë me policinë, me çka do të përparohet raporti i policisë dhe i opinionit. Njohuritë e mbledhura, me ndihmën e anketave të realizuara në teren, nga fundi i viteve të tetëdhjeta ishin një test për teorinë e lidhjeve më të ngushta ndërmjet policisë dhe qytetarëve të asaj bashkësie, posaçërisht në formë të kontakteve “nga dera në derë” dhe patrullimet nëpër rrugë, bën që qytetarët të jenë të kënaqur me shërbimin policor, që përmirëson cilësinë e jetesës në komunitet dhe e zvogëlon frikën nga krimi.

Edhe policia edhe shkencëtarët gjerësisht e promovojnë idenë shumë tërheqëse për një përvojë më të madhe me komunitetin ose për pjesëmarrje të qytetarëve në vendimmarrjen e policisë, si qasje bashkëkohore të policisë publike. Por, ç’paraqet në fakt veprimtaria e policisë në bashkësinë lokale?

Veprimtaria e policisë e orientuar në bashkësinë lokale është:

- Filozofia kryesore, dhe jo një program statik.
- Filozofi, e cila i përgjigjet nevojave të bashkësisë lokale.

- Tipa të ndryshme të profesionalizimit në veprimtarinë policore.
- Ekzistojnë dy aktivitete themelore që janë të përbashkëta për të gjitha programet e policisë në bashkësinë lokale: këto programe vënë lidhje të fuqishme ndërmjet policisë dhe bashkësisë lokale, me të cilat koordinohet pushteti ekzekutiv me shërbimet e tjera që ndikojnë në cilësinë e jetesës së komunitetit dhe këto programe e rrisin aftësinë e pushtetit ekzekutiv (policisë dhe legjislacionit) të identifikojë, të analizojnë dhe t'u përgjigjet problemeve të bashkësisë lokale në mënyrë sistematike.

Veprimtaria e policisë në bashkësinë lokale premtan, sepse ajo ndërton raporte pune me qytetarët rezultatet e së cilës janë:

- Përmirësimi i veprimit të policisë;
- Përmirësimi i raporteve ndërmjet policisë dhe bashkësisë lokale;
- Zgjidhje e përbashkët e problemeve të cilat mund të identifikohen.

Veprimtaria policore në bashkësinë lokale mund të angazhohet më mirë për të zgjidhur problemet dhe interesat e komunitetit, sepse kjo është një qasje më aktive, e decentralizuar, me obligime të forta ndaj parandalimit të krimit, zvogëlimin e prishjes së rendit dhe të frikës së nga kriminaliteti. Kur një polic do të përfshihet në një bashkësi lokale, kjo shpie në mënyrë

afatgjate në një transparencë më të madhe policore dhe në një raport afatgjatë ndërmjet policit dhe bashkësisë lokale, me ç'rast zhvillohet mirëbesimi dhe bashkëpunimi ndërmjet banorëve.

Efektet e veprimit të policisë janë sa vijon:

- Rritje fillestare e paraqitjes së veprave penale;
- Zvogëlim i frikës nga krimi;
- Rritja e mirëbesimit të qytetarëve dhe të ndjenjës së aftësisë;
- Satisfaksion më i madh i punës së policisë ; dhe
- Zvogëlim i krimit të planifikuar.

Policia në bashkësinë lokale nuk i zgjidh të gjitha këto probleme dhe nuk është shkopi magjik për problemet e sotshme të policisë; por, ajo mund të jetë një hap për drejtim të mirë, dhe si duket është më mirë të vazhdojë rruga, se sa të pritet “zgjidhja përfundimtare”, teoria “finale” për veprimtarinë policore. Strategjia e orientimit në bashkësinë lokale e zgjeron përkufizimin e funksionit të policisë. Kjo përfshinë ruajtjen e rendit, zgjidhjen e konflikteve, zgjidhjen e problemeve dhe dhënien e shërbimeve, si dhe aktivitetet e tjera. Veprimtaria policore e orientuar drejt bashkësisë lokale dhe e shërbimeve qeveritare të orientuara, gjithashtu drejt bashkësisë lokale (të

decentralizuar) si duket është strategji premtuese për t'u marrë me nevojat për ndryshime të shpejta në shoqërinë bashkëkohore.

Dhe gjersa teoritë e ndryshme debatojnë rreth asaj se çdo të thotë “veprimtari policore në bashkësinë lokale”, esenca është pothuajse e qartë: policia në bashkësinë lokale është kryesisht një filozofi e re, dhe e vetme teknikë e re në punën e policisë. Policia dhe bashkësia lokale duhet të punojnë që sa më lehtë të detektojnë problemet në komunitetin e vet dhe për të gjetur zgjidhje për këto probleme.

Filozofia e re do të thotë ndryshim i tërësishëm në të menduarit, në të vepruarit dhe në strukturat e forcës policore.

Në partneritetet me agjencitë e tjera policia është përgjegjëse për rendin, qetësinë dhe sigurinë brenda në komunitet. Policia, përveç fushës së saj evidente të aktiviteteve, në masë të madhe mund të shërbejë si “detektor” i problemeve, sepse është në kontakt të përditshëm me shumë pjesë të popullsisë. Këto probleme mundet dhe duhet në mënyrë aktive dhe publike (ndoshta ndonjëherë edhe në mënyrë drastike) të delegohen dhe të përcillen në faktorë të tjerë në shtet dhe në shoqëri.

Në shoqëritë perëndimore, kjo mënyrë e ushtrimit të punës së policisë njihet si “Punë policore në komunitet” ose Community Policing.

2. PERSONELI

Për këtë filozofi të re novitet një model i ri i rrolit të policit. Deri sot, në shumë vende policët shpesh kujtonin se punën nuk e kanë aq të suksesshme dhe efikase, se është e padobishme dhe shumë burokratike.

Këtë ndjenjë shpesh e kanë edhe politikanët, ndërsa si rezultat i kësaj është mosbesimi dhe nevoja ekzistuese për një numër edhe më të madh të dispozitave konkrete për policinë. Ky mosbesim mbështetet në brengën se policia mund t'i keqpërdorë kompetencat e veta: kjo, në radhë të parë mbështetet në ndjenjën se, realisht, nuk dihet se çfarë punon ajo. Në realitet (këtë e mësojmë edhe nëpërmjet një numri të madh të studimeve empirike në shumë shtete të Evropës perëndimore), opinioni ka mendim më të mirë për policinë se sa supozohej nga vetë policia. Por edhe kjo ndjenjë që policia e ka për veten e vet dhe atë që ndonjëherë e shprehin politikanët dhe përfaqësuesit e tyre ndoshta janë si rezultat i “sindromës së tërheqjes” në kuadër të vetë policisë; sa më e madhe të jetë ndjenja se opinioni nuk është i kënaqur me shërbimet e saj, aq më shumë policia tërhiqet brenda vetes dhe fshihet pas dispozitave zyrtare ose pas aspekteve të tjera formale- ose thjesht, largohet në fusha të tjera private të aktiviteteve ose largohet nga puna, edhe pse ende është në detyrë. Ndonjëherë policët bien në gjendje të psikozës, e shprehin agresivitetin e vet në kontaktin e përditshëm me opinionin etj.

Gjithashtu policia shpesh herë vihet në rolin për t'u mbrojtur dhe të gjejë mënyra për tërheqje intelektuale. Por, polici me vetëbesim është më i hapur për kritikë, , me tepër është për një komunikim të sinqertë me njerëzit, duke mos fshehur informacionet dhe faktet. Ne na duhen policë të tillë me vetëbesim, të edukuar mirë, të cilët janë të aftë të komunikojnë me njerëzit, në vend se t'u japin atyre vetëm urdhra, pa ndonjë shkak të rëndësishëm.

Çka në fakt do të thotë efikasitet, sukses dhe profesionalizëm për policinë? Polici në patrullim, njeriu më i ulët në hierarkinë dhe shpesh i edukuar më dobët, i arsimuar dhe i paguar në pak - është në pozitë kyçe të shprehë sasi më të mëdha të vendimeve të lira në lidhje me fushën e aktiviteteve kriminale ose të aktiviteteve të mundshme kriminale. Ai (ose ajo), realisht, janë partneri më aktiv dhe më i dukshëm në interaksionin me opinionin dhe në komunikimin në kuadër të veprimtarisë policore. Nëse do të flisnim për reforma të policisë dhe të filozofisë policore duhet pasur në mend këtë fakt dhe ta nisim çdo reformë me reformimin e stërvitjeve të policisë.

3. SHOQËRIA

Bashkësia lokale në shoqërinë bashkëkohore është krejtësisht tjetër nga ç'ishte. Atë e konstituojnë institucionet burokratike dhe mediumet e tyre për komunikim. Këto institucione dhe medime në mënyrë fundamentale e

transformojnë bashkësinë lokale si komunikim që i përfshinë traditën, marrëdhëniet cilësore ndërkombëtare, rregullimin lokal të hapësirës etj. Në një të ardhme të afërt veprimtaria policore duhet të ballafaqohet me rritjen e protestave të grupeve të veçanta të interesit dhe me rritjen përkatëse të pa dëgjueshmërisë qytetare dhe të trazirave. Problemet e pazgjidhura, sikurse janë papunësia, varfëria, të pastrehët, do të ndikojnë për trazira shoqërore, me rritjen e frekuencës së krimit të ndërlidhur me pakicat, si në shtetet e Evropës perëndimore ashtu edhe në ato të Evropës Lindore.

Kriminaliteti, veçanërisht frika nga kriminaliteti, momentalisht paraqesin çështje shumë të rëndësishme në shumë vende të botës. Rritja e kërkesave për ndihmë ose për intervenim të policisë është nevojë që ende po rritet. Viktimat gjithnjë e më shumë janë të pa përgatitur dhe nuk janë në gjendje t'i ndihmojnë vetes. Autoriteteve zyrtare qendrore gjithnjë e më shumë u bëhet thirrje të pastrojnë dhe të zgjidhin këto gjendje. Por, mendimi i opinionit dhe i kontrollit jo formal shoqëror ka rrol qendror, jo vetëm për të definuar fenomenin ç'është kriminaliteti por edhe në ruajtjen e rendit shoqëror.

4. MENAXHIMI DHE STRUKTURA E FORCAVE POLICORE

Fjalët kryesore që i adresohen policisë janë fleksibiliteti, ndarja e pushtetit, përgjegjësia autonome ekipore dhe regjionale. Policët në të ardhmen duhet të jenë pjesëmarrës aktiv në zgjidhjen e problemeve, veçanërisht kur eprorët do t'u japin liritë e domosdoshme të vendimmarrjes, të inkurajimit dhe të mundësive të tjera. Njësitet e vogla punuese, qarkullimi i lirë i informacioneve, bashkëpunimi me institucionet private të sigurisë, si dhe me ndërmarrje të tjera private gjatë adresimit në polici (së bashku për shembull: me libraritë, supermarketët ose stacionet e benzinës) janë gjithnjë disa fjalë kyçe, me çka kontestohet (mohohet) struktura e mëparshme militariste, burokratike e policisë dhe pikëpamjet e vjetra konvencionale për përfaqësuesit policor dhe për politikanët. Termat, sikurse janë *hapësira mbrojtëse* dhe *lufta kundër krimit* shkojnë në favor të përshtypjes se krimi dhe siguria, pasiguria publike janë si rezultat i konflikteve militariste të armatosura, të cilat duhet të zgjidhen vetëm me armë dhe me forcë. Veprimtaria policore në bashkësinë lokale e përfshinë këtë aspekt të “veprimtarisë racionale policore”, ndërsa “veprimtaria racionale policore” do të thotë vlerësim i aftësive organizative të shërbimit, identifikim të çështjeve kritike, kërcënimeve dhe situatave, ashtu që të bëhet vlerësimi i mjedisit të tashëm dhe atij të ardhshëm, në të cilin funksionon policia.

Suksesi duhet të matet me vlera publike, të cilat do ti prodhonte polica, por jo me procedurat për zgjidhjen e lëndëve, me numrin e kriminelëve të dënuar etj. Aktiviteti policor duhet të jetë një luftë politike aktive. Policia nuk duhet të presë që politikanët të vendosin se ç'duhet bërë sepse paraqiten disa probleme të veçanta (të cilat shpesh janë kalimtare); ajo duhet t'i qaset opinionit dhe t'u shërbejë nevojave të tij.

5. STËRVITJET

Policët me kualifikime arsimore të larta dhe personeli i edukuar mirë nuk garanton në vetvete bashkëpunim dhe komunikim më të mirë, por stërvitjet dhe arsimimi janë faktorë sine qua non në rrugën drejt cilësisë së punës policore. Sepse policët me arsim të lartë mund të bëhen të frustruar në këtë punë, të jenë cinik dhe të kërkojnë zgjidhje formale dhe jo formale. Ndryshimet duhet të bëhen jo vetëm gjatë regrutimit, të zgjedhjes dhe të programit të stërvitjeve, por edhe në mjedisin organizativ. Në të kundërtën personeli i ri do të ketë gjasa të vogla të mbijetojë në organizatë. Presionet për barazi janë aq të forta, sa që polici i ri është i detyruar ose të jetë pjesë e subkulturës policore, duke i zëvendësuar vlerat personale dhe orientimin me ato të grupit të madh, ose do të vendosë të largohet nga detyra. Policia sot është aq mirë e stërvitur, si asnjë herë tjetër, ndërsa cilësia e stërvitjes me siguri nuk ka qenë më e madhe. Edhe përkundër

këtij fakti se raporti pozitiv ndërmjet stërvitjes dhe presionit është evident, ky efekt nuk është studiuar sa duhet. Dobia që institucionet e kanë nga stërvitjet rëndom vetëm supozohet si një funksion i rëndësishëm ligjor për drejtorinë kryesore, se sa duket kjo në mënyrë empirike, ndërsa studimet empirike janë orientuar, në radhë të parë, rreth qëndrimeve të policisë, se sa në sjelljen e saj të vërtetë. Një studim i paradokohshëm tregon se ndikimi i stërvitjeve varet nga pikëpamjet e niveleve organizuese. Stërvitjet kanë efekt të rëndësishëm pozitiv në ato mjedise që japin përkrahje, por nuk kanë efekt në mjediset që janë indiferent ose kanë qëndrim armiqësor ndaj qëllimeve për të cilat janë stërvitur policët. Efekti i stërvitjeve varet nga mundësitë që i ofron institucioni për zbatimin e tyre, nga drejtuesi i cili e inkurajon të stërviturin dhe qëllimet e tij dhe nga gjasat relevante të përparimit në karrierë. Filozofia e të urdhëruarit “dil përjashta dhe shih mos biesh në ndonjë vështirësi” nuk është e mirë për inkurajim të policit të stërvitur mirë dhe të edukuar mirë (kurrsesi nuk është mirë). Ajo që është e domosdoshme është vlerësimi institucional dhe personal (nga ana e drejtuesve) që duhet të bëhet për një aktivitet të caktuar. Mbikëqyrësi duhet “të jetojë” me faktin se ç’dëshiron t’i ndodhë këtij ose asaj personi.

6. POLICIA NË BASHKËSIONË LOKALE, SI FORMË E RE E DEMOKRATIZIMIT TË FUNKSIONIT TË POLICISË

Parandalimi i kriminalitetit në bashkësinë lokale dhe veprimtaria e policisë në bashkësinë lokale janë reformat themelore në parandalimin e kriminalitetit, të zhvilluar gjatë viteve të fundit. Të dyja kanë implikime në menaxhimin policor dhe në filozofinë e veprimit policor. Gjersa reforma është orientuar ndaj kriminalitetit dhe ndaj rendit publik, duke theksuar marrëdhëniet ndërmjet policisë dhe bashkësisë lokale vihet një sublimim i qartë e vlerave në kudër të organizimit të policisë dhe të pikëpamjes se parandalimi i kriminalitetit është detyrë e të gjithë anëtarëve të bashkësisë.

Policia në bashkësinë lokale është një qasje e gjithanshme që kultivon pikëpamjen multikauzale të kriminalitetit dhe qasje multidimensionale për parandalimin e kriminalitetit.

Veprimtaria e policisë që është orientuar drejt problemeve, është veprimtari ekipore, dhe në fund policia në bashkësinë lokale ka ndryshuar , ndryshime këto që shprehen edhe në filozofinë e veprimtarisë policore gjatë viteve të fundit. Ky ndryshim është sprove jashtëzakonisht e madhe për sistemin e brendshëm të policisë, sepse strukturat kryesore të menaxhimit, si dhe strukturat dhe format e organizimit, duhet të ndryshojnë. Kjo përfshinë edhe ndryshimet në qëndrime, organizim dhe subkulturë. Fjalët

kryesore janë pjesëmarrje, decentralizim, motivim për punë të përbashkët me komunitetin në zgjidhjen e problemeve të kriminalitetit dhe të anomalive shoqërore që lidhen me të.

Zhvillimet në shërbim, i cili gjithnjë e më shumë u shërben qytetarëve dhe orientohet në raportet më të afërta me komunitetin, duhet të jenë reale, dhe jo sipërfaqësore, dhe prandaj kërkojnë ndryshime esenciale në filozofinë, radhitjen e përparësive dhe ristrukturim potencial masiv të organizatës policore.

Duhet të ekzistojë një koordinim më i madh i policisë me organet e tjera në kuadër të sistemit juridik penal, me ç'rast do të rritej dobia e klientit dhe do të thyhej izolimi i policisë. Ndryshimi organizativ do të shkojë në hierarkinë më të ulët, më pak të specializuar një koordinim më të mirë të punës policore. Domosdo mënjanohet hendeku ndërmjet policisë dhe segmenteve shumë armiqësore të opinionit, që është proces i cili mund të lehtësohet me krijimin e seksioneve për marrëdhënie me komunitetin në stacionin e policisë. Por policia në bashkësinë lokale nuk është diçka që mund t'i lehet vetëm disa policëve ose disa seksioneve. Nga njohuritë empirike të huaja, kemi kuptuar se policia në bashkësitë lokale punon në kuadër të policisë, ku të gjithë policët qëndrojnë pas filozofisë së re, dhe jo në kuadër të policisë ku vetë disa persona profesional të veçantë kërkohet të merren me policinë në bashkësinë lokale, ndërsa pjesëtarët tjerë “të kryejnë punën ashtu si zakonisht”.

Me organizimin e policisë në polici, e cila do të jetë e orientuar kah komuniteti, decentralizimi dhe organizimi i pavarur me udhëheqësi e cila merr pjesë aktivisht, mund të fitojë edhe klientë të kënaqur edhe të punësuar të kënaqur. Por, policia duhet të angazhohet për proceset në bashkësinë lokale, të cilat kanë të bëjnë edhe me krijimin mbrojtjes së kapitalit lokal, human dhe të përbashkët. Mënyra e vetme që të merret me interes publik është që të zhvillohet programi sipas fushave të veçanta dhe specifike. Nuk mund të supozojmë se çdo bashkësi lokale ka të njëjtat probleme, ose çdo bashkësi lokale duhet t'u përgjigjet në të njëjtën mënyrë të gjitha problemeve. Sistemi i hapur i veprimit policor do të gjejë zgjidhje sipas masës së mjedisit të vogël ose të fqinjëve- në kuadër të institucionit që vepron ose sillet si institucion që përpiket të mësojë.

Ekzistojnë disa forma të përkufizimit të veprimtarisë policore në bashkësinë lokale. Të rëndësishme janë karakteristikat sa vijojnë:

- problemet duhet të zgjidhen atje ku paraqiten me qasje lokale;
- problemet duhet të zgjidhen me mjete kreative dhe me masa jo konvencionale, ku kjo është e mundshme- qasje kreative;
- problemet duhet të zgjidhen duke analizuar faktorët struktural, dhe jo duke u mbështetur në shpjegimin

individual. Shqyrtimi i të gjithë faktorëve dhe mjeteve disponuese për krijimin e sigurisë, dhe jo vetëm të atyre që kanë të bëjnë me punën tradicionale policore - qasje strukturale: veprimtari policore e orientuar drejt problemeve;

- problemet duhet të shqyrtohen nga aspekte të ndryshme; dhe jo vetëm nga pikëpamja e luftës kundër kriminalitetit dhe qasjes represive . Mjetet të cilat kanë orientim drejt sigurisë; krijimi i bashkësisë të sigurt konsiderohet si më i rëndësishëm se sa kontrolli i kriminalitetit ose duke iu përmbajtur normave -qasje multifaktore.
- problemet duhet të zgjidhen së bashku me të tjerët; policia duhet të bashkëpunojë me të gjithë individët, institucionet dhe grupet në bashkësinë lokale (përfshirë edhe shërbimet e sigurimit privat); policia nuk duhet të jetë përgjegjëse për zgjidhjen e ndonjë problemi ku kompetentë janë organizata të tjera ose nga ata që kanë mjete më të mira. Përpunimi i gjerë strategjik me autoritetet e tjera u është i nevojshëm komuniteteve dhe njerëzve- qasje në ndarje të punës.
- policia duhet të shihet si pjesë e komunitetit- qasje kooperimi;
- policia ndërmerr iniciativën dhe nuk kufizohet vetëm me masa thjeshtë reaktive, pasi të jetë kryer vepra penale , ose pasi është marr thirrje për ndihmë - qasje aktive;

- orientimi i policisë duhet të decentralizohet - qasje e decentralizuar;
- karakteristikat të përcaktohen në ecje- qasje “puna në rrjedhë”.

Pasi kompleksi i punës, jo vetëm që rritet por edhe ndryshon me kalimin e kohës, puna e policisë dhe stërvitjet e tyre duhet të bëhen në lëvizje. Përmbajtja dhe qëllimet duhet të përcaktohen dhe t’i përshtaten rrethanave dhe prioriteteve të reja. Rritja e vëllimit të punës dhe kompleksi që imponohet tek organet e policisë dhe restriksionet e buxhetit nga ana e pushtetit kërkojnë shfrytëzim optimal të mjeteve të limituara. Si rezultat i kësaj, është e nevojshme që anëtarët më të vjetër të policisë në nivele të ndryshme të përvetësojnë shkathtësitë bashkëkohore dhe teknikat e menaxhimit, që në mënyrë sa më efektive të drejtojnë organizatën e tyre. Ato së paku duhet t’i kuptojnë mirë këto teknika dhe shkathtësi. Aftësia e komunikimit për zgjidhje të problemeve kanë rëndësi të barabartë, si dhe njohja e shkencave juridike, shoqërore dhe politike. Ekziston nevoja për zhvillimin e organizimit dhe të procedurave, dhe të verifikohet misioni dhe qëllimet përballë realiteti të përditshëm, rutina dhe ndryshimet shoqërore-ekonomike në shoqëri, të cilës duhet t’i shërbejë ky institucion. Shumë organe të policisë, në esencë, janë burokratike të cilat funksionojnë në nivelin organizativ. Vetëm disa prej tyre

janë në thelb organizata statike, të cilat punojnë sipas inercisë strukturore dhe me pak aftësi menaxhimi. Të tjerët vuajnë nga pesha organizative. Reforma policore domosdo të sigurojë mjete dhe njohuri që të thyhet ky qark i burokracisë. Këmbimi i informatave dhe i përvojave ndërmjet institucioneve policore anë e mbanë botës do të mund t'u ndihmonte proceseve të transformimit në organizatat e ndryshme policore. Çdokush nga secili mund të mësojë diçka. Aktivitetet e ndryshme të institucioneve evropiane, sikurse janë Këshilli i Evropës, Bashkimi evropian, Evropoli, Interpoli, ose Shoqata e kolegjeve policore evropiane duhet të koordinohen më mirë se sa ka shkuar deri më sot.

Pasi “kultura e policit” dhe “kultura e policisë” nuk janë të njëjta, drejtuesit e policisë dhe të politikanëve duhet të dinë të dallojnë kulturën individuale të anëtarëve të institucionit dhe të “kulturës “oficiale” të institucionit. Ndryshimet në “kulturën policore” (si dhe të veprimit të policisë në bashkësinë lokale) do të jenë të padobishme nëse mbetet po ajo “kulturë e policit” ose ndoshta edhe e kundërta me kulturën e policisë në bashkësinë lokale, që është orientuar drejt komunitetit.

Të përfundojmë: reforma e stërvitjes, e cila siguron vetëm aletin, pa filozofinë e domosdoshme dhe të kuptuarit e rrolit të vet policit, si pjesë integrale e komunitetit, jo vetëm që është e pavlefshme por është edhe e rrezikshme për shoqërinë.

Pyetje për studentët:

- 1. Në çka është orientuar veprimtaria e policisë në bashkësinë lokale?***
- 2. Cilët janë efektet e veprimtarisë policore në bashkësinë lokale?***
- 3. Si duhet të duket bashkësia lokale në shoqërinë bashkëkohore?***
- 4. Si duhet drejtuar policinë lokale?***
- 5. Në çka duhet të orientohet stërvitja e policëve në bashkësinë lokale?***
- 6. Defino karakteristikat e veprimtarisë policore në bashkësinë lokale?***

Literatura

1. 69 th General Assambly Session of ICPO- INTERPOL. EXHIBICION & ASSAMBLY EVENT GUIDE. 2000
2. Angeleski M. 1993: Kriminalistika (teoria e përgjithshme kriminalistike) OGB Stidenski Zbor, Shkup.
3. Angeleski M.1994: Qasja kriminalistike gjatë zvilimit të krimit ekonomik, Almanah i fakultetit të Sigurisë, Shkup.
4. Angeleski M. 2003. Taktika kriminalistike, Shkup
5. Angeleski M. 2005 Kriminalistika operative, Shkup.
6. Arnaudovski L. 1997: Kriminalizimi i politikës dhe politizimi i krimit, Bezbednost, nr.3, Shkup
7. Arnaudovski L, Angeleski M dhe Çoneva L, 1996: Prostitucioni në Maqedoni .Shkup
8. Arnaudovski L 1993: për (in) kopatibilitetin të disa metodave policore në zbulimin e kriminalitetit me postulatet themelore të shetit juridik, Bezbednost, numër i çrregullt Shkup
9. Aleksovski S, 2005: Psikologjia me psikologjinë kriminalistike, Shkup.
10. Baçanoviq O, 1997: Policia dhe viktimat.
11. Banoviq B. 2002: Sigurimi i provave në përpunimin kriminalistik të veprave penale të krimit ekonomik, Beograd.
- 12.Bechthold, Stefan: Multimedia und Urheberrecht- einige grundsatzliche Anmerkungen, in : GRUR 1998, 18.
- 13.Belkin R. S. Kriminalistika: probleme, tendenca, perspektiva. Mbi teorinë dhe praktikën. 1998
- 14.Belkin R.S. Očerki kriminalističeskie taktiki: tekst shkollor, Volgograd, 1993.
- 15.Bobev, K. 2001: Kriminalistika, Sofje

- 16.Boshković M.2003: krimi i organizuar transnacional, Beograd
- 17.Boshković .M: 2004: Metodika e zbulimit dhe e dëshmimit të veprave penale të korrupsionit, Bezbednost, nr.1 Beograd.
- 18.Buntasheski B. 1997: Psikologjia për doganierë, Ohër.
- 19.Buntasheski B. 1995: Psikologjia e turizmit dhe e hotelierisë, Ohër.
- 20.Buxhakozki S. 2002: Parandalimi i keqpërdorimit të drogës, Ohër.
- 21.cerović D. 1991: E drejta e autorit, Teknika, Beograd.
- 22.Commission of the European Communities, Green paper, Brussels, 15/10/98, COM (98) 569 final.
- 23.Davies, Gilian? Hung, Michele E: Music and video private copying, Oxsford, 1993.
- 24.Dvorsek A. 2001 : Strategjia kriminalistike , Lubjanë.
- 25.De Boer M. 2000: Problemet me provat në rastet së drejtës së pronës intelektuale, posaçërisht të të drejtave të muzikantëve dhe pirateria, Fare programi për pronën intelektuale, Shkup.
- 26.Qosiq M. 1970: Përpunimi kriminalistik i veprave penale të tregtisë informate, Beograd.
- 27.Fjulishenko, A. A: lënda dhe përmbajtja e taktikës kriminalistike (probleme teroike të taktikës 31. Enshaler, Jurgen: Produktpirateriegesetz, GRUR, 1992, 273
- 28.Enshaler, Jurgen: Produktpirateriegesetz, GRUR, 1992, 273
- 29.Fjulishenko, A. A: lënda dhe përmbajtja e taktikës kriminalistike (probleme teroike të taktikës kriminalistike)Sverdlosk, 1981.
- 30.Frleta S. 1970: Ç‘duhet ditur mbi shërbimin e doganave ? Beograd

- 31.Funk, R: The histori of the CD-ROM in: Sherman Ciris (Hrstd): CD-ROM Handbook, 2, Aufl, Nevv York 1994, s 222
- 32.Geiiier P.E. 1989: Copuright protection in the Berne Union: Analizing the issues@, Intellektual Property, Jorunal 5, 1-50.
- 33.Geller P. E (1990):” Can dhe GATT inkorporate Berne vvhole? European Intellectual Property Revien, 11, 423-428
- 34.Georgievski S, 1969: Bazat e së drejtës së autorit, Universiteti “Kirili dhe metodi” Shkup
- 35.Globerman S. & Rothman M. P (1981) : “An economic analysis of a performers’ rigat”, Otavva: Minister of supply and Services Canada.
- 36.Gonçarenko V. I, Taktika psikologičnogo vplivi na poperednjomy slidstvi: Navçaljnii posibnik, Kiev, 1994.
- 37.Hamond G (1H991): “The legal protection of ideal. # Osgoode Hall Lavv Journal, 29 (1) 93-125.
- 38.Heike Gramckovv “ Joan Jacoby: Communitu Policing: A model for lokal Governments D. Dolling, Th, Feltes (Hrsg), Communitu Policing. Comparative Aspekts of Communitu Orientet Police VVork.Hp;ykrichen (felix)
- 39.IFPI, 2001: Music Industry and Organised Crime.
- 40.IFPI, 2002: Music Piracy, Organised Crime and Terrorism.
- 41.Jakovleviq, V, dhe Jelaçiq M, 1988: Problematika e eliminimit të kriminalitetit në mardhëdhëniet ekonomike me botën e jashtme, RSUPS, Beograd.
- 42.jankovsky, Thomas: Vvirtshaftskriminalitat, 4. Aufl. Munchen,1997.
- 43.Josipoviq, Ivo: Lufta kundër piratisë audio dhe vizuale (Doracak,) Zagreb 1998.

- 44.Jovi, M: 1998: personi kriminal (janë të lindur ose formohen më vonë) Lekovc.
- 45.Kanevçev M: 2000: Praktikumi i së dejtës penale (pjesë e përgjithshme), Shkup
- 46.Kambovski V, 1982: E drejta penale (pjesë e veçantë) Shkup
- 47.Kambovski V, 2005: Krimi i organizuar, Shkup
- 48.Krstiq O, 2003: Prognozimi i kriminalitetit, Beograd
- 49.Krstiq, O 2002: Praktikumi për kriminalistikë-taktikë,
- 50.Krstiq, O 1996: Simbolet, shenjat dhe domethëniet në kriminalistikë, Beograd
- 51.Krapac D, 1982: Provat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta në procedurën penale, Zagreb.
- 52.Kriminalistisches Institut, 1999: Elektronik Commerce, Markt der Zukunft-auch fur Kriminelle? VViesbaden
- 53.Krlev T, 2007: Kriminalistika (kurs leksikoni)Shkup
- 54.Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, 1996, Shkup
- 55.Kikerkov I, 1998: Investime e huaja të drejtpërdrejta në vendet e tranzicionit, me theks të veçantë ndaj gjendjeve në Republikën e Maqedonisë, Shkup.
- 56.Krivokapiq, V, 2005: Kriminalistika-taktika, Beograd.
- 57.Krivokapiq, V, 2002: Parandalimi i kriminalitetit, Beograd.
- 58.Laboviq M, 2005: Pushtiti të korrupton, Shkup.
- 59.Lajiq O, 2004: Pozita dhe roli i policisë në procedurën para penale ose pas penale, Bezbednost, nr.1. Beograd
- 60.Matovski N. 2003: E drejta penale procesore (pjesa përgjithshme). Shkup
- 61.Marjanoviq Gj, 1988: E drejta penale, Shkup
- 62.Markoviq S, 1992: Bazat e së drejtës së autorit, Naučna Kniga Beograd

- 63.Matijeviq M, 1999: Planifikimi dhe parandalimi i versioneve kriminalistike në punën operative (punë magjistrimi) Fakulteti i sigurisë, Shkup.
- 64.Matijeviq M, 2002: Kriminalistika- operativa, Banja Llukë.
- 65.Manev P, 2005: Leksikoni i së drejtës ndëshkimore, Shkup
- 66.Milosheviq, n Milojeviq S , 2001: Bazat e metodologjise së shkencës së sigurisë, Beograd.
- 67.Milosheviq M , 2005: Organizimi dhe funksionimi i policisë në procedurën penale, Beograd.
- 68.Milutinoviq M, 1981: Kriminologjia, Beograd.
- 69.Milovanoviq M, 1982: Mjueksia ligjore, Zagreb.
- 70.Milkovski L, 1993: Rëndësia dhe shfrytëzimi i institutit të informatës, informatorit dhe raportuesit të fshehtë policor”, Bezbednost, numër i çrregullt, shkurt Murgoski B, 2003: Policia dhe siguria në komunikacionin rrugor (disertacion doktore), fakulteti i sigurisë Shkup
- 71.Muhamet R, Aleksandar D. Armatimi dhe lenda për qitje. Shkup 2009.
- 72.Muhamet R, Aleksandar D. Bazat e topograisë dhe taktika detektive në kushtet naturore. Shkup 2010.
- 73.Muraatbegoviq, E: 2004: Frika nga kriminaliteti –shqyrtim kriminologjik”, Buletin i titulluar si Eliminimi i kriminalitetit- një dekadë më vonë pas vdekjes së profesor Vodineliqitm Kragujevs, 2004
- 74.Novotni L, 1990: Psikiatria gjyqësore, Shkup
- 75.Mitriçev, S.P, 1973: Kriminalistika: tekst shkollor, botimi 2. Ohër
- 76.Oven L, 2000: Shitja e të drejtës, Shkup
- 77.Evidenca operative e arkivit të DQMB- Shkup
- 78.Evidenca operative e arkivit të MPB të RM

79. Peçar, J, 1998: “Mjetet e posaçme dhe metodat e pengimit të krimit (aspekte të observimit)”, Bezbednost, nr=3, Shkup
80. Peroviq, K, 1989: Falsifikimi i dokumentave, Nikshiq
81. Petroviq, A, 1978: Metodika kriminalistike, Beograd.
82. Popova I, 1997: Avtorskoe pravo i smežnie pravo, Amalfen, Minsk
83. Proevski J, 1998: Kodi penal, Akademik Shkup
84. Roso, Z, 1988: Biseda informative dhe intervista, Zagreb
85. Stojanovski D, 2004: Falsifikimi i dokumentave, Shkup
86. Skopti, XH, A, 2004: Mbrojtja e funksionarëve dhe terrorizmi ndërkombëtar, Shkup
87. Stojanovski T, 1992: Taktika policore (doracak) Shkup
88. Stojçev V, 2004: Metodologjia e shkencave ushtarake, Shkup
89. Stajiq, L, 2004: Bazat e sigurisë, Beograd
90. Sivriev, I dhe nestorov D, 1998: Ekspertiza kriminalistike i kompakt disqeve jo legjitime, Referat i prezantuar në Seminarin e luftës kundër piraterisë në industrinë fonograme, Ohër.
91. Simiq M, 2004: Krimi i organizuar dhe masat për eliminimin e tij, Bezbednost, nr.1 Beograd
92. Skalov A, 1998: Potencialet e doganës për lutë kundër piraterisë muzikore, Referat prezantuar në Seminarin e luftës kundër piraterisë në industrinë fonografike, Ohër.
93. Skënder B, 2001: Kriminalistika, Tiranë.
94. Spaiq, V, 1983: Teoria e së drejtës së autorit dhe e drejta e autorit në RSFJ, Fakulteti Juridik Zagreb
95. Sapeski, j Aslimoski P, 2000: Siguria, Mbrojtja, Paqesja, Ohër
96. Sapeski j, 2005: Maqedonia- shtyllë e sigurisë dhe paqes në Ballkan, Akademik, Shkup

97. Spaseski J, 1983: Realizimi i vetëmbrojtjes shoqërore si instrument efikas në zbulimin e veprave penale dhe të aktorëve të tyre, Fakulteti Juridik Shkup.
98. Szadoska, Malish M, 2004: Policia kriminale dhe kriminaliteti ekologjik, Shkup
99. Szadoska, Malish M, 2005: Doracak rreth ciklit të zbulimit, Shkup
100. Stojanov I, 1989: I dëmtuari si akuzues, Shkup
101. Simonocviq B, 2004: Kriminalistika, Kragujevc
102. Sulejmanov Z dhe Pivovarov V, 2004: E drejta penale procesore, Shkup
103. Nedzad K, Driton M, 2009: Kriminalistika, Prishtinë.
104. Nikolovska S, 2005: Kriminaliteti i tëmiturve në Republikën e Maqedonisë, Shkup.
105. The Fight Against Sound and Audiovisual piracy: handbook paperback/Published, 1995.
106. Traub, David C: A Historikal perspective of SD-ROM , In: Sherman , Chris (Hrsg)
107. Tomas, Feltes: Theories of community policing? VVhat vv need is a nevv philosophy of policing.
108. Truhçev K, 1998: Lufta kundër piraterisë intelektuale dhe bashkëpunimi ndërmjet bartësve të së drejtë sdhe institucioneve, përgjegjës për mbrojtjen e së drejtës së pornës intelektuale, Referat i prezantuar në Seminarin e luftës kundër piraterisë në industrinë fonografike, Ohër.
109. Tupançevski N, 1995: marrja kundërligjore e trollit në pronën shoqërore (punim magjistrimi) Shkup.
110. Taseva, S, 1995: Nuri i errët i kriminalitetit, Koçan
111. Taseva, S. 2003: Larja e parave, Shkup
112. Vesel L, 2004: Kriminalistik, Prishtinë.

113. Vodinelij V, 1993: Problematika e institutit kriminalistik-taktik- informat, informator dhe mbikqyrqës i fshehtë policor në shtetet demokratike, Bezbednost, numër i çrregullt, Shkup
114. Vodinelij V, 1978: Kriminalistika, Beograd
115. Vodinelij V, 1985: Kriminalistika (zbulimi dhe dëshmimi- vëllimi i parë) Shkup
116. Vodinelij V, 1995: Taktika kriminalistike, Shkup
117. Voelkel Frank: Brentrick in: PC profesionel PC Nr. 5/1998, S.165
118. Volk, Klaus: Kriminologische aspects of copurighte legislation in Canada: Economic analysis of policy optons
119. VVild, Christoph : tendenzen in der Videonutzung, in: media Perspektiven, 1991, S, 819
120. Witvvaler, benhard: Produktion von Multimedia und Unheberrecht aus schvvajcerische Sicht, in: UFITA nr. 128(95)
121. Volfhard E. 1991: Internacional trade in intelektual property: The emerging GATT regime. Univertsity of Toronto Faculty of Lavv Reviev, 49 (1), 106-151.
122. Xhukleski G, 1995: Kontolli dhe përpunimi kriminalistik i veprës penale-fsheje tatimi, Siguri, Shkup
123. Xhukleski G, 2001: Format dhe metodat e larjes së parave në Republikën e Maqedonisë Buletin i Fakultetit të Sigurisë, Shkup
124. Xhukleski G, 2002: Format më të shpeshta të kontrabandës së mallrave në vendet ballkanike, Buletin i Fakultetit të Sigurisë, Shkup
125. Xhukleski G, 1998: Mënyrat taktike- elementet e taktikës kriminalistike, Bezbednost, nr.3 Shkup

126. Xhukleski G, 2004: Ekspertiza kriminalistike i kompakt disqeve jo legale, bezbednost, Beograd.
127. Xhukleski G, 2004: Pirateria muzikore si element i krimit të organizuar, Eliminimi i kriminalitetit- një dekadë pas vdekjes së profesorit Vodinelic, Beograd, Zemun, Kragujevc.
128. Xhukleski G, 2004: Pirateria Muzikore, Shkup
129. Xhukleski G, 2005: Doracak për rrjetin e bashkëpunëtorëve, Shkup.
130. Ligji i të drejtës së autorëve dhe familjare (gz, zyrtare e RM) Shkup, nr 47/96).
131. Ligji i procedurës penale (gazeta zyrtare e Rm n nr 10/2005)
132. Zikov S, 1998: Procedura penale në rastë abuzimi të së drejtës së autorit dhe asaj familjare nga aspekti i veprimit të prokurorisë publike. Ohër
133. Sipf, Heinz: Kriminalpolitik, 2 Aufl, Heilbelberg, 1980
134. Kushtetuta e RM (Gazeta zyrtare e RM- nr 52, 91).

FALEMINDERIM



E faleminderojmë firmën “7.VËLLEZËRIT” nga Shkupi për spnzorimin e botimit të librit.